

ZGJIDHJE



Një tjetër e ardhme

Xhabir M. Deralla

Zgjidhje – Kulturë Politike dhe Dialog është projekt kompleks i cili përfshin ngritjen e vetëdijes publike, edukim dhe aksione lehtësuese për fillimin e ndryshimeve pozitive në vend. Projekti ka hyrë në vitin e dytë të implementimit, ndërsa ideja e tij boshte u bë pjesë e strategjisë afatgjate të CIVIL-it. Ai kontribuon për zhvillimin e kulturës politike dhe rikthimin e dialogut në domenin e jetës politike, të marrëdhënieve inter-etnike dhe intra-etnike.

Tentojmë të prekim larg në të ardhmen me këtë projekt. Në një tjetër të ardhme nga ajo që realiteti na e ofron sot... Një e ardhme të cilën duhet krijuar menjëherë.

Ne kërkojmë dhe angazhohemi për ndryshime në mënyrë konstruktive, duke parash-truar shembuj pozitivë në shoqëri dhe duke i dokumentuar këto ndryshime. Kësaj sho-qërie në mënyrë emergjente i nevojitet përforsim i kapaciteteve të aktorëve politikë dhe shoqërorë; na nevojitet participim i vërtetë i qytetarit në proceset e vendimmarrjes dhe në politikë. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut tani është e domosdoshme më shumë se kurdoherë në historinë dydekadëshe të Republikës së Maqedonisë.

Ky projekt dhe ky publikim paraqesin tentim të drejtpërdrejtë që të kultivohen qasjet konstruktive të aktorëve dhe bartin një porosi të fuqishme me qëllim që t'i kthejnë drejtësinë, korrektësinë dhe pjekurinë politike në skenën shoqërore. Ato e hedhin poshtë gjuhën e urrejtjes dhe i inkurajojnë mendimin e lirë dhe kërkesat për të drejta dhe liri të njeriut në të gjitha nivelet.

*

Pozicioni fillestar teorik i projektit dhe i revistës Zgjidhje përfshin bindjen se kultura politike paraqet sistem të vlerave, qëndrimeve, bindjeve dhe synimeve që i konstituojnë orientimet specifike drejt shoqërisë në përgjithësi dhe politikës konkretisht. Kultura politike e begatë me sensibilitet të lartë për vlerat njerëzore dhe e hapur për dialog është kulturë dinamike proceset e së cilës në kontinuitet ofrojnë laramani të ideve, qëndrimeve dhe koncepteve, shpesh të kundërvëna, por marrë në përgjithësi, konstituojnë shoqëri me prosperitet dhe të njerëzishme; një ind tejet dinamik shoqëror që mund të shërbejë si bazë për demokraci dhe respektim të të drejtave dhe lirive për të gjithë.

Kultura politike dhe dialogu në Maqedoni janë në formë të mjerueshme dhe vazhdimisht keqësohen. Manifestimi verbal dhe nganjëherë, fizik i armiqësisë, tensionet dhe akuzat e ndërsjella ndërmjet partive politike e ndjekin dhe e ushqejnë polarizimin politik dita ditës. Rrjedhimisht, aktivitetet politike gjithnjë e më shumë fokusohen në diskreditimin e oponentëve politikë, përmes fushatave vulgare dhe negative, njëri kundër tjetrit. Partia politike në pushtet prin me fushatat negative, duke i kombinuar praktikat e veta me mbjelljen e frikës, pasigurisë dhe tensioneve ndërmjet njerëzve. Këto praktika rezultuan me krizë serioze politike dhe me suspendim të institucioneve

dhe proceseve vitale demokratike. Zgjedhjet e parakohshme pritet të shpallen në çdo moment në ditët kur po i finalizojmë përgatitjet për këtë revistë.

Marrëdhëniet inter-etnike përjetuan dëme serioze. Problemet që dalin nga politikat joefikase dhe nga pakënaqësia nga gjendja aktuale zakonisht divertohehen përmes nxitjes së urrejtjes ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike në vend, maqedonasve dhe shqiptarëve. Një seri incidentesh, përfshirë dhunën fizike, ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë, i rrezikuan marrëdhëniet ndëretnike, i ngrinin apo (më saktë) i disavancuan proceset e pajtimit dhe integritit. Si pasojë, diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut dhe minoritare u ngrit në nivele insitucionale, madje edhe pa arritur ndonjë kualitet të ndjeshëm.

Një nga arsyt kryesore për rrezikimin e marrëdhënieve inter-etnike janë pikërisht praktikatat e partive politike. Kjo situatë ndikonte edhe mbi raportet intra-etnike. Akuzat ndaj kundërshtarëve politikë për tardhti u bënë mënyrë e zakonshme e komunikimit të qëndrimeve politike në publik, në kuadër të bllokut politik të një etniteti, ndërsa retorika nacionaliste është bërthama e sjelljes politike ndërmjet përfaqësuesve politikë të etniteteve të ndryshme. Njëra e keqe e ushqen tjetrën.

Kjo situatë i afekton marrëdhëniet inter-personale ndërmjet qytetarëve. Përkatësia partiake u bë domosdoshmëri. Vrapimi pas vendeve të punës, madje edhe vizita kafeterive me miqtë varet nga posedimi i teseres partiake. Njerëzit urrejnë njëri-tjetrin varësisht nga këto përkatësi. Të gjithë ata, në fund, besojnë se pikërisht partia e tyre është ajo që do t'i zgjidhë të gjitha problemet dhe kërcënimet që vijnë nga bashkësitë "tjera" etnike.

Nuk është rëndë fare të vihet në përfundim se këto dhe praktikatat e këtilla çojnë drejt refuzimit të institucioneve demokratike dhe seriozisht e rrezikojnë zhvillimin e vendit në tërësi.

*

Njerëzit janë të demoralizuar dhe të trembur për ardhmërinë e tyre. Ushtarët partiakë patrollojnë nëpër jetët e tyre. Varfëria zuri vend në shumë shtëpi dhe vazhdon të rritet. Urrejtja mbillet për ta fshehur paditurinë, arrogancën dhe plaçkitjen në kuptimin e shumëfishtë të fjalës.

*

Sektori i shoqërisë qytetare, gjithashtu, u bë tejet i komprometuar nga ndikimet që vijnë nga partitë politike dhe nga qeveria. Armiqësisht të disponuara dhe të mbyllura në qarqet vetjake, organizatat e shoqërisë civile shpesh s'arrijnë të sigurojnë shërbime relevante dhe t'i artikulojnë interesat e qytetarëve. Nevoja për përforcim emergjent të neutralitetit të sektorit të shoqërisë civile bëhet e qartë dita ditës.

Projekti dhe revista Zgjidhje u drejtohen sektorëve të ndryshëm në shoqëri, përfshirë partitë politike, strukturat tjera të fuqisë, votuesit e kështu me radhë. Projekti zbatohet mes aktorëve dhe palëve të ndryshme të interesuara në vend. Besojmë se, me implementimin e këtij projekti dhe me metodologjinë e tij, do të kontribuojmë për tejkalimin e gjendjes aktuale, do ta promovojmë kulturën politike dhe vlerat demokratike, si fillim i dialogut që do të ofrojë zgjidhje për problemet në nivel lokal dhe nacional.

Liria e medias në vend përjetoi goditje të rëna në disa vitet e kaluara. Kjo u theksua në dokumente të shumta/raporte të institucioneve relevante ndërkombëtare, si dhe nga Civili dhe njësisia e tij organizative Civil Media. Së këndejmi, është më se e nevojshme një hapësirë ku intelektualë të pavarur, analistë dhe gazetarë do t'i shprehin njohuritë dhe qëndrimet e tyre. Zgjidhje – Revista për kulturë politike dhe dialog do të bëjë përpjekje për ta siguruar hapësirën e tillë dhe për të ofruar përgjigje për pyetjet e zëshme të së sotmes.

Politikë, kulturë, dialog...

Ilir Ajdini

Kultura politike! Apo, ndoshta: Kultura politike? Me siguri më saktë do të ishte: Kultura politike?! Këto pikëpamje dhe dilema janë temat e publikacionit “Zgjidhje”, numri i parë i të cilit është para jush. Në të mysafirët tanë, autorë nga më shumë shtete të rajonit dhe më gjerë, i shprehin pikëpamjet e tyre për kulturën politike përgjithësisht, për dialogun, për atë politik dhe, në përgjithësi, për dialogun shoqëror.

Dialogu ekziston –do të pajtohen të gjithë autorët në këtë numër të parë, edhe ata nga Maqedonia, edhe të rajonit edhe nga vendet me traditë të gjatë demokratike dhe kulturë politike. Nuk është e kontestueshme se politikanët tanë, faktorët në disenjimin e ambientit shoqëror (të jetëve tona), bisedojnë – ulen në tryezë, zakonisht, me dyer të mbyllura, nganjëherë në emisione debative televizive, por më së shpeshti komunikojnë përmes kumtesave, mitingjeve...

Shumë shpesh “bisedat” me kundërshtarët politikë i zhvillojnë përmes “megafonëve” të tyre – një grupi gazetarësh dhe një numër mediash të cilët haptazi, që zakonisht do të thotë në mënyrën më të ulët dhe pa kurrfarë skrupullash, marrin anën e opcionit politik. Motivi është “banal” – e përkrahin atë i cili disponon, ose që presin se do të disponojë, me paratë për reklama nga fushatat e shumta qeveritare, ose nga kompanitë “të afërta” me këtë apo atë. Konstatimi i mësipërm, e them me përgjegjësi të plotë, plotësisht vlen për Maqedoninë, por, siç do të shohim nga tekstet edhe të autorëve në këtë botim, nuk është i huaj as për vendet e rrethimit, madje as për ato që e kanë “shpikur” demokracinë dhe kulturën politike.

Por, a është e tërë kjo dialog? Çfarë imazhi ky dialog, kjo mënyrë e të biseduarit, jep për kulturë tonë politike, për kulturat tona politike?

Një nga definicionet e kulturës politike, e cila si term nisi të përdoret në Amerikë në fund të viteve 50 të shekullit të kaluar, thotë: “Kultura politike e shtetit apo e një pjese të popullatës mund të ketë trajta të ndryshme. Në rast se, për shembull, shumica e popullatës dëshiron rregullim demokratik politik, atëherë edhe kultura politike e shoqërisë quhet demokratike, me ç’rast janë të mundshme disa lloje të kulturës demokratike politike. Në rast se, ndërkaq, kultura politike dhe sistemi politik i shtetit dallohen për një kohë të gjatë dhe në masë të dukshme, mund të vijë deri te probleme serioze lidhur me legjitimitetin e shtetit dhe me këtë deri te destabilizimi i tij”.

Çka nga këto kemi në shoqërinë tonë, në ambientin tonë më të gjerë? Sa këtë e dinë dhe e kanë mësuar politikanët “tanë”, ata që na e drejtojnë jetën, ata që, zakonisht, pushtetin e kuptojnë tekstualisht dhe mendojnë se duhet të sundojnë me jetën e gjithmbarshme në perandoritë e tyre, të cilat i kanë fituar, jo rrallë edhe me gjak, në kuptimin e plotë të fjalës. Natyrisht, jo me gjakun e “sundimtarëve”.

Dhe kur jemi te ta, te poltiikanët, vazhdimisht më vjen ndër mend një definicion i shkrimtarit boshnjak Semezdin Mehmedinoviç (nga viti 1997 jeton në SHBA) nga libri i tij kult "Sarajeva bluz": Politikanët janë, thotë ai në esenë "Macet", ata njerëz të cilët merren me "veprimtari njerëzore e cila supozon izolimin e ndjenjave në emër të interesit". Për dallim nga veprimi i këtyllë, thotë ky poet, "gjestet njerëzore me të cilat nuk udhëheq shpirti do të mund të quheshin dinakëri maceje". Ndërsa macja, me "fluiditetin e saj", konkludon Mehmedinoviçi, është "me plot kuptimin e fjalës kafshë politike".

Pas citeve të mësipërme më imponohen edhe shumë e shumë pyetje të tjera, por në këtë editorial nuk do t'i parashtoj. Le t'ia lëmë që pyetjet t'i parashtojë dhe për to të ofrojë përgjigje revistës "Zgjidhje", në këtë dhe në numrat e ardhshëm.

Kurse në numrin e parë: dhjetë autorë – punonjës shkencorë, profesorë universitarë, shkrimtarë, publicistë, analistë, gazetarë... të gjithë emra publikë dhe krijues të çmuar në mjediset e tyre dhe shumë më gjerë, dhe një intervistë me një diplomat kulmor të kalibrit botëror, ekskluzivisht për "Zgjidhje". Të gjithë ata pozitivisht dhe me entuziazëm menjëherë iu përgjigjën ftesës për të marrë pjesë në krijimin e këtij numri pionier të revistës sonë.

Vallë me atë që e paraqesin si pikëpamje personale, por edhe si përfundime të padiskutueshme që rezultojnë nga analizat e tyre gjithëpërfshirëse, të gjithë së bashku kemi arritur të ofrojmë ndonjë – zgjidhje, këtë jua lëmë ta vlerësoni vetë.

Harald Schenker

Mr. Harald Shenker (44), Gjermani (1966), historian për Ballkanin dhe antropolog me arsim, punon si analist politik dhe konsulent "i pavarur". Për vete thotë se ka kaluar mjaft kohë në Ballkan, sa asgjë më nuk mund ta befasojë. Por, mbetet gjithë kohës i intriguar. Ende përpiqet ta deshifrojë baletin shpesh herë spontan të gjërave që nuk shkojnë bashkë, të njerëzve të cilët s'janë asgjë tjetër përveç statistëve në rrëmujën e quajtur Shkup, ku edhe jeton. Për herë të dytë.



Harald Shenker

Kultura politike dhe pasqyra shoqërore: fshati përballë qendrës

Këto ditë u ballafaqova me një mënyrë të të menduarit të cilën nuk e kisha takuar një kohë të caktuar. Nuk kam menduar se është zhdukur, thjesht nuk ishte e pranishme në ngjarjet e mia të afërta. Flas për komplotin. Ja shkurt: Ivo Sanader është arrestuar, Millo Gjukanoviq u tërhoq, Hashim Thaçi është nën presion dhe me siguri do të përjetojë vdekje politike. Hapi i ardhshëm do të ishte qeveria e Maqedonisë, e cila do të ndihmonte që të hapë rrugën e qeverisë teknike që të zgjidhet problemi rreth emrit me Greqinë. Skenar interesant. Përveç se po i mungon një element kyç: komplotuesi. Atë ose ata, askush nuk mund t'i emërojë.

Maqedonasët (me këtë mendoj në qytetarët, pa distinkcionin e origjinës etnike) janë shqepur midis dy koncepteve

Shembulli të cilin e përmenda është artikulum i realitetit, siç është i pranishëm në kokat e atyre që janë bindës në të, njëjtë siç besojnë ata në parashikimin e sotëm të motit. Kultura politike nuk mund të jetë asgjë tjetër përveçse artikulum i shoqërisë nga e cila vjen. Strukturat jo vetëm se e diktojnë sjelljen por njëkohësisht edhe i formojnë, i kërkojnë dhe ata i vendosin kornizat dhe kufizimet. Të tejkalohen të njëjtat, është akt qytetërues. Në atë që pason, do të mundohem të shqyrtoj disa fragmente të cilat e definojnë sëmundjen e kulturës politike të Maqedon-

isë dhe do të diskutoj nëse ata janë unikatë, siç perceptohen në mënyrë lokale. Me fjalë të tjera, do të mundohem t'i vë në kontekst. Jo që t'i relativizoj ose që t'ju gjej pretext. Thjesht, me qëllim që t'i kuptoj.

Nga lepeza e shembujve të mundshëm, do të filloj me tregtimin rrugor të dokumenteve nga shërbimet sekrete. Ky është një fenomen veçanërisht i neveritshëm, kur lajmëtarë moralë të vetëshpallur gjuajnë me baltë mbi përfaqësuesit e vetëshpallur të popullit. Ta pastrojmë këtë gjë që në fillim: Edhe pse janë zgjedhur në mënyrë legale, asnjëri nga deputetët e tanishëm, nuk ka legjitimitet të vërtetë. Unë jam i bindur se sistemi ekzistues për votim, në të cilin partitë dhe strukturat e tyre udhëheqëse vendosin për atë se kush do të jetë deputet dhe në të cilin nuk ekziston lidhje e drejtpërdrejtë midis votuesve dhe të zgjedhurve "të tyre" në parlament, është thellësisht jodemokratik. Aq më shumë, sistemi i këtillë ka kontribuar për gërrimin e kulturës politike që nga vendosja e tij, duke i bërë politikanët të paprekshëm, duke u dhënë imunitet nga instrumenti i vetëm i cili i referohet demokracisë, mekanizmi i propozimit dhe aprovimit: qytetarët, gjegjësisht faktorët e një shoqërie. Shumë mirë më kujtohet se si, në një akt të egoizmit të pastër politik, partitë e atëhershme të mëdha insistonin në këtë model dhe si prania ndërkombëtare, profesionalisht e dobët dhe e painformuar, e lejoj këtë. Në emër të stabilitetit, siç deklarorin pareshtur, duke pasur në mendje stabilitetin personal.

Mossuksesi si rezultat, është programuar në këtë mënyrë: politikanët të cilët janë jashtë kontrollit, do të sillen me sjellje të keqe. Ky nuk është privilegj maqedonas. Thjesht ishte çështje e kohës para se problemi i dokumenteve të ndyra, që gjatë dy dekadave të kaluara u aprovuan nga një grumbull lojtarësh në skenën politike e madje edhe nga ata të cilët dëshirojnë që të bëhen të tillë, të krijojë turbulenca politike. Por t'u kthehemi fillimeve. Dokumentet për të cilat flitet janë në pronë të shtetit i cili i ka prodhuar ose të trashëgimtarit së tij. Dhe kështu, tregimi fillon me një numër të panjohur vjedhjesh. Të thjeshta dhe të pasofistikuara: me përvetësim ilegal dhe të paligjshëm. E gjithë ajo që pason nga kjo pikë është e paligjshme, madje edhe në rast se është e vërtetë. Ndërsa autorët nuk janë manifestim i Xhulian Asanzhit. Në këtë rast këta njerëz nuk janë të interesuar për të mirën e përgjithshme (pavarësisht se për çfarë ka menduar Asanzh me atë). Atyre u interesojnë paratë. Thjesht. Sa më shumë para të jetë e mundshme.

Mossuksesi përfundimtar i të vetëquajturave elita të Maqedonisë, në tentimin që të vendosin sistem kredibil të lustrimit dhe qasjes deri te dokumentet e shërbimeve sekrete, tani e mori tatimin e vet. A është me të vërtetë kështu? Gjykuar nga ajo se si anëtarët e shërbimeve sekrete nga sistemi i vjetër e luajtën procesin e njëjtë në vende të tjera, njeriu këtu do të përkujtojë skemë të caktuar. Në logjikën e strukturave komuniste, ekziston konstantë e cila thotë se informacioni është fuqi dhe se posedimi i informacioneve e zmadhon fuqinë personale. Kështu secili grumbullonte informacione për secilin. Kjo ishte diçka e cila u jepte shkas për punë shërbimeve sekrete paranoike dhe joefikase. Vetëm mendoni në koleksionin e faculetave me aromën e kundërshtarëve të regjimit, të grumbulluar nga Shërbimi sekret gjermano-lindor. Ato u përdorën që t'i orientojnë qentë gjurmues pas një personi të caktuar. A mund të bëhet më qesharake se kaq? Edhe në momentin kur sistemi kolaboi, fshehja e informacioneve ishte po aq e rëndësishme sa edhe ruajtja e tyre për përdorim personal. Në Rumaninë postkomuniste, disa tonë dokumentesh nga shërbimet sekrete janë gjetur të mbuluara në dhe në një luginë afër Bukureshtit. Në Berlinin Lindor, të punësuarit në Shërbimin Stazi, grisën disa dhjetëra mijëra dokumente me duar, pasi që thjesht nuk kanë pasur kohë t'i asgjësojnë me makina. Të punësuarit e tanishëm në administratën publike i bashkojnë copët dhe kjo do të zgjasë me vite.

Ky refuzim nga lojtarët politikë të Maqedonisë për krijimin e procesit kredibil të lustrimit, fare nuk befason. Madje edhe nëse aktet ligjore janë lëshuar në proces, tashmë

është vonë. Ndoshta nuk është shumë vonë, siç tregon shembulli bullgar, ku funksionarë të lartë duhej të tërhiqen. Nuk nevojitet imagjinatë e bujshme që të merret me mend se ata të cilët me të vërtetë janë të rëndësishëm, e kanë pasur gjithë kohën e botës në dispozicion, që të pastrohen në dy dekadat e kaluara. Tani është koha e lojtarëve më të vegjël. Ose e atyre të cilët qëndrojnë në rrugë ose një Zot e di se ku. Ndoshta do të bien viktimat. Disa ndoshta do të përjashtohen me forcë nga skena politike. Por a do të jenë ata lojtarët e vërtetë apo vetëm kurbanë, të cilët e kanë plotësuar rolin e tyre dhe pas kësaj mund të sakrifkohen?

Ky është problem struktural. Shteti i cili nuk ka mënyrë ta zbatojë monopolin e vet të fuqisë dhe sundimin e njëjtë të ligjeve të njëjta për të gjithë qytetarët në territorin e vet, është shtet i dobët. Pyetja është nëse ai me qëllim mbahet në këtë dobësi nga elitat e veta ose nga ana tjetër ata e fusin gjithë energjinë në përforcimin e shoqërisë dhe institucioneve shëndetësore. Në rastin me Maqedoninë, njëra nga sfidat më të mëdha nga vetë krijimi i shtetit, ndërsa ishte dhe vazhdon si e tillë – është lidhja midis kriminit dhe politikës. Linjë mikroskopike, aq e hollë sa shumë shpesh nuk mund të shihet, ndërsa interaksionet midis dy palëve u bënë aq të ndërlikuara dhe të paqarta sa që ndonjë përpjekje serioze për zgjidhjen e tyre nuk ekziston fare.

Shembull shumë i qartë për këto lidhje të ndërsjella është diapazoni i ndërtesave të cilat dalin si kërpudhat pas shiut, gjithandej nëpër Shkup dhe fshatrat përreth. Duke e marrë parasysh numrin dhe madhësinë e tyre, bashkë me gjendjen e përgjithshme të ekonomisë, vështirë se të gjitha ato janë ndërtuar me para të fituara në mënyrë legale. Numri më i madh i tyre nuk e posedojnë dokumentacionin e duhur, që i bën ilegale. Por, çka ndodh në dy dekadat e fundit? Në rastin më të mirë, vetëm disa, gjegjësisht shumë pak prej ndërtimeve ilegale në pronësi të përfaqësuesve të strukturave politike opozitare janë shkatërruar. Dikush do ta shohë këtë si akt legal, por një tjetër si akt paralajmërimi, apo si ftesë të hapur që të paguhet me qëllim që të ruhet ndërtimi. Tentimi momental që kjo gjendje të legalizohet nuk është tjetër veçse akt i kapitullimit të shtetit. Amnistia për mafian urbane pas vetes do të lë sfera të dëmtuara dhe të sakatosura. Lagjet e Shkupit Kisella-Voda dhe Debar-Mahalla u bënë viktimat të këtyre strukturave kriminale, si dhe një pjesë më e madhe e komunave tjera. Duket se është i nevojshëm hap vendimmarrës i cili do t'i pastrojë punët në një situatë e cila para ca kohësh ka dalë nga kontrolli, pikërisht ky hap thellë do ta minojë kredibilitetin e institucioneve. Përpikuni t'u sqaroni pesëmbëdhjetë familjeve të cilët brenda natës përgjithmonë e kanë humbur dritën e ditës, pasi që dikush ka vendosur të ndërtojë ndërtesë mu para dritareve të tyre, sqaroni atyre se amnistimi është mënyra më e mirë e ballafaqimit me këtë problem. Është e panevojshme të thuhet se askush, duke e përfshirë edhe shoqërinë civile nuk u ndihmon këtyre njerëzve.

Kjo na shpie deri te pika tjetër: e ashtuquajtura shoqëri civile. Në Maqedoni, sektori i tretë duhet ta luajë rolin e korrektorit politik dhe shoqëror. Intervenimet pa dyshim të shumta dhe krijimi i rrjeteve, krijuan universum paralel në të cilin, e udhëhequr nga interesi i tanishëm i zvogëluar i donatorëve ndërkombëtarë, u vendos klasa e re e mesme, duke e gjetur vendin e vet. Ajo akoma është e dobët në definimin e saj, por mjaft e aftë në sigurimin e ekzistencës. Pyetja është nëse ky pandan i borgjezisë perëndimore, ndonjëherë do të zhvillojë vetëdijen e qytetarisë së vërtetë, duke i kuptuar në mënyrë serioze rolin e vet dhe përgjegjësitë në shoqëri, ndërsa me të drejtë të plotë synon suksesin shoqëror dhe ekonomik.

Ky status-quo nuk është fort inkurajues. Sektori shumë i politizuar dhe i polarizuar i OJQ-së për momentin u ofrohet lojtarëve politikë dhe atyre pas prapaskenave, si instrument bujar. Roli i qenit –rojtari ose është harruar ose është zbatuar në mënyrë jo të rëndësishme. Rezultat i kësaj është kredibiliteti i ulët i sektorit civil në mesin e qytetarëve.



Ekzistojnë shumë artikuj të cilët i trajtojnë sëmundjet e shoqërisë civile në Maqedoni. Shumica e tyre, me të drejtë të plotë e theksojnë atë se si do të duhej të vendosen punët. Por pse prej së afërmi të mos shihet ajo që është? Shoqëria civile mezi paraqet fotografi për strukturat në shoqërinë e Maqedonisë, ndërsa këto edhe më tej janë fokusuar në mbajtjen dhe mbijetimin e familjes – këtu për familje mendoj në kuptimin më të gjerë të fjalës. Kjo do të thotë se gjithçka do të bëhet për mirëqenien e bashkësisë së afërt (dhe të mbyllur). Nuk janë të nevojshme studime sociologjike që të kuptohet se kjo është pikënisje për tipin e mbrojtjes dhe klientalizmin, tipik për të gjithë rajonin. Derisa fokusi i shoqërisë nuk transferohet nga kolektivi mbi atë individual, këto veprime me reflekshe do të vazhdojnë të ekzistojnë. Në shoqëri e cila së shpejti është ballafaquar me procese të ndryshme të transformimit, si : privatizimi, decentralizimi, ndryshimet etnike dhe në të cilën sfera publike deri në kufij të paparë është pushtuar nga forcat politike, ekziston pak hapësirë për zhvillimin e kulturës politike të qytetarëve me orientim kritik.

Prandaj, fare nuk befashishon fakti se struktura qeveritare po ballafaqohet me rezistencë tejet të vogël nga shoqëria civile, ndërsa në raste kur ajo paraqitet është aq e dobët sa makineria politike e përvetëson pa pengesa. Një shembull i palavdishëm është ligji për antidiskriminim, i cili hyri në fuqi në fillim të këtij viti. Krejt kundër nga titullit i tij, ai e institucionalizoi diskriminimin kundër personave me çfarëdo orientimi seksual të ndryshëm nga ai i diktuar nga shumica politike dhe religjioze, me përjashtimin e këtyre grupeve nga teksti i ligjit. Kritikant e Komisionit Evropian u hodhën poshtë me pohimin se diskursi shoqëror është i prirë për vendime të këtilla. Prijësit e grupeve kryesore religjioze dolën në opinion me deklarata kundër martesave të personave të gjinisë së njëjtë dhe adoptimit të fëmijëve nga ana e tyre. Strukturat e qeverisë dhe disa satelitë të saj, në mënyrë eksplicite e ndezën temën, duke krijuar atmosferë artificiale në të cilën debati kritik nuk ishte i mundshëm. Përgjigja e shoqërisë civile për këtë? Nuk pati, përveç nga organizata të cilat drejtpërdrejt merren me të drejtat e homoseksualëve, ndërsa ato ishin të vogla dhe të dobëta. Pavarësisht faktit se kjo gjë nuk ishte në pajtim me akuizitat evropiane (*acquis communautaire*), ky ligj u bë realitet. Përvoja ime e deritanishme në bisedat private me disa qytetarë të arsimuar të Maqedonisë, në pjesën më të madhe flet për solidarizimin e tyre (herë-herë të fshehur) me qeverinë për këtë temë. Sjellja devijante seksuale akoma konsiderohet si jonormale dhe patologjike. Të mos përmendim se këto teza gjetën vend edhe në tekstet shkollore, përderisa fëmijët e moshës së hershme orientohen ta shohin diskriminimin kundër të tjerëve si akt normal. Kjo është situata. Vështirë se do të ndryshojë brenda natës.

Kur flasim për fëmijët, duhet të përmendet se problemet në sistemin arsimor u bënë akute. Duket sikur lëshimet nga dekadat e kaluara janë grumbulluar dhe se ky proces për momentin e arrin kulmin e vet. Thënë në mënyrë matematikore, vektori eksponencial është në pikën më të lartë. Problemet janë të shumta, por ajo që është e rëndësishme është se gjenerata e gjenerata të fëmijëve kalojnë përmes sistemit, pa iu dhënë aftësia esenciale e cila do t'i shndërrojë në qytetarë të emancipuar: mendimi kritik. Pa të, vetëm ata të cilët do ta mësojnë këtë në kushte shtëpiake, do të kenë dobi. Të tjerët do të mbeten të dëgjueshëm, jokritikë dhe lehtë të manipulueshëm. Me tjera fjalë, do të bëhen pikërisht masë e nevojshme e njerëzve për lojëra politike. Këtu do të përkujtojmë grupet e të rinjve të cilët demoluan dyqanet shqiptare dhe dyqanet e myslimanëve në qendër të Shkupit në vitin 2001, një masë amorfe e udhëhequr nga profesionistë. Apo grupet e të rinjve shqiptarë të cilët shkonin nga një vendvotim te tjetri dhe votonin në grup. Shkelje kriminale, të bëra nga ushtarë partiakë. Jo nga qytetarë me orientim kritik. Ose, nëse guxoj të përkujtoj skenën e tmerrshme në sheshin e Shkupit, kur një bandë e huliganëve partiakë rrahën një grup protestuesish para syve të policisë. Ushtarë partiakë, jo qytetarë kritikë.

Këto janë skenat për të cilat bëhen bisedime në shtëpitë, bëhen të eksponuara në media dhe të cilat shëtisin nga celulari në celular, por edhe në rrjetet sociale. Të jesh i ashpër është *in*. Të imitohet sjellja e gangsterëve dhe kultura e cila u bë temë kryesore e medieve të globalizuara. Ky është problem global i osmozave urbane midis periferisë dhe qendrës. Ndoshta sistemi arsimor në shtetet perëndimore nuk është i përkryer. Sistemi gjerman madje është kritikuar më shumë herë se nuk u jep mundësi të barabarta të gjithë fëmijëve, duke krijuar me këtë ndarje të fuqishme nga mosha e hershme. Sistemi britanik ndërkaq as që përpiket t'u japë shanse të barabarta. Ky mentalitet silltet rreth asaj, sa para – aq vlera. Mund të gjej akoma shembuj negativë. Megjithatë, sistemi i Maqedonisë është në rënie. Nuk ka cilësi për askënd. Në këtë mënyrë, të gjithë do të kenë mundësi të barabartë pas përfundimit të arsimit të mesëm i cili është obligativ. Arsimi i lartë u bë industri për ndarjen e diplomave, ndërsa çështja e kualitetit është faktor i parëndësishëm, krahasuar me dobinë ekonomike të lojtarëve kryesorë në këtë skenë.

Mendimi kritik? Pse dhe për ç'arsye? Pasi që ata që mendojnë janë më të rëndë për t'u manipuluar, do të mendonte dikush, cila është çështja kryesore e pedagogjisë. Por, kur shikoj shmkarjet nga ky kurs, të prodhuar nga kultura e korrektesisë politike në Amerikën Veriore dhe Evropën Perëndimore dhe Qendrore, kam dyshimet e mia.

Partive politike në Maqedoni u nevojiten ushtarë. Ato i shumojnë apo i paguajnë dhe i shfrytëzojnë. Më së shpeshti bëhet fjalë për të rinj të keqpërdorur. Vetëm shikoni numrin e madh të djemve të rinj të cilët sillen rreth shtabeve të partive më të mëdha, duke shpresuar se do të marrin ndonjë punë apo detyrë. Të gatshëm të bëjnë gjithçka që ta ushqejnë familjen e tyre. Pjesërisht ky është dëshpërim si rezultat i dy dekadave të qeverisjes të cilat bënë që një e treta e popullatës të aftë për punë të mbetet pa punë. Por njëkohësisht, kjo është dëshmi se proteksionet dhe klientelizmi funksionojnë. Ata ekzistojnë me shekuj. Modernizimi nuk ka prekur deri në këtë masë shoqërore, vetëm metodat e komunikimit kanë ndryshuar dhe janë përshtatur. Nuk ka politikanë modernë pa Fejsbuk, ithtarët e të cilëve garojnë në tërheqjen e vëmendjes, përmes shtypjes së pullës "më pëlqen". Mënyra postmoderne e shprehjes së respektit më të thellë. Dhe ndoshta, vetëm ndoshta, kjo do të sjellë ndonjë punë. Poshtëruese? Po, për individët. Por normale për një anëtar të bashkësisë fisnore. Vetëm edhe një hap karrierist.

Pasi që ekziston mungesë serioze e vendeve të punës në tregun e lirë, qeveria krijoi ithtarë të rinj të vetët. Në mënyrë politikisht korrekte dhe me ndasi etnike. Derisa Ministria e re për Shoqëri Informatike dhe administrata punon në anën e maqedonasve etnikë, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit e bën po të njëjtën gjë për shqiptarët etnikë dhe kohëve të fundit me grupe më të vogla etnike. Qindra ithtarë partiakë marrin mbështetje për mbijetesë, ndërsa prej tyre pritet të sillen në pajtim me pritjet partiake. Rezultati nga kjo pas përpjekjeve për modernizimin e administratës dhe shndërrimin e saj në trup efikas dhe transparent shpjegohet vetvetiu.

Nuk është befasi ajo që ky lloj i kulturës së ithtarëve nuk rezulton me kulturë politike të dialogut dhe debatit për problemet. Kjo, në këtë rast është kultivim i mentalitetit jeniçer për nënshtrim të pakushtëzuar. Prandaj janë përplasjet midis trupeve partiake, veçanërisht në periudhat parazgjedhore. Njerëzit të cilët përplasen njëri me tjetrin, nuk e bëjnë këtë për dallime ideologjike. Ata kryejnë urdhra, të cilët më së shpeshti janë dhënë në mënyrë të pacaktuar dhe të paqartë dhe ofrojnë spektër të gjerë të interpretimeve të mundshme. "Do të hyja në zjarr për liderin e partisë sime", më tha para do kohë një zëdhënës i ri partiak. Nuk mund të paramendoj zëdhënës gjerman si thotë diçka madje as afër kësaj dhe gjermanit kjo nuk i duhet. Thjesht, kjo nuk kërkohet. Është punë, njëjtë sikur ajo e liderit të partisë.

Edhe një element i kulturës politike të Maqedonisë është muskuli partiak i cili shtrëngohet midis përlëshjeve: tubimet. Tubimet janë me rëndësi gjigante në komunikimin

politik: këto janë ngjarje në të cilat shënohet territori. Në Maqedoni ato kanë karakter të pikniqeve: autobusë plot me njerëz nevojtarë dërgohen në Shkup që të japin prezencë, ndërsa "mbështetësit" marrin mëditje të vogël dhe sanduiç. Të gjithë e dinë si shkon kjo punë, çdokush e bën. Pse do t'ju hyit telasheve të këtilla: Për disa sekonda në lajmet televizive apo për një fotografi të zbehtë në gazetë?

Kultura politike demokratike mund të shpresojë për ngritje vetëm në një ambient me media të lira, të këtilla janë leksionet momentale. Dhe këtu dyshoj në diçka. Disa nga shembujt më të mirë të kulturës politike janë krijuar në situatë të rezistencës kundër regjimeve totalitare. Në këtë fërkim gjatë mbështetjes së regjimeve, ky konfrontim konstant i nxjerr vlerat ekstreme të njerëzisë, të mirat dhe të këqijat. Nuk është rastësi që në Evropë, disa nga mendimtarët më të mirë të kulturës politike, janë në fakt njerëz të cilët janë ndjekur ose për shkak të bindjeve të tyre ose për arsye se kanë qenë: Hana Arend, Aleksandar Sollzhenjicin, Martin Niemmyler, Gjergj Konrad, Jorzha Semprun, Vaclav Havel, Milo Dor, Viktor Klempeler... të përmendim vetëm disa nga shumë të tillët.

Jo pse unë në njëfarë mënyre angazhohem për çfarëdo përveçse për media të lira, vetëm dua ta potencoj se mjedisi në të cilin ekziston liri, nuk nënkupton se atje ekziston edhe frymë e lirë. Të ndalemi në shembullin e Maqedonisë, unë kam me sytë e mi disa nga shembujt më të këqij të së ashtuquajturës gazetari në këtë shtet, e cila ka për qëllim edhe më tej ta perversojë idenë themelore për lirinë e shtypit për shumë arsye, më së shpeshti shumica prej tyre lidhur me të levërdi personale. Madje edhe pse Dragan Pavloviq Llatasi dhe Slobodan Tomiqi nuk kanë asgjë të përbashkët, e përfaqësojnë llojin e njëjtë të perversitetit të profesionit të tyre. T'i realizoni iluzionet tuaja për atë se sa shumë vleni, nuk është as më mirë e as më keq, sesa mungesën e profesionalizmit ta kompensoni përmes hiper-servilitetit ndaj partisë në pushtet. Nga ana tjetër e tregimit, liria relative në dy dekadat e fundit prodhoi pak tregime të rëndësishme gazetareske. Pse? Atë që e dëgjojmë në çdo rast është ajo që pronarët dhe redaktorët nuk lejojnë gazetari të mirë, investigative. Kjo gjithsesi është e vërtetë, por dyshoj se këtu qëndron i tërë problemi. Arsimi apo mungesa e tij këtu e luan rolin e vet. Por si të prisni gazetari të mirë nga persona të cilët në asnjë periudhë të jetës së tyre, nuk kanë mësuar në mënyrë kritike ta shfrytëzojnë potencialin e tyre në dobi të tyre dhe në kuadër të mundësive personale?

Ekziston një numër i madh i fjalëve popullore, të cilat një temë e distilojnë deri në përbërësin e vet esencial: çdokush është ekspert, secili është gjeni dhe gjithsesi, secili e di se si të bëhen punët në mënyrën më të mirë. Kjo është perspektivë të cilën e ofron kolltuku shtëpiak ose në rastin më të mirë, bota e parë nëpër një gotë të birrës. Sepse kur flasim për perspektivën, auto-administrata e mirë e vjetër jugosllave dhe të folurit e pafund që doli nga ajo, nuk prodhuan asgjë tjetër veçse konformistë me perspektivë.

Ajo që më mungon në Maqedoni janë subkulturat, kulturat e ballafaquara, ajo që nuk është shfrytëzuar në mënyrë komerciale. Shpesh dëgjoj se Shkupi është shumë i vogël dhe se nuk lejon hapësirë për subkultura. Që ta kundërshtoj këtë: qyteti i vogël gjerman në të cilin unë kalova më shumë vite, i takonte një rajoni ku fundamentalizmi ortodoks protestant ishte doktrina kryesore fetare. Kjo është kulturë e cila përdor prohibim dhe e cila e thekson si mëkat çdo manifestimi të kënaqësisë në jetë. Dhe flasim për një qytezë me nja njëzet mijë banorë. Por kjo ka prodhuar kulturë të fuqishme kundërshtuese, kulturë alternative të ndryshueshmërisë e cila në disa raste ka emaluar nëpër gjithë rajonin: panku dhe politika, partitë dhe përplasjet me autoritetin, lufta për të drejtën e ekzistimit, e kombinuar me arte, xhaz dhe ngjarje kulturore, nëpër gjenerata dhe përmes kufijve të imponuar nga tradita dhe kundër lëvizjeve të cilat kryesisht respektohen. Shumë prej kësaj është shndërruar në kultura kryesore të ditëve të sotme, ka krijuar institucione kulturore të cilat në njëfarë mënyre kanë ndihmuar në hapjen e shoqërisë së izoluar dhe të mbyllur në pesëdhjetë vitet e fundit. Domethënë – në mad-

hësinë nuk ekzistojnë argumente. Ajo që i bën dallimet e tëra është refleksi fisnor ose mungesa e tij. Madje edhe në fundamentalizmin protestant, individi është ai i cili qëndron në qendër të konstruktit filozofik apo religjioz, në marrëdhënien e tij personale me një Zot hakmarrës. Esenca e kulturës perëndimore është individualiteti. Reflekset fisnore janë para-moderne dhe anti-moderne, grupi është gjithmonë më konservativ se ndonjëri nga anëtarët e tij individualë.

Maqedonasët (me këtë mendoj në qytetarët, pa distinkcionin e origjinës etnike) janë shqepur midis dy koncepteve. Në një dorë, ekziston refleksi i fuqishëm grupor, ose vetëm i perceptuar në këtë mënyrë ose real, apo tradicional ose i ndonjë lloji i cili imiton rrymat e reja. Rrallë dëgjoj nga njerëzit të flasin për veten në kontekstin politik. Gjithnjë e më shpesh ballafaqohem me "ne" të shoqëruar me vajtime për kombin e vogël e të lënë pas dore. Ose "ne" si pjesë e kombit më të madh, jashtë kufijve shtetërore dhe konflikteve. Kjo është gjendje mbrojtëse e mendjes. Grupet nuk prodhojnë piktura, as nuk shkruajnë libra, as shfaqje teatrale, e as nuk bëjnë filma. Individët e bëjnë këtë.

Shpesh dëgjoj ankesa për atë se si turbo-folku e kaploi jetën dhe këto janë ankesa me bazë të mirë. Suksesi i këtij fenomeni është trishtues po aq sa është edhe i padurueshëm. Por ajo që fshihet pas tij është problemi kryesor. Turbo-folku është shprehje, materializim i pushtimit të qendrës nga ana e periferisë. Kasabaja kundër jetës urbane. Vlerat të cilat i përfaqëson kasabaja janë në kundërshtim strikt me ato të një shoqërie urbane dhe civile. Këtu flitet për grupin, bandën, turmën kundër individit. Me këtë lavdërohen plaçkitësit dhe vrasësit ndonjëherë të mbështjellë në ngjyrat nacionale, kundër krijuesve të kulturës. Ky është lëmshi i padepërtueshëm i lidhjeve familjare, lidhjeve me klientalën dhe ekonominë gri kundrejt sundimit të së drejtës, transparencës dhe mendjekthjelltësisë. Kjo është vjedhje nga shoqëria dhe shteti, kundrejt pagimit të tatimeve i kontributit në ndërtimin e shoqërisë.

Secili prej këtyre koncepteve krijon kulturë të vetën politike, ndërsa përplasja e të dyjave vazhdon të ndodhë në shoqëritë e Ballkanit, duke përfshirë edhe shoqërinë e Maqedonisë. Pa dallim progresit të pakontestueshëm në proceset e evrointegritimeve, për momentin duket se kultura urbane, liberale dhe e hapur, e centruar rreth individit, është nën goditje të fuqishme. Ky është paradoks i dukshmëm qartë dhe pajtimi me këtë i krijon kokëçarje Bashkimit Evropian. Ai mëson ngadalë nga shembull bullgar dhe ai rumun se institucionet nuk janë të mjaftueshme. Bëhet fjalë edhe për llojin e njerëzve të cilët punojnë në to. Gjithashtu, kualifikimet në letër aspak nuk janë përgjigjja. Struktura mentale është po aq e rëndësishme. Madje edhe institucioni më i mirë do të erodojë nën ndikim e frymës fshatareske nëse lejohet që ajo të zgjerohet.

Në anën tjetër nuk është korrekte të priten çudira. Siç thashë në fillim, kultura politike nuk mund të jetë diçka tjetër përveç se artikulum i gjendjes në të cilën ndodhet shoqëria. Në jetën reale, kjo shoqëri bie provim pas provimi, ndërsa provimi final në rast të mossuksesit, ju heq anash shumë larg. Kriteri për inkuadrim është i vështirë për t'u arritur për shoqërinë e cila akoma nuk e di se çka paraqet dhe çka përfaqëson. Konflikti midis qendrës dhe kasabasë në një vend i cili vetë ndodhet në periferi, lehtë mund të prodhohjë fasada të demokracisë pas të cilave lufta për kontroll mbi sa më shumë të jetë e mundur nga ajo që e posedon kundërshtari, bëhet brutale. Sfidat e post-demokracisë janë të pranishme anekënd rajonit, ndërsa në fakt nuk ekzistojnë instrumente të cilat do t'i mbanin nën kontroll. Kultura politike aktuale nuk është e tillë që në masë të madhe do t'u kundërvihet këtyre synimeve, njëjtë sikurse edhe pjesëmarrja në korrupsionin shoqëror është akoma në dobi të një pjese të madhe të popullatës. Sfida e vëretë për kulturën politike të Maqedonisë dhe, pa rezerva, për vendosjen e ndryshimeve shoqërore, është zbulimi i individit në vend se të grupit si qendër e identitetit të saj. Rruga për te kjo arritje është e mundimshme dhe do shumë punë.



Sasho Ordanoski

Mr. Sasho Ordanoski (46), Maqedoni është gazetar porfesionist/redaktor tashmë 27 vjet. Ka diplomuar gazetarinë dhe ka magjistruar sociologjinë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup. Në karrierën e tij shumëvjeçare profesionale, pandërprerë punon në media të shumta të vendit dhe të huaja, si të shtypura ashtu edhe elektronike. Mes tjerash, ka qenë drejtor i televizionit shtetëror publik MTV dhe drejtor i televizionit komercial nacional Alsat-M, themelues dhe drejtor i së përjavshmes "Forum", redaktor për Maqedoninë i Institutit për Raportim në Luftë dhe në Paqe (Institute for War and Peace Reporting) nga Londra etj.

Ordanoski është konsulent/analist i më shumë organizatave dhe insituteve ndërkombëtare për media, demokraci, çështje sigurie dhe politike, si dhe anëtar i më shumë organizatave ndërkombëtare që merren me media dhe/ose demokraci.

Ligjërën gazetari dhe shkathtësi komunikimi në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Për momentin është drejtor për çështje mediale dhe publike pranë Kompanisë rajonale investuese dhe konsultante VEVE Grup me seli në Tiranë dhe në Shkup.



Sasho Ordanoski

Njoftim i rëndësishëm: Kultura politike në Maqedoni anulohet për një kohë të pacaktuar

Në teatrologji që moti është e njohur se çështja qendrore në pjesën më të madhe të tragjediave të Shekspirit (Magbethi, Hamleti, Mbreti Lir, Rikardi i Tretë, Othello...) vendoset në dy probleme: dëshira për pushtet absolut dhe çështja e lojalitetit. Gërshetimi i tradhtive dhe mosbesimit, vëllavrasjet dhe babavrasjet e shumta, komplotet oborrtare të përziera me ambicien për pushtet të plotë, janë agjenset e fuqishme që i lëvizin personazhet tragjike në botën e Shekspirit. Faji dhe dënimi në atë botë të pafund të imponimeve dhe mashtrimeve sikur me vete të mos jenë në kurrfarë relacioni, sepse asnjë fitore e drejtësisë nuk është e garantuar dhe është objekt i tradhtisë së menjëherë në aktin e ardhshëm.

Hyrja e këtyllë pretencioze mund të sjellë në pritje të gabuara për zhvillimin e tezave në këtë tekst – se, njëherit edhe politika e Maqedonisë i ngjan tragjediave të Shekspirit. Në fakt, njëzet vite demokracie transite të Maqedonisë janë përplot me tradhti politike dhe “vëllavrasje” brendapartiake, me moral që zvarritet për toke dhe me personazhe

Partitë politike në Maqedoni dhe vlerat morale që ato i praktikojnë dhe i propagojnë janë një nga faktorët kyçë që ndikojnë mbi kulturën politike në vend

të cilat sikur të kishin ikur nga prova e ndonjë produksioni amator të Rikardit të Tretë. Megjithatë, skenari demokratik i Maqedonisë nuk i ka dimensionet shekspiriane, jo pse edhe këtu thurrjet nuk bëhen rreth ambicies për pushtet total dhe për dominim mbi kundërshtarët politikë, por për shkak se personazhet tona fillimisht u ngjajnë protagonistëve nga Personi i dyshimtë i Nushiqit: të mbyllur në mentalitetin e tyre provincial, menaxheria e personazheve të Nushiqit vuajnë nga forma të ndryshme të grandomanëve, paranojave, ambicieve të sëmura, lakmisë, gjysmëarsimimit, korrupsionit dhe diapazonit të gjerë të iluzioneve politike dhe sociale.

Të lënë në margjinat e intervenimeve demokratike reformuese në dy dekadat e fundit, partitë u shndërruan në qendra të fuqishme të klientelizmit politik, korrupsionit dhe jotransparencës. Partitë në Maqedoni gjithnjë kanë insistuar që ta “pushtojnë” jetën demokratike në shoqëri dhe ta imponojnë logjikën e tyre kadrovike dhe vlerësuese në administratën shtetërore.

Në dekadën e parë të mijëvjeçarit të dytë, klasa politike e Maqedonisë akoma tregon këmbëngulje kokëfortë që të nënshtrohet në analizë politike.

Që të kuptohen “rrymat nënujore” që i krijojnë politikën publike, qëndrimet partiake dhe strukturat partiake në përditshmërinë politike maqedonase, këtu duhet të aplikohet kalimi multidisiplinues i analizës shoqërore-politike, në të cilin politika është e gërshetuar me prirjet familjare, kriminale, afariste dhe psikologjike të aktorëve kryesorë.

Ky ambient fuqimisht reflektohet mbi cilësinë dhe nivelin e kulturës politike dhe dialogut politik në vend. Kultura politike është “substancë” që e plotëson sferën politike në hapësirën mes shtetit dhe shoqërisë qytetare, atë hapësirë që nuk i takon privatësisë së qytetarëve. Gjuha e asaj kulture e pasqyron raportin e qytetarëve ndaj demokracisë në shoqëri dhe flet për respektimin e institucioneve të demokracisë së këtillë, që në linjë përfundimtare është tregues për legjitimitetin me të cilin pushteti e praktikon qeverisjen e tij.

Karakteristikat dhe elementet e kulturës politike janë në mënyrë të zgjeruar të hulumtuara në teoritë politikologjike dhe në filozofinë politike, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Hulumtimet për formimin dhe ndikimin e qëndrimeve politike në demokraci (G. Almond, S. Verba), ose për kulturën politike tek masat dhe tek elitat (A. Liphart), si dhe mekanizmat politikë dhe socialë, të cilët kontribuojnë për fuqi më të madhe ose më të vogël kohezive në shoqëritë me kulturë të ndryshme politike, janë udhërrëfyes i mirë për interpretim dhe mirëkuptim të ndodhive vendore.

Çdo shoqëri në mënyrën e saj specifike i përcakton shtyllat kryesore të kulturës politike në vend. Në modelin demokratik multi-etnik, multikulturor dhe multikonfesional të Maqedonisë, karakteristikat kryesore të kulturës politike i përfshijnë parimet e tolerancës, kompromisit dhe inkluzivitetit, si diskurse kryesore në debatin publik politik dhe në veprimin e partive politike dhe strukturave jopartiake në sistemin demokratik. Cilësia e kulturës politike e përcakton tendencën e rritjes ose të zvogëlimit të përfaqësimit të këtyre parimeve në jetën shoqërore dhe në zbatimin e politikave publike të pushtetit. Mund të pohohet se nëse vendoset sistem i rregullt i matjes së tendencave të këto agregate vlerësuese shoqërore-politike, mund të fitohet imazh relativisht preciz për shkallën e konfliktit në shoqëri, respektivisht për cilësinë e kulturës politike në Maqedoni. Ai, nga ana e tij, ndikon në mënyrë thelbësore mbi ndërtimin e vlerave morale në shoqëri, si shenjë e kohës në të cilën jetojmë.

Në kushte të institucioneve të pandërtuara, integriteti i të cilave është nën presion të fuqishëm të interesave politike ditore, sistemi nuk është në gjendje "ta kthejë goditjen" dhe ta ruajë pavarësinë dhe profesionalizmin e saj. Për shkak të instrumentalizmit politiko-partiak, institucionet shtetërore, të cilat do të duhet të kujdesen për mbrojtjen e interesave publike dhe sidomos për shpenzim të rregullt të parave publike, nuk funksionojnë me kapacitetin e tyre të nevojshëm. Ata nuk janë në gjendje që të sigurojnë neutralitet politik në sferën publike dhe të ndërtojnë standarde objektive të vlefshme rreth "ringut", në të cilin, pastaj mund të zhvillohet edhe debat i ashpër politik, i cili nuk do ta prishë stabilitetin e sistemit. Sfera shtetërore dhe shoqërore janë maksimalisht të partizuar, duke përhapur logjikën dhe interesat e partive në pushtet.

Çfarë vlerash morale dhe politike promovojnë partitë politike të Maqedonisë, si faktorë markantë të kulturës politike në vend?

Me agjendën ambicioze, pa precedent, të pushtetit aktual në Maqedoni që ta imponojë logjikën e vet partiake në çdo pore të shoqërisë dhe shtetit maqedonas, kulturës politike dhe dialogut në vend përjetojnë rënie rekorde në sferat e tolerancës, kompromisit dhe inkluzivitetit, si tri shtylla të vlefshme bartëse të modelit demokratik të Maqedonisë.

"LOPËT E SHENJTA" TË POLITIKËS SË MAQEDONISË

Pas dy dekadave demokracia e Maqedonisë dhe pas shumë përpjekjeve për reformim të shoqërisë maqedonase në të gjitha dimensionet e saj politike dhe ekonomike, habit se si një zonë, thelbësore sipas rëndësisë së saj për funksionimin e demokracisë, mbeti pothuajse e paprekur nga vala e ndryshimeve që në një mënyrë ose në një tjetër, e përfshin shoqërinë. Ky rajon është "zona e ndaluar" për reforma, terra incognita jonë demokratike – funksionimi i partive politike në Maqedoni. Partitë, këto "Lopë të shenjta" në sistemin politik të Maqedonisë, edhe më tej mbeten bastione të marrëdhënieve jodemokratike të cilat kanë mbretëruar në komunizëm. Në to është vazhduar tradita e "centralizmit demokratik" partiak, në të cilin, përmes strukturës piramidale të fuqisë dhe pushtetit, roli i kreut të partisë është i plotfuqishëm dhe i pacenueshëm. Fraksionimi partiak dhe mendimi i ndarë për çështje specifike, madje edhe atje ku ai nuk është qartë në mënyrë statutare i ndaluar, në realitet është pothuajse i paimagjinueshëm. Të kesh mendim ndryshe nga lideri është mjaft e parekomandueshme, ndërsa shpesh është e barabartë me tradhti. Madje edhe kur paraqiten individë të cilët këmbëngulin në autonominë e tyre intelektuale, kjo nuk arrin më larg nga kolumnat gazetareske, pa refleks thelbësor në pozicionet dhe funksionimin e partive.

Proceset e brendshme partiake për miratim të vendimeve dhe formim të politikave janë në mënyrë qenësore jotransparente. Edhe pse të gjitha partitë e kanë proklamuar edhe formalisht parimin e rëndësisë së qëndrimeve të bazës dhe metodën nga poshtë-lart (bottom-up) të ndërtimit të qëndrimeve, në praktikë proceset zakonisht zhvillohen anasjelltas, sipas parimit nga lart-poshtë (top-down). Zbatimi i parimit të këtyllë të ndërtimit të qëndrimeve interne lë pasojë të rëndësishme në funksionimin e partive. Kur pjesa më e madhe e komunikimit vjen nga maja, atëherë parësor është funksionimi i shpërndarjes së qëndrimeve drejt anëtarësisë, e jo grumbullimi i njohurive dhe përvojave me të cilat disponon baza partiake. Në mënyrë sistematike, kjo do të thotë se kryesia partiake është gjithmonë më e rëndësishme se baza, kështu që



në këtë mënyrë procesuohen edhe interesat edhe përfitimet nga marrja me politikë. Sistemet e këtilla "komanduese" janë më të lehta për manipulim, më të nënshtruara janë ndaj çdo lloji korrupsioni (material, moral dhe të karrierës), por edhe shumë me tepër varen nga liderët harizmatikë dhe "mitologjitë" e brendshme partiake që thuren rreth liderit dhe rrethimit të tij.

Si pasojë e kësaj, faktori kyç në politikën kadrovike që zhvillohet në partitë vendoset në çështjen e afërsisë dhe lojalitetit ndaj liderit, të interpretuar nga vetë ai dhe nga rrethi i ngushtë i bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë dhe të mbrojtur. Sistemi i këtillë, me kalimin e kohës bëhet gjithnjë e më shumë në mënyrë ideore jofleksibil (qëndrimet në bazë përshtaten drejt direktivave të kryesisë) dhe në mënyrë kadrovike ekskluzive (e jo inkluzive). Meqë është i rrjedhshëm në një drejtim, në të mbretëron seleksionimi negativ kadrovik sipas kriterit të përshtatjes drejt instruksioneve të marra nga udhëheqësia. "Kanceri" kadrovik pandalur përhapet nëpër indin e partisë duke krijuar struktura burokratike sipas rregullit se "menaxherët" partiakë të klasit të parë rrethohen me bashkëpunëtorë të klasit të parë; funksionarët partiakë të klasit të dytë sjellin bashkëpunëtorë të klasit të tretë. Përvoja e deritanishme partiake e Maqedonisë tregon se sasia e kuadrit njerëzor dhe profesional të klasit të parë nëpër parti është me tendencë të zvogëlimit.

Në LSDM, si trashëguese zyrtare e Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë, inercioni i centralizmit demokratik dhe rezoni "komisar" i qeverisjes, me rregullshmëri ciklike dhe të parashikueshme në dy dekadat e fundit, kontribuon që shumë kuadro kreative dhe me kapacitet të largohen, ndërsa shpesh dhe në mënyrë brutale të përjashtohen nga partia. Politika kadrovike është në funksion të mbajtjes së vertikales së qartë partiake në maje të së cilës në mënyrë të pacenueshme qeveris lideri. Në mënyrë statutare nuk është e paraparë që në parti të mund të formohet fraksion për një çështje të caktuar ose sipas fushës së interesit, edhe pse partia ka paraparë se çdo anëtar mund të ketë opinion të veçantë ose kundërshtues për çështje të caktuara, për çka nuk duhet të ketë pasojë. Megjithatë, madje edhe kur në historinë prej dy dekadave të LSDM-së janë paraqitur "persona me mendime jo të njëjta" partiake, ata në mënyrë efkase janë izoluar në margjinat e ndikimit partiak dhe janë stigmatizuar si rebelë të padëshirueshëm ose "intelektualë sallonesh", në linjë të fundit, si një "e keqe e nevojshëm" në ndërtimin e "centralizmit demokratik" partiak.

Kripto-komunizmi i theksuar në politikën kadrovike të VMRO-DPMNE-së është maskuar në mënyrë cinike, mes tjerash edhe me shpallje të "konkurseve publike" për kandidim të anëtarëve të kryesive nga më të ulëtat deri te më lartat partiake. Kjo parodi e parimeve demokratike nuk ndihmoi që të ndryshohet funksionimi i partisë sipas modelit të subordinimit të ashpër, sikur të bëhet fjalë për ushtri, në të cilën lideri është feld-mareshali i saj me fuqi të pakufizuar për të udhëhequr edhe me poret më të imëta të jetës "ushtarake". Madje, që të mos ketë paqartësi, në Statutin valid të kësaj partie, në nenin 22 shkruan që e drejta "demokratike" e kryetarit të saj "mund të ndërpresë kryerje të vendimeve dhe të akteve të tjera të Komitetit Ekzekutiv dhe të organeve dhe trupave të tjerë të partisë", për çka ka obligim vetëm ta njoftojë Komitetin Qendror të partisë. Në VMRO-DPMNE personat me mendime të kundërta me kreun nuk trajtohen madje as si "e keqe e nevojshme", por tradicionalisht shpallen tradhtarë të kauzës patriotike dhe kombëtare, që rezulton me ekskomunikim të plotë të personave me mendime të kundërta dhe me ekspozimin e tyre publik dhe brenda partisë në "shtyllën e turpit".

Te faktori politik shqiptar në Maqedoni standardet demokratike të brendshme partiake janë akoma në nivel më rundimentar, me vërshime të shpeshta në fazat parapolitike në veprimet partiake. Në BDI mbizotërojnë "lojërat oborrtare" mes strukturave të komandantëve nga lëvizja e dikurshme guerile dhe "krahu i ri intelektual" në parti, i cili është në hijen e mitologjisë së statusit të "ikonës" së "luftës për liri të shqiptarëve",

të personifikuar në liderin e tyre. Në PDSH, situata është në mënyrë të dhimbshme e thjeshtë: ekziston lideri dhe zëdhënësi i tij – të gjithë të tjerët janë vida të parëndësishëm dhe të zëvendësueshëm në mekanizmin e brendshëm partiak për sigurimin dhe kanalizimin e resurseve që padiskutueshëm vihen në dispozicion të liderit.

Partitë tjera më të vogla në skenë, kryesisht funksionojnë si lidershipe të vetmuara, detyra e vetme e të cilëve është që në disa zgjedhje të ardhshme, përmes koalicionit me fituesin kryesor të zgjedhjeve, të sigurojnë njëfarë vendi të mirë pune të katër-pesë funksionarëve kryesorë partiakë (nga ndonjë vend deputeti ose drejtori në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore) dhe pak funksione më të ulëta në “detin pa brigje” në administratën shtetërore njëqind e kusur mijëshe.

“LIMONADA” IDEOLOGJIKE

Gjendja e këtyllë stimuluese me demokracinë e brendshme demokratike dhe me seleksionimin negativ kadrovik në Maqedoni ka të bëjë me disa faktorë kyçë. Në fillim, kuptohet është historiat i shkaktimit dhe zhvillimit të vetë partive. Pjesa më e madhe e tyre – ndoshta me përjashtim vetëm të BDI-së në vitet e para të themelimit – logjikën e tyre zhvillimore partiake nuk e shpenzojnë në stratifikimin social ose ideologjik (me përjashtim të atij etnik) të trupit politik në Maqedoni, që të prezantojnë shprehje të nevojës reale në shoqëri për artikullimin e kërkesave specifike të votuesve të tyre. Në vend të kësaj ata sot paraqesin seri të lëvizjeve të pasuksesshme fraksionare brenda-partiake dhe luftimeve për pushtet në disa formacione kryesore politike të themelura në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Historiat i këtyllë, krahas asaj që është i erëzuar me kryeneqësinë dhe me inatin e liderëve të ndryshëm dhe kuazi-liderëve në partitë, në masë të madhe është i orientuar edhe nga veprimi i strukturave të tjera të fuqisë; zhvendosja e biznes-strukturave të caktuara dhe realizimi i interesave të tyre profitabile afatshkurte dhe afatgjate; ose intrigat dhe operacionet në nivele të ndryshme dhe restllave nga shërbimet sekrete policore të Maqedonisë (por edhe të tjera), të cilat ende arrijnë që në masë të madhe zhvillimin e proceseve shoqërore në Maqedoni ta kontrollojnë përmes kontrollit të individëve në jetën politike të shtetit.

Faktori në vijim i ndikimit nuk është specifik vetëm për Maqedoninë, sepse është fenomen global demokratik: jetojmë në kohë “post-ideologjike” (“fundi i historisë”) në të cilën partitë, të gjitha vendosmërisht të përcaktuara për raportet tregtare kapitaliste, vështirë dallohen sipas dispozitave të tyre “të majta” ose “të djathta” ideologjike, sepse sistemet e tyre vlerësuese i konstruktojnë si fotografi kaleidoskopike të kushtëzuara nga politika ditore e interesave mbizotëruese të momentit. Në dhjetë vitet e fundit, vala e popullizmit politik edhe në Maqedoni i “hekurosi” dallimet ideologjike mes konkurrentëve kryesorë politikë, duke i bërë të përgjithësuara dhe të panjohura platformat e tyre ideologjike. Për shembull, qeverisja popullore-djathtiste e VMRO-DPMNE-së është shënuar me disa karakteristika kryesore të ideologjive majtiste tradicionale, në kombinim me dëshirën për vendosje të “dorës së fuqishme” në shoqëri: programe vëllimore për subvencione, aparat i madh (dhe rritës!) dhe joefikas shtetëror, luftë e qartë kundër kapitalit të madh, dëshira për kontroll mbi një pjesë gjithnjë e më të madhe të sektorit real ekonomik, kufizimi i lirive në të gjitha sferat e jetës qytetare, rritja e tatimeve nën maskën për zvogëlimin e tyre, tendenca të hapura anti-perëndimore dhe anti-demokratike, instrumentalizim i mediave...

Dikur përcaktimet thelbësore ideologjike dhe programore të cilat ishin “uji i shenjtë” të cilin e pinte anëtarësia partiake dhe me të cilin energjizoheshin tryezat partiake, sot janë të zbutura deri në nivel të “limonadave” dietale ideologjike.

“Dezideologjizmi” i këtyllë i përgjithshëm kontribuon që lufta politike të zhvillohet në “teatrin” e veprimtarisë e cila merr rëndësi parësore politike - marrëdhëniet me opin-

ionin. Mobilizimi permanent i anëtarësisë dhe monopolizimi i opinionit jopartiak, të privuar edhe nga përmbajtja relevante ideologjike, është detyra kryesore e aktivistëve dhe zëdhënësve partiakë. Ekspertët për marrëdhënie me opinionin janë më të rëndësishëm se ideologët partiakë, ndërsa fushatat janë gjithnjë e më shumë negative dhe në mënyrë agresive armiqësore, të shndërruara në garë për atë se sa është "gjatësia e hundës" së kundërshtarit, në vend të debatit për vlerat partiake dhe planet e propozuara për menaxhim me shtetin. Kultura politike anon nga jokultura, ndërsa në ballafaqimet publike nuk zgjedhen mjete.

SHOQËRI KRIMINALE

Gjithë kjo është e gërshetuar me etablimin e edhe një faktori tjetër të rëndësishëm në funksionimin e jetës partiake, respektivisht demokracisë në shoqëri. Në fakt, procesi politik u bë kaq i shtrenjtë (në kuptim të parave!), që partitë janë të detyruara të funksionojnë si shoqata korporative, të cilat do të jenë të afta të grumbullojnë mjaft para që t'i financojnë operacionet e tyre të shtrenjta për mbetje në pushtet ose marrje të tij. As për ngjitje të posterëve partiakë dhe për shpërndarje të afisheve nuk ka vullnetarë – paguhet çdo angazhim, në një mënyrë ose në një tjetër. I vogël është numri i atyre, të cilët pa kurrfarë interesi personal inkuadrohen të ndihmojnë në aktivitetet partiake.

Por, meqë ligjet ekzistuese (të caktuara në mënyrë të rregullt nga legjislativat në botën e zhvilluar demokratike) caktojnë masa rigorozë për sasi dhe mënyrat për financim legal të partive – shuma të cilat nuk përgjigjen as përafërsisht me nevojat partiake – në vepër janë dy tendenca, të cilat të gjitha partitë së bashku i krahasojnë: fillimisht, ligjet për punë më financiare të partive injorohen në mënyrë masive, me pajtueshmëri të heshtur të të gjitha garniturave në pushtet dhe të shërbimeve kompetente shtetërore nën kontrollin e tyre, të cilat do të duhet t'i sanksionojnë veprimet e këtilla kundërligjore; dhe e dyta për shkak të nevojave të mëdha financiare, partitë nga kuazikorporatat shndërrohen në shoqata masive kriminale, të cilët arkat e tyre i mbushin me zbatim të teknikave të ndryshme për fitim të parave "të zeza" partiake: reketim të sektorit të biznesit, shpallje të "tatimeve partiake" për kuadrot e punësuar partiakë në nivel lokal dhe shtetëror, larje parash nga llojet më të ndryshme, "okupim" të procedurave të tenderëve në vend, por edhe forma të tjera, shpesh herë më të rënda kriminale.

Kjo diagnozë në mënyrë ilustruese e konfirmon një shembull të paradokohshëm nga fqinjësia: "Përdori këto para për financim të fushatës zgjedhore sepse zgjedhjet financohen nga dy të tretat e parave ilegale dhe një të tretën nga para legale" – supozohet se e ka këshilluar ish-kryeministri dhe kryetar i partisë HDZ, tash i arrestuar, Ivo Sanader trashëguesen e saj Jadranka Kosor, duke lënë më shumë se dy milionë euro para ilegale në arkën partiake në momentin e pranim-dorëzimit të funksionit kryesor partiak. Në të vërtetë, deklaratat edhe të pronarit të arrestuar të TV A1, Velija Ramkovski, për mënyrat joligjore me të cilat partia aktuale qeveritare maqedonase nga buxheti shtetëror i ka financuar fushatat partiake, janë dëshmi e fuqishme për shkallën e kriminalizimit të paskrupullt të hapësirës demokratike maqedonase.

Kuptohet, nuk ka nevojë për sqarime shitesë dhe argumentim për ndikimin e veprimeve të këtilla partiake mbi funksionimin e gjithë shtetit. Praktikisht, shteti është peng i strukturës partiake në pushtet, e cila është shndërruar në shoqëri kriminale me të drejtë që të qeverisë mbi (e jo me) shtetin.

LUFTË DERI NË SHFAROSJE

Gjithë këto faktorë kontribuojnë për shfytyrim të proceseve normale demokratike, ndërsa garën politike e shndërrojnë në “luftë deri në shfarosje” në të cilën fituesi i merr të gjitha, ndërsa humbësi i humb të gjitha. Modeli i këtillë i “të gjitha ose asgjë” në politikë quhet edhe model i “zero sum game” – fituesi merr aq sa humb pala humbëse dhe që të rritet përfitimi i njëres palë, duhet me proporcion të njëjtë të rritet edhe humbja e palës tjetër. Qëllimi i partive është që përmes zgjedhjeve “demokratike” – fjala demokratike është nën thonjëza, sepse duke marrë parasysh financimin e procesit, keqpërdorimin e mediave, kanosjet për zgjedhjen e lirë të qytetarëve, lojërat me fletëvotimet etj., zgjedhjet në Maqedoni i meritojnë thonjëzat demokratike - të bëhen me “pronësi” mbi shtetin dhe resurset e tij, ndërsa kundërshtarët politikë tërësisht t’i hedhin në margjinat e shoqërisë dhe t’i përjashtojnë nga format normale të ekzistimit politik. Logjika e “ngrënies së njerëzve të gjallë”, e shqiptuar ose e pashqiptuar, është masa dhe stimuli për luftën e përgjithshme politike “deri në shfarosje”. Kur një herë do ta fitojnë pushtetin, fryrë me steroidet e disponimit të pakufizuar me resurset njerëzore sipas gjetjes personale dhe qejfit privat, oligarkitë partiakë janë të gatshme t’i përdorin të gjitha mjetet e lejuara dhe më pak të lejuara që të mbeten në pushtet.

Strategjia e këtillë e pakompromis demokracinë e shndërron në mjet, ndërsa pushtetin në qëllim. Në këtë botë të Makiavelit, të gjitha mjetet janë të lejueshme për realizim të qëllimit. Nëse për ardhje/mbetje në pushtet pengesë është demokracia – aq më keq për të!

Në kuptimin partiak, ky shtrembërim i kuptimit të garës demokratike në shoqëri prodhon një kriter në sjelljen që ngritet si parësore mbi gjithë të tjerat – lojalitetin ndaj partisë, respektivisht ndaj liderit të saj. Mund të jeni i mençur ose budalla, i arsimuar ose pa arsim, i ndershëm ose i korruptuar, por nuk guxononi të jeni jolojal. Lojaliteti, për çdo rast, përforcohet me deklaratatë të nënshkruara për dorëheqje nga funksioni shtetëror i marrë nga partia, që të përdoret nëse lideri e sheh të nevojshme që të përdoret. Kjo farë omerte partiako-politike kohëve të fundit merr edhe dimensione të reja të lojalitetit, me atë që lidhja e gjakut promovohet si garanci shtesë për lojalitetin e fituar me anëtarësim në parti. Nëse lidhja nuk mund të vendoset me lidhje të drejtpërdrejtë gjaku, atëherë lidhen martesat dhe kumbari, të cilat duhet ta garantojnë ndërlidhjen mes vete dhe heshtjen për të gjitha përdorimet dhe keqpërdorimet të kryera për qëllimet partiake, të vërtetuara, të interpretuara dhe të shpallura nga kreu partiak, respektivisht nga lideri.

Lojaliteti i vendosur në mënyrë të këtillë me të vërtetë përkujton atmosferë nga tragjeditë e Shekspirit: ngjarja është plot me dramë, me gjak dhe me lot, por edhe me paranojë nga tradhtitë dhe komplotet e vazhdueshme oborrtare. Ky është lojaliteti “mesjetar” ndaj interesit personal/grupor, jo ndaj standardeve moderne të vlerave demokratike ose ndaj interesave shtetërore. Në këtë model të qeverisjes, parimet dhe procedurat e demokracisë dhe interesave shtetërore janë të mira vetëm nëse u përgjigjen interesave të partisë në pushtet. Lojaliteti i këtillë shpërblehet me ngritje në detyrë dhe me rritje të të ardhurave, me sigurim të fisit dhe farefisit. Bëhet fjalë shumë me tepër për patologji sesa për politikologji.

DIALOG NËN TENDË

Në kontekstin e këtillë ultimativ politik – Ose ne ose ata! - agjendat politike janë maksimaliste, ndërsa komanda partiake është që të mos lihet asnjë “peng” i gjallë. Dialogu politik publik mes kundërshtarëve politikë më shumë i ngjan negociatave ushtarake nën ndonjë tendë, në margjinat e fushëbetejës ose në ndonjë vagon të parkuar në fund të hekurudhës. Faktori ndërkombëtar, i cili me vite dhe në raste të shumta paralala-

jmëron për mungesë të dialogut konstruktiv politik në vend dhe për atë se tendencat e këtilla ashpërsohen, në vend që të relaksohen, me siguri së shpejti do të duhet të sjellë ekspertë për negociata në krizat e pengjeve (si Perdju, Solana, Hollbruku i ndjerë?), sepse demokracia e Maqedonisë me të vërtetë gjithnjë e më shumë i ngjan një pengu të rrëmbyer nga ndonjë bandë kriminelësh, të cilët në pushtet vijnë me zgjedhje.

Me ardhjen e VMRO-DPMNE-së në pushtet në vitin 2006, dialogu politik në vend, i cili më parë, pak a shumë zhvillohej në korniza deri diku të denjësishme dhe të paktën me dinamikë minimale, përjetoj bllokadë complete, në kushte të konfrontimit total mes palëve "në luftë". Logjika e fituesit në zgjedhjet e fundit parlamentare, lokale dhe presidenciale është se për dialog pothuajse as që ka nevojë, duke pasur parasysh legjitimitetin e fituar në zgjedhjet. U promovua edhe politika sipas së cilës çdo artikulum publik i ndonjë qëndrimi ndryshe nga pushteti shpallet si mbështetje e opozitës. "Ose jeni me ne ose jeni kundër nesh!" nuk ka "vend i askujt", nuk ka mospërcaktim, nuk ka pavarësi. Personat me mendime të kundërta përjetojnë dëbim publik dhe stigmatizim, të cilat dimensione kanë karakteristikë të regjimeve autokrate nga periudhat më të këqija të shekullit të kaluar. Kanosjet janë në diapazon nga presionet sociale, përmes kufizimeve të një sërë të drejtash politike, deri në ndjekje tatimore ose penale me dimensione kafkiane. Fuqia demonstron para kamerave, ndërsa drejtësia përfundon edhe para se të kalohet pragu i Njësitit të Shkupit, në shoqërim të "robokapëve" të shëmtuar të policisë.

Frika është element i rëndësishëm në mënyrën e këtillë të qeverisjes. Ajo e paralizon opinionin, e shtyn të distancohet nga personat me mendime të ndryshme. Pushteti edhe nuk fsheh se ka qëllim të qeverisë me ndonjë pore të shoqërisë: gjyqësinë, mediat, biznesin, komunitetin akademik, sferën joqeveritare, shoqatat profesionale, administratën shtetërore, etj. Në vepër është procesi i pushtimit gjithëpërfshirës partiak në emër dhe për llogari të një garniture qeveritare. Ky eksperiment i rrezikshëm partiak ka shenja të fuqishme të inxhinierisë së dhunshme sociale edhe në sferat materiale dhe jomateriale të jetesës shoqërore.

Projekti i pushtetit nuk zbatohet vetëm në terrenin e mirëkuptimit tradicional në sferat ekonomiko-politike në shoqëri dhe mbizotërimin partiak me institucionet e shtetit. Përkundrazi, orvatja është shumë më gjithëpërfshirëse dhe në ambiciet e saj numëron ripërkufizim themelor ("total design") të postulateve historike për ngjarjet dhe vlerat e shtetit dhe shoqërisë së Maqedonisë, për pamjen arkitektonike të qyteteve, për rolin e religjionit në jetën e qytetarëve, për çështjet e raportit ndaj llojeve të ndryshme të pakicave në shoqëri, për ripërkufizimin e vlerave familjare etj.

Në bazën e vet, do të mund të thuhet se projekti i VMRO-DPMNE-së ka për qëllim ta zhvendosë sistemin liberal vlerësues, i cili (me shumë mund) mbisundonte në shoqëri në maqedonase në dy dekadat e fundit, drejt shumë ideve më konservative për konstituim të sistemit të ri vlerësues, më i afërt drejt kuptimeve të pushtetit. Agresiviteti në imponimin e "pikëpamjeve të reja" mbi realitetin dhe urgjencën në të cilën insistohet në torpedimin e një numri të madh të vlerave të shkaktuara në shoqëri, ndonjëherë hijëson edhe disa qëllime dhe nisma të mira nga kjo ndërmarrje megalomane, socio-inxhinierike politike. Shpejtësia dhe mosformësimi i mirë ideologjik i gjithë projektit, i cili do të duhet të përkujtojë në kapjen maqedonase të inkuadrimit drejt "konservatizmit modern" në botë, prodhon një sërë kontradiktash në realitet: shoqëria tregtare dhe ekonomia e lirë nënkuptojnë rol të limituar të shtetit dhe shans jopartiak për iniciativë të lirë për secilin, e jo anasjelltas; liritë individuale nënkuptojnë mospërzjerje të pushtetit në praktikimin e tyre, e jo anasjelltas; sundimi i "rendit dhe sistemit" të fuqishëm nënkuptojnë praktikë të fuqishme antikorrupuese të pushteti dhe parim të sundimit joselektiv të së drejtës, e jo anasjelltas; përforcimi i rolit të vlerave familjare

kërkon standarde të larta morale te pushteti, e jo anasjelltas; qëllimi që të rregullohet sjellja sociale e njerëzve (nga shprehjet e pirjes së duhanit, deri te numri i fëmijëve të lindur në familje) kërkon qeverisje me shembull personal, e jo anasjelltas; etj.

Kontradiktat në atmosferën e këtyllë “të rënduar”, nervoze dhe jodemokratike kanë reflektim të fuqishëm mbi cilësinë dhe mënyrën e politikës publike dhe komunikimit jopolitik në vend. Në komunikimin zyrtar partiak edhe mes ithtarëve të opcioneve të kundërvëna zakonisht mbisundon gjuha e propagandës. Kundërshtari vihet në një dimension negativ, ndërsa veprimet ose deklaratat e tij nxirren nga kontesti dhe i përshkruhen karakteristika nënçmuese. Gënjeshttrat njëqind herë përsëriten (shpesh edhe nëpër fushata reklamuese të paguara partiake) që t’i ngjajnë së vërtetës. Propaganduesit i kushtojnë po aq vëmendje asaj që nuk duhet të publikohet, sa edhe asaj që duhet të publikohet. Qëllimisht përzihen informacione kompetente me të pavlefshme, që të dytave t’u jepet njëfarë kredibiliteti. Kërkohen dhe paguhen kanale komunikuese kredibiluese, që të plasohen informacione jokredibiluese, me ç’rast në mënyrë të barabartë shfrytëzohen edhe mediat masive edhe ato alternative. Zakonisht synohet ndjenjat, e jo mendja e publikut, ndërsa edhe problemet më komplekse vendosen në pyetje “kuizi” bardh e zi, që të promovohet qëndrimi personal dhe të zhvlerësohet kundërshtari. Shpifjet plasohen si fakte, ndërsa faktet shtrembërohen aq shumë, sa që bëhen të pakuptimta.

„DEMI I TËRBUAR” I PROPAGANDËS

Propaganda në politikë, duke përfshirë edhe “të zezën”, nuk është asgjë e re, as në mënyrë të veçantë skandaloze. Perceptimet në opinion (dhe ndërrimi i tyre) janë lëndë e përhershme e aktivitetit politik dhe bëjnë pjesë në rrethin më të ngushtë të detyrave në “përshkrimin e punës” së çdo politikani.

Megjithatë, ajo që në gjithë aktivitetin aktual propagandues dhe në mega-projektin e tanishëm të pushtetit për ndikim mbi parimet në opinionin e Maqedonisë paraqet risi të rëndësishme, e me këtë, në mënyrë thelbësore e dallon nga periudhat paraprake kur janë praktikuar teknika të ngjashme të komunikimit politik – nuk është vetëm sasia e madhe e jashtëzakonshme e agresionit dhe konfliktit që promovohet nga qendrat partiake për komunikim, por edhe sasia e parave që janë në “qarkullim”. Investimet janë në mënyrë dramatike të rritura me vendimin e pushtetit që të mos kursejë para për makinerinë e saj propaganduese. Për fat të keq, kualifikimi i këtyllë nuk është vetëm finesë retorike. “Demi i tërbuar” i propagandës qeveritare brenda një viti shpenzon dhjetëra milionë euro para publike që, me plot kuptimin e fjalës, ta imponojë “të vërtetën” e vet propaganduese mbi shoqërinë.

Oferta financiare-propaganduese nga ana e pushtetit, krijoi kërkesë të madhe në tregun medial dhe tregun që e shërben industrinë propaganduese. Pjesë e rëndësishme e mediave ekzistuese, firmat për marketing dhe agjencitë për marrëdhënie me publikun, institutet “hulumtuese” për matje të pulsit të opinionit, organizatat joqeveritare dhe shumë individë, ekzistimin e tyre e orientuan drejt orvatjes që përmes tyre të kalojë një pjesë sa më e madhe e mjeteve financiare që i shpenzon pushteti në promovimin e tyre dhe në prezentimin e vlerave dhe projekteve, për të cilat angazhohet. Është imponuar një logjikë e veçantë e “qëndrueshmërisë” në treg – sa më shumë shpenzohet, aq më shumë rritet oreksi për shpenzime të reja. Lidhja mes të shpenzuarës për propagandë, efekteve të tyre dhe atij që i jep mjetet financiare, bëhet ekzistenciale.

Derdhja agresive, jo transparente dhe selektive e parave publike në pjesën e propagandës televizive në disa vitet e kaluara kishte detyrë të dyfishtë: të blejë hapësirë

dominuose për transmetimin e mesazheve qeveritare, por edhe ta përfitojë për vete politikën e pavarur redaktuese tek media mirë të paguara informative. Pasojat janë, qartë, në radhë të parë politike, por edhe ato mbi tregun nuk janë për t'u nënçmuar. Shumat milionëshe në euro që u derdhën në llogaritë (dhe në xhepat) e pronarëve të disa televizioneve të Maqedonisë kontribuan për çrregullim në themel të politikës së çmimeve në treg (dhe në shitjen e sekondave reklamuese, si dhe në blerjen e programit), por edhe për çrregullimin total të konkurrencës lokale në treg. Këto pasoja do të zgjasin shumë më gjatë edhe pas ndërprerjes së mjeteve të larta financiare korrupsive qeveritare për monopolizim të tregut medial në vend.

Në këtë mënyrë, "rrethi i magjepsur" i praktikës së këtushme politike mbyllet: partive u nevojiten gjithnjë e më shumë para që të mbeten në pushtet ose ta fitojnë atë; kjo e bën procesin politik gjithnjë e më të shtrenjtë dhe më të korruptuar, ndërsa resurset janë më të kufizuara dhe presioni mbi to është gjithnjë e më i madh; kjo e përforcon konfliktin shoqëror-politik dhe e përforcon logjikën fituesi-merr-gjithçka të veprimit politik. Procesi sillet në rreth, ndërsa "kënaqësia" nga paratë e shpenzuara dhe konfliktet e thelluara rritet në katror!

BE – PO, POR ME KUSHTET TONA!

Dalja nga kjo situatë nuk mund të jetë e shpejtë, as e thjeshtë. Shprehinë e fituara nuk ndërrohen lehtë, ndërsa elitat ekzistuese politike nuk tregojnë shenja të gatishmërisë për ndryshime qenësore as në mënyrën si janë të organizuara partiakisht, as në metodat e luftës politike.

Mënyra magjistrale për reformimin e sistemit politik, e me këtë edhe të vetëdijes dhe kulturës politike në vend, është ecja në rrugën e euro-integrimeve. Në atë rrugë qëndrojnë disa sfida të mëdha.

Nga njëra anë, Bashkimi Evropian ndodhet në udhëkryq në zhvillimin vetjak. Unioni në periudhën që pason do të duhet ta konsolidojë pozicionin e vet ekonomik dhe energjetik sipas krizës globale, që ta zgjidhë fatin e euros dhe aspektet e ndryshme nga "kriza kushtetuese" vetjake, nëse dëshiron në korniza botërore të mbetet zonë stabile ekonomike dhe politike. Rritja e politikës djathtiste dhe e forcave anti-evropiane në vendet-anëtare të BE-së nuk ngjallin shpresë, të paktën në afat të mesëm, se arritjet në bashkimin e Evropës do të vazhdojnë me tempin e njëjtë sikur edhe në dekadat e kaluara. Përdërisa Unioni kujdesshëm e riheton politikën e vet ndaj fqinjëve, integrimi i Ballkanit Perëndimor, të paktën në mënyrë deklarative, mbetet pjesë e prioritetëve të tij politike. Por, është fakt se politika evropiane qëndrën e saj nga Brukseli e zhvendosi në kryeqytetet e shteteve më të mëdha konstitutive të BE-së, e ky trend i "mbylljes" nacionale të agjendave politike gjithmonë paralajmëron kohë të introspeksionit dhe rishqyrtimit të prioritetëve të jashtme politike, e jo të zgjerimit aktiv të Unionit dhe hapjes drejt asaj që BE-ja e konsideron për fqinjësi të saj.

Në anën tjetër, në disa vitet e fundit Maqedonia tregon dëshirë të fuqishme deklarative për anëtarësim në BE, por me kushte të vetat. Për strukturën qeveritare në Shkup shumë më të rëndësishme janë proceset e "okupimit" të plotë (vmroizimit) të shoqërisë dhe përgatitja për mbetje shumëvjeçare në pushtet, sesa zbatimi serioz dhe joselektiv i reformave të domosdoshme për integrim të mëtutjeshëm në sistemin e BE-së. Prioritetet e këtilla të pushtetit nuk do të ndërrohen në një kohë të shkurtër, e sidomos derisa kjo do të thotë rejting i mjaftueshëm mes votuesve për fitimin e zgjedhjeve të ardhshme.

Këto trende, nga aspekti i kulturës politike dhe i dialogut politik në vend, nuk ngjallin optimizëm. Maqedonia në një periudhë të shkurtër dhe të mesme hyn në krizë politike të shkaktuar, para se gjithash, nga paaftësia që të zgjidhen problemet sociale dhe

ekonomike në shoqëri, por edhe nga politika, e imponuar nga pushteti, e zgjidhjes së problemeve të hapura përmes imponimit të qëndrimeve me anë të konfliktit dhe konfrontimit. Ndarjet në shoqëri thellohen paralelisht me mbajtjen e besimit të ulët në institucionet e sistemit, ndërsa dëshira për dialog mes partnerëve socialë, politikë dhe të tjerë në shoqëri zvogëlohet.

Kjo do të thotë se fjalori politik në Maqedoni edhe më tej do të “ngurtësohet”, në mediat do të mbizotërojnë lajmet dhe fushatat negative, ndërsa partitë do të mbeten të palëkundura në pozicionet e tyre në pritje të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në muajt e ardhshëm. Pjekuria e demokracisë së Maqedonisë do të kalojë edhe nëpër një fazë të ndarjeve dhe zhgënjimeve.

Kohët më të mira për ngritje të cilësisë së kulturës politike në Maqedoni anulohen për një kohë të pacaktuar.



Dusan Velickovic

Dushan Veličković (1947), Serbi, gazetar dhe shkrimtar, autor i librave *Imazhe të dyshimit*, *Amor Mundi*, *Internacionalja*, *Gjingjiq* dhe *Serbia hardcore*, si dhe i filmave *Lenini në lëvizje*, *Njerëz të vdekshëm*, *krime të pavdekshme* dhe *Gjingjiq*, një rrëfim jete. Veprat i janë përkthyer në më shumë gjuhë të botës. Tregime, ese dhe artikuj ka publikuar në shumë revista dhe gazeta botërore (*Foreign Policy*, *Wiener Journal*, *La Vanguardia*, *Washington Post* etj.). Tregimet e tij përfshihen në antologjinë italiane të prozës bashkëkohore serbe *Casablanka serba*. Ka qenë kryeredaktor i revistave javore *NIN* (1993 – 1997) dhe *Evropa* (2007 – 2008). I themeloi revistën *Biblioteka Alexandria* (1998) dhe shtëpinë botuese *Alexandria Press* (1999). Ka qenë bursist i *Literature Board of Australia Council* në Sidnej dhe *Melburn* të Australisë (1983 – 1985), *University of East Anglia* në Noruiç, Angli (1988) dhe *Château de Lavigny International Writers' Residence* në Zvicër. Është bartës i Çmimit ndërkombëtar për liri dhe gazetari në Napoli në vitin 2009. Jeton në Beograd.



Dushan Veličković

Dialog me vetëvrasësin

Në shikim të parë, Serbia është e pasur me dialogje. Do të mund të themi se dialogu në Serbi është me të vërtetë në modë. Emisionet më të shikuara në televizion janë ato në të cilat zhvillohet dialog, ndërsa një gazetë madje ka edhe rubrikë standarde “Serbia bisedon”. Politikanët ballafaqohen me njëri-tjetrin, punonjësit e pakënaqur bisedojnë, ekonomistët zhvillojnë dialog për dalje të mundshme nga kriza. Dhe për çudi të Perëndisë, e gjithë kjo kryesisht është e zbukuruar, deri në atë nivel sa që do të thonin se kultura e dialogut në Serbi është në nivel të lakmueshëm.

Tashmë një kohë më të gjatë nuk ka sharje në Parlament, atje më askush nuk gjuan me këpucë dhe nuk i mallkon kundërshtarët e tij, siç e bënin këtë deri para do kohe radikalët. Pas gej paradës së krenarisë dhe trazirave nëpër rrugët e Beogradit, nuk ka as vërshime më të mëdha të urrejtjes në opinion. U lodhën edhe

Se gjithçka është gënjeshtër, ndërsa Serbia është bartësi i vetëm i të vërtetës të cilën askush nuk e vëren dhe nuk është ndonjë lajm i ri, por risi është ajo që këto mendime janë gjithnjë e më shumë të pranishme në jetën politike dhe kulturore

grupet tifoze, madje kështu, mund të thuhet se momentalisht në Serbi, kur bëhet fjalë për dialogun, ndodh çudi e vërtetë. Do të thotë, në qoftë se për kulturën e dialogut mendohet në mënyrë triviale, të përditshme, duhet të pranojmë se dialogu bëhet “më i kulturuar” në sfera të ndryshme të jetës politike, shoqërore dhe kulturore. Njerëzit u mësuan me njëfarë rendi, dinë t’i dëgjojnë argumentet, atyre t’u përgjigjen edhe në tërësi, populli u arsimua, e dinë se çka është kryefjala e çka kallzuesi, bukuri fare.

Por vallë ajo që tani çdo ditë e dëgjojmë në skenën politike dhe shoqërore është dialog i vërtetë ose vetëm imitim? Ndoshta kjo është vetëm një mënyrë që të evitohen çështjet e vërteta, të mashtrohet pala tjetër ose përmes “dialogut” të kthehet në dobi, duke krijuar me të një mendim kolektiv fiktiv, duke i dhënë drejtim, madje shpejt kjo do të bëhet paragjykim i përgjithshëm i pranueshëm. Ose ndoshta, thjesht, dialogu në Serbi është disiplinë e papërfillur, si edhe kultura ose madje kultura politike, e cila është në gjendje të mjeruar. Në fakt, pyetja e vërtetë do të ishte: çka është ajo që neve na ofrohet në tregun e dialogut në Serbi dhe çka ne më lehtë blejmë?

Qëllimisht përdora fjalën “treg”, duke pranuar termin e Brajan Inos që doli nga etiketi-mi i tij i kohës në të cilën jetojmë, si kohë e tregut global.

“Kjo është domethënë, epokë e tregut” tha Brajan Ino, por krijohet treg më i madh, gjithëpërfshirës, një treg që ushton nga negociata të pandërprera midis njerëzve, ku idetë, teknika, prodhimet, filozofitë dhe stilet e jetës u prezentohen blerësve potencialë, ndërsa ata i shikojnë, provojnë, refuzojnë, përmirësojnë dhe harrojnë. Tregjet e këtilla janë relativisht të lira nga ideologjitë: vlera e çdo të mire matet me sasinë e vëmendjes që atë e tërheq.

Valuta është vetëm një prej matësve për këtë vëmendje, sepse të hollat i dedikohen vetëm asaj që mund të blihet me to (ky është një treg më i vogël në kornizat e tregut më të madh). Shumë të mira të këtilla garojnë mes vete, që ta tërheqin vëmendjen tonë, por nuk mund të blihen me të holla – për shembull, rregullimet shoqërore të cilat do të kontribuojnë me shfrytëzim më të mirë të aftësive njerëzore: këto rregullime më nuk janë zbatuar nga vendime kategorike a arbitrare fetare ose ideologjike, por edhe ato janë pjesë e ofertës, luftojnë në tregun ku janë të ekspozuara, që ne rastësisht t’i aprovojmë dhe miratojmë. Rregullimet shoqërore janë të suksesshme deri në atë masë që i përgjigjet asaj se sa ne jemi të interesuar t’i blejmë “aksionet” e tyre në atë “bursë” – e jo t’i blejmë me të holla por me pajtimin që të jetojmë në mënyrë të caktuar specifike, jo në ndonjë tjetër.

Kjo deklaratë e Brajan Inos për mua është pretekst i shkëlqyeshëm, që të mos aktroj ndonjë teoricient serioz, i cili ja, bëhet i mençur dhe gjerë e gjatë do të rrëfejë për kulturën e dialogut, duke iu referuar Platonit dhe disa autoriteteve tjera. Kjo do të ishte mundim edhe për mua dhe për lexuesin. Çfarë ka këtu për t’u folur shumë, nëse bëhet fjalë për tregun? Të gjithë jemi në atë treg, e kështu edhe përvoja personale është tejet e mjaftueshme për analizë të gjendjes së gjërave.

Dhe ja, përkujtohem në përvojën personale të “tregut të dialogut” në Serbi. Çfarëdo gjërash më kujtohen, por do të ndaj diçka të përjetuar para do kohë. E kujtoj një ditë në jetën time, çfarë ka shumë në të, pas së cilës konkludova se në Serbi mezi që ekziston dialog. E kam fjalën për dialogun e vërtetë, i cili ngrit çështje kyçe, krijon ndjenjë të tolerancës dhe e avancoon procesin e demokracisë.

Ja se çfarë ndodhi, ndërsa më pas do të shohim se nëse nga kjo mund të nxirret ndonjë mësim.

Domethënë, u nisa në qytet që ta blej librin e publikuar pas vdekjes të Nikolla Koleviqit *Formimi i Republikës Serbe – ditar – 1993 – 1995*. Shumë persona në Serbi mendojnë se kjo është ngjarje kulturore me rëndësi epokale, posaçërisht për shkak të asaj që është parathënie e librit që e shkroi Dobrica Qosiqi, shkrimtari më i njohur serb dhe më

me renome. Nikolla Koleviq, profesor universitar, ekspert për Shekspirin, gjatë luftës në Bosnjë ka qenë një prej bashkëpunëtorëve më të afër të Radovan Karaxhiqit. Bëri vetëvrasje në vitin 1997. Të kishte jetuar edhe pak, ndoshta edhe ai do të përfundonte në Hagë. U futa në mendime se vallë ky libër dhe kjo parathënie ndoshta zbulojnë diçka të re në nacionalizmin serb me ideale veçmë të shuara dhe kjo ishte ajo që më interesonte. Ndoshta në tregun e argumenteve nacionaliste ka diçka të cilën nuk e kam vërejtur.

Në rrugë pashë një grafit në mur, dukshëm i shkruar në shpejtësi me sprej, sikur autori të frikësohej se dikush do ta shihte: "Jetoj në Serbi dhe nga kjo do të vdes". Realisht, ky shkrim është që moti atje, por mua asnjëherë nuk më ik pa e lexuar. Dhe çdo herë më krijohet asociacion i ndryshëm.

Sot m'u kujtua se autori nuk ka dashur të thotë se Serbia është ndonjë sëmundje vdekjeprurëse, por më shumë si ndonjë domosdoshmëri, e ngjashme me atë që shkrimtari polak Mjecisllav Jastrum e thoshte për jetën, në librin e tij *Sëmundje e bukur*.

Sot më argëton edhe supozimi se autori anonim i këtij mesazhi është ndoshta po i njëjti i cili, nëpër muret e Beogradit në vitin 1999, shkruante: "Është pranverë, ndërsa unë jetoj në Serbi". Pothuajse jam i sigurtë se kjo është e njëjta dorë, e cila tani parafrashohet. Ndryshuan kohët dhe atyre duhet t'u përshtaten edhe definicionet. E dua këtë art rrugor beogradas, atë humor të errët dhe njëfarë optimizëm pervers.

E di një librari në qendrën e qytetit, atje sigurisht do ta gjej librin. Libraria dikur, në ish-Jugosllavi, quhej "Komunist" dhe kishte për qëllim të shesë literaturë ideologjike dhe propagandistike, ndërsa me kalimin e kohës, tejet papritur u bë vend pothuajse kult për secilin që dëshironte t'i gjejë librat më të mirë dhe më të rëndësishëm. Sot, pas kthesës së re paradoksale, në ambientin demokratik letrar, kjo librari ka udhëtuar nëpër kohë deri në të kaluarën dhe është specializuar për literaturë kryekëput nacionaliste. Është bërë edhe një lloj i shtabit kulturor të lobit kundër Hagës. Menjëherë pas arrestimit të Radovan Karaxhiqit, në hyrje të librarisë është vendosur shtatorja e tij, ndërsa në vitrinë librat e tij janë vendosur në vende të dukshme.

Arrij deri te ura e cila i lidh pjesën e vjetër me të renë. Në mes të urës, në skaj qëndron një djalosh dhe po përgatitet të kërcejë në lum. Paraqitet rrëmujë, mbërrin edhe policia, por djaloshi nxori pistoletë. Nuk është e qartë se a u kërcënohet njerëzve që dëshirojnë ta kthejnë nga vetëvrasja ose do të qëllojë veten. Policia e ndali komunikacionin dhe shumë shpejt në të dy anët e urës krijohen kolona të pafundme automjesh. Beogradi nuk ka shumë drejtime alternative përmes të cilave mund të arrini deri në qendër, madje ky është fillimi i kolapsit të përgjithshëm të komunikacionit.

Policët me durim kujdesshëm përpiqen t'i afrohen vetëvrasësit, por shoferët nuk kanë kohë, ata shpejtojnë. Një njeri me moshë të mesme përmes dritares së automobilin bërtet: "Hajde shtyjeni më, që të kalojmë". Një grup vajzash po inkurajonë djaloshin, duke recituar: "Kërce, çfarë pret? Kërce, çfarë pret?".

Nuk ka kohë që të mendohet se vallë beogradasit janë pa ndjenja ose humori i keq u është rritur në zemër, sepse kjo shpejt u shndërrua në art të vërtetë, në teatër të vrazhdë, regjinë e të cilit sikur ta kishte bërë personalisht Antoen Arto. Një person, duke bërë me dorë, thotë: "Merrjani atë pistoletë, unë personalisht do ta vras që t'ia shkurtoj brengat". Me siguri Arto do të dëshironte ta shohë edhe këtë skenë: një nënë i nxjerr fëmijët nga automobili, fëmijët të buzëqeshur përqafohen, e ëma i fotografoi me vetëvrasësin në prapaskenën e kuadrit, i cili assesi të vendos të kërcejë.

Dikush thotë se policia në fakt, pret një ekip të specializuar për raste të këtilla, ekspertë të trajnuar që të negociojnë me vetëvrasës. Atëherë përhapet zë se negociatorët nuk kanë gjasa të mbërrijnë, për shkak se komunikacioni është tërësisht i bllokuar në gjithë qytetin. Në pamje, kjo informatë është e saktë, për shkak se policët në urë menjëherë

vendosin ta zgjidhin situatën në mënyrë të thjeshtë, laike – dhjetëra prej tyre vrapojnë drejt djaloshit në skajin e urës, ai largohet duke provuar të kërcejë por ata fuqishëm e ndalojnë dhe shpejt e fusin në makinën policore. Lëshohet perdja në këtë teatër të vrazhdë dhe unë vazhdoj drejt Nikolla Koleviqit dhe Dobrica Qosiqit.

Në hyrje të librarisë më pret një befasi – shtatorja e Karaxhiqit është thyer. Dikush ka kaluar afër dyqanit, nuk ka mundur të rezistojë dhe e ka përplasur për toke. Pronari i ofenduar i librarisë, në mënyrë demonstruese e ka lënë shtatoren shtrirë të thyer, ndërsa në derë ka lënë mbishkrim *Ekspozitë e artit aplikativ vandal*. Mendoj për atë se si Karaxhiqi, kështu i thyer, do të mundet që me të vërtetë të jetë eksponat i ndonjë ekspozite postmoderne. Deri sa ishte në një copë, nuk ishte asgjë tjetër përveç objekt i admirimit nacionalist, por tani kjo tërësi e gjërave të thyera copë-copë nga gjipsi, merr dimension të ri, shumë interesant.

E shfletoj librin e Nikolla Koleviqit dhe i hedh një shikim parathënies së Dobrica Qosiqit, shpejt duke konkluduar se në publicistikën nacionaliste serbe megjithatë nuk ka ndodhur asgjë e re. Po heq dorë nga blerja e librit, por një mendim nga Qosiqi më mbetet në kokë: “Para nesh, njerëzve bashkëkohorë, ndodhi inversion epokal i një ngjarjeje historike: gënjeshtër për gjenocidin në Srebrenicë u bë e vërtetë e shenjtë dhe globale... Gënjeshtër për luftën në Bosnjë, një gënjeshtër xhihade dhe spiune, e cila me rëndësinë dhe pasojat që i ka, ka mundur të ndodhë vetëm në qytetërimin dhe konstelacionet e një bote, baza kognitive e së cilës janë gënjeshtër dhe mashtrimi”.

Se gjithçka është gënjeshtër, ndërsa Serbia është bartësi i vetëm i të vërtetës të cilën askush nuk e vëren dhe nuk është ndonjë lajm i ri, por risi është ajo që këto mendime janë gjithnjë e më shumë të pranishme në jetën politike dhe kulturore. Ekzistojnë edhe mendime alternative dhe të kundërta, por qëndrojnë të vetmuara dhe janë, në njëfarë mënyre, tepër serioze, kështu që shumë personave u duken vetëm si ana tjetër e monedhës, sikur të jetë i njejtë dogmatizëm, por me ngjyrë të ndryshme. Njëra palë quhen partiotë, ndërsa tjetra tradhtarë dhe antiserbë. Thuhet: ky roman është antiserb, ose shfaqja është antiserbe, çdoherë diçka është patriotike ose tradhtarë.

Por çfarë u bë me ironinë beogradase, me humorin beogradas, i cili ashtu bukur mund të bënte të qeshnin edhe njëriën edhe palën tjetër dhe i cili në fund, e mposhti Millosheviqin dhe regjimin e tij? Ai gjithsesi ekziston, vetëm duhet pak ta kërkojmë nën shtresat e propagandës zyrtare dhe zhurmës nacionaliste, të zhytura në baltën e së kaluarës.

Dhe kështu, në vend në ish-librarinë komuniste, frymën kreative dhe të lirë të jetës kulturore beogradase e gjeta në valët e një radio stacioni të vogël, të hapur para do kohë. Quhet Radioja e Re Beograd dhe mund të dëgjohet vetëm përmes Internetit.

Udhëheqësi këndon me zë të ulët një këngë të disko-pank grupit nga Nju-Jorku, *LCD Saundsystem*, por me fjalë pak të ndryshuara: *Prishtinë të dua, por tërheq teposhtë*. Pastaj u dëgjua paralajmërimi: *Prishtinë – Beograd, gojë në gojë, vesh në vesh*. Kështu filloi programi i përbashkët njëorësh i Radios së Re Beograd dhe Urban FM radios nga Prishtina, i quajtur Ballkani i Ri. E gjithë kjo paralajmërohet si këmbim kulturor, si vendosje e sërishme e kontakteve të ndërprera dhe që të mos ndodhë ndonjë hutim, udhëheqësi shton: *Shporruni politikanë!* dhe pastaj në mënyrë ironike: *Ne jemi këtu vetëm për shkak të parave*. Në program dëgjohet edhe gjuha shqipe edhe ajo serbe, por dialogu zhvillohet kryesisht në gjuhën angleze.

Megjithatë, temat që bisedohen edhe në studion beogradase edhe në atë prishtinase, i ngajnë diçkaje që është ose shumë e ndjeshme ose është tabu temë. Por askush prej tyre nuk i kushton vëmendje kësaj. Formula është e thjeshtë – për çfarëdo gjëje mund të flitet me tallje dhe ironi, çdo dogmë politike dhe ndalesë ka fytyrë tjetër të vetën, karikaturale. Kështu për shembull, emetimi i një emisioni u përputh me përvjetorin e

pavarësisë së Kosovës. Nga studioja beogradase thonë: "Hajde atëherë na lëshoni himin tuaj". Dhe në momentin kur njeriu do të frikësohet, duke menduar se kjo po bëhet e rrezikshme dhe se disa patriotë të zellshëm mund të futen me dhunë në studio dhe ta ndërpresin emisionin, nga Prishtina mbërrin përgjigjeja: "Ende nuk e kemi zbritur nga interneti". Për këtë gjë të gjithë qeshen dhe duket s'ka pasur rrezik.

Dhe kështu, në këtë emision serbët dhe shqiptarët informohen për ngjarjet më të reja në skenën muzikore në qytetet e tyre dhe gjatë kësaj tallen në llogari të parrulave dhe të vërtetave të mëdha politike. Përnjëherë sikur nuk ekzistojnë ata kufij, të cilët gjatë dekadave të fundit shpesh vendoseshin në këtë pjesë të botës dhe sikur ajo "sëmundje e bukur" fare nuk ishte e pashërueshme.

Gjithsesi, ky emision nuk zgjati shumë, përfundoi shpejt, ashtu siç filloi. Siç kuptova më vonë, dialogu i papritur alternativ midis Prishtinës dhe Beogradit, është shuar më shumë për shkak të autocensurës, sesa nga ndonjëfarë presioni i hapur politik. Për ndonjë lloj më tjetër të analizës, do të ishte interesant fakti se në një ironi pak të shfrenuar, rinore, pala prishtinase më gjindej vështirë. Arsyeja për këtë me siguri qëndron në faktin se, konsensusi politik prishtinas për pavarësinë është më unitar, sesa që është konsensusi beogradas për mosnjohjen e kësaj pavarësie, edhe pse është legal sipas kushtetutës.

Dhe çka mësova unë, në një ditë të tillë, për tregun e dialogut në Serbi? Si e para, shoh se nacionalizmi, patriotizmi dhe krimet e luftës, ende janë tema të nxehta të cilat vetë spostohen për dialog, por sikur të mos ekzistojë dikush i cili do të hynte në atë dialog në mënyrë të vërtetë. Mirë, të supozojmë se bëhet fjalë për treg plotësisht të lirë, në të cilin në bazë të parimit të thjeshtë të ofertës dhe kërkesës, idetë nacionaliste dhe kuazi-patriotike kalojnë më mirë.

Megjithatë, nuk është gjithçka aq e thjeshtë. Dukshëm ekziston edhe dikush i cili e rregullon gjithë këtë treg. Mjafton t'i shfletoni gazetatat ose të dëgjoni se si politikanët publikisht mendojnë në tema për të cilat asnjëherë deri në fund nuk është zbatuar dialog i vërtetë, madje të kuptoni se "tregu" është në masë të madhe i dirigjuar. Mediumet e sotme kanë një veçori të pazakonshme. Në garën për tirazh më të madh dhe në dëshirën që t'i kënaqin të gjithë, shumë medime si edhe elita politike, pandërprerë zhonglojnë me klishe populiste, duke krijuar dhe duke nxitur me këtë një lloj të caktuar të mendimit publik. Ky është një kurth i shkëlqyeshëm, prej të cilit lehtë konkludohet se lexuesit e formuar në këtë mënyrë, kërkojnë pikërisht tema të këtilla, duke e lëvizur gjithë punën. Nuk do të them se mediumet duhet të kenë ndonjë rol edukativ, as se politikanët duhet të jenë iluministë të zellshëm, por në një vend në të cilin edhe elita politike edhe mediumet vazhdimisht manipulojnë me klishe dhe paragjykimet historike, kombëtare dhe të tjera, nuk mund të prisni asgjë tjetër, përveç pafundësisë së keqe.

Në qoftë se tesktet gazetareske dhe fjalimet politike janë të pasura me demagogji, duke krijuar klimë në të cilën luhet me nacionalistët dhe patriotët, atëherë të paktën nga literatura do të mund të pritet të jetë sferë në të cilën ato klishe shoqërore dhe politike do të zbuloheshin. Megjithatë, të paktë janë shkrimtarët të cilët merren me kohën në të cilën jetojmë dhe aq më pak ka vepra të mira. Nuk besoj se kjo ndodh për shkak të mungesës së të ashtuquajturës distancë historike. Më parë do të jetë për faktin se, shumë shkrimtarë, si edhe lexuesit dhe publiku televiziv, janë nga pak të hutuar nga lëmshi i makiazhit dhe mbulimit të së kaluarës, kështu që nuk guxojnë t'i demistifikojnë gjërat. Gjithsesi se ekzistojnë edhe të atillë të cilët ankohen për të kaluarën e errët, por nuk janë shumë të zëshëm për shkak se kjo sot nuk është në modë.

Patriotizmi është temë posaçërisht e privilegjuar në tregun e dialogut, i ngjan ndonjë përmendoreje të mbrojtur nga shteti. Demistifikimi i patriotizmit thjesht asnjëherë

nuk është në rend dite, me siguri sepse edhe më tej ka vend nderi në vitrinën e dyqanit i cili shet suvenire shtetërore-krijuese. Por, realiteti është tejet i ndryshëm.

Një kohë të gjatë patriotizmi paraqiste fjalë të shëmtuar, për shkak se më së shumti e përdornin dhunues dhe mashtrues të ndryshëm politikë e të tjerë, nga Sllobodan Millosheviqi dhe e shoqja Mira Markoviqi deri te Shesheli, Arkani, e të mos flasim për ithtarët e Karaxhiqit dhe Mlladiqit. Edhe më keq, kjo fjalë çdo herë ka nënkuptuar se ekzistojnë edhe tradhtarë të cilët, paramendoni, kanë diçka kundër këtyre bartësve të privilegjuar të patriotizmit. Ndërsa e dimë se çfarë u ndodh tradhtarëve. Ajo që propaganda patriotike e Millosheviqit i paraqiti Gjingjiqin dhe Çuruvijën si tradhtarë dhe që i solli në vetëm në një hap nga atentati, është një prej shembujve më drastikë dhe karakteristikë. Do të thotë “patriotizmi” u bë fjalë aq e neveritshme dhe dykuptimëshe, që unë do të kisha zgjedhur të mos e përdori.

E ngjashme si kjo, ekzistojnë fjalë në histori të cilat me kalimin e kohës marrin rëndësi tërësisht të kundërt dhe për këtë nuk ka ilaç, më mirë është të pritet për ndonjë kohë tjetër në të cilën në mënyrë natyrale do të mund të kthehen. Në vend për patriotizmin, unë do të flisja për kuptimin e interesit të përgjithshëm, për atë se a e njohim këtë interes dhe a insistojmë për këtë. Kjo është ajo që i mungon edhe elitës politike dhe të gjithë neve si individë. Por, për atë nuk debatohet, për shkak se nuk ekzistojnë “blerës” për këtë dialog.

Megjithatë, krimet e luftës dhe përgjegjësia e atyre që janë të paditur për ta janë tema të cilat, në mënyrën më të mirë japin imazh për masën në të cilën dialogu mund të jetë imitim i thjeshtë i ballafaqimit serioz dhe konstruktiv të mendimeve. Në fakt, do të thosha se kjo është pika e zezë e tregut serb të dialogut, diçka për shkak të së cilës forma e tillë e ndërgjegjësimit të njerëzve, ajo dialektikë, assesi të lulëzojë. Ka luajtje me nacionalistët e ashtuquajtur partiotë, por për të paditurit për krime lufte, shpesh midis rreshtave mund të kuptohet se ata janë, me siguri, heronj ose vetë janë viktima të rrethanave historike.

Paradokohe kisha rastin t’i përgjigjem pyetjes, vallë për Karaxhiqin vërtet do të mund të xhirohet film i mirë. Diçka të tillë përmenda në një libër timin dhe ja tani do ta plotësojë këtë mendim timin. Nuk besoj se do të ketë film të mirë për Karaxhiqin për shkak se realiteti veçmë i ngjan njëfarë filmi të krisur në të cilin, kryepersonazhi fillimisht tund me dorë disa harta derisa njerëz vriten, ndërsa pastaj maskohet në pseudomjek, që në fund, në gjyqin ndërkombëtar performon shfaqje abusrde juridiko-globaliste. Ai që këtë realitet thjesht do ta pasqyronte në ekranin filmik, do të bënte film të keq, por ai i cili do të përpiquej të gërmojë nën sipërfaqen e këtij rrëfimi jetësor, do të mund të bëjë diçka interesante. Në Karaxhiqin, të themi, mund të shihni si prototip për mashtrues të madh, që në fakt vlen edhe për të gjithë aktorët e tjerë në të ashtuquajturën krizë jugosllave. Dallohen vetëm për nga numri i viktimave dhe i të pikëlluarve, të cilët mbetën pas politikës së tyre mashtruese. Historia e Ballkanit do të mund të shkruhej si përrallë për magjistarë dhe iluzionistë, të cilët me një dorë nxjerrin lepur nga kapela, ndërsa me tjetrën juve, ashtu të magjepsur ju dërgojnë në humnerë.

Mënyra në të cilën funksionon ky mekanizëm i mashtrimit – kjo është tema e vërtetë për dialog. Në vend të kësaj, lexojmë se si ndonjë shkrimtar i njohur e thekson vetëm mendimin e tij për Srebrenicën, dikush e ka thyer shtatoren e Karaxhiqit, dikush organizon demonstrata të dhunshme për mbështetjen e të burgosurit të Hagës, ndërsa qe besa shpesh do të lexoj edhe se si Karaxhiqi ka qenë vetëm një patriot, i cili e ka mbrojtur popullin e vet.

Ylli më i ndrtishëm në yllësinë e temave për të cilat “Serbia bisedon” është gjithsesi, hyrja në Evropë. Ky ndoshta është edhe dialogu më kreativ që zhvillohet në Serbi, edhe pse falë presioneve nga Evropa, por megjithatë edhe ai ka një kufizim të qartë. Thuhet: “Po, ne duam në Evropë, por me identitetin dhe kulturën tonë”. Në shikim të parë, kjo

tingëllon si shumë logjike dhe bindëse, madje nuk është çudi që edhe presidenti i shtetit e deklaron të njejtën. Këtu do të thotë, ndërpritet dialogu, ndërsa duket sikur rasti është ideal për trumbetime me disa metoda të ashpra të të menduarit.

Mirë, unë mund të supozoj se presidenti me siguri është shprehur në mënyrë në të cilën të gjithë do ta kuptojnë. Supozoj se ka menduar për atë se në Evropë do ta fusim kreativitetin tonë, talentin tonë, të menduarit tonë të lirë dhe vullnetin e lirë, ose të paktën shpresoj se ka menduar në këtë. Unë personalisht, ngapak frikësohem nga insistimet në identitetit kulturor, kjo më ngjan si njëfarë shpifje kolektive, e fiksuar. Identiteti mund të jetë vetëm individual, ndërsa kultura nuk është diçka e pandryshueshme, të cilën diku e jepni si dhuratë ose paje, ose që ruhet në vitrinë. Nuk ekziston as identiteti yni i pastërt, as francez, as evropian, por në këtë e bëjmë me individualitetin tonë, ndërsa kultura është përherë në interaksion dhe ndryshim. Kështu ka qenë deri më tani dhe kështu do të jetë pasi që të hymë në Evropë. Ata edhe më tej do të marrin nga pak prej nesh, në ndoshta edhe më shumë prej tyre dhe gjërat nuk do të jenë si më parë. Dhe kështu ka qenë gjithmonë dhe nuk duhet të frikësohemi se dikush do të na i marrë lahutat dhe boritë.

Megjithatë, deklaratën e presidentit e interpretoj para se gjithash, si një lloj medikamenti për patriotët dhe nacionalistët vulgarë, të cilët janë të shumtë edhe në mesin e, siç do ta quanin – botës finoke – por pastaj do të duhet të pasojë falsifikim pak më vendosës i shumicës së klisheve dhe paragjyqimeve populiste, të cilat si një barrë e rëndë na tërheqin më larg Evropës. Dhe gjithsesi, më larg dialogut të vërtetë për rrugën e Serbisë drejt Evropës dhe për arsyet se pse kjo po zgjat kaq shumë.

Megjithatë, nga të gjitha gjërat të cilat e rregullojnë tregun e dialogut në Serbi, një është me rëndësi të veçantë dhe do të thosha, çështje vendimtare. Serbia si dhe çdo vend tjetër mund të zgjedhë nëse do të jetë vend i mërzhitshëm dhe sklerotik, në të cilin qëndrohet në vend, në të cilin mbisundon fryma provinciale dhe në të cilin mediokriteti është "forcë lëvizëse" e vetme, ose do të jetë vend interesant, vend i gjallë i cili qytetarëve të vet u mundëson kreativitet, shumëllojshmëri, mobilitet... Kam frikë se momentalisht në Serbi, provincializmi dhe mediokriteti janë fuqimisht të vendosur, sepse në këtë mënyrë dukshëm më mirë ruhet pushteti ose karrigia në firmë, apo edhe dominimi në familje. Madje tani, kjo po më ngjan në sëmundje të pashërueshme nga e cila janë goditur të gjitha shoqëritë në të cilat tranzicioni më zgjat më shumë dhe në të cilat formohet një klasë politike e cila më shumë kujdeset për interesat personale, ndërsa gjithnjë e më pak për të mirën e përgjithshme. Në natyrën e qëndrimit të tillë është që çdo kreativitet dhe ekskluzivitet ta shohë si diçka të padëshirueshme, e cila vetëm e prish regjimin e vendosur.

Në rrethana të këtilla, dialogu në rastin më të mirë mund të jetë i qytetëruar dhe i njerëzishëm, por nuk mund të arrijë larg, as deri në keqardhjen më të thjeshtë për vetëvrasësin në urë.



Iso Rusi

Iso Rusi (1951), Maqedoni, është gazetar. Karrierën profesionale e nis në revistën "Mllad Borec" (1971). Në RSFJ bashkëpunon me "Danas" – Zagreb, "Dello" (edicioni i së shtunës) dhe "Teleks" – Lubjanë, "Nasha Borba" – Beograd. Ka qenë bashkëpunëtor dhe kolumnist i gazetave "Koha" dhe "Koha Ditore" – Prishtinë. Ka bashkëpunuar në njëqind numrat e parë të revistës "Puls" dhe ka qenë redaktor në revistën "Fokus" (1996-2000). Ka bashkëpunuar me rrjetet AIM dhe IWPR. Ka botuar opinione në "New York Times" (1996 dhe 2001) dhe "Whall Street Journal" (2002). Është një nga themeluesit dhe kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i së përjavshmes në gjuhën shqipe në Maqedoni "Lobi" dhe i ueb-faqes tregjuhësore "Pres On Line" (2001 – 2007). Ka qenë koordinator për media në OSI Maqedoni (1992 – 1996) dhe u.d. kryetar i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë (2007 – janar 2011). Nga viti 2011 jeton në SHBA.



Iso Rusi

Një vështrim mbi Maqedoninë nga SHBA-të: Nuk ka të bëjë me fjalët, por me njerëzit

Nëse kultura politike e kuptuar si “bindje, vlera, besim dhe synime të individëve në shoqëri për sistemin e tyre politik” është korniza, në të cilën amerikanët i shprehin pikëpamjet e tyre ideologjike dhe politike, mjet me të cilin ata e realizojnë komunikimin e tyre, do të duhej të ishte kultura e dialogut, e bazuar në “besimin: se njerëzit me dallime të fuqishme mund të mbështeten njëri te tjetri me ndershmëri dhe respekt: se të vërtetat e shenjta mundën në mënyrë të hapur dhe të pambrojtur të hulumtohen; se njerëzit mund t’i drejtohen njëri tjetrit si qenie njerëzore të vetme dhe komplekse, se ajo në pamje të paprekshme mund të tregohet dhe të dëgjohet; se njerëzit mund të kërkojnë mirëkuptim të thellë për mendime shumëpalëshe dhe konfliktuoze; se edhe atje ku ka mospajtime dhe mosmiratime, ngushëllimi dhe mirëkuptimi mund ta zëvendësojnë mosdurimin dhe se me dëgjimin aktiv dhe thënien e të vërtetës nga perspektiva e tyre, njerëzit mund ta përhapin vizitonin e tyre për atë që mund të ndodhë”.

Kultura më thjeshtë e shënuar politike për amerikanët është “bindje, vlera, besim dhe synime të individëve në shoqëri për sistemin e tyre politik” ose set i ideve të cilat amerikanët i ndajnë rreth asaj se si duhet të udhëhiqet një shtet

Por, nuk duket gjithmonë kështu edhe në SHBA, e cila shquhet se djepi i demokracisë, ku liria pothuajse e pakufizuar e fjalës është një nga liritë e shenjta të inkorporuara në shoqëri në vitin 1971 në "Bil of Rajts" (Ligji për të drejtat). Oponentët e sotëm e lirisë së fjalës konsiderojnë se "liria e të shprehurit është shprehje e urrejtjes" dhe angazhohen për revokim të amendamentit të parë të kushtetutës amerikane me justifikimin se "nga viti 1791 e këndej ndjenjat e shumë e shumë njerëzve të pafajshëm janë lënduar, ndjeshmëria e milionave është ofenduar dhe e drejta e atyre njerëzve që të mos lëndohen është injoruar gjatë kohë kështu që sot madje edhe nuk paraqet drejtësi".

Ashpërsia e gjuhës në skenën politike sidomos pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2008 është më se e dukshme.. Pasionet politike mes oponentëve pothuajse ndjehen në ajër, ndarja e opcioneve politike është sjellë në prag të padurimit, ndarja (dhe ekskluziviteti) i mediave sipas afërsisë ndaj njërit apo tjetrit pol (ekstrem) politik është më se e dukshme dhe shpesh në kufij të propagandës partiake, ndarja e personaliteteve politike sipas simpativë politike bëhet e rëndësishme edhe për vlerësim të cilësisë profesionale...

A ngjan e gjithë kjo në diçka tashmë të parë te ne në Maqedoni?

1.

Më 8 janar të këtij viti në vendlindjen e tij Tuson, Arizona gjatë takimit me zgjedhësit e saj, vetëm një javë pas fillimit të mandatit të saj të dytë, kongresistja Gabriel Giford u qëllua me plumb në kokë. Gjashtë persona të tjerë të pranishëm në takim e humbën jetën (mes tyre një gjykatës federal, një ndihmës për marrëdhënie me komunitetin në zyrën e kongresistes, por edhe njerëz të thjeshtë që kishin ardhur tashohin, ta dëgjojnë ose ta pyesin Gifordin), madje trembëdhjetë u plagosën. Numrat do të ishin gjithsesi më të mëdhenj nëse revolveristi, një i ri me probleme serioze psikike, nuk do të pengohej nga disa persona trima në qëllimin që ta ndërrojë karikatorin e zbrazët me një të ri me 31 plumba të tjerë.

Kongresistja, edhe pse plumbi ka hyrë dhe ka dalë nga ana e majtë e kokës së saj, për çudi mbijetoi dhe rikuperohet shpejt dhe është në rehabilitim në Hjuston, Teksas.

Ngjarja tragjike me ditë ishte lajmi i parë në mediat amerikane, të cilat garojnë se kush do të botojë ose transmetojë informacione të reja për manifestimet e problemeve psikike të 22 vjeçarit Xhared Li Logner, për rikuperimin e Gifordit ose për njerëzit e guximshëm, të cilët në vendin e ngjarjes në gjithë rrëmujën me breshëritë e pistoletave me trupat e tyre i mbrojtën më të afërmit, e mposhtën revolveristin dhe ofruan ndihmë të parë për të plagosurve.

Menjëherë pas ngjarjes në opinion dolën edhe interpretimet e para sipas të cilëve mund të fitohet përshtypje se ngjarja është rezultat i drejtpërdrejtë i pasioneve të nxeha të skenës politike amerikane (dhe mënyrës se si mediat përballen me të) në të cilën dy alternativat dominuese – demokratja dhe republikanja – një kohë të gjatë janë në pozicione ashpër të acaruar. Për një pjesë të qarqeve liberale demokratike, procedurat agresive dhe sidomos vokabulari i konservativëve gjithnjë e më i fuqishëm në radhët e republikanëve, të paraqitur para se gjithash përmes lëvizjes Ti-Parti, krijojnë "gjakra të këqinj" edhe tek njerëzit e thjeshtë.

Që në informacionet e para për kongresisten Giford është treguar edhe harta e SHBA-ve me caqe në vendet e njësive zgjedhore, në të cilat Ti-parti republikanët duhet të bëjnë gjithçka që t'i fitojnë kundërshtarët e tyre demokratë. Me një shënjestër nga kjo hartë ishte shënuar edhe njësia zgjedhore e kongresistes Gabriela Giford. Harta ishte e vendosur në njërin nga sajtet e Sara Pelinit, pretendentes së dështuar për nënkryetare të republikanëve në zgjedhjet presidenciale të vitit 2008, e cila ndërkohë u bë një nga simbolet e forcave të reja konservative republikane. Mbi hartën qëndronte kon-

statimi “E diagnostikua problem...Na ndihmoni që ta shkruajmë zgjidhjen”, thirrje e qartë – të dështojnë të gjithë 20 demokratët, të cilëve iu kundërvunë kandidatët e Ti-parti, mëkati i të cilëve ishte ajo që kanë votuar për reformat në sigurimin shëndetësor (helthker), të cilën republikanët e quajnë “Obamaker” dhe revokimi i së cilës tani është shënuar si qëllimi i parë i kongresistëve dhe senatorëve të rinj republikanë. Kongresistja Giford me këtë rast në intervistën për rrjetin MSNBC, duke folur për retorikën e republikanëve konservativë, do të deklarojë: “Duhet të kuptojmë se ajo retorikë, kjo “djegie” e popullit...për shembull ne jemi në listën e qëllimeve të Sara Pelinit, por mënyra në të cilën ajo është bërë, me cak për të shtëna përmes distriktit tonë...se kur njerëzit e bëjnë këtë, ata duhet të kuptojnë se ka konsekuenca nga aksioni i këtillë...”.

Në këtë u ndërlidhën edhe shembuj të tjerë luftarakë nga emisionet e Glen Bekut, drejtues i radio dhe TV-emisioneve, ylli i njuz kanalit më të shikuar “Foks njuz”, she Rash Limbos, radio drejtues, të cilët në veprimtarinë e tyre mediale kontribuan për rritjen e lëvizjes populiste Ti-parti, përmes kritikës së tyre të ashpër dhe thirrjeve në aksion kundër politikës së presidentit Obama dhe demokratëve. Margaritari i tij i fundit është pohimi se nëse nuk shfuqizohet reforma e sigurimit shëndetësor e administratës së Obamës (revokimi kaloi në Kongres, por jo edhe në Senat ku shumicën akoma e kanë demokratët), atëherë SHBA-të duhet ta kalojë rrugën, të cilën para do kohë e kaloi Egjipti – si mënyrë që të rrëzohet Obama! Limbo ka edhe slogan për këtë rast “Gou Egjipt!”.

Bek për raste të Maqedonisë më lehtë mund të përshkruhet si kombinim i asaj që në TV Sitel e bën Dragan Pavloviq Llatas dhe storjeve konspirative të Mirka Velinovskës, edhe pse dorën në zemër që të dy janë “naivë” krahasuar me Bekun. Muajve të fundit Glen Bek e tejkaloi vetveten. Para dy vjetëve i promovoi vlerat e vërteta konservative, u bë ideolog jozyrtar dhe promotor altruist i “rastisjes së popullit” amerikan në formën lëvizjes Ti-parti. Në zenitin e popullaritetit dhe fuqisë së tij para Kapitolit në Uashington ditën e njëjtë të gushtit kur edhe Martin Luther King e mbajti fjalimin e tij “Kam ëndërr” (përputhjen e datës do ta shpjegojë si zgjedhje e Zotit) tuboi disa qindra mijëra njerëz, luajti në kartën profet “gjysmë laik, gjysmë fetar”. Në dritën e ngjarjeve në Egjipt, kryengritjen e shpjegoi si orkestër e marksistëve dhe Vëllezërve myslimanë, duke predikuar kataklizmë të sistemit politik në botë sipas skenarit të komunistëve dhe myslimanëve. Nga konkurrenca, rrjeti MSNBC e cila e përcjell me vëmendje (por edhe komenton), çdo dalje të tij, do të porosisin pak më ashpër në formë pyetje: Gleni e humb shikueshmërinë, por vallë po e humb edhe mendjen?

Nga aspekti i gjuhës politike të (mbi)fuqishme, Sara Pelin (në stilin e saj, përmes Tuit-erit, menjëherë e dënoi ngjarjen në Tuson dhe dëshiroi rikuperim sa më të shpejtë të Gifordit) në tentim që ta sqarojë hartën në sajtin e saj bëri gafë të re duke përdorur në intervistën e saj për “Foks njuz” termin “bllad lejbel” i cili në histori është përdorur për akuzat e rreme, me shekuj të vjetra se hebrenjtë në ritet e tyre përdorin gjak të fëmijëve të krishterë si justifikim për ndjekjen e tyre.

Edhe pse mbështetja e Sara Pelinit dhe e lëvizjes Ti-parti u solli fitore shumë kandidatëve republikanë dhe me siguri ishte një nga shkaqet për shkak të të cilave demokratët e humbën shumicën në Kongres, në rastin e Gifordit, konkurrenti i saj republikan, një ish-marins, i cili bënte thirrje në fitore zgjedhore duke përmendur armën e tij personale pushkën M16, nuk përfitoi. Gifords, edhe vetë republikane e mëparshme, e cila tani e konsideron veten si “blu dog” demokrat (i matur), megjithatë fitoi.

Vetëm disa ditë para ngjarjes kongresistja Giford mori pjesë në pikën e parë të rendit të ditës të përbërjes së re, të imponuar nga shumica e re republikane – lexim publik i Kushtetutës së SHBA-ve nga vetë anëtarët e Kongresit! Që të jetë ironia më e madhe, Gifordit i ra që ta lexojë amendamentin 1, i cili flet për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe shtypit. Në fakt, i pari nga dhjetë amendamentet e Kushtetutës amerikane, të njohura edhe si “Ligj për të drejtat”, të ratifikuara nga Kongresi i SHBA-ve më 15 dhjetor

të vitit 1791, është një nga vendet e shenjta të demokracisë amerikane. Amerikanët, si rrallë kush tjetër në botë, gëzojnë liri pothuajse të pakufizuar të shprehjes. Edhe pse, pas vitit 2001 ekzistonin tentativa për vendosje të disa kornizave më të ashpra. Kështu "Akti patriotik" i miratuar pas 11 shtatorit të vitit 2001 si pjesë e luftës kundër terrorizmit solli disa restriksione të lirive të gëzuara – përgjim i telefonave, komunikimeve elektronik, qasje në pjesë të ndryshme dhe aktivitete financiare dhe afariste, por edhe në dosjet shëndetësore e ngjashëm, mes tjerash në disa raste e vështirësonte punën e medie, për shembull, obligonte që gazetarët ta zbulojnë burimin për atë që e shkruajnë: Por përpjekjet e këtilla kanë kohëzgjatje të shkurtër (këto ditë Kongresi i ri fillimisht nuk votoi për vazhdimin e validitetit të disa segmenteve të këtij ligji kontrovers që pastaj mezi të marrë dy të tretat e shumicës, të cilën republikanët vetë e kanë, për vetëm 10 muaj vazhdim).

Presidenti Obama nga vetë fillimi nga ana e oponentëve të zemëruar republikanë është pritur në thikë. Fjalimet vjetore të presidentit amerikan para kongresistëve dhe senatorëve sipas rregullt janë ngjarje e cila është e respektuar nga mbarë spektri politik i përfaqësuar në Kongres. Barak Obama përjetoi në fjalimin e tij të parë (shkurt i vitit 2009), pa mbushur një muaj nga inaugurimi, që kongresisti republikan nga Karolina Jugore Xho Uilson ta komentojë me thirrjen "Ju gënjeni!". Drejtuesit si Bek, Limbo, TV kanalet si "Foks njuz", e shpallën si socialist për shkak të gjoja zbatimit të redistribuimit të pasurisë së SHBA-ve, pohojnë se Obama nga SHBA-të dëshiron të bëjë shtet socialist sipas disa vendeve evropiane (me ç'rast rregullisht nuk bëhet dallim mes socialdemokratëve dhe socialistëve), se administrata e tij – tej mase e madhe – shpenzon shumë mjete dhe do t'i bankrotojë SHBA-të, se me kuazi roformat e tij në sigurimin shëndetësor do ta shkatërrojë shtetin, u jepnin "zëshmëri" pohimeve se nuk ka lindur në tokë amerikane dhe si i tillë ilegalisht është zgjedhur president (sipas Kushtetutës, presidenti duhet të ketë lindur në SHBA). Kërkesat e këtilla nuk janë edhe shumë naive, kështu që në shtetin Montana, me propozim të një kongresisti të atjeshëm republikan do të shqyrtohet mundësia për ligj special, me të cilin do të verifikohet nëse kandidatët presidencialë janë me të vërtetë të lindur në SHBA, edhe pse kjo de fakto është antikushtetuese dhe meqë nuk është sferë veprimi e shteteve por e federatës, e cila për këtë edhe jep dokument. Plus, propozuesi i këtij ligji, i cili nëse miratohet do të vllente vetëm në këtë shtet, konsideron se shtetas amerikan duhet të konsiderohet çdo fëmijë i lindur në tokën e SHBA-ve me prindër të cilët kanë status të shtetasve amerikanë. Propozuesi e anulon automatizmin e marrjes së shtetësisë amerikane me aktin e lindjes në tokën amerikane, të vendosur me amendamentin e 14 të Kushtetutës së SHBA-ve. Dhe nuk është çudi që rezultat i drejtpërdrejtë i përhapjes së pavërtetës se Obama nuk ka lindur në tokën amerikane është se numri i atyre që mendojnë tani se kanë të huaj për president arrin në 41 për qind.

Fare nuk janë të rrallë amerikanët, të cilët pohojnë se feja e Obamës është islami. Para do kohë në një fokus-grup shikuesish nga Ajova në kanal "Foks njuz" pothuajse gjysma e njëzet të anketuarve në grup u prononcuan se besojnë se Obama është mysliman. Në emisionin politik në kanal NBC "Takoje shtypin" drejtuesi Dejvid Gregori në intervistën me spikerin e ri të Kongresit, Xhon Beiner pyeti pse kryesia republikane hesht dhe kontribuon që të krijohen stereotipe për fenë e presidentit të SHBA-ve. Spikeri Beiner u përgjigj thjesht se nuk është puna e tij që t'u tregojë amerikanëve çka të mendojnë. Pasi që drejtuesi ia ceku deklaratën ironike të një kongresisti amerikan se ai ka certifikatë të vërtetë nga libri amzë i të lindurve (aluzion se Obama nuk e ka) Beiner u përgjigj se kongresisti me siguri ka dashur të jetë shakaxhi.

Të orientuarit në mënyrë kritike ndaj administratës së Obamës, media, gazetarë dhe analistë jo rrallë për arsye tërësisht të qarta rregullisht me emrin dhe mbiemrin e tij e theksojnë emrin e tij të mesëm (Husein). Nga paraqitja dhe përforcimi i lëvizjes Tj-parti në tubimet e tyre në mbarë SHBA-të rregullisht mbahen transparente me të cilat Obama jo vetëm që përqeshet, por edhe paraqitet si Hitleri...

Shembujt më të rinj janë karikaturat, në të cilat Mishel Obama, e paraqitur si grua e trashë me disa hamburgerë para vetes, i komunikon bashkëshortit të saj Barak se heq dorë nga qëllimi i saj që t'i bindë restorantet t'i zvogëlojnë porcionet me ushqim të yndyrshëm, ndërsa ky i vizatuar me veshë të mëdhenj gomari, e paralajmëron se pason rizgjedhja dhe se për këtë mund të humbë vota. Finalja është replika e Mishelit: Hesht dhe ma jep dhjamin e derrit! Drejtuesi i prajm-tajm programit "Fjala e fundit" e MSMBC, Loren O'Donald i cilësoi karikaturat përfundimisht ofenduese dhe raciste, duke i bërë thirrje opinionit, por edhe prindërve dhe miqve të autorëve të karikaturave të reagojnë ndaj ofendimeve të drejtuara në llogari të "gruas më të adhuruar afrikano-amerikane në botë". Në sajtin konservativ ku karikaturat janë publikuar, komentet e vizitorëve zakonisht janë përfundimisht pozitive ose të shlyera nga ana e administratorit të sajtit – mund të supozohet se çfarë fjalori është përdorur.

Edhe pse mbështetja e Sara Pelinit dhe e lëvizjes Ti-parti u solli fitore shumë kandidatëve republikanë dhe me siguri ishte një nga shkaqet pse demokratët e humbën shumicën në Kongres, në rastin e Gifordit, konkurrenti i saj republikan, ish-marins, i cili bënte thirrje në fitore zgjedhore duke përmendur armën e tij personale pushkën M16, nuk përfitoi. Giford, republikane e mëparshme, e cila tani e konsideron veten si "blu dog" demokrat (e matur), megjithatë fitoi.

Megjithatë, kur gjuha dhe stili i komunikimit politik janë në pyetje, përbërja e re e Kongresit amerikan do të jetë interesant për shkak të kontributit të freshmenëve nga radhët e bllokut konservativ, të cilët periudhës para zgjedhjeve i dhanë shenjë të fjalimit të ashpër, të drejtpërdrejtë dhe provokues politik. Angazhimet e tyre për zvogëlim të shpenzimeve, me qëllim të zvogëlimit të deficitit rekord shtetëror amerikan në dritë të debatit për shkurtim të buxhetit është fushë pothuajse e pafund për akrobacione gjuhësore të të përzgjedhurve të popullit, motoja e të cilëve është se amerikanët kanë porositur çka mendojnë ("populli tha", "mesazhi i popullit...") në zgjedhjet për anëtarë të Kongresit dhe Senatit në nëntor të vitit 2010. Dhe kuptohet material i shkëlqyer për mediat të afërta me demokratët për komente rreth nivelit intelektual të njerëzve kryesorë të lëvizjes Ti-parti.

Ngjarja tragjike në Tuson për këtë nuk solli deri në përforcim ose krijim të masës kritike për precizim ose restriskion në zbatimin e Amendamentit të dytë të Kushtetutës së SH-BA-ve – e drejta që të posedohet dhe të mbahet armë, edhe një vend i shenjtë në liritë amerikane. E imagjinuar si e drejtë në pikëpamje të sigurisë personale dhe mbrojtjes së pronës kohëve të fundit shpesh është shndërruar në absurd sipas botëkuptimeve tona evropiane (kjo e drejtë shfrytëzohet për blerjen pushka të fuqishme automatike dhe, si në rastin e Tusonit, për blerjen e pistoletës automatike me karikator të rritur për 31 plumba nga një person, i cili është evidente se gjatë kohë ka pasur probleme psikike, për shkak të të cilave është përzënë nga kolegji). Pas ngjarjes në Tuson, opinioni u informua se Kongresi, me siguri për shkak të frikës nga reagime të pavolitshme në publik, pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit të kaluar dukshëm më i afërt me konservatorët, të cilët e adhurojnë amendamentin 2 të Kushtetutës amerikane, nuk e ka vazhduar validitetin e ligjit, i cili në 10-të vitet e kaluara parashihte procedura sado pak më të ashpra për blerje të llojeve të veçanta të armatimit personal.

Sido që të jetë opinioni amerikan megjithatë shumë shpejt u distanca nga tentativat që ngjarja në Tuson të ngjyroset si pasojë e gjuhës shumë të ashpër politike, para se gjithash nga rryma e re e përforcuar konservative në radhët republikane. Tërthorazi solli deri në debat për cilësinë e gjuhës së përdorur në komunikimin politik. Në Kongresin e SHBA-ve u paraqitën shumë zëra të përmbajtura, të cilët bënë thirrje për përdorim të kujdesshëm të fjalimeve në opinion dhe braktisje të radikalizimit të sforcuar të gjuhës në fjalimet publike.

Por edhe kjo nuk zgjati shumë. Në debatin në Kongres për revokim të reformave të sigurimit shëndetësor në të cilat administrata e Obamës e shpenzoi pothuajse tërën vitin e parë nga ardhja në pushtet kongresisti demokrat nga Tenesi Stiv Koen, duke i komentuar kualifikimet e kolegëve republikanë do t'i përdorë fjalët në vijim: "Thonë se kjo është uzurpim i sigurimit shëndetësor nga ana e Qeverisë, kjo është gënjeshtëri e madhe, njëjtë si e Gebelsit. E thua mjaftueshëm, e përsërit gënjeshtëri dhe, eventualisht, populli do të besojë". Pjesa më e madhe e republikanëve, por edhe opinioni, mediat, në fjalët e demokratit panë krahasim të republikanëve me nazistët. Pak efekt kishin sqarimet shpesh të Koenit se Gebelsi është i njohur për propagandën e tij politike, me siguri një nga më efikasat sipas së cilës, përsëritja e vazhdueshme e gënjeshtërisë çon deri te ajo që populli të besojë në të.

Koen është pritur me thikë edhe nga programet liberale, siç është "Shou i ditës" i Xhon Stjuartit. Ky shou në kanalini Komedi Sentral, përndryshe program humoristik, vite me radhë është fitues i çmimit "Emi", si tok-shou më i mirë në SHBA. Në stilin e tij të njohur të pamëshirshëm dhe ironik, Stjuart e përqeshi krahasimin e kongresistit Koen ndaj sjelljes së republikanëve në lidhje me reformat në sigurimin shëndetësor të administratës së Obamës me propagandën e Gebelsit. Dhe e gjitha do të mbetet me aq sikur të mos përzihet edhe drejtuesja e "Foks njuz", e cila në programin e saj pohoi se në Foks, krahasime të këtilla nuk janë përdorur as në kulmin e mospajtimeve me demokratët. Stjuart në emisionin e tij të radhës transmetoi një sërë xhirimesh nga "Foks njuz", në të cilat politikanë liberalë dhe demokratë dhe media në raste të ndryshme janë krahasuar me nazistët, ose janë quajtur të tillë. Shembujt i përfshinë pothuajse të gjithë drejtuesit e programit Foks, si dhe vetë udhëheqësin, e cila krahasim të atillë ka pasur edhe në programin e saj.

Ky kanal televiziv kabllor, vitin e fundit e mori primatin mes të ashtuquajturve njuz kanale, duke i lënë prapa vetes kanalet kabllore CNN dhe MSNBC. Rritja e shikueshmërisë u përputh me paraqitjen dhe rritjen e lëvizjes konservative në formën e Ti-pari dhe në radhët e vetë republikanëve. Ndoshta është më saktë të thuhet se "Foks njuz", si dhe disa "tok radio" si programi i Rash Limbo, nga njëra anë, si një lloj ideologësh (si i tillë konsiderohet Glen Bek) e nxitën rritjen e konservativëve në Partinë Republikane dhe të konservativëve më ekstremë në lëvizjen Ti-parti, ndërsa në anën tjetër veprojnë si zëdhënës të tyre. Dhe jo rastësisht mes bashkëpunëtorëve ekskluzivë të këtij kanali janë Sara Pelin (kandidate republikane për nënkryetare në zgjedhjet e vitit 2008), Majk Hokabi (një nga ata të cilët në vitin 2008 luftuan për nominimin republikan për kandidat presidencial), Nut Gingriç (spiker republikan i Kongresit nga viti 1995-99), Karl Rouv (zëvendës-shef i stafit të Xhorxh Bushit deri në vitin 1997)... të gjithë në një mënyrë apo në një tjetër përmenden si pjesëmarrës potencialë në garën për kandidatë republikanë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2012.

Para do kohë, menjëherë pas "Super bolit", derbit të futbollit profesionist amerikan, sipas një tradite të pashkruar edhe presidenti Obama dha intervistë për rrjetin, i cili e bënte transmetimin e derbit, në këtë rast Foks. Intervistuesi ishte Bil O'Rajli, me siguri drejtuesi më i çmuar i programit politik të "Foks njuz". Obama për "O'Rajli Faktor" është shënjestër pothuajse e rregullt, çdo hap i tij rregullisht vlerësohet në mënyrë jashtëzakonisht kritike, motoja e gjithë mesazheve për Obamën është ose orientimi i tij socialist politik ose jokompetenca e tij. Për këtë ishte interesante të shihet intervista e parë e kritikut të rreptë me objektin e kritikave të tij. Në fund, asgjë nga intervista interesante. Gjithçka përfundoi me parashtrimin e pyetjeve nga ane O'Rajlit dhe ndërprerjen e përgjigjes së presidentit në gjysmë të fjalisë. MSNBC-ja konkurrente dhe me orientim të kundërt politik, e afërt me demokratët liberalë, numëroi 72 ndërprerje nga ana e O'Rajlit të përgjigjeve të Obamës pa mundësi që ta përfundojë mendimin, ose mesatarisht ndërprerje në çdo 19 sekonda!

Në përpjekjen që ta justifikojë, sipas shumicës së komentuesve, intervistën e pasuksesshme, Bil O'Rajli u paraqit me kolumnë në shtyp. "Bush, Obama ndajnë besimin në vete" pohon në titullin O'Rajli në bazë të impresionave nga bisedimet e paradokohshme me dy presidentët. Mesazhi është se "presidentët Bush dhe Obama kanë një ngjashmëri shumë të theksuar: sigurinë në vetvete": Bushi në pohimin se "lufta në Irak e cila i kushtoi Amerikës 750 miliardë dollarë...deri më tani 4.400 amerikanë janë vrarë në atë vend, afërsisht 32.000 të plagosur...Bush akoma mendon se viktimat e mëdha janë të vlefshme sepse Sadam Hyseini ka vdekur dhe Iraku është në rrugën për demokraci. Nuk ka argument në qëndrimin se kush mundet t'ia ndërrojë mendjen Bushit në besimin e tij". "Ngjashëm është edhe me Obamën. Ai sinqerisht beson se vendi ishte në prag të Depresionit të madh kur ai erdhi në pushtet dhe se shpenzimet e mëdha federale, të cilat ai në mënyrë kampioni i udhëhiqte e parandaluan katastrofën. Sërish, nuk ka mënyrë kushdo qoftë ta bindë presidentin për të kundërtën" – shkruan O'Rajli.

Ajo që O'Rajli ua quan si mëkat Bushit të riut dhe Obamës (vetëbesimin) de fakto vlen për vetë atë. Në ditët pas intervistës me presidentin e SHBA-ve, O'Rajli jep sqarime plotësuese për atë se cili ka qenë qëllimi i tij. Kështu në njërin nga emisionet "O'Rajli faktor" që pasuan në bisedë me një nga të ftuarit e tij pohonte se presidenti Obama nuk ka dashur ta definojë Vëllazërinë myslimane dhe rolin e tij në ngjarjet në Egjipt dhe se kjo "ikje" ngjan me gjërat që i transmeton MSNBC dhe se e gjithë kjo është thjesht "anti-amerikanizëm"! MSNBC në këtë rast vetëm do të konstatojë se O'Rajli është "i njohur për atë se fiksionalizon/imagjinon gjëra".

Episodi i fundit i "Satërdej Najt Llajf", shou i njohur humoristik, i cili kishte episod brilant gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale të vitit 2008 (duke i karikuar pamëshirshëm të gjithë politikanët e implikuar në garën zgjedhore, Sara Pelin, HilariKlinton, Xhon MekKein, Barak Obama, Xho Bajden...) bëri version të tij të intervistët së O'Rajlit me Obamën, në të cilin gazetari u prezantua si një injorant jashtëzakonisht mendjemadh, i cili mes tjerash me këmbëngulje pohon se Gadafi është president i Afganistanit dhe nuk i "blen" korrigjimet që ia bën Obama, shtron pyetje, menjëherë e ndërpret bashkëbiseduesin duke mos i lejuar të thotë asnjë fjalë, duke zhvilluar praktikisht monolog, por megjithatë qartë duke bërë me dije se edhe pse nuk e di nëse është e vërtetë ajo që ky e thotë, ai këtë nuk e "blen".

Por, edhe ana tjetër nuk është më e mirë. MSNBC kabllore ka pozicione të qarta liberale-demokratike dhe është e pamëshirshme edhe majtas edhe djathtas nga pozicioni i saj i preferuar politik. Kuptohet konservativët rritës, Ti-parti dhe republikanët janë shënjestra prioritare, por nuk kalojnë më mirë as, sipas tyre, kompromiset e presidentit Obama me pozicionet republikane.

Një nga emrat prestigjiozë të MSNBC është Kris Methju, i cili të themi nuk nguron që kongresisten Mishel Bakman ta quajë "ballunhed" (tekstualisht kokë-tullumbace, me kuptimin e qartë kokëboshë). Kongresistja është, përndryshe, në krye të kokusit (të ri) të Ti-parti në Kongres (diçka si grup parlamentar te ne), e cila në përgjigjen tradicionale opozitare, në këtë rast republikane, në fjalimin vjetor të Obamës, shtoi edhe përgjigje të kokusit Ti parti (edhe pse Ti-parti është formalisht pjesë e republikanëve në Kongres dhe është thjesht lëvizje, e jo parti). Bakman, kohëve të fundit edhe nuk e fsheh se ka ambicie që të kandidohet për president në zgjedhjet e vitit 2012, me distancimin se seriozisht do të mendojë për këtë në rast se Sara Pelin nuk do të paraqitet në zgjedhje. Kongresistja, dorën në zemër është në shënjestër për shkak të pohimeve pothuajse të jashtëzakonshme, siç ishte ai se një ditë e vizitës së presidentit Obama në Indi kushton 200 milionë dollarë! Të themi edhe se për shkak të paraqitjeve të saj publike është shpërblyer me vendin në "Dikipedia" (nderi që të jesh në këtë sajt fitohet me atë që duhet të jesh, siç implikon edhe emri i tij në anglisht, budalla si penisi!). "En-

ciklopedia" ndërkaq është prodhim i Hefington Post Komedi, pjesë e sajtit të njohur demokratik liberal Hefington Post, i cili para do kohë u ble për 350 milionë dollarë nga internet gjiganti Amerika On Lajn.

Programet ditore të të lartpërmendurit Xhon Stjuart dhe kolegut të tij nga Komedi Sentral, Stiven Kolber ("Kolber Riport") rejtingun e tyre të lartë me plot kuptimin e fjalës e kanë falë marrëzive në politikën ditore dhe të kolegëve të tipit të Foks njuz garniturës (Bek, O'Rajli, Haniti etj.). Gjatë kësaj, madje është e tepërt të përmendet, zakonisht, me gjithë respektin, prezentohen si budallenj të jashtëzakonshëm.

2.

Do të mundeshim gjatë e gjerë të japim shembuj e shembuj, të cilat tekstualisht çdo ditë dalin në skenën politike dhe në mediat amerikane. Dhe gjatë kësaj, rregullisht dhe, do të thoshim, sipas ligjeve të tregut (diçka duhet të jetë e "kripur" që ta tërheqë vëmendjen), gjërat janë të nxehta, edhe sipas fjalëve të përdorura edhe sipas stilit.

Kultura më e thjeshtë e shënuar politike për amerikanët është "bindje, vlera, besim dhe synime të individëve në shoqëri për sistemin e tyre politik" ose set i ideve të cilat amerikanët i ndajnë rreth asaj se si duhet të udhëhiqet një shtet. Gjatë kësaj vlera janë idetë e ndara për atë që është e mirë, besimet janë ide të ndara për atë që është e vërtetë. Besimet shpesh janë baza të vlerave, kështu që besimi se e drejta e jetës, lirisë, pronës janë të shenjta, u jep këtyre kategorive status të vlerave në kulturën politike amerikane. Subkulturat gjithashtu ekzistojnë dhe janë të bazuara në religjionet e ndryshme, rasat, identitetet etnike, ndonjëherë duke përmbajtur vlera të ndryshme, madje edhe kundërshtuese.

Shikuar në aspektin historik, republikanizmi (në fillim i kuptuar si kundërshtim përmes angazhimeve të të drejtave të barabarta për të gjithë përkundër asaj që është konsideruar si devijuese tek aristokracia dhe sistemet rojaliste – korrupsioni, stili luksos i jetesës së aristokracisë) bashkë me liberalizmin klasik, gjatë kohë janë ideologji dominuese amerikane dhe do t'i gjeni në dokumentet e tyre bazë nga Deklarata e Pavarësisë (1776), përmes Kushtetutës (1787), Dokumentet Federale, një vit më vonë, deri te Ligji për të Drejtat (1791).

Nga to dalin parime themelore për detyrimet qytetare (nevoja që të kuptohet dhe mbështetet udhëheqja e shtetit, të merret pjesë në zgjedhje, të paguhen taksat, të kryhet shërbimi ushtarak...), të kundërshtohet në mënyrë aktive në tentativat e korrupsionit politik, të praktikohet demokracia (me ç'rast qeveria u përgjigjet qytetarëve, të cilët me zgjedhjet mund t'i ndryshojnë përfaqësuesit e tyre), barazi para ligjit (dhe sidomos se nëpunësit qeveritarë janë të barabartë para ligjit me qytetarët e thjeshtë), liritë fetare (pushteti as nuk përkrrah, as nuk nënçmon religjione), lirinë e shprehjes (pushteti nuk mundet ta kufizojë me ligj ose me veprim të shprehurit e padhunshëm të qytetarëve)... Nga vetë fillimi qeverisë i pamundësohet të vë dorë mbi ekonominë, shteti kryesisht është i varur nga nismat private ose lokale. Kjo politikë ekonomike e llojit "lese-fer" përsëri përforcohet dhe pothuajse dominon në gjysmën e dytë të viteve shtatëdhjetë dhe gjysmën e parë të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar.

Në kohët e sotme, sidomos në këto vite të krizës për SHBA-të, raporti i shtetit ndaj ekonomisë (dhe kuptohet ajo që nga kjo del si vlera e taksave, madhësia e administratës, madhësia e buxheteve...) është një nga temat e ballafaqimit të liberalizmit modern amerikan dhe konservativizmit modern amerikane, kryesisht të prezantuara përmes Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane. Prandaj shpesh do të hasni në deficite, sipas të cilave konservativistët amerikanë i kundërvihen rolit të rëndësishëm të shtetit në ekonomi, por edhe përforcimit të normave sociale përmes shtetit, për-

derisa liberalët besojnë në fuqinë e shtetit në përforsimin e ekonomisë dhe janë më tolerantë për dallimet në normat sociale.

Në nivel të SHBA-ve - duhet përmendur edhe këtë si pjesë të zhvillimit të kulturës politike amerikane - para Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara kryesisht e kanë respektuar parimin e mosintervenimit në politikën e jashtme, në mënyrë që me marrjen e statusit të superfuqisë pothuajse tërësisht e braktisi.

Edhe këtu vlejnjë përfitimet qytetëruese në nivelin në të cilin debatohet për dallimet në debatet politike. Kultura e dialogut kultivohet, ajo themelohet në besimin se njerëzit sado që të dallohen duhet të respektohen dhe të çmohen kur bisedojnë për dallimet në kuptimin e gjërave. Gjatë kësaj, toleranca bazohet në besimin se nuk ka të vërteta të tilla të shenjta, për të cilat nuk mundet hapur, pa ndjenjën se rrezikohen me atë që rihetohen nga fillimi, të trajtohen nga çdo kënd, çdo argument pro dhe kundër për ato të rishqyrtohet. Nuk ka shenjtëri të atillë, e cila do të ndalojë të shprehet dhe të dëgjohet madje edhe ajo që konsiderohet e papërshkrueshme. Njerëzit komunikojnë mes vete, si qeniet e vetme të gjalla të mençura në botë, të vetëdijshëm për kompleksitetin e natyrës dhe shikimeve të tyre. Njerëzit mund të kërkojnë mirëkuptim të thellë për mendime dhe ide shumëpalëshe dhe konfliktuoze, në bazë të besimit se edhe atje ku ka mospajtime dhe mosmiratime, ndjesia dhe mirëkuptimi, mund ta zëvendësojnë mosdurimin dhe se me dëgjim aktiv dhe me thënien e së vërtetës, secili nga perspektiva e vet, njerëzit mund ta zgjerojnë vizionin e tyre për atë që mund të bëhet, që mjedisi në të cilin jetohet dhe bota të bëhen vende më të mira.

Gjithsesi kjo kulturë e dialogut nuk manifestohet vetëm me situata jokonfliktuoze, përmes debateve të qeta intelektuale çfarë u kanë hije njerëzve të mençur, të bindur në fuqinë e argumenteve që i përdorin. Pasioni, fjalët e fuqishme, ndonjëherë vrasëse nuk janë aspak të rralla, por do të thosha se janë rregull për shkak të realitetit të egër që të kthehet vëmendja e opinionit për lëndën e debatit ose vlerësimit. Cinizmi, ironia, përqeshja nuk janë aspak të rralla, prandaj, mes tjerash, tok-shout televizive janë mes më të shikuarave, ndërsa Xhej Leno, Dejvid Leterman, Konan O’Braen janë yje të vërteta.

3.

Për çfarë kulture politike, për çfarë artikulimi të interesave politike të popullatës për krahasim mund të flasim në Maqedoni, në të cilën për njëzet vjet pavarësi nuk është bërë as hapi i parë. Akoma kemi parti politike etnikisht të pastra socialisht të paetabluara, programe politike në formën e dekorit ideologjik, të cilat as nga larg nuk janë shprehje e interesave sociale të anëtarësisë së tyre. Përkundrazi, gjithçka çon në garë politike të kuptuar si luftë e përditshme verbale mes çapkënëve, sipas maksimës “qëllimi i justifikon mjetet”, me ç’rast gjithçka është e lejuar (politikisht) dhe e vetmja gjë që është e rëndësishme, është që të vihet në pushtet, çfarëdo qoftë ai.

Por, a është i mundur çfarëdo qoftë dialogu, jo vetëm politik, në vendin të cilin tashmë njëzet vjet, gjoja se e ndërtojmë?

Ndërkaq pushteti nënkupton partizim të plotë të të gjitha institucioneve në vend, kontrollin e rrjedhave ekonomike, nënshtrimin e biyngesit, përqendrimin e gjithë fuqisë në duart e kryesisht partiake, të kuptuar si lideri dhe rrethi më i ngushtë i njerëzve të tij të besueshëm – “familja”, ndonjëherë dhe tekstualisht – familja.

Qeveria është pushtet mbi gjithçka. Prandaj nëse Kuvendi, në vend që të jetë pushtet ligjdhënës, i cila e kontrollon qeverinë si pushtet ekzekutiv, do të jetë makinë e heshtur votuese, vulosës i dëshirave qeveritare (lexo partiako-lidere). Ministrinë dhe ministrat



formë e realizimit të kontrollit në çdo segment në shtet, Ministria e Punëve të Brendshme grusht goditës i partisë (lexo liderit dhe njerëzve të tij) në pushtet: Koncepti nuk duron kurrfarë afrimi të pushtetit deri te qytetarët, për këtë edhe decentralizimi, përforsimi i vetëqeverisjes lokale, më nuk janë as angazhime deklarative.

Jashtë, sa më të izoluar, sa më larg çfarëdo lloji integrimi në botën globale – kjo është më mirë.

Koncepti i këtillë në mënyrë të pashmangshme kërkon edhe vendosje nën kontroll të qendrës së njëjtë të fuqisë politike edhe të jurisprudencës edhe medie, si dhe sektorit civil, madje edhe të gjitha niveleve të arsimit, që edhe ato të bëhen hallkë në realizimin e pushtetit dhe fuqisë absolute, por edhe formë e pagesës së meritoreve (partiakë).

Zgjedhjet, de fakto nuk ndërrojnë asgjë, bëhen pothuajse të panevojshme, janë si mundësi që eventualisht të ndërrohen protagonistët, në mënyrë të rreme të grimosur si oponentë politikë, por me qëllime identike politike.

Në ambientin e këtillë politik investimi kuptohet që është i madh, sepse nëse jeni në anën e fituesve keni gjithçka nga çka tekstualisht ju varet cilësia e jetesës. Nëse jeni mes të dështuarve, do të duhet ta duroni errësirën deri në ndonjë rast zgjedhor që ju ta kalëroni kalin e pushtetit. Me angazhimin e madh vjen edhe pasioni i madh.

Rregullat e këtilla politike imponojnë tolerancë ndaj njerëzve tu, ndaj bashkëmendimtarëve. Secili jashtë rrethit është armik i pamëshirshëm, sipas rregullit “nuk je me ne, je kundër nesh”. Antagonizmat luftarakë janë pasojë normale në ambient të këtillë.

Xhamat e thyer në kaleidoskopin e këtillë e bëjnë për rrethin e njerëzve tu të pranueshëm definicionin se “antisemitist është personi që i urren hebrenjtë më shumë sesa nevojitet”. Autorët e përkufizimit të këtillë në një libër universitar për teori politike për juristë dhe politikanë të ardhshëm në asnjë rast nuk do të largohen nga skena politike, as nuk do të dënohen për antisemitizmin e tyre, as si profesorë do të shpallen si diletantë, sepse janë presidenti ynë partiak i shtetit, njerëz nga Akademia të afërt me politikën tonë.

Dhe çka është atëherë e çuditshme, nëse ata që mendojnë se gjithë pushteti dhe fuqia është e tyre dhe se gjithçka është nën kontrollin e tyre, mendojnë edhe kështu:

Në transformimin shpirtëror të shoqërisë sipas vlerave konservative, të kuptuara ashtu siç i kuptojmë ne të pushtetit, do të vendosim klerarki tonën të vlerave. Do të bëjmë gjithçka që të dëshmojmë se kemi rrënjë mijëvjeçare, se jemi kategori biblike. Shteti jemi ne, në shenjë falënderimi ndaj religjionit i cili na ruan me shekuj, do të ndërtojmë objekte sakrale. Ndërsa Kisha për shpërblësë do të na e ndërrojë Kushtetutën që të mos e tregojmë homofobinë tonë.

Në kohën kur bota e zhvilluar flet për dështimin e konceptit të multietnicitetit pse ne ta kultivojmë tonin. Më mirë të jetojmë njëri pranë tjetrit sesa së bashku.

Pse të shqetësohemi për incidente që i ndezin pasionet ndëretnike, sidomos nëse prej tyre kemi dobi ditore politike.

Më mirë është që ne ta kontrollojmë popullin tonë, ata të vetin.

Dhe është e lejuar që lideri i tyre, partneri ynë ta ketë besnikërinë e pafund të zëvendësministrit të tij të Punëve të Brendshme, kur ne e kemi besnikërinë e pafund të ministres sonë të Punëve të Brendshme. Është e lejuar që së bashku të marrim vendime që të ndërtohet objekt, i cili ndoshta do të provokojë tensione te popullata edhe ashtu

e ndarë etnike, e pastaj gjithkush të shkojë në rrugën e tij – njëra anë me organizata joqeveritare të organizohemi në protesta kundër ndërtimit të objektit, ana tjetër në mbrojtje të saj për shkak të parave të shtetit të investuara në të. Dhe përkundër të gjithave koalicionin ta kemi stabil dhe afatgjatë.

Në rrethana të këtilla, kush është më afër realitetit tonë të shpifur: ata të cilët në opinion, në mediat sociale e përdorin gjuhën e urrejtjes ose ata të cilët në mënyrë të rreme janë të shqetësuar për përdorimin e saj në Fejsbuk, sepse jo vetëm që e tolerojnë por e stimulojnë në të gjitha segmentet e shoqërisë maqedonase?

Nëse pas incidenteve në Kalanë e Shkupit, Fejsbuku shfrytëzohet për luftë ndëretnike me fjalë, a thua do të ndihmojë ndalesa e përdorimit të tij në Maqedoni që të mos kthehemi në terrenin rrëshqitës të përleshjeve ndëretnike? Ministria e Punëve të Brendshme, e cila e kërkon këtë, vepron si Qeveria e Mubarakut, fillimin e rrëzimit të së cilës e shënoi pikërisht fuqia e medieve sociale. A frikësohet MPB-ja nga rrjetet sociale apo nga fjalët e ashpra, të cilat në vende tjera i toleron?

Kam përshtypje se megjithatë nuk ka të bëjë me fjalët, ka të bëjë me njerëzit tanë.



David Brewer

Dejvid Bruer, Britani e Madhe, është këshilltar për strategji mediale dhe drejtor i Media Ideas International Ltd (<http://www.mediaideas.co.uk/>).

Përvoja e tij gazetareske përfshin gazeta, radio, televizione dhe onllajn media. Është redaktor përgjegjës i BBC News Online në vitin 1997, ndërsa në vitin 2000 transferohet në CNN për t'i themeluar CNN.com EMEA dhe CNNArabic.com, ndërsa ishte edhe konsultant redaktorial në Al Jazeera English në vitin 2006. Bruer punon me organizata të shumta për zhvillim të medimeve në Azi, Evropën Juglindore, Lindjen e Afërt, Afrikë, vendet e Komonveltit dhe në Amerikën Qendrore.

Dejvid Bruer e themeloi Media Helping Media (<http://www.mediahelpingmedia.org>) me qëllim që t'i përkrahë mediumet në vendet në tranzicion dhe në ato që kanë dalë nga konfliktet, ku liria e të shprehurit është e kërcënuar. Ai kalon shumë nga koha e vet duke punuar në Afrikë, Azi, Ballkan, vendet e Komonveltit dhe në Lindjen e Afërt.



David Brewer

Për shoqëri të shëndoshë nevojiten media të lira nga ndikimi

Politikanët marrin vendime dhe veprojnë në emër të popullit. Roli i gazetarëve është që hollësisht t'i shqyrtojnë ato vendime (dhe organin ekzekutiv që i zbaton) dhe të njoftojnë për implikimet në emër të popullit. Ekosistemi mes mediave dhe politikës është sistem hierarkik i kërkesave dhe lejeve, së vërtetës dhe gënjeshtërisë dhe mashtrimit dhe shpalljes publike.

Dobësitë njerëzore në mënyrë plotësuese i komplikojnë punët. Këto mund të lëvizin nga një mungesë e thjeshtë e profesionalizmit gazetaresk në një anë, deri në bërje të kompromisit, bashkëpunimit dhe manovrave të motivuara në aspektin politik në anën tjetër.

Gjithë këto elemente krijojnë tabllo komplekse, renditja e të cilave mund të çojë deri në rritje të transparencës dhe përgjegjësisë në njërin rast, ose të rezultojë me manipulim dhe korrupsion, në rastin tjetër. Kohabitacioni mes mediave dhe politikës është i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë vetëm në raste të rralla.

Lidhja mes mediave dhe politikanëve mund të ketë efekt të dukshëm mbi funksionimin e shoqërisë korrekte dhe të drejtë.

TIPET E GAZETARËVE

Përvoja ime në punën me politikanë, vjen nga periudha e punës si gazetar dhe redaktor për tema politike dhe së fundi, nga puna ime si konsulent për strategji mediale, duke punuar në vende në tranzicion dhe në periudha post-konfliktuale.

Në këtë punim, të mbështetur nga Qendra maqedonase për Liri, do të flas për të dy rastet. Në çdo rast, perspektiva ime është ajo e gazetarit, e jo e politikanit; punaimi i shkruar nga një politikan, me siguri do të ishte tërësisht ndryshe në fokusin dhe konkluzionet e veta.

Gjaktari: Pa lodhje i përcjell politikanët. Përcjell çdo gjurmë. Ky gazetar asnjëherë nuk dorëzohet derisa nuk e fiton gjahun e vet. Ata kanë fuqi udhëheqëse dhe nuk do t'u besojnë politikanëve, madje as kur ata e flasin të vërtetën. Gjaktarit shpesh mund t'i mungojë objektiviteti dhe këndvështrimi i gjerë. Kontributi i tyre për qartësimin e të kuptuarit nga ana e publikut është në pikëpyetje.

Aktivisti: I përkushtuar në kauzën e tij, do të luftojë me çdo politikan që është kundër saj dhe do ta mbështesë atë që dakordohet me të njëjtën. Ky gazetar mund të udhëhiqet nga ndonjë njëmendësi dhe të kufizohet vetëm në një dimension. Për ta është vështirë që të gjendet baraspeshë, sepse është vështirë që ta vlerësojnë perspektivën e ndryshme ose sepse kanë kuptuar se nëse ofrojnë baraspeshë, koncepti i rrëfimit që duan ta realizojnë, mund të dobësohet. Aktivisti kënaqet kur perceptohet si martir dhe shpesh rrezikon që ai të shndërrohet në rrëfim, në vend që ta udhëheqë atë dhe ta mbulojë.

Miku: Bëhet i afërt me politikanët dhe rrallë herë e sjell pozicionin e tyre në pikëpyetje, shpesh herë duke marrë këndvështrim të vetin se politikanin ka të drejtë, pa dallim të dëshmimeve për të kundërtën. Ky gazetar do t'i bëjë shërbim politikanit, por do të ketë kufij – zakonisht kur do të mendojë se do të zbulohet. Sido që të jetë gjithmonë do të jetë i gatshëm ta shtrijë dorën nëse ka nevojë, nëse vlerëson se mbulimi i rrëfimit mund të jetë në dobi për të dhe për politikanin. Gazetari mik lëvizë si fryn era dhe është i lehtë për manipulim.

I poseduari: Ai është në pronësi të politikanit, përmes varësive të vendosura me kompromis dhe afërsisë të tepruar. Me siguri e ka humbur integritetin e vet gazetaresk në zhvillimin e hershëm. Me siguri do të publikojë çfarëdo qoftë sipas dëshirës së politikanit, pa shtruar pyetje. Ky gazetar është vetëm pak më shumë se një anëtar vullnetar i ekipit për marrëdhënie me opinionin të politikanit të njëjtë. Ai kënaqet duke u lavdëruar me emrat e personave të njohur dhe afërsinë me personat me ndikim.

Anëtari i partisë: Bën gjithçka që ta fshehë anëtarësinë e vet, por megjithatë e tregon atë me tonin tij, përzgjedhjen e rrëfimeve dhe aftësinë (ose paaftësinë) e tij në parashtrimin e pyetjeve hulumtuese. Ky gazetar do të shpenzojë shumë kohë në nxitjen e qëndrimeve politike të atyre me të cilët nuk pajtohet. Zakonisht do t'i njihni sipas entuziazmit të tyre për të imponuar një rrëfim, të cilin gazetarë të tjerë më pak të komprometuar fare nuk e shohin se ekziston. Ai do ta mbrojë zgjedhjen e këtillë përkundër çfarëdo mendimesh logjike.

Komodi: Unë do ta kruaj shpinën ty, ti timen. Përse të zihemi kur që të dy mund të jetojmë rehat dhe levërdishëm. Kush do ta dijë? Ky gazetar e shikon punën e vet si detyrim nga ora 9 deri në orën 5, që shërben vetëm për qëllimin e ekzistimit të tij. Zakonisht kënaqet me verë dhe ushqim të mirë. Në dispozicion është për "afërën" e të gjitha partive. Ai këtë e shikon si qëndrim të vetin korrekt, jo të njëanshëm dhe të pavarur.

Gazetari i vërtetë: I lirë nga lidhjet partiake, ka integritet dhe nuk mund të blihet, ka pasion për informim të opinionit, e kërkon të vërtetën, raporton në mënyrë të rregullt dhe korrekte dhe paraqet më shumë perspektiva, madje edhe kur të njëjtat mund

ta dobësojnë konceptin e rrëfimit. Është i gatshëm të hulumtojë gjithçka që e ka për zemër. Askënd nuk e shikon jashtë kufijve të kritikës dhe është i realtë për çështjen e natyrës së njeriut. Gazetari i vërtetë e kërkon të vërtetën.

Roli i gazetarit: Në sisteme demokratike, roli i gazetarit duhet të jetë që ai ta informojë opinionin dhe ta udhëheqë debatin publik në mënyrën në të cilën publikut do t'i lejojë të bëjë përzgjedhje të edukuar. Roli i politikanëve është që t'i përfaqësojnë ata që i kanë zgjedhur dhe të sigurohen se shqetësimet e atij trupi zgjedhor janë dëgjuar, shqyrtuar dhe ku është e mundur, është reaguar në bazë të çështjes.

Në sistemin e këtyllë politik, gazetari do të duhej të veprojë në emër të publikut, që të sigurohet se politikanët e kryejnë punën e tyre. Ai do të duhej t'i hulumtojë dhe mbulojë edhe temat, të cilat më shumë i prekin lexuesit dhe dëgjuesit. Duke e bërë këtë, do të duhej të inkuadronin llojllojshmëri të zërave dhe opinioneve politike me qëllim që ta ofrojnë mbulimin më të pasur dhe më komplet të mundur. Nëse e arrijnë këtë kanë gjasa më të mëdha të ofrojnë gazetari që e nxit mirëkuptimin dhe inkurajon dialog dhe debat.

Për disa ai rol, ndonjëherë i kushtëzuar si "fuqia e katërt" është crucial për funksionimin e shoqërisë së shëndoshë dhe të drejtë – gjithashtu e rëndësishme si dhe roli i vetë politikanëve. Presidenti i dikurshëm i SHBA-ve Tomas Xheferson një herë theksoi se: "po qe se do të më lihej mua që të vendos nëse duhet të kemi qeveri pa gazeta dhe gazeta pa qeveri, nuk do të heyitoja për asnjë moment që ta zgjedh të dytën".

Ndoshta Xheferson ka pasur të drejtë, duke sugjeruar se gazetarët janë më të rëndësishëm për shoqërinë sesa politikanët. Ndoshta në disa shoqëri, politikanët e dinë dhe kanë frikë nga kjo dhe ndoshta që këtu, fillojnë komplikimet dhe kompromiset. Gazetarëve u nevojiten informacione dhe duhet deri te ato të vijnë, në ndonjë pjesë edhe nga politikanët. Kështu gazetari vihet në situatë që të lusë për informacion ose në mënyrë të fshehtë të hulumtojë që të marrë të njëjtin. Politikani mund të vendosë nëse do t'i mundësojë ose ndalojë ato informacione, por është shumë më vështirë të mbyllet çdo vrimë dhe të mbulohet çdo gjurmë. Në disa situata, politikani e ka pozicionin prijës – lirin e informacioneve, të cilat mendon se i ka nën kontroll – por jo edhe në rastin e dhënies së informacioneve të cilat nuk janë nën kontroll. Kufiri mes dy kategorive gjithnjë e më shumë mjegullohet, siç mund të shohim nga ngjarjet e afërta me Uikiliks.

RREZIKU NGA KOMPROMISI

Tundimi që gjithmonë t'i bëjë lajka, ta joshë dhe të miqësohet me politikanin gjithmonë do të jetë i pranishëm. Disa gazetarë ndoshta do të mendojnë se me adoptimin e kësaj strategjie, do të kenë më shumë gjasa për qasje deri te më shumë informacione sekrete dhe kështu të krijojnë avantazh mbi konkurrencën e tyre (shitja e gazetave ose përfitimi i rejtingjeve në eter është gjithashtu motivim i madh medial). Por, afërsia ka rreziqet e veta.

Nëse politikani është mik i juaj, ndoshta do ta keni vështirë që ta zbuloni ose ta kritikoni, si dhe të shkruani për të në mënyrë të ndershme. Kështu që, një çështje kyçe për gazetarët politikë, është distanca që e mbajnë nga gazetarët për të cilën shkruajnë dhe kjo distancë do të ndryshojë varësisht nga gjendja e sistemit politik.

Nëse jetoni në sistem të prishur politik, e keni për detyrë që atë prishje ta shpalosni para syve të publikut. Vështirësia që ta mbani distancën nga politikanët është çështje praktike. Sa larg mund të shkoni gjatë informimit? A mund të qëndroni të lirë? A mundet gazeta juaj ose shtëpia televizive të vazhdojë të punojë? A jeni në rrezik?

DUKE FILLUAR ME IDEALE TË LARTA

Si gazetar i ri në gazetë, kokën e kisha të mbushur me deklaratat më të mira redaktoriale, që mua ma justifikonte ekzistencën personale. Ndjeva se kam obligim të "hulumtoj organet ekzekutive", t'i "eksponoj të fuqishmit në përgjegjësi" dhe t'u "jap zë të pazëshmëve". Çdo ditë unë do të nisesha me fletore në dorë, duke e kërkuar rrëfimin i cili do t'i përmirësonte gabimet. Për hir të së vërtetës, kërkoja rrëfim ekskluziv për faqen e parë, gjë që do të rezultonte me emrin tim të shtypur në ballinë.

Gjithsesi, nuk kisha të drejtë ta bëjë këtë. Unë nuk isha i zgjedhur. Unë vetëm u emërova nga redaktori im që ta kryejë detyrën. Shpesh kjo detyrë ishte thjesht – e përditshme. Shkuarja deri te byroja informative e gazetave që të flas me ndonjë grua për një qen të humbur, përcjellja e ndonjë premiere në teatrin lokal, ose shkuarja deri në stacionin lokal policor që të shoh nëse ka ndonjë rast kriminel të padenoncuar.

Megjithatë, nga unë kërkohej edhe të marr pjesë në mbledhje të botës lokale, ku politikanët e përzgjedhur lokalë diskutonin për tema të përditshme, të cilat kanë efekt mbi jetën e atyre që e lexonin gazetën time dhe artikujt e mi. Kjo kërkonte përgatitje të mëdha. Duhej t'i lexojë axhendat dhe raportet e këshillit, që të mundohem ta kuptoj gjuhën komplekse që përdorej dhe në të vërtetë të kuptoj për çka vendosej, kush vendoste për këtë, në dobi të kujt dhe pse. U mundova të flas me të gjitha palët e prekura në debat, ato që mbulonin politika të ngjashme dhe ato që i kundërshtonin ato. Në bisedat dhe përballjet e mia me çdo grup, duhej të isha korrekt dhe objektiv. Ai ishte qytet i vogël. Të gjithë njiheshin mes vete dhe e dinin ku jetojnë. Qyteza kishte dinamikë të vetën, jo të përditshme, mes mediave lokale dhe politikanëve – njohja dhe përgjegjësia – meqë të nesërmen pas publikimit të gazetës do të rrinin në rend të njëjtë para qoshkut me ata njerëz.

TË KUPTUARIT E RËNDËSISË SË ROLIT

Gazetarët ndodhen në rol të privilegjuar dhe të rëndësishëm. Ky ndonjëherë është pozicion, të cilin disa nuk arrijnë ta vlerësojnë mjaftueshëm. Mund të trokitni në derën e të fuqishmive dhe mundeni përmes telefonit të kërkonin intervistë. Puna jonë ka qenë që gjithmonë ta bëjmë këtë, si pjesë e përgjegjësisë tona në shoqëri: - media të lira dhe të pavarura, gërmim atje ku të tjerët nuk gërmojnë, hulumtim i korrupsionit dhe veprimi jo të ligjshëm.

Gjatë kësaj etape të karrierës kam njohur shumë politikanë, të cilët janë bërë kontakte të miat. Ata më informonin dhe shpesh ishin në dispozicion, ndonjëherë edhe në afat të shkurtër, të paparalajmëruar, që të më ndihmojnë në hulumtimin e storjes, për të cilën vlerësoja se përfshin veprimtari kriminele. Ndonjëherë më merrnin në telefon natën vonë, që të më tregojnë ndonjë gjurmë, me shpresë se unë do ta hulumtoj.

Unë i shfrytëzoja për mbledhjen e informacioneve, me shpresë se do të gjej artikuj të mirë për gazetën time, ndërsa ata më shfrytëzonin mua që të sigurohen se temat që ata duan të publikohen, nuk do të mbeten të pambuluara, ose të paktën do të shqyrtohen. Me këtë erdhi një obligim i çuditshëm, i cili asnjëherë nuk diskutohej. Kur ata do të më ndihmonin që të hulumtoj një temë, të cilën unë e vlerësoj si të rëndësishme, a nuk u kisha borxh unë si kundërshtërim t'i mbuloj ato storje, të cilat politikanët i çmonin si të rëndësishme – madje edhe pse unë mendoja se ajo që shqyrtohej, nuk sillte kurrfarë dobie më të gjerë? Në anën tjetër, nëse unë jepja më shumë dritë sesa nevojitej mbi një temë për të cilën besoja se është e rëndësishme për interesin publik, vallë unë isha i shfrytëzuar nga ana e politikanëve? Përgjigjja ishte e qartë – po.

Mbajtja e baraspeshës precize mes mediave dhe politikanëve u bë shumë më e ndërlikuar kur u transferova në televizion dhe radio dhe përfundimisht, në Uestminster,

që të mbuloj politika kombëtare dhe ndërkombëtare. Në atë kohë, kisha një pjesë të parlamentit për të mbuluar dhe puna ime ishte që të njihem me politikanët nga fusha për të cilën duhej të raportoja.

Së shpejti fillova të kuptoj se në cilën mënyrë funksionon sistemi. Gazetarët takoheshin me anëtarët e parlamentit, në kafe ose në drekë, që të flasin për informacionet e brendshme. Kjo justifikohej si grumbullim i informacioneve relevante, që të mundësohet gazetari të hartojë komente ose raporte të rëndësishme (ose jo aq të rëndësishme), ku ai do të duket i aftë për të kuptuar diçka në lidhje me politikën ditore, që zakonisht nuk është e kapshme për njerëzit e rëndomtë.

Sido që të jetë, gradualisht gazetari bëhet pjesë e "sistemit", ku kontaktet me politikanët janë të pashmangshme për ekzistencë. Ky është sistem, i cili në fillim nuk është i kapshëm për gazetarin e ri. Kjo duhet të fitohet. Dhe këtu ka problem.

Redaktori im i mëparshëm, Bob Eginton, drejtues i Sektorit politik të BBC-së, e theksoi sfidën me të cilën përballen gazetarët, të cilët jetojnë në një vend në të cilën liria e fjalës është e mbrojtur me ligj.

Eginton e përfaqëson këndvështrimin se ekzistojnë rreziqe në sistemin politik perëndimor, ku "gazetarët e politikës janë ngushtë të integruar në makinerinë e raporteve, konferenca gazetareske, deklarata për shtyp dhe ngjarje të caktuara nga organet kompetente". Eginton thotë "fuqia korrupton dhe afërsia deri te ajo fuqi mund të jetë mahnitëse dhe të paraqesë kënaqësi". Në atmosferë të këtillë, thotë ai "gazetari duhet ta shmangë joshjen nga sistemi".

Kjo është e vërteta në përvojën time. Pas një kohe të kaluar në mbulimin e parlamentit dhe politikës si reporter dhe korrespondent televiziv dhe i radios, më pajisën me lobi-fletëhyrje. Ky dokument për identifikim me madhësi të kartelës kreditore më dha qasje deri te shumë pjesë nga skena politike britanike, të cilat ishin të pakapshme për shumë gazetarë. U bëra anëtar i një grupi të vogël gazetarësh, të cilët kishin leje që të shetiten nëpër korridoret ku qarkullonin anëtarët e parlamentit, në Pallatin e Uestminsterit. Kisha mundësi të marr komente të parakohshme "jozyrtare" nga njerëzit, të cilët më vonë bëhen të njohur si "burime" ose "anëtarë apo ministra pa resor". Kjo gjithashtu më dha qasje deri te konferencat e rregullta për shtyp të qeverisë, në zyrën e kryeministrit në rrugën Dauning nr. 10.

Për një gazetar të ri të politikës, dita kur do t'ju fusin nëpër derën e rezidencës së kryeministrit, deri te zyra e sekretarit për shtyp, është moment i fuqishëm. Në fillim, mundësia që të dëgjohen anësh bisedat jozyrtare, ishte ethe adrenalinë e jashtëzakonshme. Siç thotë Bob Eginton, kjo fuqi mund të jetë "mahnitëse dhe e kënaqshme" dhe lehtë mund të jesh "i joshur nga sistemi".

Me këtë njoftim me korridoret e fuqisë, erdhi edhe një presion – frika që të mos dilet nga kufijtë, ndërsa ekzistonin shumë njerëz përreth që e shfrytëzonin këtë në avantazh të tyre. Kjo mënyrë dinake e kontrollit u paraqit herët në karrierën time si gazetar politik i lobit politik. Në një brifing për një vendim të caktuar politik në rrugën Dauning nr. 10, e çova dorën që të parashtroj pyetje. Ajo ishte pyetje, për të cilën kisha nevojë për sqarime që të mundem më mirë ta informoj publikun tim. Nuk isha i censuruar nga zëdhënësi qeveritar (edhe pse pamja e tij e vrazhdë fliste mjaft), por nga një koleg më i vjetër, anëtar i lobit medial, i cili më shikoi, e ktheu kokën, u kollit dhe vazhdoi me pyetje. Pas brifingut, ai në mënyrë subtile theksoi se "nuk ka qenë me vend" që të shtrohet një pyetje e atillë, "joadekuate". Ndoshta ishte pyetje e marrë – tani nuk mund të kujtohem – ose ndoshta thjesht më futën në rend, që prej atëherë në të ardhmen të kem kujdes për rregullat dhe standardet e sjelljes, për të cilën të dy palët paraprakisht janë dakorduar. Unë supozoj se ishte kjo e dyta. Kuptohet që më lanë iluzion rreth asaj nëse i kam tejkuluar rregullat e klubit, të cilit tani i takoja. Çështja ishte sa unë e vlerësoja atë anëtarësi. Për disa, ky mund të jetë faktor kufizues.

Nga perspektiva ime, e gjithë kjo ngjante sikur të isha gradualisht i involvuar në mënyrën e sjelljes, e cila kishte potencial që ta dobësojë efektivitetin tim si gazetar, përmes zhvillimit të afërsisë dhe mirëkuptimit me ata për të cilët unë objektivisht duhej të raportoja. Është vështirë të silleni në mënyrë të rreptë ndaj një politikani, me të cilin keni pirë ose keni drekuar dhe i cili në të kaluarën ju ka dhënë informacione me vlerë. Miqësia mes politikanit dhe gazetarit mund të rezultojë me impotencë.

TË VLERËSUARIT E GAZETARISË SË ASHPËR, TË SIGURT

Kur bëhet fjalë për mbulim të politikës, gazetarët e vërtetë e zbulojnë atë që politikanët nuk duan që të bëhet e ditur. Publikimi vetëm i informacioneve të cilat politikanët duan t'i bëjnë të ditura, është vetëm diçka më shumë nga ajo që të jesh sekretar për shtyp ose propagandist. Gazetari i vërtetë është i gatshëm të rrezikojë gjithçka, me qëllim që të publikojë të vërtetën të pakëndshme, është i aftë t'i mbështesë storjet e veta me fakte të pamohueshme dhe i përkushtohet ndriçimit të jokompetencës, rryshfetit, gënjeshtërave dhe korrupsionit. Unë mendoj se pikërisht kjo është ajo që Tomas Xheferson e ka menduar, gjatë potencimit të vlerës kaq të madhe të gazetave.

Në rast të këtyre, me rëndësi kryesore për gazetarin është që të kuptojë vetveten dhe motivet e veta personale dhe të vendosë kodeks të etikës redaktuese, e cila do të sigurojë se gjithçka që është bërë, është bërë me integritet. Por, gazetarët dhe politikanët janë qenie njerëzore. Të gjithë ata kanë axhenda personale, të cilat mund të jenë të përcaktuara nga ambicia, dëshira për status dhe vlerësim, fitimi i pasurisë materiale, praktikimi i fuqisë së ndikimit dhe një mori çështjesh tjera.

Për shembull, në demokraci, një gazetar duhet të votojë. Ai ose ajo do të votojë për një parti ose për një tjetër. Ndoshta ndonjë përvojë personale do të ndikojë në atë përzgjedhje. Ndoshta do të kenë brengë shoqërore ose shqetësim për rrethinën, për të cilën duan që të korrigjohet, kështu që ndiejnë se ndonjë parti është e përcaktuar që ta bëjë këtë. Kjo është normale, por ajo që është e rëndësishme është se gazetari nuk guxon të lejojë që kjo të ndikojë në punën e tij.

Gjithçka që bëjnë duhet të kënaqë interesin e publikut dhe duhet ta kalojë testin e tij. Ata gjithmonë duhet të pyeten nëse rrëfimi që e mbulojnë do të korrigjojë diçka që është e gabuar në shoqëri, do të sqarojë disa informacione, të cilat do të ndikojnë në mirëqenien dhe sigurinë publike, e përmirëson mirëkuptimin e opinionit për çështjet ditore dhe nëse çon deri në siguri dhe transparencë më të madhe në jetën publike.

Vetëm nëse sigurohet se storjet e publikuara e kalojnë testin e interesit publik, gazetari mund të fillojë të tentojë ta plotësojë rolin më të rëndësishëm në gazetari – ta zhvillojë debatin publik në mënyrën e cila do t'i lejojë publikut të marrë vendime të edukuara. Ky tekst, gjithashtu, i ndihmon gazetarit që më qartë ta shohë motivimin e vet.

Para se gjithash, një gazetar sidomos ai që merret me politikanë, nuk guxon t'i ketë borxh askujt, as t'i kërkojë shërbim, si dhe të mos ketë personalitete të preferuara. Duhet të jenë tërësisht të lirë nga çfarëdo ndikimesh, të cilat mund të shfrytëzohen kundër tyre ose mund ta komprometojnë integritetin e tyre. Sido që të jetë, derisa ekziston rrezik nga "kuptimet" të cilat e dobësojnë fuqinë e gazetarëve, në të ashtuquajturat demokraci, sfida është akoma më e madhe në shoqëritë transite dhe post-konfliktuale.

Në shoqëritë transite dhe post-konfliktuale, ku mediat ende zhvillohen, ekziston rreziku nga lëvizja më e shpejtë përpara. Politikanët antagonistë, si dhe personat e pasur të fuqishëm mund të sjellin rezultat me zhdukjen e gazetarit. Unë kam trajnuar gazetarë, të cilëve u është thënë se nëse nuk e shkruajnë atë që pronari i tyre e kërkon, do të mbeten pa punë. Këto janë zgjedhje të vështira. Në të vërtetë, për disa nuk ka

zgjedhje. Akoma më me rëndësi, nuk ekziston gjithmonë ajo mbrojtje që është në perëndim, ku gazetarët e kanë përkrahjen e sindikatave, që ta mbështesin rastin e tyre, nëse janë viktima të pushimeve të padrejta nga puna dhe të presionit.

Edhe një dallim në perëndim është ai që, gazetarët jo rrallë qerasen nga njerëzit me ndikim dhe të fuqishëm, ndërsa në vende të tjera, kjo përfundon me plumba dhe bomba.

Në një mjedis të tillë në të cilin zhvillohen mediat, ekziston mundësia që akoma të mos jenë të sendërtuara sistemet të cilat do t'u mundësonin mediave të funksionojnë pa pengesa dhe pa vështirësi. Mënyrat e vjetra të punës, shpesh herë të ndërlidhura me normat kulturore, mund të kenë efekt mbi ngjarjet e përditshme.

Që të bëhet tentativë për luftë kundër kësaj, trajnimi i mediave në shoqëritë transite dhe post-konfliktuale shpesh fokusohet në gazetari hulumtuese. Kjo, sipas meje, është gabim i madh. Kuptohet që çdo gazetari është hulumtuese, por që të mbushen kokat e gazetarëve të cilët janë akoma në tranzicion me ide për gazetari hulumtuese, dërgon vetëm sinjale të gabuara.

Ekziston rrezik që kjo qasje të prodhojë një grup gazetarësh – nga të cilët disa deri vonë kanë qenë aktivistë politikë – të nxehur për idenë se guxojnë të hulumtojnë për ish-kundërshtarët politikë. Me këtë vjen tundimi për hakmarrje kundër atyre që ata i perceptojnë si tipa të këqinj nga regjimi i kaluar politik, ndërsa në mënyrë të vazhdueshme janë të implikuar në biznese të mëdha dhe, kuptohet, në politikë.

Kjo është receta për katastrofë. Një skenë politike në zanafillë, me gazetarë impresivë – shumë nga të cilët ende duhet t'i mësojnë bazat e gazetarisë – të fokusuar në zbatimin e gazetarisë hulumtuese, pa i vendosur paraprakisht rregullat bazë të lojës. Kjo kurrë nuk do të ndihmojë në zhvillimin e një shteti dhe gjithsesi, nuk do të kontribuojë fare në raportet mes politikës dhe mediave.

KONFUZIONI MES GAZETARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Politikani i mençur, në cilëndo qoftë shoqëri, do të involvohet në marrëdhënie të dendura komunikimi (PR) me qëllim që të përfitojë dhe të zbutë gazetarë të caktuar. Shkaku kryesor për të cilin politikanët e bëjnë këtë është se e dinë se kjo shpesh ka sukses. Ata që nuk janë të përfituar dhe të cilët nuk bëjnë pjesë askund, mund të mbeten të vetmuar në acar. Kultura e përjashtimit dhe e hedhjes poshtë është e fuqishme dhe sakatuese; kultura e të pajtuarit mund të jetë e këndshme dhe shpërblyese, por jo në termet të cilat e përcaktojnë gazetarinë e vërtetë.

Sipas Premesh Çandranit kryetarit të internet portalit për lajme Malajsiakini , i cili u ngrit gjatë qeverisjes së dr. Mahathir bin Mohamedit nga Malajzia, politikanët i duan mediat, kur ato janë nën kontrollin e tyre ose ideologjikisht përshtaten.

Në raste të këtilla, Çandran thotë se mediat shpesh herë mund të shërbejnë për "justifikim të situatave politike" me zbatimin e "fakteve", të cilat mbështesin "qëllime politike". Çandran thotë se rezultati është ai që gazetarët e shkëmbejnë objektivitetin e tyre për qasje të privilegjuar të fuqia dhe politikanët.

Që të ndërpritet ky cikël, ekziston nevoja për "gazetarë me integritet" dhe kompani mediale që janë "më shumë të motivuar nga parimet sesa profiti". Sa i përket politikanëve, ai thotë se shoqërisë i nevojiten "politikanë që janë të aftë ta vendosin përgjegjësinë para egos së tyre".



Shahidul Alam, drejtor i rrjetit Drik në Bangladesh dhe gazetar i jashtëzakonshëm, thotë se ekziston dallim i qartë në raportin mes gazetarëve dhe politikanëve, kur politikanët të hyjnë në qeveri. Alam thotë se kur ai raport do të priset, efekti mbi gazetarinë është shumë i thellë.

Procedurat e përgjithshme, thotë ai, nënkuptojnë se opozita i konsideron mediat për miq të vetët, ndërsa qeveria i konsideron si armiq. “Kjo në masë të madhe ka të bëjë me atë që mediat, duke e luajtur rolin e ndërgjegjes kritike, zakonisht kritikojnë politika qeveritare të padrejta dhe të pakuptimta.

Alam thotë se ekzistojnë përjashtime dhe se edhe qeveria edhe opozita “me vendim të tyre i frikësojnë gazetarët, kur disa njoftime nuk u shkojnë në favor”. Ai citon raste ku thotë se “ka pasur raste në Bangladesh ku ministrat kanë deklaruar se fotografët janë pre e lehtë”.

Kjo ka rezultuar me “instruksione të dërguara deri te anëtarët partiakë”, që “t’u thehen eshtrat fotografëve”. Alam thotë se, përderisa shumë fotografë janë sulmuar, “asnjë procedurë nuk është ngritur kundër policisë ose kundër aktivistëve partiakë të implikuar në sulmet”.

RËNDËSIA E INTEGRITETIT GAZETARESK

Gazetarët duhet të kuptojnë se, pa dallim të territorit në të cilin jetojnë dhe punojnë, ata kanë për detyrë të qëndrojnë të ndarë nga ata që e kanë fuqinë. Puna e tyre është që ta hulumtojnë punën e organeve ekzekutive dhe t’i nxjerrin para përgjegjësisë, por këtë mund ta bëjnë vetëm nëse kanë integritet. Ata duhet të kenë përgjegjësi ndaj publikut, njëjtë sikur politikanët kanë përgjegjësi ndaj atyre që i kanë zgjedhur. Nëse kjo nuk ndodh, të ashtuquajturit gazetarë, të cilët janë të komprometuar nga politika dhe politikanët, në fund mbeten në rolin e asgjë më shumë se propagandistëve dhe zëdhënësve të thjeshtë të politikanëve. Rezultat i kësaj do të jetë ajo që publiku do të privohet nga qasja deri te informacionet, të cilat i nevojiten shoqërisë me qëllim që të funksionojnë në mënyrë normale dhe korrekte.



Jasna Koteska

Dr. Jasna Koteska (1970), Maqedoni, punon si profesore e letërsisë në Fakultetin Filologjik në Shkup. Ka magjistruar në Shkup dhe Budapestë dhe ka doktoruar në Shkup. Punon në më shumë disiplina: psikanaliza teorike, teoria e letërsisë, studimet gjinore; dhe me spektër të gjerë temash: komunizmi, pajtimi, sanitariteti, intimiteti, identiteti. Shkrimet dhe librat e saj janë përkthyer në më shumë gjuhë. Është autore e librave: Studime postmoderniste letrare (2002), Letra femërore maqedonase (2003), Enigma Sanitare (Templum, 2006) dhe Intima komuniste (Templum, 2008).



Jasna Koteska

Dialogu dhe samizdati

1 Xhabir Deralla më bëri ftesë të shkruaj një tekst për kulturën politike dhe për dialogun në Republikën e Maqedonisë. Kulturën e konsiderova si temë të gjerë, prandaj u përcaktova për të dytën. Domethënë, për dialogun. Fillimisht më ranë ndërmend tre dialogët të cilat para do kohe përfunduan në gjykatë. Irena Cvetkoviç e hapi dialogun për tekstet shkollore homofobike në arsimin e mesëm, dhe përfundoi në gjykatë. Zharko Trajanovski e hapi dialogun rreth thirrjeve publike për ekzekutim me personat të cilët nuk janë të një mendimi me pushtetin nga ana e Milenko Nedellkovskit, prandaj përfundoi në gjykatë. Edhe Nikolla Gelevski pati kontest me Dragan Pavloviç Latasin, prandaj përfundoi në gjykatë, më pas pësoi humbje dhe i duhej të paguajë gjobë për shpifje. Në tri rastet dialogun e iniciuan njerëz të sferës civile. Mesazhi u bë alarmues. A përfundon kështu çdokush i cili hap dialog publik? A është ky fenomen i ri, i lidhur për vendet e vogla pa masë kritike – këto ishin pyetjet e mia të para instiktive.

Vendosa t'i kërkoj përgjigjet në të kaluarën. Mishel Montenj ka një tekst të rëndësishëm: "Për aftësinë e zhvillimit të bisedës", mu duk si hyrje e mirë. Por, sapo e hapa tekstin, goditje. Studimin për dialogun, Montenj e fillon kështu: "Është zakon gjykatat tona të ndëshkojnë me qëllim që t'ua tërheqin vërejtjen të tjerëve. Sikur t'i gjykonin vetëm pse kanë gabuar do të ishte marrëzi... I ndëshkojnë që vetë të mos gabojnë në

Në Maqedoni njerëzit më me ndikim më së shpeshti janë edhe më të paaftit

mënyrë të njëjtë sërish, por që edhe që të tjerët të kenë frikë nga shembujt e tyre". Dhe shton: "Ne nuk e përmirësojmë atë të cilin e varim, por i përmirësojmë të tjerët përmes tij". A nuk është ironi që teksti i Montenjit për debat që në fjalinë e parë e përmend gjykimin? Nëse kështu qëndrojnë punët në shekullin 16, vallë mbrehja dialog – gjykatë nuk ka ndryshuar, për katër shekuj të plotë? Duket se kështu ka qenë edhe në komunizëm. Babai im e ka kritikuar sistemin shtetëror, dhe ka përfunduar në gjykatë dhe nuk ka paguar vetëm gjobë, por është dashur të vuaj edhe dënimin me burg (shkaqet për këtë, megjithatë, akoma nuk janë të qarta). Por ai ka qenë sistem totalitar. Vallë demokracia, për të cilën jemi aq krenarë, sot çuditshëm vazhdimësinë e saj e gjen në totalitarizmin?

Montenji për këto dilema nuk ka përgjigje, por teksti i tij vazhdon: pse është mirë të zhvillohet dialog? Thotë: kur lexon libër, ai nuk të "ndez", përkundrazi, biseda me një bashkëpunëtor të ashpër, të fuqishëm, të nxit të ngrihesh mbi veten. Por, Montenji e bën edhe dallimin kryesor kur thotë: "Dëshiroj të ngatërrohem dhe të fjalosem, por në shoqëri të vogël dhe në llogarinë time". Ndërsa kjo dallon nga dialogu publik, apo jo? E megjithatë, edhe pak për Montenjin. Ai thotë: dua kur dikush më kundërshton, kjo e zgjon vëmendjen time e jo zemërimin tim.

Por, e thotë edhe këtë: është vështirë në kohën time të gjesh njeri i cili dëshiron të drejtojë, pasi që: "njerëzit nuk kanë guxim të kundërshtojnë". Ja edhe një ngjashmëri me ditët e sotme. Njerëzit nuk diskutojnë për shkak të frikës. Frikohen se do ta godasin dikë nga pushteti, por frikohen edhe nga kritika e kthyer. Sokrati përkundrazi, gjithmonë i buzëqeshur e ka pranuar kundërshtimin ndaj ideve të tyre, në të ka gjetur dëshmi se bashkëfolësi i tij është i pafuqishëm; në anën tjetër me të vërtetë ka diçka të amësht dhe të jobindëse te personat të cilët na admirojnë ose na lëshojnë, duke na thënë sa jemi të mirë. Anisteni, për shembull, i ka këshilluar fëmijët e tij asnjëherë të mos jenë falënderues ndaj atij që i lavdëron.

Por, a thua kur goditjet e konisderueshme nga bashkëfolësit tanë më të dobët pushojnë së qeni interesante dhe nisin të bëhen të mundimshme? Atëherë kur nga bashkëfolësit nuk kërkojmë vetëm fuqi apo gjindshmëri, por edhe respektim të rregullave. Atëherë kur, nëse shkojmë në gjykatë, kërkojmë që gjykata pa frikë t'i vlerësojë argumentet e dy palëve. Por, a janë gjykatësit tanë të këtillë? Është e pamundur që në mënyrë të ndershme të debatoni me një të marrë, por gjithashtu është e pamundur atë ta bëni para një gjykatësi të frikësuar, apo jo? Te bisedat është edhe kjo: fillimisht fillojmë zënkë rreth argumenteve, e më pas kalojmë te njerëzit. Dhe gjykatësi na vlerëson edhe në këtë mënyrë. Platoni në Shtetin e tij u ka ndaluar personave të paafte dhe të jofalënderues të zhvillojnë dialog. Të tillët shpesh i gjejmë ndër politikanët, gazetarët dhe gjykatësit, ndërsa Maqedonia është përplot me njerëz të këtillë.

Edhe diçka. Montenji thotë: "Më shumë do të që doja djali im të mësojë të bisedojë në pijetore, sesa në shkollat e retorikës". Ka të drejtë. Profesorët kanë përparësinë e ditorisë së mëdha, por megjithatë ata nuk zhvillojnë diskutime publike. Pse? Dituria sjell peshë të madhe, ndërsa ata mbyten nën atë peshë. Por, profesorët mbyten edhe në frikë, njëjtë si dhe gjykatësit. Te Platoni, Sokrati debaton me bashkëfolësit e tij që t'i ushtrojë. Shpesh e lexoj portalin maqedonas "Okno", dhe shikoj se si Kola (Nikolla Gel-evski – v.j.) i ushtron bashkëfolësit e tij. Në njërin nga replikat e tij të shumta, gjeta një fjali me të vërtetë qesharake e cila ma kthjelloi edhe ditën, ndërsa përfaqësisht vijonte kështu: "mjaft ju mësoj këtu, Partia le t'ju regjistrojë në shkolla nate, të shoqëroheni, të mësoni nëpër lojë".

Me të vërtetë njeriu ndonjëherë ofendohet, jo nga mosdija ose nga e pavërteta por nga kokëtullësia dhe mungesa e humorit. Montenji na përkujton në një skenë kur në punëtorinë e piktorit grek Apel për vizitë ka ardhur Megabiz, njeri autoritar, i cili fillimisht ka heshtur, e më pas ka filluar gjatë të flasë për veprat e tij, ndërsa Apeli i është

përgjigjur: “Derisa heshte, dukeshe si njeri i madh, por kur fillove të flasësh, madje edhe djelmoshat e punëtorisë sime të përbuzën”.

Një nga kurthet e mençura është kur dialogu transferohet në meta-nivel. Bashkëshorti im, për shembull, nëse dëshiroj të zihem, sillet sipas kësaj strategjie. Nëse e pyes: “Pse janë këto sende këtu?”, më përgjigjet: “Më fal, a the sende apo sene? Meqë, sene nuk është në gjuhën letrare”. Kjo është kur dialogu shndërrohet në dialog për dialogun dhe formon sistem të mbyllur, si në grafikën e Esherit Duar që vizatojnë (1948), ku ka dorë e cila vizaton dorë, e cila vizaton dorë, e cila vizaton dorë. Apo si te fotografia ikonografike për televizorin që shfaq televizorin, etj. Vargjet e këtij tipi ose përfundojnë në pafundësi, ose truri i njeriut nuk mund t’i kapë. Në këto raste mezi që flitet për formën, ndërsa debatet tona publike në numër të madh janë të tilla.

2. Në Maqedoni njerëzit më me ndikim më së shpeshti janë më të paaftët. Njëherë më ftuan në një emision debativ në televizion. Politikani kryesor i emisionit ishte aq monoton dhe i mërzitshëm sa dëshiroja t’ia fusja gjumit që të mos e dëgjoja një orë të tërë. Numëroja pika në murin e studios që të mbetem zgjuar. Vallë si janë ndërë ata para ekraneve? Për njerëzit e pozitave të larta nuk gjykojmë sipas qëndrimeve të tyre, por sipas kostumit dhe iluzionit të madhësisë. Si replika romake: “Nuk e pashë, pasi që ishte i errësuar me fjalë”, por këtu ndodh e kundërta: “Nuk dëgjova pasi që fjalët a pavlefshme i ngulfateshin nga pozita e lartë që e ka”. Funksionet publike nga njerëzit e paaftë bëjnë cirkusantë, të cilët shërbejnë për përqeshje nga i gjithë kombi. Megjithatë ata e kanë fuqinë, ndërsa qytetarët, të verbuar nga kostumet, në fjalët e tyre shpesh herë me zor kërkojnë virtyte çfarë aty nuk ka.

Po, a nuk janë të po kësaj natyre edhe llomotitjet kuturu në tribunat publike dhe në televizion? Kur në debatet mezi identifikoni llomotitjet, komoditet ky i cili lind nga afërsia e paqartë në studio, vend ku ushtrohet gjithçka, përveç frymës për bisedë dhe polemikë – duhet ta dini se ata njerëz flasin që të mos thonë asgjë të rëndësishme. Ata nuk duhet t’i dëgjojmë me asnjë kusht. Ka një anekdotë nga shekulli 19, nga kabineti i psikanalistit hungarez Balint, te i cili në seanca ka ardhur një zonjë sharmante: simpatike, interesante, llafazane, grua e cila vetëm flet, flet dhe flet, pa fillim dhe pa fund. Në një seancë, pas një ore llomotitje, Balint përnjëherë lehtë e ka prekur simptomën për të cilin ajo ka ardhur në seanca, duke kërkuar ndihmë. Zonja sharmante ka marrë rekomandim për vend të ri të punës. Në rekomandimin ka shkruar se ajo është “person krejtësisht i besueshëm”. Momenti brengosës përbëhej nga fakti se ajo nuk ka dashur të perceptohet si e besueshme. Nuk dëshiron askush të mbështetet në fjalën e saj. Pasi që fjala obligon. Nëse pushon së foluri, ajo duhet të fillojë të punojë dhe t’i respektojë marrëveshjet. Pikërisht për këtë pavarësi sharmante njerëzit llomotisin e llomotisin kur debatojnë. Këtë e bëjnë që të mos thonë diçka të rëndësishme, që të mos obligohen për asgjë.

Në një emision televiziv më pyetën se çka mendoj për origjinën antike të maqedonasve. Thashë se origjina antike e kombit maqedonas është nebulozë mitike. Ligjëroj në Katedrën për Letërsi Maqedonase, dhe gjuhë maqedonase si gjuhë sllave për mua është pjesë e identiteti tim më intim. Nëna ime është nga Maqedonia e Egjeut, në atë vend unë kam humbur më shumë se shumë maqedonas të tjerë. Nëna dhe gjyshja ime kanë folur gjuhën sllavo-maqedonase. Gjyshja ime vdiq në moshën 93 vjeçare para një dekade, jetonte në Miçurin, mëhallë egjejase në Shkup, në të cilën sot jetoj me familjen time. Gjuha e saj amtare ishte sllave, ndërsa ajo ka lindur në Kostur, ajo atëherë ishte gjuhë minoritare sllave në vendin fqinj, Greqi. Gjyshja ime ka qenë pjesëtare e minoritetit dhe vetëm për shkak se ka qenë minoritare, është dëbuar nga prona e saj, ka jetuar në një vend me njerëz të rëndomtë por me politikanë jo të drejtë. Prandaj sot mendoj se duhet ta mbroj të drejtën e pakicave në vendin tim me ashpërsinë dhe fuqi-

në e njëjtë, me të cilin gjyshja ime është dënuar me egzil, vetëm se ka qenë pakicë. Pa drejtësisë njeriu gjithmonë duhet t'i përgjigjet me luftë për drejtësi. Kur më dhanë të ligjëroj letërsi për studentët e gjuhës shqipe dhe asaj turke në vendin tim të punës isha tejet e lumtur, ndërsa sot jam krenare për secilin student që arrita gjatë gjithë këtyre viteve ta prek në njëfarë mënyre. Për mua ky takim ishte si kthim drejt rrënjëve të mia dhe mundësi për të luftuar për të drejtën për të qenë i ndryshëm – e drejtë e lashtë, e vendosur, nëse doni, edhe në historinë e paraardhësve të mi. Gjyshja ime dhe unë e flasim gjuhën sllavo-maqedonase në mënyrën e njëjtë, me dallime të parëndësishme dialektore. Këto dallime nuk ishin greke. Dhe kaq për këtë temë. Gjatë gjithë jetës sime të vetëdijshme mësoja t'i bëj dallimet midis gjuhëve dhe letërsive. Paraardhësit e mi janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, por ata nuk do t'i kthejnë pronat e tyre me historinë e rrejtshme që politika jonë e shet viteve të fundit. Dhe si shkencëtare, e di saktë se nuk ka mënyrë shkencore të bashkoni dhjetë shekuj histori që nuk ekziston, pa gënjeshtër.

Njoh shumë klasicistë, të cilët në këto kohë fatkeq, mbyten nga bara e njohurive të tyre dhe në vend se t'ia kristalizojnë gjërat opinionit midis Maqedonisë antike dhe të sotme, heshtin, ndërsa vendin e të folurit, në vend të tyre e plotësojnë njerëz me dituri selektuese ose pa kurrfarë njohurish. Njëkohësisht e di se kjo gënjeshtër antike viteve të fundit na duhet neve veçanërisht për të arsyetuar mossukseset tona dhe gjysmë-produktet, gjithë ndërtimin pa leje të mendimeve tona provinciale. Dhe prandaj në emision thashë: jo, origjina antiko-maqedonase e popullit tim është nebulozë.

Por, në sajtin e emisionit më duhej të lexoja dhjetëra komente se jam tradhtare e popullit tim, tradhtare e babait tim, se jam majtiste me origjinë djathtiste, thua se ajo fjali është, Zot ruajna, dënim me vdekje apo ofendim fatal. Studentët e mi erdhën shumë të nervozuar orën e ardhshme. Përse njerëzit mendojnë se jam tradhtare? U përgjigja me replikën e filmit Shoqata e poetëve të vdekur, i pari që më ra ndërmend atë mëngjes. Kur profesori të cilin e luajti Robin Uiliams në orën e parë të letërsisë i nxori studentët e tij në oborrin e shkollës dhe u tha të hapëronin. Vetëm të hapëronin. Fillimisht çdo student hapëronte siç di më mirë, secili për vete, shpejt pas kësaj filluan të sinkronizohen, të harmonizohen në shpejtësi, temp, ritmin e hapave, ndërsa në fund të gjithë shkonin të bashkuar si një trup i madh. Ai ishte leksioni i parë i tyre për hipokrizinë. Leksioni se ndonjëherë e tradhtojmë njohurinë tonë më intime dhe veçantinë sikur të jenë armë trofe të cilën na e ka marrë armiku, vetëm për atë se për atë moment të dhënë, kemi menduar se të gjithë hapërojnë në mënyrë të njëjtë. Pasi që nuk kemi dëgjuar hap të ndryshëm. Njëherë shkrova, do të përsëris. Vargu im i preferuar i shekullit 16 nuk i takon Montenjit, por një njeriu tjetër të mençur, klerik-anonim i të njëjtit shekull, i cili ka thënë: "Asnjëherë mos thuaj se është qetë. Thuaj se unë asgjë s'kam dëgjuar".

Edhe pak për këmbët. Kjerkegor përshkruan se si një herë, për shkak rrethanave, ndërsa kjo është në shekullin 19, tridhjetë e gjashtë orë është dashur të udhëtojë nga qyteti i tij deri në Berlin në karrocë të ngushtë, së bashku me gjashtë veta të tjerë. Dhe gradualisht ka ndjerë se si të gjashtë udhëtarët përnjëherë dhe pa paralajmëruar bëhen një trup gjigant i përbashkët, në të cilin nuk ka mundur të identifikojë se cila këmbë është e tij. Jeta në kushte të ngushta, ndërsa jeta e Maqedonisë është e gjykuar të jetë e tillë (çdokush prej nesh vazhdimisht ta aktivizojë memorien se ka pasur këmbë në trup gjigant), është fenomen të cilin duhet vazhdimisht dhe syzgjuar ta përkujtojmë, nëse dëshirojmë dialog autentik.

Tek e fundit, në dialogët shpesh ndodh që, pasi t'i keni dhënë argumentet tua, bashkëfolësi t'ua kthejë: "Të njëjtën e mendoja, vetëm se nuk pata fjalë ta them këtë". Edhe Montenji thotë: shkunde atë budallallëk të paturpshëm me të keq. Gjithsesi, përveç se nuk duhet gjatë dialogëve të jeni i lig, por edhe të studiohet se ku mundet, kjo nuk vlen gjithkund. Pse t'u shtrini dorën të marrëve? Duhet t'u lejoni, përmes refuzimit, ta shohin marrëzinë e tyre. Siç thotë Montenji: njeriu nuk bëhet muzicent vetëm sepse ka dëgjuar një melodi të mirë.

Përliçev në Autobiografinë e tij kur i përshkruan rrugët e ngushta të Ohrit, përnjëherë thotë se ato kanë qenë aq të ngushta sa dy gomarë nuk kanë mundur të takohen e të mos fyejnë njëri-tjetrin. Kështu funksionojnë qytetet dhe bashkësitë e vogla. Kokëfortësia dhe prapambeturia jo vetëm se janë dëshmi për budallallëkun, por në bashkësitë e vogla janë shenjë e kulturës së kokëfortësisë së gomarit. Ekzistojnë shumë mejdane të këtilla publike të ashpra dhe të pakuptueshme.

Por, ekzistojnë edhe debate në të cilat thjesht nuk duhet të merrni pjesë. Është i njohur averzioni i Zhil Delez për dialogët. Kur në kafene do t'i afrohej ndonjë njeri me replikën: "Hajde të debatojmë për këtë temë", filozofi i madh, shpejt është ngritur dhe ka braktisur kafenenë.

Në arsyetimin për sjelljen e tij të çuditshme, paradoksale, në dispozicion e kemi pjesën më të madhe të filozofisë perëndimore. Te Platoni, dialogu është këmbim asimetrik i argumenteve. Platoni (njeriu i cili në botën perëndimore e shpiku formatin e dialogut) menjëherë e futi edhe gjykimin tronditës: nuk duhet lënë hapësirë e barabartë për bisedë të gjithë bashkëfolësve. Te Platoni i hershëm më së shumti flet Sokrati. Te Platoni i vonshëm flet vetëm personazhi kryesor, derisa bashkëfolësi i tij shërben që herë pas here të thotë ndonjë replikë të ngurtë, të tipit: "Ashtu është", "Në emër të Zeusit, plotësisht ke të drejtë".

A nuk ka të drejtë Sllavoj Zhizhek kur thotë se i gjithë opinioni perëndimor përbëhet nga mosekzistimi i dialogut ose nga moskuptimi i argumenteve të bashkëfolësit? Aristoteli nuk e ka kuptuar Platonin. Hegeli nuk e ka kuptuar Kantin. Niçe nuk e ka kuptuar Jezu Krishtin. Marksi nuk e ka kuptuar Hegelin. Stalini nuk e ka kuptuar Marksën. Është fakt se e gjithë lëvizja perëndimore ideore bazohet në veshë të shurdhër.

Më kujtohet Henri Miler, i cili në një film dokumentar, tha: "Nxënësi i parë është ai i cili i pari do ta shtrembërojë të vërtetën". E saktë. Zë të fortë ka vetëm ai i cili i pari do ta mposhtë tjetrin, e jo ai i cili i pari do ta dëgjojë ose që do të flasë me të.

Atëherë, vallë nuk është më e sinqertë që në fillim të pranojmë një gjest radikal filozofik dhe me sinqeritet të themi: nuk duhet gjithmonë të aktrojmë se ekziston mundësi të flasim me njerëz të cilët ideologjikisht nuk mendojnë si ne! Nganjëherë është më e drejtë që në vend se rrejshëm ta plotësojmë zgafellen midis keqkuptimeve tona, të fillojmë me një zgjedhje të gabueshme dhe sinqerisht t'i themi armikut tonë ideologjik: "Nuk dëshiroj të bisedoj me ty", që më pas, eventualisht, të krijohen kushte që të fillojmë ndonjë bisedë. Nuk e di se çfarë kompromisi në dialog akoma mund të kemi, kur sot mbretëron proliferim i së drejtës që çdokush ta dhiejë (kërkoj falje për lexuesit më skofiarë) mendimin e tyre, madje edhe kur ai mendim kufizohet me fashizëm të pastër? Ndërsa me fashistët nuk duhet bërë negociata.

Është një skenë ikonike: nazistët nënës ia parashtrojnë pyetjen e pamundur: "Cilin nga dy fëmijët, zonjë, dëshironi të mos e pushkatojmë?" Njeriu nuk duhet dhe nuk mundet në çdo situatë dhe në çfarëdo rrethana të bëjë dialog.

3. Dëgjojmë vazhdimisht: "Në debatet, duhet të përfshihen sa më shumë analistë". Por, pse? Ka situata kur detyra e analistit është të MOS marrë pjesë në debatet, veçanërisht kur pjesëmarrja do të thotë pranim i koordinatave bazike në debatet me të cilat elita në pushtet e formulon problemin. Apo medien.

Çdokush që është ftuar në "bisedë" televizive këtë e di mirë. Analistit i jepet hapësirë prej tre minutave, të cilat duhet të plotësohen me fjalim cirkusant nga barku, kërkohen fjali punktuale, të cilat përfundimisht nuk i shërbejnë askujt, përveç se e ushqejnë medien, si një Matriks i madh.

A nuk e formuluan Hard dhe Negri saktë problemin kur thanë: demokracia dhe e drejta e dialogut janë në qendër të konflikteve dhe luftërave të sotme . Sot, pas kërkesës për dialog të përbashkët, për ndarje, për komunikim, qëndron hegjemonizimi i qartë ushtarak në botë.

Nëse pajtohemi se pa medie nuk ka bisedë (përveç si një këmbim privat, pothuajse konfidencial), atëherë çka qëndron pas medias? Të përkujtohem në skandalin me televizionin A1 në nëntor dhe dhjetor 2010. Fillimisht policia bëri bastisje rreth ndërtesës së televizionit me sqarimin se kërkon korrupsion në punën e firmave, në pronësi të pronarit. Më pas pronari i medias doli me rrëfim shokant se pushteti prej tij e ka blerë hapësirën mediale, jo me para partiake por me para shtetërore – domethënë ktheu me një skandal më të madh korporativ dhe shtetëror. Në fund pronari i njëjtë, një ditë më pas i kërkoi falje opinionit se në afekt ka dhënë deklaratë jo të saktë.

Problemi më i madh me këtë seri potenciale kriminale të aksioneve është se madje edhe sikur të gjitha këto deklarata do të ishin të vërteta, madje edhe sikur të gjithë aktorët ta pranonin fajin e tyre pa bërë zë, e vërteta për këto ngjarje do të ndërrohet me shpejtësi aq të madhe, nga dita në ditë, që në fund kjo e vërtetë do të bëhet kategori mezi efmere, pa status, pa stabilitet dhe qëndrueshmëri, ndërsa në afat të gjatë, vetëm senzacion afatshkurtër. Në gjithë këtë, opinioni do të vihet në pozitë që ta gëlltisë të vërtetën e cila për momentin do të servohet si e tillë. Media i drejtohet publikut të pasivizuar e me këtë edhe të dëmtuar, për të cilin e vërteta është mezi një ngjarje e ditës. Pavarësisht se çfarë është imazhi real për ndershmërinë apo korrupsionin e medias, është ai imazh liberal apo konservativ, stili që cili mund të lëvizë nga joshës deri në të mërzitshëm, nga vulgar deri në me klas ose të dyja, media çdo herë shërben që ta ndërpresë bisedën dhe ta konfirmojë diagnozën e Platonit se në dialog fiton më i zëshmi, e jo më i kuptueshmi.

Në filmin Film (1965) të Semjuel Beketit, askush nuk flet me askënd, ndërsa personazhet tregojnë frikë të paqartë dhe të tmerrshme nga diçka misterioze, së cilës nuk mund t'ia përcaktojmë formën, deri në sekuencën e fundit të filmit, kur e kuptojmë se pa përjashtim, ata frikohen nga shikimi ynë, nga shikimi i kameras, me të cilën refuzojnë të bëjnë dialog. Ngjashëm si Negri dhe Hardi, Beket medien e definoi si vend për dialog të pamundshëm: së këndejmi edhe emri gjenerik i filmit, thjeshtë Film. Për Beketin forma e medias mbetet përmbajtja e tij, ajo që Mek Luan më vonë e paketon në fjali elegante: "Media është mesazhi". Asnjë bisedë përmes medias nuk sjell mesazh, përveç se e legjitimon medien.

Por, edhe më dramatike. A nuk është kështu që te Platoni? Atij ia kemi borxh idenë për dialog, ndërsa Polisit të tij – idenë për demokraci. Por, nga antika këto të dyja vijnë si pako me simptomën: demokracia bazohet në dialogun e lejuar, pikërisht se dialogu bëhet i parëndësishëm. I sjellë deri në ekstremin e tij filozofik, dialogu publik është ose të folur me të shurdhërin, ose anasjelltas, parashtrim i pyetjes së pamundur: "Cilën nga dy fëmijët tuaj, Madam, zgjidhna ta pushkatojmë?". Ndërsa në prohibicionin e ngjashëm të zërit bazohet edhe filmi Plaçkitësi (1952). Në të, me të vërtetë, dëgjojmë ndonjë pëshpërimë të paqartë të njerëzve në prapavijë apo zëra të automjeteve të cilët kalojnë, por atje nuk ka skenë në të cilën personazhi do të detyrohej ose mundësohej të hyjë në dialog.

Gjithsesi të dy filmat luajnë në letërën e atmosferës klaustrofobike, universumi akustik është i suspenduar, ndërsa llomotitja e pakuptimtë e njerëzve, sikur te zonja e Balintit, nuk shërben për asgjë – sa më shumë që media prodhon zhurmë të pëlqyer, aq publikut të dëmtuar i merret replika. Këtë e dimë edhe nga përvojat tona themelore, kur njerëzit na thonë: "Ç'më duhet ta them mendimin tim, kur ai humbet në pakuptimësinë e shumë bisedave?", që i gjithë dialogu mund të reduktohet në stereotipin e sjellshëm për bisedën britanike ekskluzivisht për motin. Dialogu e nxjerr fuqinë e vet perpetuale të pafund pikërisht nga fakti se është i shurdhër.

Megjithatë, kjo qasje është kapriçioze. Nuk është e pakuptimtë të bisedohet, por derisa bisedohet, duhet qenë i vetëdijshëm për parazitin e ngjitur në trupin e dialogut – këto janë mediet dhe pushteti që e diktojnë bisedën.

Derida pyet: çka do të bënin makineritë tona mediale nga Rembo apo Lotreamon, nga Niçe apo Prusti, nga një Kafkë apo nga një Xhojs? Këta autorë janë shpëtuar nga një grusht lexuesish, nga shkalla minimale e dëgjueshmërisë, janë shpëtuar nga privatësia, e jo nga jeta publike. Në këtë shkallë, nëse një libër nuk lexohet më shumë se dhjetë mijë ekzemplarë, thotë Derida, ai duhet të trajtohet si korrespondencë private.

Të kthehem në fillim të tekstit. Pas lajmit për padinë penale deri për Irena Cvetkoviçin, nga agjencia Makfaks më kërkuan mendim për nxënësit homofobikë. U përgjigja: ata janë jokompetentë kur homoseksualitetin e definojnë si sëmundje, dhe shtova se dëshiroj të jetoj në vend në të cilin, djali im apo miqtë e tij, kur të rriten, do të mundën me zë të thonë se janë gej, nëse janë, dhe të jenë krenarë për këtë. Mendimin tim nuk e publikuan. Dialogët tanë, prandaj nuk kushtëzohen vetëm nga gazetarët, të cilët ndoshta janë të pafuqishëm, madje as nga mediet, por edhe nga ajo që e quajmë "klimë e përgjithshme". Prandaj them, ndonjëherë dialogët janë të pamundshëm, përveç si debate private. Ndërsa të tillat nuk kryejnë punë.

4. Atëherë çka na mbetet? Midis privatësisë (librave dhe analizave tona, të cilat reduktohen në bisedë midis tre personave) dhe publikes (mediet dhe lëvizja e tyre marramendëse nga një e vërtetë te tjetra) ekziston një zonë gri, që quhet: samizdati. Samizdati është forma e vetme e dialogut në të cilën akoma besoj.

Më 2 dhjetor 2010 (gjashhtë ditë para afatit tim për këtë tekst) Amazoni refuzoi ta hostojë sajtin e Uikiliksit. Uikiliks po atë ditë u përgjigj: "Nëse Amazonit i vjen keq për shkak të amendamentit të parë (për lirinë e të shprehurit, vërejtje e imja), atëherë Amazoni duhet ta braktisë biznesin me libra", e pasi që veçmë e braktisën terrenin publik për dialog, po të njëjtën ditë, në mënyrë precize e definuan vendin e vet në botë: "Uikiliks është lëvizja e parë globale samizdati". Pajtohem plotësisht.

Për momentin, Uikiliks rrjeti për publikimin e informacioneve është dialogu i vetëm politik global, i cili as nuk i takon privatësisë – ata nuk e ndajnë të vërtetën midis tyre, ua japin të gjithë njerëzve të cilët kanë kompjuter dhe modem, nga Johannesburgu deri në Shkup, pa përjashtim; ndërsa njëkohësisht, ata nuk i takojnë as publikes – shumë shtete botërore dhe banka (madje edhe zvicëranët) gjithnjë e më shumë e ngushtojnë rrethin rreth personave më të eksponuar të Uikiliksit, për momentin para së gjithash rreth themeluesit Xhulian Asanzh, me rast shumë të dyshimtë gjyqësor, ndërsa kompanitë në internet ua heqin hapësirën.

Jetojmë në erën e post-politikës, çdo budalla - nga Berlusconi, deri te Sarkozy dhe Sara Palin, si dhe budallenjtë tanë politik - më shumë veprojnë si cirkusantë medialë të estradës sesa si politikanë, ndërsa për kompensim, njerëzit ankthshëm e ndërmarrin rolin e politikës, flasin vetëm për politikë, pa ndihmesë duke u munduar që punët t'i mbajnë nën kontroll. Por, me Uikiliks in hyjmë në erën e post-samizdatit, me vëllim të rezistencës të panjohur për qytetërimin e deritashëm. Në këtë kuptim, Uikiliks ka paraprijës historik dinjitoz në samizdatet e kohës së totalitarizmit, por edhe mbështetje teknologjike të panjohur deri më tani.

Uikiliks për momentin nuk e ridefinon historinë vetëm si shkencë (Timoti Esh në Gardian shkroi: ajo që historisë i bëhej e kapshme pas 20 deri 30 viteve, me Uikiliks in i bëhet e kapshme për 30 javë", duke e quajtur Uikiliks in banket për historianët), por edhe gazetarinë si profesion. Gardianit, Si-en-en-it, Nju-Jork Tajms-it, Tajm-it, nuk u mbeti tjetër përveçse ta ndjekin Uikiliks in, dhe tri lajmet e para shokuese dhe editorialet t'ua kushtojnë të dhënave të cilat rrjedhin prej tyre.

Është interesante se Uikiliks para katër viteve filloi pikërisht me idenë për dialog. Rrjetin e vet e quajtën Uikiliks, sipas modelit të Uikipedisë, çdo anëtar nga bashkësia globale të mund ta japë kontributin e vet për të vërtetën e ngjarjeve. Uikiliks ka ide të ngjashme. Beson se nëse publikojnë informacion për krimin korruptivo-ekologjik në Shqipëri, p.sh. se një pjesë e qytetarëve shqiptarë do të interesohen të japin dëshmi autentike, ndërsa dy palët e involvuara të hapin dialog që të arrihet te e vërteta. U dëshmuar se bota nuk është e përgatitur për punë hulumtuese, ndërsa publiku i dëmtuar, pas një dresure të gjatë, në fakt as që di se si të bisedojë, nëse biseda bëhet jashtë rregullave të dakorduara për bisedën e zbrazët, jashtë ceremonive, riteve dhe simulacioneve. Shumica e njerëzve kanë dëshirë të sinqertë t'i redaktojnë të dhënat leksikografike për Tolstoin, për parqet nacionale në Malajzi, apo për elektronet, por u dëshmuar se pak, ose askush, nuk e di se si të bisedojë për shtyllat qendrore politike, financiare dhe mediale të qytetërimit tonë.

Më 3 dhjetor 2010 arriti lajmi se administrata e universitetit Kolumbia nga Nju-Jorku, i paralajmëroi studentët e vet të mos bëjnë dialog publikisht për Uikiliks, përndryshe i rrezikojnë karrierat e tyre të ardhshme profesionale. Me fjalë të tjera, e dërgoi mesazhin e njëjtë si shtetet, bankat dhe mediet: se është në rregull të jesh dyfytyrësh. Si njeri i cili me vite punon në universitet, ky lajm për mua ishte shokues. A nuk janë universitetet vende ku e vërteta mbrohet me çdo çmim, ku besoni se njerëzimi mund të fitojë, besoni në gjestin etik? Ku është Al Paçino nga filmi Aroma e gruas (1992) që nga bankat shkollore t'ua përplas të vërtetën anëtarëve të korruptuar të komisionit universitar, përmes fjalisë legjendare: "Kam parë djelmosha me duar të këputura dhe këmbë të prera, por nuk ka asgjë më të trishtueshme se fotografia e shpirtit të amputuar, pasi që për atë nuk ka protezë"? Ky film nga bankat shkollore, e parashtrroi pyetjen e stërlashtë për gjestin etik: "Sa vlejné fjalët tua në momentin kur mund ta humbësh të mirën personale? A je i gatshëm, nëse rrethanat nuk të shkojnë për shtati, t'i hash fjalët e tua? "Dhe u përgjigj se ekzistojnë momente kur, madje edhe sikur e gjithë bota jote të shembet, ajo që nuk guxon ta shesësh është e vërteta. Por, jeta nuk është film, ndërsa amputimi moral i Kolumbisë, i Amazonit, janë vetëm pjesë e befasive të cilat do të pasojnë gjatë muajve në vazhdim, kur do ta shohim shitjen me shumicë të moralit nga instancat më të larta të cilat deri dje kanë luftuar për të.

Ky fenomen, edhe pse i ri, në mënyrë paradoksale na kthen mbrapa në shekullin 16, pikërisht në kohën e Montenjtit. Por, jo në kuptimin e kthimit mbrapa (Umberto Eko duke e komentuar Uikiliks, me shaka tha se prej tani diplomatët do t'i bartin informacionet e besueshme me pëllumba), por përkundrazi. Disa analistë komentuan se Uikiliksi për botën moderne është ajo që ishin shtypshkronjat në shekullin 16. Kur për shkak qasjes të shtypshkronjat, në Holandë filloi përhapja e pamfleteve dhe gazetave me informacione të besueshme, fenomen rezultati final i të cilit ishte shkatërrimi i censurës së Kishës katolike, e cila, para asaj e kontrollonte publikimin e librave. Kjo gjë shkaktoi zhvillimin e shkencës, dhe përfundimisht demokratizimin e botës. Më pas gazetat gjithnjë e më shumë u rregulluan me dispozita gjithnjë e më të rrepta ligjore, që eventualisht prej tyre t'i krijojnë përbindëshit e sotëm medialë, kafshët e neveritshme politike, si edhe një vegël për dominim në botë.

Politika praktike, megjithatë, tregon se ndikimi i Uikiliks, për fat të keq, me siguri nuk do të jetë afatgjatë. Më 7 dhjetor Xhulian Asanzh, frontmeni i Uikiliks u arrestua në Londër. I kthehem raportit: "dialog i lirë – gjykatë" nga fillimi i këtij teksti. Me siguri do ta na presin edhe surpriza të tjera rreth Uikiliks. Por, ndikimi që ai për momentin e ushtron mbi historinë, diplomacinë dhe gazetarinë është i madh.

Njëri nga skenarët e mundshëm për fundin e Uikiliks do të jetë se shtetet e involvuara, bankat dhe mediat do të arrijnë përfundimisht të paketojnë një rrjet të këtyllë nga informacionet dhe rrëfimet, të cilat përfundimisht do ta bindin çdo banor të planetit se Uikiliks ka qenë vetëm një pjesë e kompleteve për fuqi, se ka qenë vetëm

degë e CIA-s, FBI-së, e rrjeteve të mëdha botërore të spiunimit. Mua personalisht, do të më duhet shumë, shumë kohë që intimisht ta pranoj këtë cinizëm, madje edhe pas shpëlarjes disamujore të trurit, gjë së cilës me siguri do t'i nënshtrohemi gjatë muajve në vijim. Por, bile për këtë moment, Uikiliksi e bëri të dukshme esencën e qenësisë së planetit tonë. Tashmë disa vite, më shumë se gjysmë dekadë, publikisht flas për nevojën që të deklasohen arkivat e Maqedonisë komuniste, të hapen përmes internetit, edhe atë menjëherë sipas parimit "të gjithë për të gjithë", pa mediimin e strukturave politike dhe të medieive. Atë që nuk u arrit te ne, e arriti Xhulian Asanzh masovikisht dhe në përmasa të papara deri më tani, jo vetëm për arkivat e kaluara por edhe për arkivat ekzistues të shërbimeve sekrete dhe të diplomacisë. Prandaj për mua, Asanzh dhe ekipi i tij janë heronj të kohës tonë. Për momentin derisa po e shkruaj këtë, akoma, është e paqartë se çfarë do të jetë fati i tij personal. Kur do ta lexoni tekstin me siguri do të dini më shumë se unë tani. Por, Uikiliksi nuk është vetëm Asanzh dhe do të nevojitet punë dhe logjistikë e madhe (të cilën, të jemi të realtë, perandoritë e kanë me tonë) që Uikiliksi të kapet për fyti, të çohet për ekzekutim. Megjithatë, informacionet nga Uikiliksi ndodhen në milionë kompjuterë privatë në planet, ndërsa rreth një mijë persona të padukshëm punojnë çdo ditë në dokumentet sekrete dhe i deklasojnë derisa flasim. Sidoqoftë, për këtë moment, Uikiliksi e ktheu besimin në dialogun, dhe bile sot, pa u përmbajtur mund ta përsëris komentin e bashkëfolësit të Sokratit, nga dialogët e Platonit: "Në emër të Zeusit, ashtu është siç shkruan në dokumentin e Uikiliksit të 29 nëntorit të vitit 2010".

Për fund një histori e vërtetë. Filozofi Alan Badju para disa viteve ka qëndruar në publik derisa Sllavoj Zhizhek ka mbajtur ligjeratë publike. Përnjëherë celulari i Badjuit ka rënë. Në vend se ta shkyçë, Badju butë e ka ndërprerë Zhizhekun dhe e ka lutur nëse mundet para publikut të flasë më qetë, që ta dëgjojë bashkëfolësin e tij në anën tjetër të telefonit. Për këtë ngjarje, Zhizhek, me humor u prononcua se është shenja e vetme e miqësisë së përhershme dhe të thellë. Nëse më lejohet ta përdor anekdotën për parabolë, Uikiliksi, për momentin, do të ishte zilja e samizdatit global deri te të gjithë celularët tanë përnjëherë, ndërsa punë e jona do të ishte t'i lusim ata që bërtasin nga foltoret, nëse mundet, i lusim, të flasin më qetë. Në linjë kemi një link të drejtpërdrejtë, i cili i drejtohet gjithë botës, përnjëherë. Duhet ta dëgjojmë.

8 dhjetor 2010



Afrim Krasniqi

Mr. Afrim Krasniqi (1971), Shqipëri. Politolog dhe gazetar. Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori – Filologji (1996) dhe ka kryer studimet pasuniversitare në Universitetin Europian të Viadrinës, Frankfurt – Oder, Gjermani. Mban gradë M.A. në Shkencat Politike dhe të Komunikimit Ndërkulturor (2003), në proces doktorimi në marrëdhënieve ndërkombetare në UT. Ka mbaruar kursin e lartë të drejtimit në Kolegjin e Mbrojtjes në Tiranë (2003) dhe në Qendrën "Marshall", Garmish – Parteikirchen, Gjermani (2004). Ka punuar si komentator politik në mediat e shkruara (1991-1995 dhe 2000-2002); zëdhënës në MPJ (1993-94), Kryetar i FRPD (1994-1998), deputet në parlamentin shqiptar (1996-1997), Ndihmës dhe Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës, Alfred Moisiu, (2002-2007) dhe Sekretar i Përgjithshëm MSH (2007-2008). Prej vitit 2005 e në vijim është pedagog i shkencave politike në universitetin e Tiranës dhe në disa universitete private. Botimet e tij me të rëndësishme janë librat "Rënia e Demokracisë" (1997), "Fundi i Siberisë Shqiptare" (1998), "Shoqëria Civile në Shqipëri" (2004), "Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006", (2006), "(Mbi)pushteti i Partive" (2007), "Partitë Politike dhe Sistemet Politike" (2008), "Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008" (2009) dhe "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008" (2009).



Afrim Krasniqi

Dialogu i brishtë politik: rasti i Shqipërisë

Dialogu i qëndrueshëm politik është një prej kriterëve politike për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik dhe anëtarësimin e Shqipërisë dhe të rajonit të Europës Juglindore në Bashkimin European. Për përmbushjen e këtij kriteri është e nevojshme të sigurohen parakushtet politike e sociale të zhvillimit të dialogut politik si dhe të garantohet një mjedis i përshtatshëm për një elitë politike të përgjegjshme, ku dialogu të jetë shtysë për forcimin e institucioneve dhe të demokracisë. Shqipëria paraqet një shembull konkret të problematikës komplekse të mungesës së dialogut dhe vështirësive në arritjen e tij. Mungesa e traditës, institucionet e brishta, vendi e roli drejtues që luajnë individët politikë në dëm të institucioneve si dhe mentalitete e kultura sjelljeje që vijnë nga një sistem përjashtues për dialogun, - janë disa prej vecorive të rastit shqiptar. Studimi përpiqet të analizojë të gjithë faktorët historikë e aktualë pengues të dialogut. Ai analizon format e dialogut politik, rolin e faktorit ndërkombëtar dhe të atij të brendshëm, produktet e dialogut dhe pasojat që kanë ardhur për shkak të mungesës institucionale të tij, si dhe sfidat për të ardhmen. Ai mbron tezën se modeli shqiptar i dialogut politik, si pjesë e modelit rajonal, është reflektim i një sistemi të ri të brishtë, një demokracie hibride,

Studimi përpiqet të analizojë të gjithë faktorët historikë e aktualë pengues të dialogut.

një tranzicioni konfliktual, ndikimi i të cilit ka qenë përgjithësisht negativ në progresin demokratik dhe ekonomik të vendit. Në funksion të studimit janë shfrytëzuar burimet shqiptare dhe të huaja mbi zhvillimet politike në Shqipëri, sidomos raportet ndërkom-bëtare të Bashkimit Europian, OSBE-së, Freedom House dhe institucioneve të tjera me besueshmëri të lartë analize dhe konkluzioni.

TRADITA E MUNGUAR E DIALOGUT POLITIK

Fjala “dialog” ishte e panjohur në fjalorin politik dhe publik. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1980) me mbi 41 mijë fjalë, nuk ekziston fjala “konsensus” dhe as “dialog politik”. Për rreth pesë dekada të sistemit njëpartiak vendin e dialogut politik e zuri monopoli politik. Partia e Punës së Shqipëria, partia e vetme politike, me ligj ndaloi mendimin kundër dhe kushdo që shprehte kritika ose mendime të ndryshme nga vij zyrtare, sipas Kodit Penal, dënohej me burgim. Hera e fundit kur në Shqipërinë politike ishte përdorur fjala “dialog politik” i përket pranverës së vitit 1946. Në atë kohë, rreth 10 deputetë propozuan bisedime të reja për draftin kushtetues dhe problematikën politikë të vendit. Dy muaj më vonë ata u arrestuan dhe brenda dy muajve të tjerë u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan.

Në organizimin e brendshëm shoqëror, ashtu si shumica e popujve ballkanikë, edhe Shqipëria ka pasur një traditë të gjatë organizimi fisnor e patriarkal. Në familje vendimet merreshin nga drejtuesi i saj, në fis nga prijësi kryesor, në krahinë nga bajraktari i saj dhe në rregjimet politike në 7 nga 10 dekada vendimet janë marrë nga individi udhëheqës (mbreti Zog dhe diktatori Hoxha). Studiuesi italian R. Rocca, në analizën e kontrastit të sotëm dhe trashëgimisë shqiptare me të drejtë arrin në konkluzionin se “e kaluara e Shqipërisë është mbushur me feudalizëm, klanizëm, pushtime të huaja, diktatura. Në Shqipëri mungon tradita borgjeze”. Ai e sheh këtë jo vetëm si një tipar shqiptar, por edhe më gjerë, si tipar rajonal. Sipas tij “politika është njëlloj si në të gjithë Ballkanin dhe Europën Lindore: politikë pa ndërmjetësime, pa kompromise, me ndeshje balllore, me monopolizimin e pushtetit. Kjo praktikë politike nuk ka të bëjë me personalitetet...edhe as me nocionet politike të së djathtës e të së majtës”.

Modeli shqiptar ka shumë ngjashmëri me modelet e vendeve fqinje lindore. Gjithësesi brenda tij ka edhe shumë tipare të vecanta. Për shembull, në dallim nga vendet e tjera ish komuniste ku institucione ndërmjetësuese shpeshherë u bënë grupet civile, elitat intelektuale apo institucionet fetare, në Shqipëri ato nuk ekzistonin si të tilla. Institucionet fetare u ndaluan me ligj më 1967, jeta civile ndalohej me kushtetutë, elitat intelektuale faktikisht ishin produkt i të njëjtit mekanizëm formimi, shkolle politike dhe propagande shtetërore si PPSH. Për më tepër, krijimi i vetë partive politike më 1990-1991 u realizua prej kësaj elite; asnjë lider politik nuk ishte disident politik dhe me ligj u ndaluan të angazhohen në politikë edhe personalitetet e diasporës politike. Shqipëria nuk pati një periudhë liberalizimi si në Hungari, Poloni, Cekosllavaki apo Jugosllavi; ajo nuk pati përvojë të dukshme demokracie midis luftave botërore dhe gjatë sistemit komunist, kaloi nga kontrolli jugosllav në atë rus, kinez e më pas u vetizolua tërësisht nga lindja e perëndimi. Kontaktet e saj me botën perëndimore, nocionet dhe zhvillimet, ishin minimale dhe pa efekte të brendshme.

Me këtë trashëgimi negative u ndesh Shqipëria më 1990. Që prej atëherë kanë kaluar dy dekada, janë shënuar shumë arritje, por në drejtim të dialogut politik si kulturë mendimi e sjelljeje, pak ka ndryshuar. Kjo konfirmohet edhe nga Raport Progresi 2010 i Bashkimit Europian mbi Shqipërinë në përgjigje të kërkesës për anëtarësim. Kërkesa u refuzua me argumentin themelor se vendi nuk përmbush kriteret e Samitit të Kopenhagenit. Midis të tjerash BE vlerësoi se “dialogu politik është konfrontues dhe jokonstruktiv” dhe se “situata aktuale politike rrezikon polarizimin e thellë dhe të tejzgjatur me pasoja serioze përsa i përket aftësisë së klasës politike për arritjen e kompromisit

dhe gjetjen e konsensusit për reformat kyce". Përcaktime të tilla kritike nuk janë të reja për Shqipërinë. Ato janë përsëritur më 1991, 1992, 1996, 1997, 2001, 2003 dhe 2007. Në dy raste (1991 dhe 1997) konflikti politik avancoi aq larg sa që vendi shkoi drejt kaosit dhe Shqipëria u detyrua të kërkojë ndihmë ushtarake e humanitare ndërkombëtare (misioni "Alba" dhe misioni "Pelikan").

Fazat e zhvillimit të dialogut politik në Shqipëri

Në analizë retrospektive dialogu politik në Shqipëri ka vijuar të kalojë përmes disa fazave kohore, të cilat në masë të madhe janë edhe fazat kryesore të zhvillimeve demokratike në Shqipëri.

■ Faza e parë i përket dy viteve të para të ndryshimit të sistemit politik dhe nisjes së tranzicionit nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur pluraliste. Në këtë fazë u krijuan konceptet e para mbi dialogun politik dhe politikën publike. Muajt e parë ishin momente të takimit të politikanëve me konceptet e reja të demokracisë, vrapim politik për të kapur kohën e humbur. Seancat e para parlamentare ngjasin me shkollën e fillores së demokracisë, ku gjithësecili deputet e parti politike mësonte dicka të re, dhe cdo gjë e re kthehej në normë e pranuar nga të tjerët. Rezultat i kësaj klime ende utopike ishin disa prej marrëveshjeve më të rëndësishme politike të tranzicionit mes të cilave edhe krijimi i një qeverie koalicioni midis mazhorancës dhe opozitës, me përgjegjësi administrimin politik e teknik të vendit deri në zgjedhjet e parakoshme të vitit 1992. Pjesë e kompromisit ishte ndarja konsensuale e posteve drejtuese në të gjitha njësitë vendore në vend, sipas formulës, fituesi i njësisë në zgjedhjet parlamentare merr edhe administrimin e saj lokal. Hapi i dytë ishte vendimi unanim për anulimin e kushtetutës komuniste (1976) dhe hartimit së bashku të Dispozitave Kryesore Kushtetuese (1991-1998). Hap tjetër themelor ishin ligjet konsensuale për partitë politike, për zgjedhjet, për pronat, për depolitizimin e organizave shtetërore të sigurisë, për mbrojtjen, për grevën, për sindikatat, për amnistinë e ish të përndjekurve politikë, etj. Palët me dialog e konsensus punuan për pranimin e Shqipërisë në KSBE (sot OSBE), për rivendosjen e marrëdhënieve me SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, për marrëveshje bashkëpunimi me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, etj. Ky vullnet i mirë për dialog e bashkëpunim të gjithëanshëm, për reforma të përbashkëta dhe zgjedhje konsensuale, koha dështoi se ishte i rastësishëm dhe në rrethana të jashtëzakonshme. Ish komunistët ende nuk kishin provuar kalimin në opozitë, demokratët antikomunistët ende nuk kishin provuar marrjen e pushtetit dhe qeverisjen politike të vendit. Kur dy palët u vunë në provë pas vitit 1992, distanca politike midis palëve politike u thellua aq shumë sa që në vend të ftesave për dialog liderët politikë synuan arrestimin, burgosjen ose denigrimin e kundërshtarit politik.

■ Faza e dytë nis pikërisht në këtë pikë të kalimit nga politika konsensuale në politikën bipolare, në konflikt të ashpër midis palëve dhe më tej më 1997, në konflikt të ashpër shoqëror. Kjo fazë zgjati shumë, deri në vitin 2002. Tipar dallues i saj është mungesa tërësore e dialogut politik dhe e bisedimeve institucionale. Vetë fakti simbolik se dy liderit kryesorë politikë, të cilët më 1991-1992 takoheshin rregullisht brenda e jashtë vendit cdo javë ose muaj, midis viteve 1992 dhe 2002 nuk u takuan asnjëherë, as formalisht, shpreh më së miri natyrën e konfliktualitetit dhe të mungesës tërësore të dialogut politik. Gjatë këtyre viteve marrëdhëniet politike mazhorancë – opozitë u ashpërsuan edhe për shkak të një natyre të personalizimit të tyre privuese ndaj individëve, familjarëve dhe stafeve të tij. Kështu në kudër të reformave të reja u larguan nga postet publike dhe administrata një pjesë e madhe e anëtarëve politikë të opozitës. Rotacioni politik i vitit 1997 ishte gjithashtu i dhunshëm dhe larg cdo parametri institucional. Fituesit e rinj, ish komunistët tashmë të grupuar në një koalicion të gjerë politikë, u sollën ndaj demokratëve në opozitë ashtu sic këta të fundit ishin sjellur më 1992, me mospërfillje, denigrim dhe hakmarrje.

■ Faza e tretë i përket viteve 2002 – 2008 dhe kanë dy momente kulmore: zgjedhjen konsensuale të krizës politike të vitit 2002 si dhe konsensusin e gjerë për pranimin e Shqipërisë në NATO dhe për ndryshime kushtetuese më 2008. Më 2002 kur palët politike ndodheshin nën kritika të forta ndërkombëtare, liderit respektivë politikë Nano e Berisha, pas 10 vjetësh konfliktualitet dhe luftë të ftohtë në distancë, ranë dakord të takoheshin. Nga takimi i tyre Shqipëria përfitoi disa muaj qetësi e normalitet, por fitorja më e madhe ishte zgjedhja konsensuale e Presidentit të Republikës si dhe nisja e bisedimeve për MSA me Bashkimin Europian. Në vitin e fundit të kësaj faze të tretë të zhvillimeve politike dhe dialogut politik në Shqipëri, u arritën dy rezultate me rëndësi të madhe për Shqipërinë dhe sistemin e saj politik: Shqipëria mori ftesën për anëtarësim në NATO dhe se palët politike me konsensus të gjerë miratuan ndryshime thelbësore në Kushtetutën e Shqipërisë. Pjesë e ndryshimeve kushtetuese ishin evitimi kushtetues i krizës politike në zgjedhjen e presidentit (kalimi i zgjedhjes nga shumicë absolute në shumicë të thjeshtë votash), fuqizimi i pozitës kushtetuese të kryeministrit përmes futjes në Kushtetutë të konceptit gjerman të mocionit konstruktiv, ndryshimi i sistemit zgjedhor në proporcional, vendosja e një mandati kohor për Prokurorin e Përgjithshëm, etj. Kjo fazë e evoluar e dialogut dhe bashkëpunimit politik u ndërpre me zgjedhjet parlamentare 2009, pas të cilave palët politike u rikthyen në pozitat tradicionale të konfliktualitetit dhe refuzimit reciprok politik. Fakti që Shqipëria u pranua në NATO më 2009 nuk ndihmoi në reflektimin dhe maturimin e elitës politike dhe se refuzimi i statutit kandidat për në BE (nëntor 2010) është një kthim i rëndësishëm pas.

MODELET E PRODUKTEVE TË DIALOGUT POLITIK

Në brishtësinë e tij dialogu politik ka mbijetuar përmes disa faktorëve kulturorë, socialë e politike, të imponuar nga nevojat e brendshme ose nga ndërhyrje të jashtme. Procesi i mirëadministrimit dhe mirëqeverisjes së vendit në kushtet e mungesës së mjeteve të nevojshme financiare apo të një vullneti e vizioni të qartë për reforma u kompensua fillimisht me kompromise politike. Ideja dhe synimi i tyre ishte fitimi i kohës dhe menjanimi i pengesave politike që mund të vinin nga kontestimet e mëdha politike e popullore. Disa qeveri të përbashkëta koalicioni (1991,1992, 1997) janë produkt direkt i nevojës për mbylljen e kanaleve të protestës.

Nga ana tjetër, cdo qeveri në Shqipërinë e post viteve 90, edhe pse ka pasur një shumicë solide parlamentare të një partie politike është detyruar të krijohet mbi bazë të një koalicioni më të gjerë, me aleatë të majtë e të djathtë, pavarësisht ideologjive politike, por me synim shpërndarjen e përgjegjësisë dhe të pushtetit në më shumë duar. Në fillim koalicionet ishin formale (deklarata mediatike të kryetarëve) më pas u kthyen në institucionale (në bisedime dhe marrëveshje të shkruara) dhe sot cdo palë është e ndërgjegjshme se për të pasur koalicion duhen negociata, bisedime, marrëveshje dhe kontrata politike, të cilat monitorohen nga palët dhe nga publiku.

Në një plan krahasues, marrëveshjet politike të arritura në Shqipëri 1991-2010 mbi bazë dialogu dhe konsensusi politik, ofrojnë gjithashtu pesë modele.

1. Modeli i parë, dialog real dhe i përgjegjshëm. Bilanci i tij është minimal dhe lidhet kryesisht me periudha të ndryshimeve të mëdha. Ai ka ndodhur në rastet kur pala kryesore (qeveria) ka qenë shumë e dobët ose kur tendenca e zhvillimeve politike të brendshme ka qenë kundër saj. Gjithashtu ajo ka ndodhur përpara ngjarjesh madhore që kanë të bëjnë me interesa të mëdha kombëtare e publike, për dështimin e të cilave asnjë palë nuk ishte e gatshme të mbajë përgjegjësi. Të tilla janë marrëveshjet për ndryshimet kushtetuese dhe politike 1991 dhe 2008, marrëveshjet në fushën e integritimit (MSA dhe pranimi në NATO), për liberalizimin e regjimit të vizave, për luftën në Kosovë, për bashkëpunimin me SHBA, etj.

2. Modeli i dytë është dialogu i imponuar. Faktori ndërkombëtar që në fillim të viteve 90 këshilloi dhe imponoi palët politike të bashkëpunojnë për një axhendë të përbashkët zhvillimi dhe reformash. Ideja ishte kalimi nga mentaliteti i partisë – shtet, i partisë që me pushtetin politik zotëron të gjitha pushtetet, tek ideja e ndarjes së pushteteve dhe shndërrimit të partive në aktor zhvillimi e konkurrence për pushtetin politik. Ky model ka funksionuar në faza të vecanta, sidomos në çështje të lidhura detyrimisht me dy palët politike, sic janë çështjet e reformës zgjedhore, të zgjidhjes së pronësisë, komisioneve hetimore, të komisioneve përgatitore kushtetuese, të reformës në organet e sigurisë, të integritimit, etj. Shpeshherë këto marrëveshje kanë qenë jetëshkurtër pasi palët sapo kanë përfituar ose humbur nga frutet praktike të tyre (psh, pas cdo procesi zgjedhor), konflikti politik është rikthyer.

3. Modeli i tretë është ai i dialogut formal. Një formë e tillë dialogu aplikohet kur palët politike nuk refuzojnë por as nuk avancojnë debatet në dialog, krijojnë komisione formale, monotoni deklarimesh dhe veprimesh, në mënyrë që çështja në debat të shtyhet pambarimisht. Në gjuhen shqipe ka një shprehje popullore “dialog për dialog”, e cila e shpreh simbolikisht përmbajtjen e këtij modeli. Ky model ka qenë dominues në jetën politike shqiptare. Pafundësi negociatash, bisedimesh, draft marrëveshjesh, ndërhyrjesh ndërkombëtare, tryeza presidenciale ose partiake dhe në fund, mungesë e plotë e praktikës së marrëveshjeve konsensuale të pranuar dhe respektuara nga palët. Të prirur për krijimin e një imazhi pozitiv në raport me publikun dhe faktorin ndërkombëtar palët politike nuk refuzojnë dot dialogun, por pranojnë zhvillimin e tij me bindje dhe synim mosarritjen e ndonjë rezultati konkret.

4. Modeli i katërt është ai i dialogut dhe marrëveshjeve personale midis liderëve politikë. Në politikë të kundërtat bashkohen kur bëhet fjalë për pushtet dhe interesa, - shprehje që në Shqipëri ilustron nga shembuj konkretë. Dy liderit tradicionalë politikë demokraci Berisha dhe socialisti Nano refuzuan të takohen me njëri tjetrin për 10 vjet, por kur në maj 2002 u takuan, ata brenda pak orësh vendosën ndryshime drastike në strukturën politike të vendit. Gjatë viteve 2005-2008 liderit respektivë kryeministri i djathtë Berisha dhe kryetari i socialistëve Rama zgjodhën një retorikë të ashpër dhe diskretituese ndaj njëri tjetrit, por kur në mars 2008 ata u takuan në një seancë parlamentare 4-5 orëshe u ndryshua kushtetuta dhe bashkë me të, edhe sistemi politik e qeverisës në vend.

5. Modeli i pestë i dialogut janë marrëveshjet e arritura për ndarjen e pushtetit kushtetues. Numerikisht raste të tilla janë të pakta, por efektivisht ndikimi i tyre është shumë i madh në sistemin politik e qeverisës të vendit. Më 1991 palët ranë dakord të ndajnë në formë konsensuale drejtuesit kryesorë të institucioneve të reja kushtetuese. Gjatë 1992-2002 pala në pushtet u tërhoq nga kjo marrëveshje dhe krijoi institucione kryesisht nën kontrollin partiak të shumicës. Pas 2002 nisën përsëri bisedimet dhe marrëveshjet për balancim politik të institucioneve kushtetuese (Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Bordi Drejtues i Bankës Qëndrore, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Këshilli Drejtues i Televizionit Publik, etj) edhe pse sipas Kushtetutës koncepti i balancimit politik është antikushtetues. Këto forma marrëveshjes ekstrakushtetuese kanë qenë kryesisht marrëveshje personale të liderëve politikë dhe simbolikisht më 2007 u etiketuan nga Presidenti i Republikës Bamir Topi si “aksham pazar”, një cilësim me konotacion negativ për kulturën politike në Shqipëri.

KONTRASTE DHE PROBLEMATIKE TË DIALOGUT POLITIK

Sjellja ndaj dialogut politik si koncept dhe respektimi i tij praktik janë dy gjëra të ndryshme në modelin shqiptar. Referuar programeve politike të partive kryesore, të gjitha ato e pranojnë dhe e theksojnë dialogun politik si bazë të komunikimit dhe marrëdhëniet politike. Ato shkojnë më tej kur e cilësojnë atë si mjet ia pazëvendësueshëm

për arritjen e marrëveshjeve politike, për një proces transparent, cilësor e përfshirës në hartimin dhe miratimin e ligjeve parlamentare, si dhe për hartimin e axhendave politike që tejkalojnë interesa politike të momentit. Por kur të njëjtit aktorë e parti politike përballen në terren me nevojën për dialog, ka një ndryshim dramatik të konceptit të tyre. Secila palë konsideron dialog pranimin nga pala tjetër të propozimeve të saj, jo bisedimet institucionale për një zgjidhje kompromisi të përbashkët. Pra, palët ngatërojnë konceptin e dialogut politik me atë të debatit politik dhe monologut politik.

Për pasojë e kësaj "ngatërrese" midis koncepteve të dialogut dhe debatit politik, në dy dekadat e fundit parlamenti ka qenë një institucion "në hije" kryesisht për shkak se ai ka reflektuar dhe është prekur më shumë se cdo institucion tjetër nga krizat periodike politike. Asnjë nga 16 kabinetet qeveritare të tranzicionit nuk është rrëzuar me votim në parlament, asnjë nga 22 marrëveshjet politike të deritanishme nuk është negociuar dhe firmosur në parlament. Parlamenti ka qenë në rolin e noterit të vendimmarrjes së selive të partive politike, gjë që ka patur ndikim në uljen e besueshmërisë publike dhe efektivitetit të tij demokratik. Për më tepër, bojkoti parlamentar si dhe zëvendësimi i luftës politike nga instrumentet parlamentare e institucionale në forma të tjera joparlamentare, sic janë protesta në rrugë, mitingjet, grevat e urisë apo refuzimi i vendimmarrjes zyrtare, mbetet një problem sa i vjetër aq edhe i ri i demokracisë shqiptare.

Partitë politike në Shqipëri reflektojnë edhe një kontrast të thellë midis qëndrimeve ndaj politikës së brendshme e të jashtme. Psh, në listën e prioriteteve të politikës shqiptare bëjnë pjesë disa fusha për të cilat palët politike në Shqipëri kanë konsensus të gjërë. Nuk ka dallime dhe marrin gjithnjë votë absolute konsensuale cdo vendimmarrje politike që lidhet me çështjet kombëtare, me traktatet ndërkombëtare, me angazhime themelore sociale apo me çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes. Asnjë parti nuk mbron dhe as promovon dallime në politikën e jashtme, në raport me SHBA apo me Bashkimin Europian, me anëtarësimin në NATO apo me pjesëmarrjen në misionet paqëruajtëse ose në koalicionin antiterror. Në kontrast me to është sjellja ndaj problematikës së brendshme. Psh, burimi kryesor i mosmarrëveshjeve politike tradicionale kanë qenë e mbeten proceset zgjedhore të kontestuara. Prej vitit 1990 deri më 2010 janë zhvilluar tri referendume, 7 zgjedhje parlamentare dhe 5 zgjedhje lokale, por prej tyre deri tani është pranuar nga të gjitha palët vetëm referendumi për formën e regjimit (1997) dhe zgjedhjet parlamentare e lokale të vitit 1992. Cdo zgjedhje tjetër, përfshirë zgjedhjet parlamentare 2009 janë kontestuar, gjë që ka krijuar tensione permanente politike, ka minuar hapësirën e dialogut politik dhe ka krijuar një konfliktualitet me pasoja të mëdha mbi stabilitetin dhe efektivitetin e demokracisë shqiptare.

Problem tjetër për të sotmen e të ardhmen e demokracisë shqiptare mbetet mungesa e qarkullimit të elitave politike. Zgjedhje politike bazohet në votat e qytetarëve, por kur qytetarët detyrohen të zgjedhin gjithnjë midis të njëjtave alternativa, atëherë ai ndjehet i kufizuar në lirinë e tij demokratike. Në Shqipëri prej vitit 1991 vijojnë të jenë aktorë të njëjtit lider politik, e njëjta sjellje politike, e njëjta retorikë politike, i njëjti premtim e imazh politik. Janë të njëjtit individë që kanë provuar të jenë edhe kryeministër edhe president, edhe kryetar partie edhe bashkie, edhe deputetë edhe ministra; që janë rrëzuar nga pushteti me protesta masive dhe janë rikthyer disa herë në pushtet me mbështetje elektorale. Për shkak të sistemit elektoral bipartiak është gati e pamundur të krijohet hapësirë për lëvizje të reja politike, ndërkohë që është kufizuar cdo mundësi për aplikimin e demokracisë direkte apo për qarkullimin e elitave partiake brenda vetë partive politike. Ky proces është shoqëruar me rënie gjithnjë e më të madhe të numrit të votuesve dhe mbështetësve militantë të partive kryesore politike.

Problem tjetër me rëndësi është faktori civil dhe roli i tij i brishtë në Shqipëri¹². Gjatë viteve në Tiranë ka pasur përpjekje për krijimin e instrumenteve civile e publike të dialogut politik. Në Tiranë veprojnë fondacione politike të partive kryesore amerikane, gjermane, italiane e franceze, secila me projekte nxitëse edhe për dialogun politik.

Gjithashtu në Tiranë dhe në qytetet kryesore të vendit veprojnë një numër i konsiderueshëm i institucioneve të pavarura, grupeve të shoqërisë civile, rrjete kulturore dhe shoqata me theks politik, qëllimi i të cilave përveç aspekteve konkrete është e mbetet edhe nxitja e kulturës demokratike të dialogut, bashkëpunimit dhe vullnetit të mirë në trajtimin e problemeve themelore qytetare. Porë në retrospektivë asnjë vendim i rëndësishëm politik dhe asnjë krizë politike serioze nuk është negociuar me sukses prej këtyre aktorëve jopolitikë, gjithësesi në cdo rast dhe për cdo temë të rëndësishme politike secili më vehte ose së bashku, aktorët civilë kanë ushtruar të gjithë presionin e tyre pozitiv për nxitjen e dialogut dhe zgjidhjen e problemeve.

Sfidat e dialogut për të ardhmen

Cdo aktor politik shqiptar pranon se faktorët kryesorë përcaktues për nivelin e dialogut dhe ardhmërinë e tij janë njëherësh edhe parametrat kryesorë për një demokraci funksionale e të qëndrueshme. Raportet ndërkombëtare mbi Shqipërinë theksojnë nevojën e dialogut të qëndrueshëm dhe produktiv, të bazuar në interesa madhore publike të vendit, sic janë reformat e brendshme politike dhe ekonomike. Vetë fakti se parlamenti shqiptar prej vitit 2008 nuk ka arritur të votojë asnjë ligj me shumicë të cilësuar (ligje të reformës që kërkojnë votat e opozitës) është tregues i nevojës për ndarje të qartë midis interesave madhore të vendit dhe interesat momentale të partive politike.

Shqipëria ka nevojë për zëvendësimin e modelit të politikanëve të fortë në atë të institucioneve të forta. Individët mund të luajnë rol pozitiv ose negativ, ata kanë rëndësinë e tyre në procese politike, por gjithësesi ata nuk mund dhe nuk do të mund ti zëvendësojnë asnjëherë institucionet me peshën dhe rolin e tyre politik e kushtetues. Personalizimi i politikës shkon në dëm të institucioneve, konfliktualiteti politik mban peng edhe punën e institucioneve, lufta ndaj korrupsionit çënon e pengon edhe vetë institucionet, ndaj edhe një shoqëri e shëndoshë parasëgjithash krijohet vetëm nga institucione të forta, efektive, të besueshme dhe demokratike. Veprimi i institucioneve nuk synon dobësimin e partive politike por ridimensionimin e rolit të tyre brenda asaj hapësire publike e ligjore që parasheh kushtetuta dhe sistemi politik.

Pjesë e forcimit të institucioneve duhet të jetë një rol i ri aktiv e përfshirës i parlamentit shqiptar si institucioni kryesor debatues e politikbërës në sistemin politik. Në funksion të këtij roli kanë nisur debatet politike në Shqipëri mbi mundësinë e ndryshimeve strukturore (parlament me dy dhoma apo ndryshim të sistemit zgjedhor për rritjen e demokracisë direkte) apo për ndryshime organizative (heqje e imunitetit parlamentar, ndarje më e qartë e përgjegjësisë drejtuese parlamentare si dhe rritje e transparencës së aktivitetit të parlamentit).

Për shkak të peshës së rëndësishme të partive politike dhe liderëve politikë Shqipëria e ka mëse të nevojshme demokratizimin e brendshëm të vetë partive dhe përputhjen më të madhe të tyre me pozitën që u njeh Kushtetuta. Aktualisht asnjë parti politike nuk ka demokraci funksionale të brendshme, - këtu duhet nisur ndryshimi për të mundësuar karrierë mbi bazën e projekteve politike, vizionit, aftësisë dhe votës konkurruese. Pjesë e reformës partiake është edhe ndryshime të thella në ligjin formal për partitë politike dhe sidomos format e financimit të tyre, ligj që pritet të jetë pjesë e axhendës parlamentare më 2011 ose 2012.

Dialogu politik kërkon aktorë politikë me ndergjegje dhe edukim demokratik. Shqipëria ka akoma shumë hapësira veprimi e korigjimi në këtë drejtim. Edukimi demokratik në shkollë, rritja e nivelit të angazhimit qytetar në debatet publike, inkurajimi i shoqërisë civile dhe pavarësisë së medias, zgjerimi i demokracisë direkte dhe llogaridhënies politike tek publiku. Kultura demokratike përmes arsimit demokratik përbën sfidën themelore dhe afatgjatë për ndarje reale nga traditat negative të së kaluarës dhe kri-

jimit të një identiteti qytetar – europian. Më tej, shoqëria shqiptare ka nevojë për ikjen nga modeli i dialogut dhe marrëveshjeve formale për të krijuar një praktikë dhe axhendë të qëndrueshme bisedimesh brenda kuadrit kushtetues dhe në dobi të interesit publik dhe reformave të kërkuara për anëtarësim në Bashkimin Europian. Në këtë sfidë publiku e qytetarët, media e shoqëria civile kanë rol themelor dhe të mirëpritur.

Shqipëria do të duhet të dëshmojë aftësi për zgjidhjen vetë të mosmarrëveshjeve që krijohen nga zhvillimet e brendshme, si një vend në NATO dhe me pretendime serioze për në BE. Vendi duhet të dëshmojë stabilitet demokratik, një projekt i munguar për të cilin politikanët marrin votat qytetare për të qeverisur dhe për të cilin qytetarët ftohen të votojnë në cdo zgjedhje politike. Një shoqëri e shtet demokratik e funksional është në dobi të qytetarëve, të politikës, të publikut, të shteteve fqinje dhe të shteteve dhe organizave partnere në rajon, Europë e më gjerë.

Literatura e shfrytëzuar

- Anastasi, Aurela. "Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)". Tiranë 1998.
- Bashkurti, Lisen. "Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë". Tiranë. 2003.
- Biberaj, Elez. "Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë", Tiranë 2001.
- Biagini, Antonello. "Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona". Tiranë 2000.
- Daniel Serwer, Referat, ISHSN, Tiranë, 29 maj 2001
- Ferraj, Hysamedin: "Kriza e përkryer e Shqipërisë". Tiranë 2003.
- Fuga, Artan. "Majtas, jo djathtas". Tiranë. 2003.
- Hensell, Stephan. "Regieren in Albanien". WeltTrends Nr 45. Hamburg. 2004.
- Grup autorësh. "Këshilli i Europës për Shqipërinë", Tiranë 1999.
- Krasniqi, Afrim. "Partitë Politike në Shqipëri 1912-2006", Tiranë 2007.
- Krasniqi, Afrim. "(Mbi)pushteti i partive politike", Tiranë 2008.
- Krasniqi, Afrim. "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2009". Tiranë 2009.
- Krasniqi, Afrim. "Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008", Tiranë 2009.
- Omari, Luan. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri, Tiranë, 2004.
- Pëllumbi, Servet. "Pluralizmi politik", Tiranë, 2007.
- Pëllumbi, Servet. "Të mendosh ndryshe". Tiranë. 2001.
- Pipa, Arshi. "Albanian Stalinism. Ideo – political aspects". USA 1990.
- Rama, Shenasi. "Probleme politike shqiptare I". Tiranë, 2006.
- Vickers, Miranda. "Shqipëtarët, një histori moderne", Tiranë, 2008.
- Zaganjori, Xhezair. "Demokracia dhe shteti i së drejtës". Tiranë. 2002.

Botime / revista / raporte

- Arkivi i ODHIR/OSBE. Raporte për zgjedhjet në Shqipëri, (www.osce.org)
- Arkivi i BE. "Shqipëria – Raporti i Stabilizimit dhe Asociimit", 2002-2010.
- Arkivi i IPU. "Report on Election in Albania", (www.ipu.org)
- BE: "Ballkani Perëndimor 2004. Asistenca. kohezioni dhe kufijtë e rinj të Europës". Bruksel. 3.11.2002.
- BHRG: "Albania 1996: Democracy or Dictatorship?". London. 1996
- Botimi "Quo vadis. Shqipëri?". Tiranë. 1993.
- Botimi "Shqiptarët në Ballkan". ISHSN. Tiranë. 2001.
- Kushtetuta e Shqipërisë, Tiranë, 1998.
- Revista "Politika & Shoqëria". ISPS. Tiranë 2000-2002.
- Revista "E drejta parlamentare dhe politikat ligjore", 2004-2008.
- Revista "Studime Historike". Akademia e Shkencave. Vëllimi 1-4. Tiranë. 1997.
- U.S. Library of Congress. Albania - A Country Study.



Ana Triandafilidu

Dr. Ana Triandafilidu, Greqi, (diplomë të Universitetit Panteon, Doktorat në Institutin Evropian Universitar) është profesor me honorar pranë Institutit Evropian Universitar, Qendrës Robert Shuman për studime të avancuara në Firencë dhe Hulumtues senior pranë Fondacionit Helenik për Politika Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) në Athinë. Ajo gjithashtu është mysafir-ligjërues në Kolegjin Evropian në Brizh, nga viti 2002. Ka punuar në pozita ligjëruese dhe hulumtuese në Britaninë e Madhe, Itali, SHBA, Belgjikë dhe Greqi. Fushëveprimet e saj kryesore si eksperte janë migracioni, nacionalizmi dhe integrimet evropiane. Ka shkruar dhe redaktuar më shumë se 10 libra dhe ka publikuar mbi 100 artikuj në revista dhe libra të referuar për po këto tema. Kohët e fundit, ndër të tjerët, i ka botuar librat Migracioni në Greqi në shekullin 21 (me T. Maroukis, 2010, Kritika, në gjuhën greke), Myslimanët në Evropë në shekullin 21 (2010, Rutlexh), Migracioni i parregullt në Evropë: Mit dhe realitet (2010, Ashgat).

Për më shumë hollësi rreth punës së saj, vizitoni www.annatriandafyllidou.com



Ana Triandafilidu

Çka përmban një emër? Nacionalizmi grek dhe "Çështja e Maqedonisë" në Evropën e ndryshueshme

Rymat e hershme të nacionalizmit grek në fund të shekullit XVIII janë shënuar nga ndikimi i iluminizmit dhe idealeve të tij, të cilat e privilegjuan definicionin territorial dhe civil të kombit grek. Megjithatë, nga fillimi i dekadave të para të ekzistimit të shtetit të pavarur grek në shekullin XIX, kombi në pjesë të madhe u definua nëpër elementet etno-kulturore, përmes theksimit të paraardhësve të përbashkët, kulturës dhe gjuhës. Indi dominant nga rrëfimi për kombin, i krijuar nga historiografët grekë në shekullin XIX filloi me të kaluarën klasike aq të pranuar si brenda ashtu edhe jashtë Greqisë, e vazhduar me krishterimin, e rehabilituar nga Perandoria e Bizantit dhe e përfunduar me bashkimin grek drejt Perandorisë Osmane dhe rilindjen kombëtare në vitin 1821. Për këtë, bashkësia kombëtare greke u pa si unike, në unitetin dhe universalitetin e saj.

Çka qëndron prapa
"çështjes maqedonase"
dhe "problemit me em-
rin" dhe identitetin?

Ajo pati trajektore historike unike nga kohët antike deri më sot dhe profil kulturor unikat, duke e kombinuar karakteristikën e kombit me dy universalizma rivale: njëri i kulturës antike greke, ndërsa i dyti i krishterizmit ortodoks. Kështu, bashkësia e bashkuar dhe unike kombëtare, thellë u përforcua përmes politikave shtetërore, rekrutimit ushtarak dhe arsimit dhe kulturës në shekullin XX.

Edhe pse identifikimi i kombit me ortodoksizmin ishte problematik për shkak të kontradiktave midis pohimeve specifike të nacionalistëve grekë dhe tendencave universale të religjionit krishter ortodoks, ndarja e kishës greke nga Patriarkana e Konstantinopolit në vitin 1833, e vërtetoi lidhjen integrale midis kombit dhe tufës. Kështu, të jesh grek u bë amalgam nga (besimi në) paraardhës të përbashkët, traditat kulturore dhe religjioni. Ky definim i trefishtë i vetvetes gjithashtu mundësoi kufizimin e trefishë, me të cilën grekët dallonin nga kombet tjera fqinje. Grekët ishin të ndryshëm nga myslimanët dhe hebrenjtë e Lindjes, pasi që ishin të krishterë ortodoksë. Gjithashtu ishin të ndryshëm nga sllavët e veriut, duke falë pohimeve të tyre se kanë të drejtë mbi kulturën klasike greke. Greqia moderne e shihte veten si trashëgimtare natyrore të qytetërimit antik grek – sikur kultura të ishte send, ndërsa kombi pronar i tij - një cilësi e cila Greqinë e vogël dhe gjeopolitikisht relativisht periferike, e bëri qendër simbolike në konstruimin e qytetërimit evropian. Edhe pse cilësitë territoriale dhe civile gjithashtu fituan rëndësi përmes konsolidimit të territoreve nacionale në fund të shekullit XIX dhe në fillim shek. XX, të qenët grek shpesh definohet si moment transcendirik në debatet publike greke.

Në këtë punim të shkurtër unë do të përpiqem ta sqaroj dinamikën e cila ekziston pas “çështjes së Maqedonisë” dhe “problemit me emrin” i cili krijon tensione midis Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe Greqisë dhe gjithashtu t’i zbuloj sfidat e identitetit, me të cilat Greqia është ballafaquar në 20 vitet e fundit dhe në cilën mënyrë e kanë bërë atë.

ÇËSHTJA E MAQEDONISË

Ndërlíkueshmëria e çështjes së Maqedonisë është rezultat i gërshetimit të çështjeve kulturore me ato gjeografike. Nga njëra anë ekziston pjesa greke e Maqedonisë, qendër e së cilës është Selaniku dhe e cila formon pjesë integrale të shtetit dhe kombit grek. Sipas historisë greke, popullata në këtë rajon e definoi veten kryesisht si greke. Më tej, ky rajon identifikohet në botëkuptimet dominuese greke me dinastinë dhe arrijtjen e Aleksandrit (Lekës) të Madh. Prandaj, grekët i vlerësojnë simbolet, mitet dhe traditat lidhur me Aleksandrin si pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Si kontrast, sipas qeverisë së IRJM-së, nuk mund të ekzistojë pohim i këtyllë historik lidhur me kombësinë e Aleksandrit të Madh; ai kurrsesi nuk ka qenë sllav, por nuk ka qenë as bullgar e as grek, duke folur për kuptimin modern të fjalës. Prandaj, të gjitha pjesët nga rajoni gjeografik i Maqedonisë (ish-jugosllav, bullgar dhe grek) kanë të drejta të barabarta të lidhen me Aleksandrin, pasi që trashëgimia e tij ndahet në gjithë këtë territor. Pikëvështrimi i këtyllë i punëve, nuk e sjell në pikëpyetje idenë greke për “pronësi” të kulturës si objekt. Kjo në fakt e sfidon pronarin e saj, duke zhvilluar diskutim se ata të cilët e kanë emrin Maqedoni si shenjë kombëtare, janë trashëgimtarët legjitimë të Aleksandrit.

Siç pohon Bordie, emërimi është shprehje fundamentale e fuqisë politike. Dhënia e emrit një diçkaje, do të thotë t’i mundësohet ekzistimi. Edhe pse burrshtetasit grekë me siguri janë të pavetëdijshëm për këto analiza të tij, ata e konfirmojnë tezën e tij me kundërshtimin e njëanshëm për përdorimin e emrit Maqedoni, si simbol kombëtar dhe emër i shtetit të pavarur, deri në ditën e sotme. Republika Socialiste e Maqedonisë, paraprakisht ekzistonte si shtet federal në kuadër të Jugosllavisë, pa pasur efekt mbi pikat e ndjeshme kombëtare të Greqisë. Por situata u ndryshua kur, pasi u shpërbë federata jugosllave, u formua shteti i pavarur dhe sovran në vitin 1991. Në mënyrë paradoksale, në pajtim me qëndrimin e qeverisë së IRJM-së se kultura është objekt i cili mund të posedohet, njëjtë si edhe heronjtë kombëtarë dhe mitet, qeveritë greke dhe mendimi publik grek, në kontinuitet e kanë shprehur brengosjen e tyre se përdorimi i emrit implikon përvetësimin e plotë të simboleve, traditës, miteve e madje edhe ter-

ritorit lidhur me emrin Maqedoni. Me fjalë të tjera, qytetarët dhe elitat e dy shteteve, Greqia dhe IRJM-ja si duket pajtohen me pohimin se kultura është “objekt” i cili mund të posedohet nga ana e popullit dhe kombit. Pyetja është se kush e posedon këtë pjesë specifike të kulturës, lidhur me Aleksandrin e Madh dhe Maqedoninë antike. A ka qenë ajo helene apo maqedonase? A ekziston Maqedoni maqedonase apo Maqedoni helene? Dhe a janë këto mbiemra: maqedonase, helene (apo bullgare) me kualifikime me natyrë gjeografike, politike apo ndoshta kulturologjike?

Kontesti midis Greqisë dhe IRJM-së rreth pronësisë së kulturës, involvon më shumë simbole kombëtare dhe artefakte kulturore. Greqia kundërshtoi përdorimin e flamurit të parë të IRJM-së (i përdorur midis viteve 1992 dhe 1995 dhe më pas i reviduar me kërkesë të Greqisë) pasi që paraqiste diellin nga Vergina. Ky yll apo diell, siç është quajtur shpesh, është zbuluar nga mesi i viteve 70, në Vergina, në juglindje nga Selaniku, ku ndodhej kryeqyteti antik maqedonas, Egjeu, dhe që nga ai moment ai konsiderohet si emblema e perandorisë së Aleksandrit të Madh.

Qeveria greke ka theksuar situatën e pazakonshme kur një flamur që paraqet identitetin kombëtar të një populli, për shembull atij maqedonas, ndërsa mbështetet në traditën kombëtare dhe trashëgiminë kulturore të një kombi tjetër, respektivisht Greqisë. Gjithsesi, pasi filloi kontesti, dielli nga Vergina u prezantua me intensitet të zmadhuar, nëpër ndërtesa publike dhe lokacione të tjera në rajonin grek të Maqedonisë, si simbol kombëtar dhe rajonal.

Argumentet e dy palëve mbështeten në rolin politik dhënë simboleve kulturologjike të kombit dhe shtetit. Ato duhet ta kenë për qëllim ta prezantojnë kontinuitetin dhe unitetin e bashkësisë kombëtare nëpër histori. Semantika historike dhe kulturologjike, e vendosur në simbolet kombëtare, solli deri tek ajo që grekët ta konsiderojnë krijimin dhe njohjen e republikës së re si shkelje të identitetit të tyre kombëtar. Lëvizja nacionaliste greke me atë u bë me karakter mbrojtës; kjo deshi ta pasqyrojë dhe mbrojë atë që ishte perceptuar si trashëgimi kombëtare, nga invizioni simbolik i shkupjanëve (siç quhen qytetarët e IRJM-së, në gjuhën e folur greke).

Qeveria konservative (1989-1993) e Konstantin Micotakis, lideri i Demokracisë së Re, ndërmori një pozitë nacionaliste dhe rigide për këtë çështje. Ajo ndërmori një numër të caktuar të iniciativave nga fusha e kulturës, kundër njohjes së Republikës së Maqedonisë. Janë organizuar forume, punëtori dhe debate publike, me pjesëmarrjen e intelektualëve dhe medimeve. Agjencia turistike kombëtare lancoi fushatë reklamuese, e cila promovoi udhëtim në veri të Greqisë, që në mënyrë kulturore të njihen rajonet e Maqedonisë dhe Trakisë. U shtypën mesazhe nacionaliste në bluza dhe afishe, ndërsa të shkruara në gjuhën angleze që të mund t’i kuptojnë turistët e huaj. “Fillimisht mësoni histori” dhe “Fryma e Aleksandrit të Madh është universale por atdheu i tij Maqedonia është grek që 3.000 vite” ishin disa nga sloganet më elokuate.

Këto iniciativa qeveritare ishin të suksesshme në mobilizimin e grekëve, në atdhe dhe jashtë tij. Një tubim i madh publik me afërsisht një milion njerëz u mbajt në Athinë në dhjetor të vitit 1992. Mobilizimi kolektiv u bë spontanisht, por zemërimi publik kundër pohimeve të IRJM-së në masë të madhe u ndez nga elitat politike. Edhe disa demonstrata u organizuan në Selanik disa muaj më vonë, si dhe të tjera në shumicën e bashkësive të diasporës greke, në SHBA, Kanada dhe Australi.

Aprovimi i një qëndrimi më fleksibil për çështjen e Maqedonisë nga qeveria konservative në verën e viti 1993, solli deri te rrëzimi i saj nga pushteti. Ministri i atëhershëm i punëve të jashtme, Andonis Samaras, bashkë me një numër të caktuar të anëtarëve konservativë të parlamentit të cilët e mbështetnin, e akuzoi kryeministrin Micotakis për sjellje “të rrezikshme për kombin”, ndërsa më pas e tërhoqën mbështetjen e tyre të qeverisë. Samaras formoi parti të re, e quajtur Pranvera Politike (Politiki Anixi). Një numër i vogël i deputetëve konservativë e braktisën Demokracinë e Re dhe iu bash-

kangjitet partisë së re, duke pohuar se kryeministri vepron kundër interesit kombëtar. Fryma nacionaliste dominonte në fushatën parazgjedhore në vjeshtën e vitit 1993 dhe u promovua gjerësisht nga partitë opozitare, Pranvera Politike dhe PASOK-u socialist, në diskutimet e tyre gjatë fushatës.

Çështja e Maqedonisë mbeti çështja kryesore instrumentale për qeverinë socialiste dhe liderin e saj të atëhershëm, Andreas Papandreu, i cili fitoi në zgjedhjet e vitit 1993. Administrata e Papandreut fitoi pozitë akoma më rigide për çështjen dhe në nëntor të vitit 1993 i vendoset embargo tregtare IRJM-së edhe në daljen e vetme të vendit, Detin Egje. Situata e arriti kulminacionin e tensioneve gjatë kryesimit grek me Bashkësinë Evropiane në gjysmën e parë të vitit 1994. Qeveria greke e përforcoi pozitën e saj dhe refuzoi ta heqë embargon. Gjegjësisht, çdo propozim për kompromis për çështjen e emrit të Maqedonisë dhe simboleve lidhur me të, zgjonin reagim të fuqishëm te populli dhe e linin legjitimitetin e qeverisë në pikëpyetje. Marrëdhëniet diplomatike dhe ekonomike midis Greqisë dhe IRJM-së u rehabilituan në shtator të vitit 1995, pas intervënimit të SHBA-ve, të cilët bënë presion në dy vendet, për gjetjen e kompromisit. Dielli nga Vergina u mënjana nga flamuri i IRJM-së, ndërsa Greqia e hoqi embargon të cilën ia vendosi vendit në vitin 1993. Administrata e Kostas Simitisit, e cila e trashëgoi atë të Andreas Papandreut në janar të vitit 1996, qartë deklaroi se dëshiron të gjejë kompromis, njëjtë sikur edhe qeveria e IRJM-së. Megjithatë, negociatat për çështjen e emrit janë akoma aktive dhe një numër i caktuar i alternativave (Maqedonia e Re apo Sllavo-Maqedonia) janë diskutuar në kuadër të ndërmjetësimit të Kombeve të Bashkuara, por megjithatë nuk është arritur zgjidhje përfundimtare. Të dy palët janë të kujdesshme deri në ekstrem në pranimin e zgjidhjes e cila në çfarëdo mënyrë do të mundte t'i provokojë ndjenjat kombëtare të vetë popullatës. Tani për tani, shteti njihet nga Kombet e Bashkuara, nga Këshilli i Evropës dhe organizatat e tjera ndërkombëtare me emrin IRJM. Megjithatë, më shumë se disa qeveri kombëtare dhe popuj (duke e përfshirë Greqinë) i drejtohen vendit si Maqedoni, pa shtesa.

Çështja e ashtuquajtur e Maqedonisë, e cila u paraqit me krijimin e IRJM-së, është centruar rreth përdorimit të vëllimit të përbashkët të vlerave kulturore dhe simboleve, nga ana e dy kombeve dhe shteteve të ndryshme me qëllim të njëjtë. IRJM në shikim të parë nuk pati alternativa të tjera gjatë definimit të identitetit kombëtar, duke e pasur parasysh kontekstin ballkanik. Nëse merret parasysh se të gjitha kombet ballkanike e definojnë kontekstin kombëtar në bazë të origjinës etnike dhe lidhjeve kulturore, republika e re duhej ta ndjekë modelin e njëjtë. Nëse konfirmohet se historia kombëtare e rajonit është perceptuar, hulumtuar e regjistruar dhe e distribuuar mjaftueshëm, kundrejt zënkave të shteteve fqinje rreth disa interpretimeve të caktuara, duhej të krijojë hapësirë për krijimin e kombit të ri. Kjo ishte detyrë jashtëzakonisht e rëndë. IRJM duhej në njëfarë mënyre të krijojë histori të vetën kombëtare, në "llogari" të simboleve kulturore dhe historisë së ndonjë kombi tjetër.

Konflikti të grekët krijoi ndjenjën e izolimit, gjeografik dhe kulturor, me respekt ndaj partnerëve të tyre evropianë për të cilët ishte e vështirë ta vlerësojnë ndjeshmërinë greke për këtë çështje. Ata nuk panë kanosje territoriale në krijimin e shtetit të ri dhe nuk mund ta kuptonin simbolizmin e komplikuar kulturologjik në kontestin me emrin. Koncepti për llojllojshmërinë e Greqisë veçanërisht u potencua në kontestin ballkanik nga viti 1990. Shkatërrimi i Jugosllavisë, jostabiliteti politik dhe ekonomik nëpër Evropën qendrore -lindore, interesat e afërme politike dhe fetare midis IRJM-së dhe Turqisë dhe përvoja historike për përzierjen traumatike etnike gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, ishin faktorë të cilët kontribuan drejt ngritjes së brengosjes së Greqisë rreth krijimit të Republikës së Maqedonisë. Po ky kontest dhe përvojat e mëparshme, e inicuan perceptimin grek për vete si komb i cili nuk ka vëllam, komb i cili është unikat por njëkohësisht edhe komb i cili nuk ka vëllezër e as aleatë. Qeveritë greke dhe reagimet e opinionit publik për çështjen e Maqedonisë në vitet e hershme të 90-ta e deri më sot, duhet kuptuar në kuadër të këtij konteksti.

POZICIONIMI I GREQISË NË EVROPË DHE NË BALLKAN

Por përse qytetarët dhe elita greke do të perceptoheshin vetë si komb pa miq? Me të vërtetë, historia greke dhe politika janë shënuar nga pozita ambivalente gjeopolitike e vendit, në udhëkryq midis lindjes dhe perëndimit. Kjo ambivalencë është reflektuar mbi identitetin nacionalo-kulturologjik grek e gjithashtu mbi politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me vendet e tjera. Identiteti grek është dyshtresor. Në njërën anë orientohet drejt Lindjes, drejt traditës bizantine dhe trashëgimisë krishtere ortodokse. Por Lindja njëherit është edhe kanosje potenciale për Greqinë moderne; ajo e përfaqëson Turqinë dhe botën myslimane. Në anën tjetër, Perëndimi ishte burim i frymëzimit nacionalist dhe mbështetje për shtetin e ri grek në shekullin XIX. Intelektualët grekë dhe elitat politike në Greqi e shihnin djepin e modernes evropiane. Qytetarëve modernë grekë me këtë iu imponua barra dhe nderi i trashëgimisë nga e kaluara e lavdishme, e cila duhej të jetë unikate për nga rëndësia në mënyrë e cili do t'i dallonte grekët nga kombet e tjera, ndërsa njëkohësisht të jetë universal për nga kultura, në mënyrë që do të kontribuonte drejt arketipit të sqarimit evropian.

Edhe pse koncepti nacionalist arriti t'i shkrijë Greqinë klasike dhe traditën bizantine në një, duke konstruuar të kaluar kombëtare pa zbrazëtira, ambivalenca midis lindjes dhe perëndimit u bë cilësi e rëndësishme e identitetit dhe politikës greke deri në ditën e sotme. Evropa e krijoi pikëpamjen e saj për Greqinë moderne me referenca drejt qytetërimit të saj antik, duke i lëshuar dymijë vjetët ndërmjet. Në këtë mënyrë grekët u gjetën të robëruar midis helenizmit dhe romanizmit. Edhe pse Evropa (perëndimore) është referenti kryesor politik dhe kulturologjik nëpër shek. 20 e deri më sot, pozitat e Greqisë mbeten ambivalente, ndërsa të jesh grek modern do të thotë të jesh në Evropë – por jo në të. Megjithatë, evropeizmi i Greqisë moderne zyrtarisht është vërtetuar me bashkimin e saj drejt Bashkimit Evropian në vitin 1981. Por grekët edhe më tej i shohin evropianët me dyshim; njerëzit e paudhëzuar por edhe elitat politike shpesh kulturën moderne perëndimore të Evropës e perceptojnë si injorante ndaj traditave greke.

SFIDAT E TANISHME

Pas vitit 1989, Greqia u bë nikoqire e një numri të madh të emigrantëve, kryesisht nga Ballkani (Shqipëria dhe Bullgaria), Evropa Qendrore dhe Lindore (Rumania, Ukraina dhe Rusia), por gjithashtu – me përqindje të konsiderueshme – edhe nga Azia (India, Pakistani, Bangladeshi dhe Kina). Imigracioni parashtrroi pyetje të rëndësishme për të vetëkuptuarit kombëtar të Greqisë. Me trup emigrues prej 10% nga e gjithë popullata, institucionet shtetërore dhe opinioni publik gradualisht e kuptuan se shoqëria greke faktikisht është bërë multikulturore dhe multietnike. Madje edhe pse pikëpamjet dominuese të kombit grek pohojnë se “Greqia u takon grekëve”, jeta e përditshme në shkollat dhe vendet e punës e dëshmon të kundërtën. Reformat e fundit në ligjet qytetare (mars 2010) me të vërtetë e pranojnë dhe institucionalizojnë këtë realitet të ri.

Dekada e parë e shekullit XXI filloi me të vërtetë pozitivisht për Greqinë. Inkuadrimi i vendit në fazën e parë të implementimit nga euro-zona, më 1 janar 2002, e konfirmoi karakteristikën e saj evropiane, në nivelin monetar si dhe në nivelin simbolik. Lojërat Olimpikë në vitin 2004 ishin shembull për bindjen e krijuar se Greqia moderne është shoqëri kulturologjikisht e ndërgjegjshme, e cila ka ekonomi të fuqishme dhe e cila i ka lënë problemet me identitetin, së bashku me dobësitë ekonomike, pas vetes. Shtesë, fillimi i viteve 2000 solli ndryshime të rëndësishme në kontekstin evropian dhe ballkanik për Greqinë: zgjerimi në vitin 2004 drejt Evropës Qendrore dhe Lindore i ndryshoi kufijtë gjeopolitikë, kulturorë dhe fetarë më larg drejt Lindjes, duke e bërë Greqinë të pashmangshme në atë peizazh të sapokrijuar evropian. Dy proceset zhvillimore i vendosën diskutimet kombëtare greke në pozitë më të fuqishme në Evropë.

Njëkohësisht, zgjerimi i BE-së me inkuadrimin e Turqisë dhe Ballkanit, hapi sfida të reja rreth identitetit dhe çështjeve gjeopolitike. Ndërsa opinioni publik grek ishte në pajtim me inkuadrimin e Kroacisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së (i gjithë procesi u vlerësua si faktor i cili siguron demokracinë, stabilitetin dhe paqen në rajon) ky opinion ishte kundër inkuadrimit të Turqisë. Turqia ishte dhe vazhdon të perceptohet si kanosje nga fqinjësia, para së gjithash për shkak të çështjes së Qipros, pretendimeve turke drejt Detit Egje, si dhe për shkak të manipulimit turk me minoritetin i tij etnik në Trakinë perëndimore.

Dekada e re filloi me krizë të rëndë dhe të dhimbshme ekonomike. Kjo krizë e konfirmoi dyshimin e shumicës së qytetarëve (por në të cilën nuk dëshironin të besonin), gjegjësisht se vitet “e arta” të zhvillimit ekonomik dhe shkëlqimit të Lojërave Olimpikë, vetëm e fshehën dobësinë strukturale të ekonomisë greke dhe nevojën për ndryshime radikale në tregun e fuqisë së punës, në ekonominë, sistemin social dhe pensional, si dhe në organizimin e përgjithshëm të administratës publike.

Është me të vërtetë befasuese se me të gjitha sfidat sociale, politike dhe ekonomike me të cilat u ballafaqua Greqia (dhe në të cilat më shumë apo më pak është përgjigjur në mënyrë përkatëse) gjatë dy dekadave të fundit, çështja për emërimin e IRJM-së është akoma e gjallë dhe e paharruar. Ndërsa “Çështja e Maqedonisë” sot na çon drejt tubimeve publike, anketat e opinionit publik tregojnë dokumente valide se shumica dominuese e të anketuarve e vlerëson çështjen si mjaft të rëndësishme dhe se me keqardhje të madhe do të reagoje në vendimin e qeverisë greke që të pranojë kompromis për përdorimin e emrit Maqedoni pa kualifikim shtesë dhe të qartë (si Sllav-o, p.sh.). Ata këtë do ta vlerësonin si humbje kombëtare dhe qeveria (e cila do ta pranonte këtë) do të konsiderohet si tradhtarë.

Unë besoj se mënyra e vetme që këto vende të vazhdojnë me lëvizjen përpara është, natyrisht, kompromisi. Megjithatë, ky kompromis duhet më pak të bazohet në selektimin e disa fjalëve të caktuara të cilat do ta krijonin emrin e IRJM-së. Duhet të përfshijë ndryshimin e drejtimit: një fushatë publike e cila do t’u sqaronte qytetarëve të Greqisë dhe IRJM-së se Aleksandri, Leka i Madh nuk ka qenë as maqedonas as grek, në kuptimin me të cilin ne i kuptojmë këto terme në ditët e sotme dhe se me siguri ka qenë që të dyja, edhe maqedonas edhe helen në kuptimin me të cilin ata i kanë kuptuar ato atëherë! Prandaj, nuk ekziston poentë në diskutimin rreth asaj se kush e posedon historinë, heronjtë, e me këtë edhe emrat. Ekziston çështje për njohjen e përbashkët të ekzistimeve të tyre dhe ndërtimit përmes tregtisë, bashkëpunimit ekonomik, këmbimit kulturor (në fund të fundit, muzika jonë pop dhe folk ngjajnë me njëra-tjetrën) dhe turizmit. Në këtë rast, zgjidhja e problemit me emrin do të duhej dhe do të ishte konstatim logjik i gjithë kësaj, në vend se fillimi i tij. Historia është me të vërtetë modusi me ndihmën e të cilit ne e rikonstruojmë të kaluarën tonë, që e tanishmja të ketë kuptim dhe që të mundemi ta paramendojmë të ardhmen. Që këtu, ndoshta ne, si dy palë të involvuara, duhet ta shqyrtojmë historinë tonë dhe sërish të mendojmë për të, me pikëpamje kritike mbi atë që na bashkon, në vend se mbi atë që na ndan.



Milaim Fetaj

Mr. Milaim Fetaj, Maqedoni, është politikolog. Ka kryer Shkencat politike në Universitetin e Zagrebit në Kroaci, ku fiton titullin Magjistër i shkencave politike në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në maj të vitit 2010 zgjedhet nënkryetar i Këshillit të Radiodifuzionit të Republikës së Maqedonisë. Në vitet 2004-2005 është iniciator dhe drejtues i parë i televizionit Alsat-M. Nga viti 2001 është ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Ka botuar një sërë punimesh shkencore dhe artikujsh të tjerë në më shumë publikime në vend dhe jashtë. Milaim Fetaj është i lindur më 11 korrik 1958 në fshatin Çegran të Gostivarit. Jeton në Shkup.



Mr. sc. Milaim Fetai

Kontesti me Greqinë dhe integrimet e Maqedonisë

1. RËNIA E EPOKËS SË REALSOCIALIZMIT DHE KRIJIMI I MAQEDONISË SI SHTET I PAVARUR DHE SOVRAN

1.1 Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore u krijuan kushtet reale, shoqërore dhe politike që ideja për një Evropë të bashkuar dhe unike, edhe pse relativisht e hershme, me vështirësi dhe për një periudhë relativisht të gjatë, të krijojë shtigjet dhe të hapë rrugët drejt jetësimit. Lufta e ftohtë, e cila gjeti shprehjen fill pas fitorës së koalicionit antihitlerian¹, shpejtoi proceset integruuese në trollin e Evropës Perëndimore.

Ndryshimi i emërtimit kushtetues i hap rrugë procesit të integrimin të më-tutjeshëm të Maqedonisë në strukturat evropatlantike

1.2 Pasi që Organizata e posathemeluar e Kombeve të Bashkuara nuk arriti të zgjidhë thelbin e konfliktit të interesave midis Lindjes dhe Perëndimit, Evropa Perëndimore, me sukses iu qas proceseve integruuese në fusha të ndryshme. Këto procese gjetën

¹ Njëri nga luftëtarët e paepur të Evropës së Bashkuar ishte edhe shkrimtari famëmadh francez, Victor Hugo. Siç thotë profesori Vukadinović, "fjalët e adhuresit të unitetit evropian Victor Hugo, të cilat i tha në Kongresin e Paqës në Paris, në muajin gusht të vitit 1849, edhe sot tingëllojnë profetike: "...Do të agojë dita kur... të gjitha kombet e këtij kontinenti, pa humbur vetitë dhe individualitetin e famshëm të tyre, do të shkrihen në një tërësi unike superiore dhe do të krijojnë vëllazërinë evropiane ... Do të agojë dita kur më nuk do të ketë fushëbeteja përveç tregjeve që krijojnë këmbimi i vlerave (tregtia) ... Do të agojë dita kur plumbat dhe bombat do të zëvendësohen nga votat, nga votimet e gjithmbarshme popullore..." – Cituar sipas: R. Vukadinović dhe L. Čehuljić, "Politika evropskih integracija", Zagreb, 2005, 29.

² Lufta e Ftohtë gjeti shprehjen në një bashkësi ndërkombëtare bipolare. Në një anë, shtetet e koalicionit antihitlerian që tradicionalisht ndërtonin sistemin demokratik, kurse në anën tjetër, ato që, pas Revolucionit të Tetorit, të vitit 1917, ndërtonin sistemin e së ashtuquajturës "demokraci popullore", sistemin realsocialist.

shprehjen, së pari, në fushën politike dhe të sigurisë. U krijuan edhe format e para integruese institucionale në fushën ekonomike: që nga bashkësitë e para me karakter supranacional dhe bashkësitë ekonomike evropiane deri te Bashkësia Evropiane.

2. ANËTARËSIMI I MAQEDONISË NË NATO ËSHTË HAPI I PARË INTEGRUES NË STRUKTURAT EVROATLANTIKE

2.1 Rënia e Murit të Berlinit shënoi simbolikisht edhe përmbylljen pothuaj definitive të periudhës famëkeqe të “luftës së ftohtë”. Kjo, njëkohësisht shënoi edhe rënien definitive të një epoke, epokës së realsocializmit. Rënia e realsocializmit, për shtetet e vogla, siç është edhe Maqedonia, ringjalli dhe forcoi shpresat se shkallën e sigurisë së tyre fizike do ta rrisë integrimi i tyre në NATO dhe se, kësaj, do të mundësohet edhe zhvillimi dhe përfundimi i mëtejshëm i demokracisë së posakonstituuar në to.

2.2 Maqedonia, duke synuar integrimin e plotë të saj në të gjitha strukturat evropiane, pothuaj në mënyrë plebishitare³ u deklarua për anëtarësim të plotë të saj, si anëtare e NATO-s, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat i parashikon akti themelues i kësaj aleance ndërkombëtare ushtarake⁴.

2.3 Si partnere disavjeçare e NATO-s për paqe, si anëtare e Kartës së Adriatikut dhe, veçmas, si shtet që gëzoi përkrahjen dhe ndihmën e NATO-s në disa situata të krizës që i përjetoi që nga shpallja e pavarësisë e deri në nënshkrimin dhe fillimin e procesit të implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, Maqedonia me të drejtë priti që, si kandidat për anëtare të NATO-s, të ftohet në Samitin e NATO-s në Bukuresht, që u mbajt në gjysmën e parë të muajit prill të vitit 2008. Mirëpo, Greqia, si anëtarë e përherëshme e NATO-s, në mënyrë të padyshimtë u deklarua se nuk heq dorë nga përdorimi i së drejtës së vetos. Ky veprim i Greqisë, me të cilin efektivisht u shtye vendimi për antarësim të Maqedonisë në NATO, shkaktoi komente të shumënduarta, si në qarqet politike të palëve të interesuara, Greqisë dhe Maqedonisë, ashtu edhe në hapësirën e gjërë politike.

Me qëllim që këtë çështje të ndriçojmë më për së afërmi, sado pak, do të përiqemi që, në vazhdim, të trajtojmë disa aspekte të thelbit të këtij kontesti dhe të sugjerojmë një zgjidhje të mundshme të tij.

3. EMËRTIMI KUSHTETUES NGADALËSOI PROCESIN INTEGRUES EVROATLANTIK NË MAQEDONISË

3.1 Emri kushtetues i Maqedonisë⁵ u kundërshtua nga Greqia, fill pas konstituimit të saj. Ky kundërshtim gjeti shprehjen si në periudhën e njohjes nga shtetet e tjera, ashtu edhe gjatë procedurës me rastin e anëtarësimit të Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

³ Maqedonia konstituohet shtet në bazë të Deklaratës së Kuvendit (Sobranie) për Sovranitet, të datës 25.01.1991 dhe Referendimit për Sovranitet dhe Pavarësi, që u zbatua më 08.09.1991. Fill pas zbatimit të Referendimit, më 17.11.1991, Kuvendi aprovon Kushtetutën, e cila deri sot ndryshohet dhe plotësohet: më 1992, kur Maqedonia deklarohet kategorikisht se nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjërit nga fqinjët e saj dhe se në punë të brendshme të fqinjëve të saj – nuk do të përzihet. Ndryshimet dhe plotësimet e radhës bëhen më 1998, kur me Kushtetutë përfordohen disa nga të drejtat e njeriut (vetëm në bazë të vendimit gjyqësor paraburgimi mund të zgjasë prej 90 – 180 ditë, por jo më gjatë). Ndryshimet më të thella kushtetuese, të tretat me rradhë, bëhen më 16.11.2001, fill pas aprovimit të Marrëveshjes së Ohrit, me qëllim që dispozitat e saj, në mënyrë më efektive, të zbatohen në jetë. Dhe, ndryshimet e fundit, bëhen në vitin 2003, me qëllim që edhe më tutje të përfordhet mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave të njeriut. Për më tepër hollësi, shih: S. Klimovski, V. Mitkov, R. Treneska, T. Karakamisheva, “Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija”, Skopje, 2003.

⁴ Në një konferencë, me moton “Maqedonia në rrugë drejt NATO-s”, të organizuar nga Forumi Rinor Evro-Atlantik dhe të mbajtur në Shkup, më 28-30.09.2001, secili pjesëmarrës në diskutim u deklarua në favour të anëtarësimit në NATO. Për më tepër hollësi, shih Materialet në dorëshkrim nga konferenca e titulluar “Maqedonia në rrugë të saj drejt NATO-s”, Shkup, më 28-30.09.2001

⁵ North Atlantic Treaty Organization (Pakti i Veriatlantikut, NATO pakti) u themelua pas Luftës së Dytë Botërore, në periudhën e konflikteve gjatë luftës së ftohtë, më 04.04.1949, në Uashington. Themeluesit e NATO paktit ishin: Belgjika, Danimarka, Franca, Holanda, Islanda, Italia, Kanada, Luksemburgu, Norvegjia, Portugali, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më 1952 NATO pakti u bashkuan Greqia dhe Turqia. Më 1955, NATO paktit iu bashkua edhe Gjermania Federale. Sëlia e NATO paktit është në Bruksel.

⁶ Kushtetuta e Maqedonisë, që nga dita e shpalljes së saj, emërtohet: “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë”. Kushtetutën e shpalli Kuvendi i (Sobranie e) Republikës së Maqedonisë, në seancën e datës 17.11.1991, me Vendimin për Shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Sipas nenit 1 të kësaj Kushtetute, edhe pas të katër ndryshimeve dhe plotësimeve të bëra (shih fusnotën nr. 4 të këtij punimi), “Republika e Maqedonisë është shtet Sovran, i pavarur, demokratik dhe social”. Pra, emri kushtetues i Maqedonisë është “Republika e Maqedonisë”.

3.2 Pas insistimit të Greqisë që Maqedonia të mos pranohet anëtare e Kombeve të Bashkuara me emrin e saj kushtetues, Asamblea e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara bëri një presedan: nuk e pranoi Maqedoninë anëtare me emrin e saj kushtetues, por atë e emërtoi "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë". Ky veprim aso kohe u arsyetua me qëndrimin se ky emërtim për Maqedoninë do të përdoret vetëm brendapërbrenda strukturave të Kombeve të Bashkuara.

Ky veprim i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u prit me keqardhje në qarqet institucionale, politike dhe shtetërore të Maqedonisë⁷. Në këto qaqe u konsiderua se me këtë veprim, në fakt, jo vetëm që u "përkrah" qëndrimi konsekuent i Greqisë që të mos e njohë Maqedoninë me emrin e saj kushtetues, por në mënyrë indirekte u zhvlerësuan edhe të gjitha kundërshtimet e Maqedonisë lidhur me dëmet konkrete që ekonomisë së saj i shkaktoi Greqia, pasi që kjo, që nga fillimi i vitit 1990, bllokoi tranzitin e të gjitha mallrave që vinin në Selanik, duke përfshirë edhe mallrat që ishin të dedikuara për disa nga shtetet e Bashkësisë Ekonomike Evropiane.

3.3 Kjo bllokadë "e gjithëmbarshme", për shtetin e ri – Maqedoninë dhe ekonominë e saj të brishtë, e zbatuar në pesë vitet e para të ekzistencës së saj si shtet i pavarur dhe sovran⁸, ishte goditje e rëndë. Goditja ishte e rëndë edhe për marrëdhëniet e brendshme shoqërore dhe politike. Goditja ishte veçmas e rëndë për marrëdhëniet ndërkombëtare politike të saj, pasi që objektivi ishte u vështirësua rruga e afirmimit të saj në skenën politike, madje edhe institucionale ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Maqedonisë në Kombet e Bashkuara, megjithatë, ishte një ngjarje që rriti shpresat e saj se pengesat e shkaktuara nga fqiu jugor dhe mosmarrëveshjet e shfaqura me këtë fqinj, së shpejti, do të tejkalohen dhe se, si Greqia ashtu edhe Maqedonia, si fqinjë, për secilën vështirësi dhe mosmarrëveshje, do të gjejnë zgjidhje të pranueshme për dy palët. Dhe, vërtet, me përpjekjet e të dy palëve të interesuara, më 13.09.1995, Greqia dhe Maqedonia lidhën Marrëveshjen e Përkohshme, e cila që të dy palëve u dha shpresë se bashkërisht mbollën pemën e shpresës së mirë – krijuan bazën e zgjidhjes së të gjitha konflikteve bilaterale.

3.4 Marrëveshja e Përkohshme, e vitit 1995, ngjalli shpresat e fqinjëve, të rajonit dhe veçmas të Bashkësisë Evropiane se periudha e shkuar pesëvjeçare, që për potencialin ekonomik dhe për afirmimin ndërkombëtar të Maqedonisë ishte një periudhë shumë e vështirë, u përmyll. Por, siç doli në shesh brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, me Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995, kontesti lidhur me emërtimin e Maqedonisë – nuk u zgjidh; zgjidhja, në fakt, vetëm u shtye për një kohë të pacaktuar.

Është fakt se me Marrëveshjen e Përkohshme, të vitit 1995, Maqedonisë iu hapën rrugët e zhvillimit të saj më intensiv ekonomik dhe të afirmimit të mëtutjeshëm të saj në skenën politike ndërkombëtare; Maqedonisë iu hap rruga e afrimit me bashkësitë ekonomike evropiane dhe me vetë Bashkësinë Evropiane. Maqedonisë, veçmas, iu hap rruga e afrimit të shpejtë me NATO-n, gjë kjo që Maqedonia e synoi që nga ditët e para të pavarësisë së saj.

⁷ Maqedonia është njëra nga pasardhëset e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). RSFJ ishte anëtare themeluese e Kombeve të Bashkuara, pasi që ajo, më 25.06.1945, nënshkroi Kartën e Kombeve të Bashkuara, të cilën më 19.10.1945 edhe e ratifikoi. Pas shkapërderdhjes së RSFJ-së, u krijuan shtetet të cilat fill pas shfaqjes së tyre u bënë anëtare të reja të Kombeve të Bashkuara: Bosna e Hercegovina, Republika e Kroacisë, Republika e Sllovenisë, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika Federale e Jugosllavisë (të cilën, më vonë, e trashëguan Republika e Serbisë dhe Republika e Malit të Zi).

⁸ Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika Federale e Jugosllavisë u pranua në Kombet e Bashkuara në bazë të Rezolutës A/RES/47/225, dt. 08.04.1993. Asamblea e përgjithshme mori vendim që këtë shtet ta pranojë në Kombet e Bashkuara dhe atë, brendapërbrenda Kombeve të Bashkuara, për të gjitha qëllimet, përkohësisht ta emërtonte "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" për deri sa të zgjidhet mosmarrëveshja e ngritur lidhur me emrin e saj.

⁹ Në pajtim me nenin 4 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, anëtar mund të bëhet secili shtet paqedashës, i cili pranon obligimet e parashikuara me Kartë dhe, sipas vlerësimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, është i aftë dhe ka vullnet që obligimet e tilla t'i përmbushë. Mirëpo, sipas Maqedonisë, porosia e kësaj dispozite nuk u përfill, pasi që kësaj pranimi në OKB, praktikisht, iu kushtëzua: emri i saj kushtetues – nuk u pranua. Për hollësi, shih: R.Nikovski, Memorandum do Evropskiot parlament – Fakti za zadninata na grčkata politika kon Makedonija, që u publikua nëpërmjet shtypit, në muajin prill 2008; Memorandum i është dedikuar Këshillit të Evropës dhe është pritur se do të shqyrtohet bashkërisht me Raportin e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi zgjedhjet, raport ky që u shqyrtua në Sesionin e Tretë të Parlamentit Evropian, më 23.06.2008; shih edhe dokumentin: AS (2008) CR19, Addendum 1, Troisième partie, Compte Rendu de la dix-neuvième séance, lundi 23 juin 2008 – Addendum.

¹⁰ Bllokada në fjalë u suprimua pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme, të lidhur më 13.09.1995, midis Greqisë dhe Maqedonisë; edhe në këtë Marrëveshje Maqedonia emërtohet "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë".

3.5 Pasi u hoq pengesa më serioze nga rruga drejt proceseve integruese ndërkombëtare ekonomiko-politike dhe ushtarake në institucionet e Evropës Perëndimore dhe në botë, Maqedonia përfitoi nga rasti dhe brenda pesëvjeçarit që pasoi, me marrëveshje ndërkombëtare, krijoi dhe në shumë fusha institucionalizoi bashkëpunimin e ngushtë, para së gjithash – me bashkësitë ekonomike evropiane, pastaj me vetë Bashkësinë Evropiane, ndërsa me Aleancën e Atlantikut Verior, NATO-n, krijoi partneritet dhe u inkuadrua në struktura të shumë organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, qoftë si anëtare qoftë si partnere¹⁰.

Ndër dispozitat më shpresëdhënëse për Maqedoninë ishte dispozita e nenit 11 të Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995, sipas së cilës fqiu jugor, Greqia, obligohet që të mos ndër marrë asnjë masë që do të pengonte cilindo proces të integritetit të Maqedonisë në ato organizata dhe shoqata ndërkombëtare, në të cilat, tashmë, vetë Greqia është e anëtarësuar. Kjo dispozitë e Marrëveshjes së Përkohshme, nga pala maqedone, është kuptuar si obligim ndërkombëtar i Greqisë që kjo, vullnetarisht dhe në mënyrë të njëanshme, heq dorë nga e drejta e vetos, po qe se kjo e drejtë asaj, sipas akteve organizative – normative të organizatave dhe shoqatave ndërkombëtare në fjalë, ia njeh Greqisë këtë të drejtë. Dhe, vërtet, Greqia veproi mu kështu, por – vetëm deri në vitin 2001. Me të hyrë të Maqedonisë në krizë, për shkak të konfliktit të armatosur që shpërtheu në territor të saj, Greqia nuk vonoi dhe nisi të injorojë detyrimet e saj që dalin nga dispozita e cituar e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995.

3.6 Konflikti i armatosur Maqedoninë vërtetë e ballafaqoi me një krizë shumë serioze. Por, kjo krizë, pas mobilizimit të suksesshëm politik të forcave të brendshme dhe me ndihmën e Bashkësisë Ndërkombëtare u zgjidh brenda vitit me një akt me vlerë historike që në Maqedoni solli paqën për të gjithë dhe stabilitetin institucional shtetëror; ky akt tani është i njohur si Marrëveshje e Ohrit.

4. NDRYSHIMI I EMËRTIMIT KUSHTETUES INTENSIFIKON PROCESIN INTEGRUES TË MAQEDONISË NË STRUKTURAT EVROATLANTIKE

4.1 Konstelacioni i marrëdhënieve ndërkombëtare në Ballkan, që u krijua për shkak të veprimeve efektive luftarake në trollin e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e cila tashmë sapo ishte shkapërdërdhur, kushtëzoi dhe, njëherit, përshpejtoi afrimin e Maqedonisë ndaj NATO-s. Këtë afërsi, më vonë, e përforcoi edhe konflikti efektiv i armatosur, që në fillim të vitit 2001 shpërtheu në trollin e vetë Maqedonisë, vetëm dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së saj dhe njohjes ndërkombëtare të shtetësisë së saj.

Këto ngjarje, të cilat në vazhdimësi rrezikuan qenien shtetërore të Maqedonisë, me ndihmën e gjithanshme të Bashkësisë Ndërkombëtare, kontribuan që Maqedonia gjithnjë e më afër dhe në fusha të shumta të lidhet dhe të bashkëpunojë me NATO-n. Këtu, veçmas po theksojmë vetëm njërin nga format e këtij bashkëpunimi të frytshëm: fill pas përfundimit të konfliktit të armatosur dhe nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, NATO-s iu besua një detyrë thelbësore – zbatimi i çarmatimit të përgjithshëm, gjë kjo që kishte për qëllim që të sigurohen kushtet para-prake për implementim të Marrëveshjes në jetë.

4.2 Pos kësaj, brenda suazave të përcaktuara me Kartën e Adriatikut, Maqedonia nisi me sukses t'i zbatojë të gjitha detyrat e saj që dilnin nga Marrëveshja me NATO-n për Partneritet: me sukses zbatoi dhe ende është duke e zbatuar riorganizimin e brendshëm të forcave ushtarake, me njësitet e saj përkatëse ushtarake ajo me sukses po përgatitet dhe po inkuadrohet në program të përgjithshëm të NATO Aleancës që ka

¹⁰ Me Marrëveshjen e Përkohshme, të datës 13.09.1995, të lidhur midis Maqedonisë (Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë) dhe Greqisë, në fakt, u ndërpre bllokada pesëvjeçare (1991 – 1995), të cilën Greqia e pat vendosur ndaj Maqedonisë në mënyrë të njëanshme. Maqedonia, edhe pse e kishte mundësinë, nuk mori asnjë masë retorizive ndaj Greqisë.

për qëllim ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare (Afganistan, Sudan) dhe, në këtë mënyrë, po dëshmon pëcaktimin dhe aftësinë e saj që nga Aleanca të marrë dhe me sukses të realizojë detyrimet e saj ndërkombëtare ushtarake.

Mirëpo, në fillim të vitit 2008, kur Maqedonia tashmë i plotësoi të gjitha kushtet dhe kur realisht pritej që kjo, bashkë me dy anëtarët e tjera të Kartës së Adriatikut – Shqipërinë dhe Kroacinë, përfundimisht të bëhen anëtarë të NATO-s, me të drejta të plota, edhe kësaj radhe, Greqia bëri pengesën më serioze: u kërcënua se do të përdorë të drejtën e vetos dhe se, në këtë mënyrë, nuk do të lejojë që Maqedonia të bëhet anëtare e NATO-s, po qe se nuk ndërron emrin e saj kushtetues!

4.3 Pasi që Greqia, pra, duke vepruar në këtë mënyrë, mu në momentin kur Maqedonia me të drejtë priste që, sikurse edhe Shqipëria dhe Kroacia, të ftohet në Samitin e NATO-s në Bukuresht, para Maqedonisë, popullit dhe institucioneve shtetërore të saj u shtrua detyrë e pashmangshme që kontesti rreth emrit të zgjidhet sa më parë. Sepse, për Maqedoninë, rruga drejt anëtarësimit në NATO do të thotë rrugë drejt demokracisë evropiane, drejt sigurisë së saj fizike dhe sigurisë së ardhmërisë së saj shtetërore.

5. EMËRTIMI I MAQEDONISË, I PRANUESHËM PËR TË DY PALËT NË KONTEST, DUHET TË JETË SYNIM I VULLNETIT POLITIK TË TYRE

5.1 Çështja e emërimit të Maqedonisë ka dimensione të shumëfishta politike ndërkombëtare. Edhe pse vite me rradhë, që nga krijimi i saj si shtet i pavarur dhe sovran, ka rënduar dhe rëndon edhe më tutje marrëdhëniet bilaterale midis Maqedonisë dhe Greqisë, ende nuk ka gjetur zgjidhje adekuate. Duke konsideruar se kjo çështje, patjetër do të duhej që definitivisht të zgjidhet, në vazhdim, do të përpiqemi që ti trajtojmë, disa nga faktet dhe qasjet, për të cilat konsiderojmë se janë relevante për zgjidhje të këtij kontesti

5.2. Nisemi nga fakti se siguria e një shteti është parakusht immanent për një zhvillim stabil. Kjo siguri nënkupton një sistem, një tërësi metodash, me zbatimin e të cilave arrihet siguria e njerëzve dhe e pasurisë, arrihet mbrojtja e tyre nga numri dhe lloji i pacaktuar i rreziqeve, duke llogaritur këtu edhe rreziqet nga lufta, nga aktiviteti kriminal, madje edhe nga pasojat e fatkeqësive natyrore, zjarrit, aksidenteve, sabotazheve, subversioneve, akteve dhe aksioneve terroriste. Siguria në një shtet ndërtohet dhe ruhet nëpërmjet të instituit të sistemit që mbështetet në institucione funksionale të pushtetit. Me ndërmarrjen e masave të caktuara, të përditshme dhe preventive, dhe me nxjerrjen e akteve dhe të vendimeve përkatëse, ligjore e politike, institucionet e pushtetit, varësisht nga autorizimet dhe kompetencat e tyre, qenësisht sigurojnë zhvillim stabil shoqëror dhe ekonomik në shtetin e tyre.

5.3 Mirëpo, çfarëdo që të jetë sistemi i institucioneve të pushtetit, madje le të jetë ai një sistem më se funksional, nuk duhet të kuptohet si zgjidhje e vetme, e dhënë, e krijuar – një herë për të gjitha kohërat, një herë për gjithëmonë! Sepse, secili nga këto sisteme, në mënyrë kontinuele, do të duhej që t'i përshtatet kërkesave të gjithmbarshme shoqërore, politike dhe ekonomike, para së gjithash – brendapërbrenda shtetit, por edhe të atyre që janë aktuale në rajon dhe në botë në tërësi.

Siguria „e brendshme“ dhe ajo „e jashtme“, pra – siguria ndërkombëtare e një shteti (siguria në rajon dhe ajo në një hapësirë më të gjerë), në fakt, paraqet dy anë të një medaleje të vetme. Së këndejmi, sistemi i instituit, ai i vendosur nga institucionet e pushtetit në një vend, siç është rasti edhe me Maqedoninë, po qe se si qëllim kryesor ka realizimin e vullnetit dhe të përpjekjeve të gjithmbarshme të popullatës së vendit që aty të arrihet një siguri e plotë, para së gjithash, në planin e brendshëm, duhet patjetër që të jetë i orientuar drejt një bashkëpunimi shumë të ngushtë me një faktor

përkatës ndërkombëtar të sigurisë, si në planin rajonal ashtu edhe në planin global. Ky faktor përkatës ndërkombëtar, pa dyshim mund të jetë dhe është Aleanca Veriatlantike – NATO. Dhe, s'ka dyshim se NATO-ja sot, pa asnjë vërejtje, është njëri dhe e vetmi ndër institucionet me rëndësi më të madhe të sigurisë ndërkombëtare, regjinale dhe globale.

5.4 Të shumta janë arsyet, faktorët, që secilit shtet, e veçmas secilit shtet të vogël, siç është Maqedonia, ia imponojnë kërkesën për një përshtatje të vazhdueshme të sistemit të saj të organizimit të institucioneve të pushtetit me qëllim që këto institucione, në çdo kohë, të jenë të afta që t'i përgjigjen kërkesave të kohës. Këto arsye, këta faktorë, mund të jenë të natyrës së brendshme politike, respektivisht mund të jenë me origjinë shoqërore dhe ekonomike brendapërbrenda shtetit, pasi që shfaqja e tyre varet si nga ecuritë politike, ashtu edhe nga ecuritë e përgjithshme shoqërore dhe ekonomike brendapërbrenda shtetit.

Arsyet dhe faktorët në fjalë, pa dyshim, mund të jenë edhe të natyrës ideore, por edhe religjioze! Mu në këtë kuptim, analiza e profesorit Gaber, është interesante. Sipas kësaj analize, ndër arsyet dhe faktorët relevantë, të përshtatshëm për të ndikuar në stabilitetin e gjithmbarshëm, të brendshëm dhe ndërkombëtar, të një shteti, profesori Gaber llogarit vlerat kulturore, etnike, morale, pastaj vlerat historike dhe religjioze, vlera këto të cilat, tashmë, janë pranuar nga shoqëria dhe nga shteti në fjalë, kanë fituar „të drejtën e qytetarit“ në këtë shoqëri dhe në këtë shtet. Madje, sipas profesorit Gaber, të gjitha këto dhe vlerat e tjera si dhe kuptimi i tyre, në mënyrë të caktuar, në Ballkan, sajtojnë bazat mbi të cilat krijohen situata konfliktuoze dhe situata të krizes, siç ishte kriza e shkaktuar nga Konflikti i armatosur në Maqedoni, në vitin 2001¹¹.

5.5 Ka qenë reale, pra, të pritët që, në pjesën e parë të viti 2008, sikurse edhe dy anëtarët e tjera të Kartës së Adriatikut, edhe Maqedonia të ftohet në Bukuresht. Sikur të veprohej kësisoji, Maqedonisë, e cila mu në këtë kohë ka plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme paraprake, të cilat nga Aleanca Veriatlantike kërkohen, do t'i hapeshin dyert drejt anëtarësimit të plotë të saj, së pari – në NATO dhe shpejt pas kësaj – edhe në Bashkësinë Evropiane.

Ajo që është dashur të ndodhë, respektivisht, ajo që dukej plotësisht „normale“ se do të ndodhë – nuk ndodhi! Sepse, sikurse edhe para gati plot dy dekadave, në rastin e pranimit të Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në rrugë të Maqedonisë drejt anëtarësimit të plotë në NATO, përsëri, doli Greqia – me kërkesën e saj energjike që, para se Maqedonia të anëtarësohet, definitivisht, të zgjidhet çështja e emërimit të saj, që me fjalë të tjera, do të thotë – të ndryshohet emri kushtetues i saj dhe që për Maqedoninë të gjendet një emërtim „ndërkombëtarisht“ i njohur dhe, për Greqinë, i pranueshëm.

5.6 Kështu, sot, para nesh u shtrua një çështje, e cila, për nga natyra dhe pesha e saj, tejkalon kufijtë e një „kontesti bilateral“ midis Greqisë dhe Maqedonisë, përkundër faktit se Bashkësia ndërkombëtare, fill pas Samitit të NATO-s në Bukuresht, mori qëndrim se ky kontest është – kontest bilateral dhe se, si i tillë, ky kontest nuk ka dimension të kontestit ndërkombëtar! Megjithatë, po qe se merren parasysh subjektet dhe institucionet ndërkombëtare, të cilat janë të involvuara në këtë çështje dhe, veçmas, po qe se merret parasysh fakti se për anëtarësim të Maqedonisë në cilëndo organizatë ndërkombëtare, në të cilën vetëm shtetet janë anëtare dhe në të cilën Greqia tashmë është anëtare, objektivist nuk është e mundur që në një organizatë të këtillë Maqedonia të bëhet anëtare në qoftë se për një anëtarësim të këtillë Greqia nuk shfaq „vullnet të mirë“. Sepse Greqia, tani është reale që të pritët, në mënyrë të vazhdueshme do të ngrejë çështjen e emrit të Maqedonisë si – „çështje paraprake“.

¹¹ Për më tepër hollësi, lidhur me këto meditime, shih: Gaber, V.: Kolateralna šteta – Međunarodnata zaednica i krizata vo Republika Makedonija vo 2001 godina, Skopje, 2007.

5.7 Sipas Greqisë, emri kushtetues i Maqedonisë, „Republika e Maqedonisë“, vetvetiu sugjeron pretendë territoriale të këtij shteti ndaj shtetit fqinj – Greqisë. Mirepo, për dallim nga ky qëndrim, të shumta janë ato shtete, të cilat konsiderojnë se ky qëndrim „nuk sugjeron“ ndonjë kërkesë të Maqedonisë me çfarëdo pretendi territorial ndaj Greqisë. Ndër këto shtete, 126 sish, janë edhe fuqitë e mëdha dhe shtetet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat Maqedoninë e kanë njohur me emrin e saj kushtetues.

Në favor të qëndrimeve të shteteve, të cilat konsiderojnë se emri i Maqedonisë nuk sugjeron kurrfarë pretendimesh të saj territoriale ndaj pjesës veriore të territorit të Greqisë, po theksojmë edhe qëndrimin e Komisionit të Badinter-it, të shfaqur në Raportin e tij të Parë, i cili i është dorëzuar Këshillit të Bashkësisë Evropiane. Në këtë Raport, le të përkujtojmë, Komisioni i Badinterit ka shfaqur një qëndrim të qartë dhe të padyshimtë, sipas të cilit, në rast se shpërndahet Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, vetëm Slovenia dhe Maqedonia i plotësojnë kushtet që drejtpërsëdrejti të njihen ndërkombëtarisht! Shi në këtë kohë, Maqedonia ka qenë e njohur si „Republika (Socialiste) e Maqedonisë“.

5.8 Pos kësaj, si krijesë shtetërore, për herë të parë në kartën politike të botës, është shfaqur, pra ka lindur dhe ka jetuar (si njësi federale e shtetit të ri – Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, më 1944) me emrin e saj të sotëm kushtetues – Republika e Maqedonisë¹².

Emri i Maqedonisë, pas pavarësimit, i njohur si emri kushtetues i saj – „Republika e Maqedonisë“ është shkruar edhe në Kushtetutën e saj të parë, të vitit 1991 dhe, që nga kjo kohë, për gati gjashtë dekada pas shfaqjes së saj të parë në kartën politike të botës (më 1944), respektivisht, për gati dy dekada pas shpalljes së pavarësisë së saj (më 1991), emërtohet: „Republika e Maqedonisë“. Dhe, sot, Greqia është i vetmi shtet në botë, e cila Maqedonisë fuqimisht ia konteston emrin. Madje, nën presionin e Greqisë, para se Maqedonia të anëtarësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, sipas propozimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, propozim ky i cili është përkrahur nga e tërë bashkësia ndërkombëtare, Maqedonia nuk është pranuar anëtare me emrin e saj kushtetues, por, për Maqedoninë, është caktuar një „emërtim i përkohshëm“ – „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“ dhe kjo, me këtë emërtim, është bërë anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5.9 Kështu, një „argument“ që edhe në pamje të parë vështirë se mund të konsiderohet „i qëndrueshëm“, të cilin Greqia e përdori si mjet ndikimi për të mos njohur Maqedoninë me emrin e saj kushtetues, në një mënyrë, në përmasa ndërkombëtare, fitoi të „drejtën e qytetarisë“; Maqedonia, edhe zyrtarisht, u bë me dy emra: njëri – emri i saj kushtetues – Republika e Maqedonisë, emërtim ky që kësaj mund t’i shërbejë vetëm për nevoja të brendshme (dhe, kuptohet, edhe për nevoja të komunikimit ndërkombëtarë me ato shtete, të cilat e kanë njohur atë me emrin e saj kushtetues) dhe tjetri – emri i saj i fituar me rastin e pranimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kur u pagëzua: „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“ („the Former Yugoslav Republic of Macedonia“), emërtim ky – për përdorim „ndërkombëtar“ në kuadër të „sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara“. Sepse, sipas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në bazë të së cilës Maqedonia u pranua anëtare e saj, emri „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“ („the former Yugoslav Republic of Macedonia“) është i përdorshëm vetëm për nevoja të komunikimit brendapërbrenda sistemit të Kombeve të Bashkuara. Pra Maqedonia, me këtë emërtim, është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe anëtare e të gjitha organeve dhe organizatave të specializuara, të cilat veprojnë në gjirin e Kombeve të Bashkuara dhe në të cilat kjo, si shtet, ka cilësi të subjektit politik dhe juridik¹³.

¹² Për hollësi, lidhur me emërtimin e Maqedonisë, gjatë tërë kohës sa ajo ka qenë njësi federale e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, shih: Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, e vitit 1946, Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, e vitit 1974; pastaj, pas shpalljes së pavarësisë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e vitit 1991 me të gjitha amendamentet e aprovuara deri në vitin 2003.

¹³ Shih rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, A/RES/47/225, dt. 08.04.1993.

5.10 Marrëveshja e Përkohshme e vitit 1995, vërtet, soll një kthjelltësi në marrëdhëniet bilaterale: Greqia dhe „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“, gati që „normalizuan“ marrëdhëniet bilaterale, të cilat, pas shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë, për disa vjet me radhë ishin relativisht të tensionuara. Marrëdhëniet bilaterale shënuan ngritje: filloi bashkëpunimi i ngushtë dhe miqësor i dy shteteve në të gjitha fushat. Ky bashkëpunim veçmas gjeti shprehjen në fushën e ekonomisë dhe të financave. Kështu, së shpejti, në fushën e marrëdhënieve ekonomike, „Greqia dukshëm përmirësoi rejtingun e saj“ duke u bërë shteti me të cilin Maqedonia kishte shkallën më të lartë të këmbimit të mallrave dhe të shërbimeve. Këtë e dëshmojnë të dhënat e shumta statistikore mbi këmbimin e gjithëmbarshtëm të mallrave dhe të shërbimeve midis këtyre dy vendeve.

U intensifikuan edhe përpjekjet për përparim dhe zhvillim të marrëdhënieve të mira politike. Mirëpo, në këtë fushë, të gjitha përpjekjet mbetën – vetëm në nivel të përpjekjeve, pasi që Greqia, edhe pas gati një dekade e gjysmë, nuk hoqi dorë nga qëndrimi i saj – që emri kushtetues i Maqedonisë të ndryshohet. Kështu Greqia, për sa i përket ndryshimit të këtij qëndrimi të saj, nuk bëri asnjë hap përpara: edhe pse „kontesti“, ngandongjëherë, është lënë në një anë, kjo lënie ka qenë vetëm e „përkohshme“, sepse deri tash asnjëherë nuk është hequr nga „rendi i ditës“.

5.11 Fakti se kontesti lidhur me emërtimin e Maqedonisë asnjëherë nuk është hequr nga „rendi i ditës“ u dëshmuua edhe gjatë gjysmës së parë të viti 2008, në vigjilje të Samitit të Bukureshtit. Greqia, në fakt, para se të mbahej Samiti i NATO-s, e shfrytëzoi Bukureshtin që të „ringjallë“ qëndrimin e saj, të cilin pas Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 nuk e kishte theksuar ndonjëherë.

Por, kësaj radhe, Greqia tregoi vendosmëri që çështjen e mosnjohjes së emrit të Maqedonisë ta ashpërojë aq sa, së paku, përkohësisht të pengojë anëtarësimin e saj në NATO, apo aq sa, së paku, seriozisht të ngadalësojë këtë proces. „Shkupi ka vetëm një rrugë deri në NATO dhe në Bashkësinë Evropiane – të respektojë parimin e ndërtimit dhe të zhvillimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, gjë kjo që nënkupton edhe veprimin e përbashkët për gjetjen e zgjidhjes për emrin që do të jetë i pranueshëm për të dy palët“, deklaroi zonja Dora Bakojani, Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë, fill pas takimit me zonjën Kondoliza Rais, Sekretaren e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga mesi i muajit shkurt të vitit 2008. Zonja Bakojani, madje, kishte edhe vërejtje serioze lidhur me shkallën e përgatitjes së Maqedonisë për anëtarësim në NATO, pasi që, sipas saj, „Shkupi ndjek një politikë nacionaliste, një politikë anakronike dhe bën përpjekje që të monopolizojë identitetin maqedon... Këtu nuk është fjala për psikologji politike dhe ndjenja të masës, fjala është për stabilitet rajonal“, theksoi ajo¹⁴.

5.12 Maqedonia pas kësaj, si në planin politik, ashtu edhe në planin juridik, e kundërshtoi energjikisht qëndrimin e Greqisë. Kështu, me qëllim që të eliminojë çdo dyshim të mundshëm se emri „Republika e Maqedonisë“ mund të aludojë, të sugjerojë ndonjë pretendë territoriale ndaj Greqisë, bëri në Kushtetutën e saj një ndryshim thelbësor: Më 10 janar 1992, me Amendamentin I, parashikoi, citojmë: „Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje“, dhe se „Kufijtë e Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohen vetëm në përputhshmëri me Kushtetutën, në pajtim me parimin e vullnetit të lirë dhe në pajtim me normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare“¹⁵.

Maqedonia, madje, konsideron se Greqia, me Marrëveshjen e Përkohshme, të vitit 1995, është obliguar që të mos pengojë integrimin e Maqedonisë në organizata dhe shoqata ndërkombëtare në të cilat vetë Greqia, tashmë, është anëtare dhe si e tillë, në përputhshmëri me aktet përkatëse mbi organizimin e brendshëm të tyre, ajo gëzon të drejtën e vetos. Këtë qëndrim Maqedonia e mbështet në dispozitën e nenit 11 të Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995. Maqedonia edhe sot konsideron se, mbështetur

¹⁴ VOA/News, „Rruga deri në NATO dhe BE çon nëpër zgjidhje bashkërisht të pranueshme për emrin“, Uashington, 14.02.2008.

¹⁵ Për tekstin integral të Amendamentit I në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, shih: Ustav na Republika Makedonija, So amandmanite na Ustav I – XVIII, Skopje, 2002.

në këtë dispoozitë, Greqia ka hequr dorë nga pëdorimi i së drejtës se vetos edhe për sa i përket anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe në Bashkësinë Evropiane.

5.13 Ecuria e ngjarjeve, pas anëtarësimit të Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, tregoi se edhe Kombet e Bashkuara, të nxitura nga situata e krijuar pas Samitit të NATO-s në Bukuresht, janë të përcaktuara që palëve në kontest t' u ndihmohet që sa më parë të vijnë te një zgjidhje për emrin, që para së gjithash do të ishte e pranueshme për të dy palët. Për këtë qëllim, para Kombeve të Bashkuara, u emërua emisari Nimic, i cili, me ekipin e tij teknik dhe këshilldhënës, edhe më tutje po bën përpjekje intensive dhe kreative me qëllim që, sa më tepër, të afrohen pozicionet e palëve në kontest. Në këtë mënyrë, konsiderohet se, palët në kontest do të vijnë deri te një zgjidhje „ndërkombëtarish të pranueshme“ për emrin, zgjidhje kjo që do të ishte e pranueshme – „për të gjithë“. Brendapërbrenda „ekipit teknik dhe këshilldhënës“ të Përfaqësuesit të Kombeve të Bashkuara Nimic, po përpunohen me kujdes të posaçëm të gjitha variantat e mundshme të emrit për Maqedoninë. Secila nga zgjidhjet e mundshme, po trajtohet me kujdes të posaçëm dhe, po ashtu, me kujdes të posaçëm po përcillen edhe idetë e shumta dhe propozimet e mundshme konkrete; veçmas po përcillen dhe po shqyrtohen me vëmendje të gjitha argumentet për dhe kundër.

5.14 Mirëpo, pasi që ky proces i bisedimeve lidhur me emrin e Maqedonisë po zgjat tash e shumë vjet më parë¹⁶ dhe, nëse kihet parasysh edhe fakti se çështja e anëtarësimit të Maqedonisë në Kombet e Bashkuara tashmë ka përfunduar, konsiderohet e domosdoshme që lidhur me gjetjen e zgjidhjes dhe saktësimin e emrit „ndërkombëtarish“ të pranueshëm për Maqedoninë, përpjekjet ndërkombëtare të zgjerohen ashtu që në funksion të ndërmjetësimit të angazhohen edhe organet kyçe të NATO-s dhe të Bashkësisë Evropiane. Konsiderohet e nevojshme, po ashtu, që duke pasur parasysh faktin se Maqedonia dhe këto dy institucione me rëndësi të madhe ndërkombëtare (NATO-ja dhe Bashkësia Evropiane), në bashkëpunimin e tyre të deritashëm reciprok, kanë bërë deri tani shumë përpjekje që të gjitha format e mundshme të bashkëpunimit – të përparohen dhe që të gjitha marrëveshjet e harmonizuara – me konsekuencë të implementohen. Kështu, Maqedonia dhe Bashkësia Evropiane tashmë qenësisht kanë ecur përpara në realizim të procesit të stabilizim-asociimit, kurse me NATO-n, tashmë, qenësisht kanë ecur përpara në realizimin e qëllimeve dhe të parimeve kryesore nga programi „Partneriteti për paqë“.

6. NË VEND TË KONKLuzionIT

6.1 Është i qartë fakti se Maqedonia, që nga paraqitja e saj në skenën ndërkombëtare, është ballafaquar me një vështirësi të papritur, e cila në vazhdimësi ngadalëson proceset e integritit të saj në organe, organizata, dhe institucione ndërkombëtare. Kjo vështirësi gjen shprehjen në një pretendencë dikur latente e sot haptazi të shfaqur të fqijut të saj jugor, Greqisë, që shtetit të posakrijuar në trollin e ish-RSFJ-së, Maqedonisë, dikur ish-njësisë së saj federale (1944-1991) e sot – shtetit të pavarur dhe sovran (prej vitit 1991), të mos i lejohet emërtimi – Maqedoni, emërtim ky të cilin kjo e ka zgjedhur dhe me të cilin sot, tashmë, është e njohur në pjesën më të madhe të globit tokësor.

6.2 Këtë pretendencë të fqijut të saj, Greqisë, Maqedonia po e përjeton me vështirësi. **Sepse, emri i saj – Republika e Maqedonisë, përderisa kjo ishte njësi federale e ish-**

¹⁶ Pas konsultimeve (më 21.08.2008 në Shkup dhe më 22.08.2008 në Selanik), në të cilat mori pjesë përfaqësuesi i Greqisë (Adamantios Vasilakis) dhe i Maqedonisë, ndërmjetësi ndërkombëtar – mediatori, përfaqësuesi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara Metju Nimic (Matthew Nimitz) vlerësoi se ende ka kohë deri sa të formulohet propozimi konkret, që do të çojë deri te zgjidhja e kontestit. Mirëpo, „Maqedonia dhe Greqia kanë shfaqur përcaktimin e tyre që këtë kontest ta zgjidhin“, deklaroi Nimic pas këtyre konsultimeve.

Vlerësohet se këto biseda, sadopak, kanë sjellë më tepër kthjelltësi: secila palë në kontest, lidhur me faktin se cilat nga ato zgjidhje të mundshme të emrit mund të pranohen dhe cilat janë ato të cilat nuk mund të pranohen, ka qenë e qartë dhe e padyshimtë. Megjithatë, edhe ky deklaram nuk ofroi bazë të mjaftueshme që të hartohet një propozim definitiv. Sepse, siç konkludoi Nimic, në këto biseda u ngriten shumë çështje, si aso të natyrës periferike, pastaj aso me relevancë më pak të rëndësishme dhe aso që kishin rëndësi dhe ndikim më të madh për formësim definitiv të propozimit për emrin e Maqedonisë.

Përfaqësuesi Grek (Adamantios Vasilakis) në këto bisedime, veçmas theksoi se, tani për tani, bisedat po zhvillohen ngadalë por se që të dy palët kanë treguar vullnet të mire dhe durim që të zgjidhet çështja e emrit të Maqedonisë.

Burimi: shtypsi ditor, dt. 22.08.2008.

RSFJ-së, nga aspekti i marrëdhënieve dhe i të drejtës ndërkombëtare, asnjëherë nuk u paraqit si ndonjë pengesë e natyrës serioze në rrugën e realizimit të qëllimeve dhe interesave të saj në cilëndo fushë të bashkëpunimit ndërkombëtar: ekonomike, kulturore, madje edhe politike.

Mirëpo, këtij rrugëtimi të „pa brenga“ të Maqedonisë në botë dhe zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në të gjitha fushat e jetës, deri sa kjo ishte njësi federale e RSFJ-së, i erdhi fundi fill pas shpalljes së pavarësisë dhe sovranitetit të saj: Greqia ndaj Maqedonisë, energjikisht, ushtron kërkesë që kjo të ndërrojë emrin e saj kushtetues duke ia bërë me dije se, po qe se nuk vepron kështu, pra po qe se emrin nuk e ndërrojnë – nuk do të mund të llogarisë se do të mund të anëtarësohet në Kombet e Bashkuara (çështje kjo e cila tashmë është zgjidhur me emërtim të përkohshëm të Maqedonisë), e as në Bashkësinë Evropiane (në ç’ drejtim janë bërë tashmë përgatitje të mëdha) e as në Aleancën Veriatlantike (gjë kjo që u shtrua në fillim të vitit 2008 dhe që, me vepërimin konkret të Greqisë, u vërtetua në mënyrë të padyshimtë) dhe, madje, as në organet, organizatat, institucionet, shoqatat dhe organizmat e shumtë ndërkombëtarë, në të cilët anëtarësinë e sajojnë vetëm shtetet e pavarura dhe sovrane.

6.3 Çështja e emrit të Maqedonisë, tashmë sa vjet, tejkaloi suazat e një kontesti reciprok, bilateral midis Greqisë dhe Maqedonisë; që nga koha e pranimit të Maqedonisë në Kombet e Bashkuara, kontesti u zgjerua dhe sot, për zgjidhjen e tij ka treguar interesim shumë të gjallë e tërë bashkësinë ndërkombëtare. Kur Maqedonia parashtrroi kërkesën për pranim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, bashkësinë ndërkombëtare mëson për kontestin e ngritur, pasi që Greqia ngre këtë kontest mu para Kombeve të Bashkuara, saktësisht – para Këshillit të Sigurimit. Qysh atëherë janë bërë përpjekje që ky kontest të zgjidhet me kompromis. Mirëpo, me kompromis u zgjidh vetëm çështja e anëtarësimit të Maqedonisë në Kombet e Bashkuara, por jo me emërtim të saj kushtetues, po vetëm me emërtim të saj të përkohshëm: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (the former Yugoslav Republic of Macedonia).

6.4 Kështu, që nga kjo kohë, Maqedonia jeton me dy emra: me emërtim të saj kushtetues, i cili përdoret në raportet e brendshme, në komunikim brendapërbrenda sistemin të gjithmbarshëm politik, ekonomik dhe juridik – „Republika e Maqedonisë“. Mu me këtë emërtim, Maqedoninë sot e njeh një numër i madh shtetesh. Mirëpo, si subjekt ndërkombëtar, si subjekt politik ndërkombëtar dhe juridik – ndërkombëtar, (pos në shtetet të cilat atë e kanë njohur me emrin kushtetues) Maqedonia është e njohur si: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (the Former Yugoslav Republic of Macedonia). Po ky emërtim për Maqedoninë zbatohet pothuaj në të gjitha sferat e komunikimit dhe në të gjitha aktet ndërkombëtare në të cilat Maqedonia paraqitet në cilësi të subjektit përkatës. Kështu, Maqedonia është e emërtuar edhe në të gjitha traktatet dhe marrëveshjet, të cilat kjo i ka lidhur me bashkësitë ekonomike evropiane dhe me vetë Bashkësinë Evropiane dhe me Aleancën Veriatlantike – NATO-n.

6.5 Me theksimin e kërkesës për ndërrim të emrit, fatkeqësisht, në mënyrë të suksesshme Greqia Maqedonisë i ka shkaktuar vështirësi dhe probleme serioze jo vetëm në planin politik, edhe pse Maqedonia në këtë plan ka pësuar më së tepërmi probleme, por edhe në plan ekonomik, kulturor dhe në fusha të tjera të bashkëpunimit të saj me botën. Ndër këto, veçmas po theksojmë: problemet dhe vështirësitë e përjetuara gjatë procedurës së anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, gjatë anëtarësimit në organizata të tjera ndërkombëtare (pasi që në këto organizata Maqedonia është anëtarësuar me emrin e përkohshëm: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe tani – gjatë anëtarësimit në NATO.

6.6 Me qëllim që këto probleme dhe vështirësi thelbësisht të zvogëlohen, deri tash, periudhë kjo relativisht e gjatë që nga shpallja e pavarësisë, si në planin bilateral (midis Greqisë dhe Maqedonisë), ashtu edhe në planin multilateral, ndërkombëtar, janë bërë

përpjekje të rëndësishme që të zgjidhet ky kontest, i cili, para së gjithash, është kontest i natyrës politike dhe i cili, sipas të gjitha argumenteve të shfaqura deri sot, nuk ka ndonjë bazë materiale dhe juridike.

6.7 Angazhimi i Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet organit të tyre kolektiv (Komisionit) dhe individual (ndërmjetësit Nimic), pasi që dëgjoji të dy palët (Greqinë dhe Maqedoninë), propozoi shumë zgjidhje të mundshme. Mirëpo, palët në kontest – Maqedonia dhe Greqia, deri sot, nuk pranuan asnjërin prej tyre. Le të kemi parasysh se në tavolinë, ndër të tjera, janë edhe këto propozime, të cilat japin mundësi për përcaktim, respektivisht japin mundësi për ndonjë zgjidhje tjetër të kombinuar: Maqedonia Veriore, Maqedonia Demokratike, Maqedonia e Vardarit, Maqedonia e Epërme, Republika e Maqedonisë (Shkupi) dhe variante të tjera të shumëta të krijuara mbi bëto baza.

6.8 Konsiderojmë të pashmangshme domosdonë që, tani e tutje, të bëhen përpjekje që ky kontest, i cili ndoshta është i panatyrshëm, të zgjidhet – definitivisht. Konsiderojmë po ashtu se zgjidhja, e cila patjetër do të duhej të gjendet, do të jetë një zgjidhje politike e arritur mbi baza të kompromisit. Zgjidhjen, së pari, do të duhej ta kërkonin vetë palët e interesuara, Greqia dhe Maqedonia. Por, po qe se këto dy shtete, pasi që të parashtrajnë të gjitha argumentet e tyre, mbeten edhe më tutje në pozicionet e tyre, në ndihmë do të duhej që të vijnë, pos Kombeve të Bashkuara, të cilata tashmë janë të involvuara në këtë proces, vetë NATO-ja dhe Bashkësia Evropiane, nëpërmjet organeve përkatëse të tyre¹⁷.

Fundja, konsiderojmë se të gjitha këto subjekte ndërkombëtare, të cilat sot sajojnë boshtin e organizimit bashkëkohor të Bashkësisë Ndërkombëtare, janë ndër më kompetentet që të gjejnë, të propozojnë dhe palët në kontest t'i bëjnë vullnetmirë që të akceptojnë zgjidhjen e rekomanduar.

¹⁷ Sipas asaj që është pritur, zgjidhja e kontestit lidhur me emrimin e Maqedonisë është dashur që të arrihet deri në fund të vitit 2008, respektivisht – deri në fund të mandatit të presidentit të SHBA – Xhorxh Bush. Madje, ka pasur shpresa se ky kontest do të zgjidhet deri në fund të muajit shtator

Gordana Duvnjak

Gordana Duvnjak, Maqedoni, është gazetare politike në të përditshmen "Utrinski vesnik". Në mandat të dytë është kryetare e Këshillit Drejtues të Fondacionit Instituti Shoqëria e Hapur Maqedoni, ndërsa nga dhjetori 2010 është anëtare e Kuvebndit Koordinativ të Iniciativës Rekom për Maqedoninë.

Ka diplomuar Studimet Interdisiplinare të Gazetarisë në Shkup. Nga viti 1991 deri në vitin 1999 ka punuar gazetare në "Nova Makedonija". Ka marrë pjesë në shumë projekte lidhur me shoqëritë mulëtietnike



Gordana Duvnjak

Të falet, por të mos harrohet

Balkani ka traditë të gjatë për krijimin e miteve. Popujt të cilët jetojnë në këto hapësira, ndoshta shumë më tepër se të tjerët janë të prirur për krijimin e miteve dhe drejt politizimit të shkencës historike.

Kundrejt disa bindjeve se miti është kthim i disa ish fazave evolutive të botës njerëzore dhe se duhet shikuar në to vetëm si pjesë e folklorit, gjithnjë e më të shumta janë mendimet se "racionalizmi" dhe "iracionalizmi", janë vëllezër binjakë. Përveç se nuk është e lehtë të përcaktohet kur përfundon njëra gjendje dhe kur fillon tjetra, mendohet se kur bëhet fjalë për mitin, ato nuk janë opozitë e njëra tjetrës. Thonë se aftësia e racionalizimit nuk do të thotë edhe aftësi e demitologjisë. Kjo do të thotë se mitet jetojnë. Akoma janë të nevojshme për dikë dhe – vepronjë. Sipas një rregulli të pashkruar, me dekonstruktimin e një miti, lind tjetri. Prandaj nuk është çudi që disa mite qëndrojnë me shekuj, por ekziston edhe hapësirë për krijimin e miteve të reja, bashkëkohore. Historia më e largët dhe ajo më e afërt njohin shumë shembuj. A duhet të përmendim emra? Jo, faleminderit!

Në të gjitha shoqëritë post-jugosllave krimet e luftës të cilat i ka kryer pala tjetër rregullisht stërzmadhohen, ndërsa ato personalitativizohen.

Prandaj më tepër se kurdo është i nevojshëm ballafaqim i paanshëm me të kaluarën. Pasi që, periudha e këtyre kontribuon për shkatërrimin e stereotipeve dhe paragjykitimeve për të tjerët rreth nesh. Jep skemën e historisë nga perspektiva të ndryshme, i mënjanon mitet. Çon drejt deviktimit, faljes dhe pajtimit. Jep mundësi për shqyrtimin e njëkohshëm të fakteve. I përcakton shkaqet se pse ka ndodhur diçka. Jep mundësi për njohjen e pasojave, krijon bazë për kujtim të përbashkët. Dhe për pranimin e së vërtetës. Pasi që ajo di të ketë shumë fytyra. Disa janë shumë të shëmtuara dhe të deformuara.

Në të gjitha shoqëritë post-jugosllave krimet e luftës të cilat i ka kryer pala tjetër rregullisht stërzmadhohen, ndërsa ato personalet relativizohen. U bë praktikë e zakonshme të satanizohet pala tjetër, ndërsa ajo personalja të glorifikohet. Të stigmatizohen ata të cilët më herët kanë qenë fqinj, miq, pjesë e familjes dhe të përjetohen si armiq potencialë. Kultura politike dhe vetëdija që jetesa e përbashkët të ndërrohet me izolimin dhe ndërtimin e stereotipeve për ata të cilët nuk i takojnë bashkësisë së vet. Vuajtja të matet me numra, ndërsa viktimat të jenë të rëndësishme vetëm gjatë solemniteteve dhe ceremonive.

Gjatë luftërave, konflikteve, përlëshjeve të armatosura, e para goditet e vërteta. Pasi që më së lehti është të akuzohet dikush tjetër për vuajtjet personale, madje edhe për atë që nuk kemi përgjigje logjike. Apo, nuk dëshirojmë ta pranojmë...

Këto ditë po lexoj libër në të cilin janë grumbulluar dëshmi të banorëve nga Pakraci i Kroacisë. Në mesin e tyre edhe të njëfarë Vesne. E rritur në mjedis ku martesat e përziera janë shumë të shpeshta, në fillim të viteve nëntëdhjetë, ajo nuk mundej as të paramendonte se në një mjedis të këtyre heterogjen është e mundshme të vijë ndodhë lufta. Por, babai i saj ka përgjigje se si njeriu mund të përcaktohet. Kur mendon se këtë duhet patjetër ta bëjë. "Kur të fillojë lufta, secila anë e di cila është e tija!"

Por, cila është ana e vërtetë? A ka ndonjë të tillë.

A mund të paramendonte dikush se diçka e këtyre do të ndodhë edhe në Maqedoni? Dikush do të thotë, nëse mundej që një Bosnje multietnike t'i përjetojë ndodhitë më të përgjakshme dhe më dramatike, kjo është e mundur çdokund.

A dimë të japim përgjigje objektive dhe të paanshme për pyetjen se çka ndodhi në Maqedoni në vitin 2001?

Agresion i importuar i terroristëve nga Kosova të ndihmuar nga një pjesë e popullatës shqiptare, apo luftë për të drejta të njeriut e një bashkësie të pakënaqur etnike? A ishte ky tentim për rikomponimin e sovranitetit dhe integritetit shtetëror të vendit dhe për pushtimin e territoreve të huaja, ose mënyrë për përmirësimin e një padrejtësie historike dhe korrigjimin e gabimit të fabrikuar në Kushtetutë? A ishte dhe sa ishte e nevojshme të vijë deri te zëvendësimi i mjeteve politike me ushtarake, gjë që rezultoi me viktima të dy palët... Dhe në linjë të fundit, frustracion i thellë dhe besim i shkatërruar midis dy etnikumeve më të mëdha.

Edhe dhjetë vjet pas këtyre ngjarjeve të cilat në tërësi e ndërruan jo vetëm mënyrën e të menduarit dhe vetëdijen për funksionimin e shtetit të Maqedonisë, por edhe konceptin shtetëroro-juridik në Maqedoni, akoma ekzistojnë çështje të hapura, por edhe frikë që haptazi të flitet për njërin nga periudhat më dramatike në historinë më të re. Sepse, më thjesht dhe më lehtë është që punët të lihen të zhvillohen vetvetiu.

Me siguri, shumica edhe tani pyeten se pse ka nevojë pikërisht tani të hapet debat publik për vitin 2001? A ka ndonjë arsye të veçantë që nga fillimi të preken plagët e vjetra, kur ato akoma nuk janë shëruar. Edhe atë pikërisht tani kur e gjithë energjia politike dhe kreative duhet të drejtohet drejt reformave dhe zhblokimit të proceseve eurointegruese të Maqedonisë.

Nëpër dilemat e njëjta të ngjashme kalojnë të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë. Por, a mundemi të shkojmë përpara, pa u kthyer prapa.

„Të fal mundem, por të harroj assesi nuk mundem!”

Kjo fjali e shkurtër por shumë e sinjertë me ngarkesë të fuqishme emotive, duket se në mënyrën më të mirë të mundshme e shpreh esencën e idesë për ballafaqim rajonal me të kaluarën. Përmbahet në film dokumentar reklamues prej 15 minutave kushtuar pritjeve të REKOM-it. Autor i saj është një pjesëtar i shoqatës së veteranëve, i cili në lëkurën e vet i ka ndjerë tmerret e luftës ballkanike nga fillimi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Dhe prandaj po ndjehet i ftuar të flasë pasi që nuk janë të gjithë pjesëmarrësit në luftë kriminelë lufte. Dhe se shpesh njeriu në rrethana të këtilla të jashtëzakonshme, mund të gjendet në rol të dyfishtë – edhe vetë të jetë viktimë.

Por, ai nuk është i vetmi i cili pret shumë nga REKOM-i.

Gjatë muajve të ardhshëm kjo fjalë shpesh do të përmendet jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë në Ballkan. Shumica do të interesohen se çka fshihet pas këtij kalku pak të pazakonshëm. Në anën tjetër, ata të cilët do ta kuptojnë, do të pyeten pse pikërisht tani kanë nevojë për REKOM-in.

Për ata të cilët akoma nuk e dinë rëndësinë e këtij termi, ose e njohin në mënyrë të pacaktuar si edhe një kalk, duhet të thuhet se REKOM-i është shkurtësë nga Komisioni Rajonal (“Regionalna Komisija”).

Bëhet fjalë për iniciativë civile rajonale të krijuar në hapësirën e ish-Jugosllavisë që para tri viteve, qëllimi i së cilës është krijimi i komisionit ndërshtetëror për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës, si dhe për shkeljet tjera të të drejtave të njeriut nga konfliktet në rajon në periudhën midis 1991-2001. Maqedonia është e fundit nga vendet e shteteve të ish-Jugosllavisë e cila iu bashkëngjiti kësaj iniciative, në qershor të vitit 2010.

Iniciativa është realizuar nga ana e rrjetit të organizatave joqeveritare dhe individëve të bashkuar në Koalicionin për REKOM. Kjo iniciativë bashkon më shumë se një mijë grupe dhe individë nga shoqëria civile nga gjashtë ish-republikat jugosllave (Serbia, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Sllovenia dhe Maqedonia), si dhe nga Kosova. Nën shenjën e REKOM-it janë përfshirë shoqata të ndryshme dhe organizata të viktimize, grupe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veteranë, të burgosur, bashkësi religjioze, grupe femrash, bashkësi minorene, juristë, media... Target grup shumë i rëndësishëm janë të rinjtë, të cilët edhe pse nuk kanë përgjegjësi për politikat e gabuara në shtetet e tyre, megjithatë kanë interes të madh që kjo iniciativë të ketë sukses. Pasi që, siç thonë, dëshirojnë të jetojnë në “shtete normale” me leksione të mësuara nga e kaluara. Mu për këtë, të rinjtë do të jenë ata të cilët në shpinën e tyre do ta bartin fushatën për grumbullimin e një milion nënshkrimeve nga rajoni, që do të jetë mesazh i fuqishëm deri te elitat politike ta mbështesin dhe implementojnë këtë proces.

Iniciativa për herë të parë është promovuar më 9 maj 2008 në Podgoricë (Mal të Zi), në kuadër të debatit me përfaqësuesit e shoqatave të viktimize nga rajoni, ndërsa në lidhje me gjetjen e instrumenteve për dokumentimin dhe kumtimin e së vërtetës për të kaluarën.

Koalicioni është themeluar në tetor të vitit 2008 dhe deri më tani ka organizuar mbi 120 konsultime dhe shtatë forume internacionale, me grupe nga i gjithë rajoni, të cilët janë interesuar për mundësinë për formimin e një komisioni të këtyllë.

Rastësi ose jo, sivjet bëhen 20 vjet nga lufta e parë në Ballkan, ndërsa 10 nga konflikti i fundit në Maqedoni. Ai i cili beson në tezën se “rastësitë nuk ndodhin rastësisht” do të thotë se ka ndonjë simbolikë të fshehur në atë se pikërisht ky vit duhet të kalojë në shenjën e REKOM-it.

Në gjysmën e parë të këtij viti pritet të finalizohet dokumenti, i cili duhet të jetë bazë për formimin e komisionit rajonal. Projekt-Statuti, duhet të ketë fuqinë e marrëveshjes ndërkombëtare dhe duhet ta aprovojë parlamentet kombëtare të të shtatë vendeve nënshkruese. Teksti i statutit është konceptuar në bazë të përvojave nga rajoni, por edhe sipas shembullit të njëzet komisioneve për vërtetësi dhe për pajtim, të cilat kanë ekzistuar në shoqëri postkonfliktuale.

Por, për dallim nga komisionet e formuara në Argjentinë, Ugandë, Kil, Peru, Afrikën e Jugut, Siera Leone, Marok apo në vende të tjera, REKOM-i për shumë gjëra duhet të jetë unikat dhe komisioni i parë ndërkombëtar, i cili do të dallojë nga të tjerët edhe për faktin se nuk nisët nga e para. Pasi që do të marrë parasysh edhe gjykimet e deritanishme për krime lufte para Tribunalit të Hagës, si dhe gjykimet para gjykatave vendore, të cilat deri më tani ishin instrumenti i vetëm juridik për përcaktimin e përgjegjësisë individuale penale. Por duke e pasur parasysh se gjykimet janë në numër të vogël, ato nuk janë të mjaftueshme që të bëhet regjistrim dhe të dokumentohet ajo që me të vërtetë ka ndodhur në këto hapësira në dy dekadat e fundit.

Vlerësimet janë se rajonit i nevojitet një trup jashtëgjyqësor, në fokus të të cilit do të jenë viktimat. Trup, i cili do të ketë autoritet, fuqi dhe njohuri t'i verifikojë faktet për krimet e luftës, ndërsa të njëjtat të pranohen në të gjitha vendet post-jugosllave. Që të mos ndodhë në çdo 40-50 vjet në këto hapësira të ketë luftë të re. Secila më e përgjakur se tjetra. Dhuna të kthehet me dhunë. Ndërsa armët të ndërrohen me dialogun dhe mirëkuptimin. Secili popull ta ketë të vërtetën e vet. Sa popuj, aq të vërteta!

Dhe jo rastësisht, sepse Ballkani ka traditë të veten për krijimin e miteve. Në të gjitha shoqëritë post-jugosllave krimet e luftës të cilat i ka kryer pala tjetër rregullisht i stërzmadhon, ndërsa të vetat i relativizon. U bë praktikë e zakonshme të satanizohet pala tjetër, ndërsa ajo personale të glorifikohet. Të viktimizohen ata të cilët përjetohen si armiq potencialë. Kultura politike dhe vetëdija për bashkëjetesë të ndërrohet me izolimin dhe ndërtimin e stereotipave për ata të cilët nuk i takojnë bashkësisë së vet. Vuajtja të matet me numra, ndërsa viktimat të jenë të rëndësishme vetëm gjatë solemniteteve dhe ceremonive.

Ose, siç do të thotë me një rast Natasha Kandiç nga Fondi për të Drejtë Humanitare, e cila është njëra nga bartësit e këtij projekti, "kultura ballkanike gjithmonë dëshiron të flasë me fjalor politik, ndërsa pak po kujdeset për njerëzit dhe për vuajtjet e tyre".

A duhet përkujtuar bilancin e zi nga luftërat e fundit të Ballkanit, i cili është më shumë se mposhtës?

Numri i viktimave në luftërat e ish-Jugosllavisë nuk është preciz dhe sillet prej 130.000 deri 160.000 persona. Sipas Komitetit të Kryqit të Kuq ndërkombëtar, 14.790 persona rezultojnë të zhdukur. Jo zyrtarisht, spekulohet se ky numër është më i madh dhe është rreth 16.000 persona. Akoma nuk bëhet i ditur fati i 10.512 personave në Bosnjë e Hercegovinë. Saktë 1.842 persona rezultojnë të zhdukur në Kosovë. Në Kroaci edhe pas 20 viteve, gjurmohet pas 1.859 personave. Serbia nuk ka të zhdukur në territorin e vet, ndërsa numrat të cilat kanë të bëjnë me qytetarët e saj janë në kuadër të të zhdukurve në Kosovë, BeH dhe Kroaci. Në Maqedoni si të zhdukur rezultojnë 12 maqedonas të rrëmbyer në vitin 2011. Pjesërisht është ndriçuar rasti i katër të rrëmbyerve, trupat e të cilëve u zhvarrosën në Neproshten. Nuk dihet as fati i 6 shqiptarëve të zhdukur. Me vite familjet e këtyre personave shkojnë nga njëri kabinet në tjetrin, nga një organizatë ndërkombëtare në tjetrën, në kërkim të informacioneve për familjarët e tyre.

Mu për këto arsye, shumica shansin e tyre më të madh e shohin në REKOM. I cili duhet të paraqesë një lloj përgjigjeje lokale në kërkesën në rrugë drejt së ardhmes, që të mos përsëriten krimet. Por, edhe një lloj udhërrëfyesi për shpresë, forca e të cilit del pikërisht nga qasja rajonale.

Besohet se REKOM-i do të mund të parandalojë që në opinion të nxirren të pavërteta për ngjarje të caktuara, ose, nëse ato veçmë janë nxjerrë, të bëhen – jokredibile. Se do të arrijë në mënyrë efikase të ndërtojë platformë që të dëgjohet zëri i viktimave dhe me ndihmën e tyre të nxitet në opinion ngushëllim, respektim dhe solidaritet.

Procesi për formimin e Komisionit rajonal duhet të fillojë gjashtë muaj pasi që Parlamenti i fundit ta votojë Statutin. Selia e REKOM-it planifikohet të jetë në Sarajevë. Zgjedhja nuk është e rastësishme, pasi që Bosnjë e Hercegovina është vend në të cilin u zhvilluan ngjarjet më të përgjakshme nga konfliktet e luftës dhe pati shumë viktima. Pikërisht për këtë madje pesë nga 20 anëtarët e REKOM-it do të zgjedhen nga Bosnjë e Hercegovina. Nga tre anëtarë do të zgjedhen nga Serbia, Kroacia dhe Kosova, ndërsa nga dy nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia. Anëtarët do të zgjedhen me procedure të shumë precise, e cila njëkohësisht do të zbatohet në të gjitha vendet. Kujdes i veçantë duhet në zgjedhjen e kandidatëve, të cilët kërkohet të jenë personalitete pa njolla në karrierë. Me kualitete të larta morale, prestigj dhe integritet, të përkushtuar tolerancës, dialogut dhe zgjidhjes konstruktive të problemeve. Kjo për shkak se nga cilësia e personave të zgjedhur dhe përkushtimi i tyre, i cili duhet të lirohet nga presionet nacionale, do të varet kredibiliteti i REKOM-it. Zyrat kombëtare do të hapen në të shtatë vendet nënshkruese, të cilat në mënyrë aktive do të bashkëpunojnë me zyrën qendrore në Sarajevë.

Mandati i Komisionit do të zgjasë tri vjet, me mundësi për gjashtë muaj shtesë. Kjo periudhë kohore vlerësohet si optimale, pasi që në është kornizat e përvojave nga komisionet e tjera të ngjashme. Argument shtesë për limitimin e mandatit është edhe ajo se nuk guxon të kalojë periudhë më e gjatë nga veprimet ushtarake, që të mos ndodhë që një numër i madh i viktimave të mos munden të dëshmojnë.

Qëllimet kryesore të Komisionit do të jenë përcaktimi i fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të drejtave të njeriut në territorin e ish-RSFJ-së në periudhë prej 1 janarit 1991 deri më 31 dhjetor 2001. REKOM do të angazhohet edhe që të njihen padrejtësitë që u janë shkaktuar viktimave, të kontribuojë për realizimin e të drejtave të tyre. Në listën e qëllimeve të tij janë që t'i shtyjë elitat politike t'i pranojnë faktet, të kontribuojë për ndriçimin e fatit të të zhdukurve, të ndihmojë në parandalimin e përsëritjes së krimeve të luftës.

Ky trup jashtëgjyqësor do të ketë për detyrë që të bëjë edhe biseda informative publike të viktimave, por edhe të gjithë atyre të cilët kanë nevojë dhe dëshirojnë të nxjerrin fakte të panjohura. Në mandatin e REKOM-it do të jetë edhe përpilimi i regjistrit të të gjitha viktimave, qofshin ato nga radhët e civilëve apo të ushtrive. Ai do të jetë një lloj i trupit hetues i cili do të mund të grumbullojë dëshmi për atë se në cilën mënyrë disa institucione, të caktuara në mënyrë individuale apo në grup, kanë bërë lëshim në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Të gjitha këto prova të cilat do të kontrollohen në mënyrë precize dhe të cilat do të dokumentohen, do të gjejnë vendin e tyre në raportin final, i cili do të vendoset për shqyrtim në parlamentet e të gjitha vendeve.

Në Maqedoni akoma nuk është hapur debat rreth nevojës dhe qëllimeve të REKOM-it. Që nuk duhet edhe të na habisë, duke e pasur parasysh faktin se Maqedonia e fundit iu bashkua iniciativës. Për dallim nga Kroacia dhe Serbia, ku presidentët Ivo Josipović dhe Boris Tadić, hapur dhanë mbështetje për këtë iniciativë, elitat politike të Maqedonisë tani për tani heshtin. Duam të besojmë se nuk është në pyetje ndonjë rezistencë, por ajo që REKOM-i akoma është anonim në hapësirat tona.

Por kjo nuk është rast me diplomacitë evropiane të cilët me vëmendje të madhe po e ndjekin gjithë atë që po ndodh rreth REKOM-it.

Ambasadori Ervan Fuere, shef i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, në seminarin e 75-të Rose Roth të mbajtur në Shkup më 19-21 tetor 2010, në fjalimin e tij do ta përmendë edhe iniciativën për REKOM-in.

“Cilido proces i pajtimit do të jetë i suksesshëm vetëm nëse në të përfshihen të gjitha pjesët e shoqërive në rajon. Iniciativa e vendosur para do kohë për REKOM-in është rrjet i organizatave të shoqërisë civile dhe i individëve, të cilat angazhohen për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut. Ajo insiston ta promovojë procesin e integritit evropian në Ballkan si projekt paqësor dhe ka për qëllim sundimin e së drejtës në rajon”

Seminari i cili është i njohur si Rose Roth, është pjesë e programit me po të njëjtin emër të cilin e udhëheq kuvendi parlamentar i NATO-s. Është një program në bashkëpunim me KP NATO me parlamentet e shteteve nga Evropa Qendrore dhe Lindore, të cilët viteve të fundit merren kryesisht me çështjet lidhur me Ballkanin dhe çështjet e sigurisë në rajon. Inkurajim i madh për Koalicionin për REKOM-in vjen nga bashkësia ndërkombëtare e cila ka mirëkuptim të madh për rëndësinë e këtij procesi. Mbështetje tashmë kanë dhënë Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, të cilët i ftojnë vendet e rajonit të angazhohen në këtë proces.

Shumë nga këto hapësira ende janë të ndjeshme me të përmendur fjalën “pajtim”. Konsiderojnë se kjo nuk duhet të jetë mision i REKOM-it, sepse pajtimin e përjetojnë si akt personal dhe individual, të cilin çdonjëri duhet ta zbatojë në mënyrën e vet. Megjithatë, nuk duhet të lihet pas dore fakti se, nëse ka sukses ideja për REKOM-in, në mënyrë siç janë projektuar qëllimet dhe detyrat e tij, në mënyrë të pashmangshme do të vijë deri te hapja e këtij procesi.


Por, çështja kryesore do të jetë, si të kryhet presion pozitiv ndaj qeverive që ta pranojnë dhe zbatojnë këtë projekt me një rëndësi të madhe për rajonin. Dilema kryesore është se çfarë do të ndodhë nëse disa vende nuk bien dakord për të të vëmë nënshkrimin në këtë akt ndërshtetëror. Sepse, vetëm me valorizimin e vullnetit pozitiv të autoriteteve, REKOM-i mund të marrë legjitimitet të fortë dhe do të pranohet mandati i tij. Por, për më tepër për shkak se suksesi i REKOM-it në masë të madhe do të varet edhe nga bashkëpunimi i organeve kompetente në vendet anëtare, por edhe nga mbështetja e tyre financiare. Janë të mundshme rezistenca nga më shumë anë, sepse nuk përjashtohet se ky Komision do t'i rrezikojë interesat e disave, të cilët udhëhiqen nga nevoja që punët të mbeten ashtu siç janë dhe të mos ndryshojnë. Por, më me rëndësi është që fuqia e kësaj iniciative shqyrtohet “nga brenda” dhe nga ata të cilët kanë nevojë më së shumti. Argumenti kryesor bindës, i cili duhet të jetë udhëheqës në këtë proces, është se askush nuk duhet të qëndrojë anash. Sepse, në këtë mënyrë do të bëhet një padrejtësi e madhe qytetëruese – për veten e tyre dhe për gjeneratat e ardhshme. Dhe një luks të këtyllë, rrallë ndonjë qeveri e botës mund ta tolerojë.



Intervistë

**Sh. T. Amb. Ervan Fuere, Përfaqësues Special i BE-së dhe
Shef i Delegacionit të BE-së**

**Shembuj,
vlerat
morale dhe
kultura
politike...
Vështrim personal**





Sh.T. Ambasadori Ervan Fuere (1946), Irlandë, diplomat profesional i Bashkimit Evropian. Shef i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, paraprakisht në Slloveni, Afrikën e Jugut dhe Meksikë. Ka diplomuar të Drejtën Civile, 1967, dhe Juridkun, 1968, në Universitetin e Dublinit, ka diplomën e Studimeve Evropiane të Institutit Evropian në Nicë, 1969 dhe postdiplomë të asistentit për hulumtime në Institutin Maks Konstam në Bruksel, 1970-72. Ka marrë Çmimin e Rendit të Shpresës së Mirë, Oficer i Lartë nga Presidenti jugafrikan Nelson Mandela (1998).

Intervistë: Sh. T. Amb. Ervan Fuere, Përfaqësues Special i BE-së dhe Shef i Delegacionit të BE-së

Shembuj, vlerat morale dhe kultura politike... Vështrim personal



Ambasadori Ervan Fuere ishte njëri nga frymëzuesit kryesorë të projektit tonë për kulturë politike dhe dialog nga i cili rezulton kjo revistë, në bazë të bisedave tona prej para më se një viti. Si një nga diplomatët më markantë dhe më harizmatikë që ka shkelur në Maqedoni nga apavaresimi i saj, njeri që iu përkushtua misionit të tij këtu, ai e vizitoi çdo pëllëmbë të këtij vendi, dëgjoi dhe bisedoi me njerëz të panumrt. Te shumëkush i popullarizuar dhe kontrovers për disa, ai bëri dallim gjatë mandatit të tij. Kjo intervistë koincidon me kohë tejet të vështira për demokracinë maqedonase, me mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit special të BE-së dhe me startin e këtij publikacioni të përgatitur gjatë kohë.

Në fund të takimit tonë ai na tha se do të dalë në pension. Është e vështirë të besohet një gjë e tillë. Jemi të bindur se do ta shohim në aksion edhe për shumë vite.

INTERES Nëse nuk ka dialog atëherë nuk ka as besim mes bashkësive të ndryshme dhe në atë rast kurrësi nuk mund të shkoni përpara. Në rast të këtillë vazhdimisht shpenzohet energjia në tentativë që të mbrohen interesat personale, ndërsa interesi më i gjerë i shoqërisë është tërësisht i neglizhuar

ZGJIDHJE¹: Cili është definicioni Juaj për kulturën politike?

Ervan Fuere: Definicioni më i mirë për kulturën politike është me siguri ai të cilin e mësova në Afrikën e Jugut, vendin në të cilin sundonte sistemi i aparteidit, ku një pjesë e stërmadhe e popullatës ishte e privuar nga të drejtat elementare njerëzore. Atje ishte një lider, Nelson Mandela, i cili kalo në burg 27 vjet dhe i cili, kur u lirua, vendosi dialog politik me armiqtë e tij politikë, pikërisht me ata që e mbajtën në burg. Kjo për mua ishte shembull i shkëlqyer për autoritet moral me vlera më të larta, e kjo shumë shpesh mungon në shoqëritë tona. Sidomos në ato post-konfliktuale, siç është Maqedonia, ku ka komunitete të ndryshme etnike, interesa të ndryshëm politikë, por ku, megjithatë, ekziston një qëllim që e bashkon gjithë vendin – e ai është që të bëhet pjesë e familjes evropiane. Por, për fat të keq, këtu nuk ekziston kultura e dialogut.



Pra, ky është një dimension i kulturës politike me rëndësi të veçantë, sepse nëse nuk ekziston dialogu atëherë nuk ekziston as besimi mes komuniteteve të ndryshme dhe në atë rast kurrsesi nuk mund të shkoni përpara. Në rast të këtillë vazhdimisht shpenzohet energjia në tentativë që të mbrohen interesat personale, ndërsa interesi më i gjerë i shoqërisë është tërësisht i neglizhuar. Për shkak të kësaj ne gjithmonë jemi angazhuar fuqimisht për vlefshmërinë e dialogut në procesin e përforcimit të institucioneve politike dhe arritjen e konsensusit politik.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e kulturës politike, ka të bëjë me ligjet dhe implementimin e tyre, sidomos të atyre që i përkasin mekanizmave për mbisundim në shoqëri, si për shembull – antidiskriminimi. Si të siguroheni se të gjitha metodat aplikuese kundër njerëzve, në bazë të handicapit, përkatësisë etnike dhe religjioze, orientimit seksual..., në praktikë nuk do të ndodhin? Për këtë ekzistojnë ligjet evropiane në nivel të Bashkimit Evropian dhe obligim i të gjitha vendeve-anëtare, si dhe i atyre që dëshirojnë të bëhen anëtare, është që t'i miratojnë këto ligje dhe të njëjtat t'i implementojnë.

Do të thotë se këto janë vlera, të cilat në disa vende do të miratohen, por në të tjera, për fat të keq – për shkaqe historike ose të tjera, duhet të definohen me ligje, në të

¹ Intervistën e bënë: Xhahir M. Deralla, Harald Shenker, Ilir Ajdini dhe Xveydan Georgievski; Foto: Gjorgje Popoviq

cilat më vonë duhet të kryhet monitorim efektiv i implementimit. Edhe një aspekt i rëndësishëm për mua nga sfera e kulturës politike politike, sipas meje, është se asgjë

DIALOG Për mua aspekti më i rëndësishëm i kulturës politike është mënyra se si funksionojnë institucionet demokratike, siç është parlamenti. Në atë kontekst, për ekzistimin e një parlamenti funksional dialogu është absolutisht thelbësor. Nëse nuk ka dialog mes liderëve të partive politike – flas konkretisht për Maqedoninë – atëherë, nuk ekziston proces i rregullt, funksional dhe demokratik në parlament

s'është e pakthyeshme. Për këtë isha dëshmitar në BE, por sidomos në Ballkan. Madje edhe sikur të keni rregulla, korniza të vendosura dhe të gjithë këto, gjithmonë ekziston rrezik, nëse mekanizmi hierarkik nuk është mjaft i fuqishëm, kur në pushtet do të vijë një qeveri tjetër, do të vendosë gjithçka në pikëpyetje edhe atë në mënyrën, e cila do të kundërshtohet vlerat themelore.

Për shembull, keni ligje që kanë të bëjnë me mediat, të cilat gjithsesi janë të ndryshueshme, por megjithatë ekzistojnë disa parime dhe vlera kryesore që janë permanente për shoqëritë në BE, si për shembull respektimi i pavarësisë së mediave, që është pjesë kryesore e proceseve demokratike. Kështu, në Hungari kemi ligj të ri që synon ta kufizojë lirinë e mediave dhe i cili është vënë në pikëpyetje nga institucionet e BE-së, ndërsa edhe një numër i madh i liderëve e kanë shprehur shqetësimin e tyre. Do të thotë, kemi shoqëri e cila ka bërë zhvendosje të proceseve të mëparshme komuniste deri në post-neo procese dhe tani synon që të kthehet drejt atyre praktikave të mëparshme. Domethënë, duhet të përforcohen mekanizmat hierarkikë në strukturat për propozim dhe miratim.

Megjithatë, për mua aspekti më i rëndësishëm i kulturës politike është mënyra se si funksionojnë institucionet demokratike, siç është parlamenti. Në atë kontekst, për ekzistimin e një parlamenti funksional, dialogu është absolutisht thelbësor. Derisa nuk ka dialog mes liderëve të partive politike – flas konkretisht për Maqedoninë – atëherë, nuk ekziston procesi i rregullt, funksional dhe demokratik në parlament. Gjithsesi, që të ekzistojë dialogu i drejtë, Qeveria është ajo që duhet të ecë përpara në plan të parë, të tregojë transparencë... shkallë e caktuar e shpirtmirësisë duhet të demonstronhet nga garnitura qeveritare. Vetëm pse ajo ka shumicë absolute nuk do të thotë se mund ta injorojë opozitën. Përkundrazi, ajo ka përgjegjësi të shtrijë dorë drejt opozitës dhe të krijojë kushte lehtësuese për ndërtimin e konsensusit. Kjo është diçka që mungon viteve të fundit, sidomos te kjo Qeveri. Do të merrja vetëm një shembull, me rrezikun që të kritikohem si i njëanshëm, por kjo për mua ishte mjaft domethënëse. Unë erdha në Maqedoni në nëntor të vitit 2005. Në vitin 2006 Parlamenti debatonte për ligjin e zgjedhjeve dhe revizionin e të njëjtit. Në kohën kur PDSH-ja e bojkotonte parlamentin, kryeministri i atëhershëm udhëtoi për në Tetovë me propozim-ligjin, në tentim që ta bindte PDSH-në që ta pranojë dhe ta inkurajojë konsensusin. Ky për mua ka qenë shembull i tentativës për promovim të konsensusit në rast të një ligji shumë specifik, ndërsa shembuj të këtillë që atëherë nuk kam parë shumë.

ZGJIDHJE: E përmendët Republikën e Afrikës së Jugut. Unë kam qenë atje në një qëndrim studiues dhe dua të ndaj me Ju një impresion. Ajo që më mahniti atje, ishte optimizmi i atij populli pas rrëzimit të aparteidit dhe besimi i tyre se atë që e bëjnë autoritetet është për të mirën e të gjithëve. Për shembull, ju e dini me siguri, atje të gjithë edhe taksistët, shoferët, shitësit, e kishin në xhep

kushtetutën vendit. Dhe të gjithë na tregonin dhe na thoshin se, ja, këtu shkruan se edhe ju jeni qytetarë tanët...

Ervan Fuere: Po, ata ishin shumë krenarë para se gjithash për shkak të personit me të cilin identifikoheshin, për shkak të Nelson Mandelës, i cili me të vërtetë tregoi se përkundër historisë së ndarjes, ata mund të bashkohen dhe në një mënyrë ky ishte shembull i çuditshëm, i shkëlqyer për atë se si pajtimi mund të funksionojë. Por, nevojiten liderë që me të vërtetë do ta udhëheqin këtë proces. Ai vetë nuk do të funksionojë. Ai proces duhet të vlerësohet dhe të kultivohet.

ZGJIDHJE: A ka te ne liderë të tillë?

Ervan Fuere: Për fat të keq mendoj se jo vetëm në Maqedoni, por edhe në vende të tjera, mungon lidhshipi, mungojnë njerëz, të cilët kanë guxim dhe vizion, si Vaclav Havel për shembull, i cili përkundër gjasave të këqija, me të vërtetë arriti ta nxjerë vendin nga kohët e këqija. Ngjashëm edhe në Irlandën Veriore, arritëm marrëveshje paqësore, e cila ishte shumë e dhembshme, sepse jemi shembulli i vetëm në kohën moderne, në të cilin ne u tërhoqëm – Irlanda hoqi dorë nga një pjesë e territorit të vet, Irlanda Veriore, dhe duhej ta ndërromim kushtetutën, ta pranojmë atë dhe e gjithë kjo me qëllim që të pajtohemi me Britaninë. Ky ishte guximi dhe lidhshipi i udhëheqësve, që mundësuan paqe afatgjatë në ishujt. Në anën tjetër keni model tjetër si shembull, si Nënë Tereza, e cila ngjallte te njerëzit ndjenjë për vlera morale, me veprën e saj vet-



jake, me shembullin vetjak. Këto janë tipe të njerëzve që frymëzojnë dhe mendoj se e theksojnë faktin se shoqëria jonë nuk është e formuar nga makina dhe mekanizma, por nga njerëzit. Ne me të vërtetë mund të bëjmë diçka të veçantë.

ZGJIDHJE: Ekziston kontradiktë mes realitetit të shoqërisë dhe realitetit të legjislativës. Mund t'i keni ligjet më të mira, por derisa shoqëria nuk është e aftë t'i zbatojë dhe t'i mbështesë, atë proces mund ta përsëritni shumë herë, me çdo qeveri të re. Ju keni pasur përvojë të këtillë në Afrikën e Jugut dhe gjithashtu, paraprakisht në jetën Tuaj, jeni përballur me lloj-lloj variacionesh të kulturës politike. A mund të bëni krahasim?

Ervan Fuere: Po. Shembull më të thjeshtë e kam Slloveninë. Unë isha atje kur i përgatisnin dhe finalizonin negociatat për inkuadrim në BE dhe ajo që më habiti ishte se – mbisundonte konsensusi. Ajo kishte të bënte me faktin se liderët me të vërtetë e zhvillonin procesin dhe kishin administratë publike profesionale, që ishte shumë e respektuar. Kryenegociatori, i cili tani është komisar, z. Patoshnik, tregoi shembull të shkëlqyer për kyçjen e të gjithë faktorëve, vendosi dialog mjaft të drejtpërdrejtë



me ta dhe ishte shembull i shkëlqyer për krijimin e klimës së besimit mes të gjithë liderëve. Amerika Jugore gjithashtu kishte sfida të vetat, unë isha i ngarkuar për themelimin e misionit të parë të BE-së në Meksikë dhe Kubë, vende ku kishte probleme me të drejtat e njeriut dhe që akoma janë, si dhe probleme me refugjatët. Ligjet nuk mjaftonin, ne ishim të detyruar përmes insistimit të vazhdueshëm t'i bindim udhëheqësit rajonalë për domethënien dhe rëndësinë e të drejtave të refugjatëve dhe njëherit, duhej këtë ta bënim në terren, në vendngjarje. Më kujtohet një rast: kishte refugjatë nga komunitete të ndryshme që jetonin njëri pranë tjetrit. Njëra palë kishte qasje te uji, ndërsa të tjetra jo. Ata ziheshin mes vete, kështu që duhej aty për aty të zhvillojmë dialog dhe të gjejmë kompromis. Ndonjëherë nuk është fare e lehtë, por nëse vendosni besim mes aktorëve në atë dialog, atëherë gjithë detyra bëhet më e pranueshme.

Supozoj se pjesa më e madhe e këtyre veçorive ka rrënjë në fëmijërinë time, kur ishim refugjatë politikë nga lufta, të ballafaquar me probleme rreth të drejtave të njeriut dhe ishim të ushqyer me imperativin që gjithmonë të sigurohet respektim i denjë i të drejtave individuale njerëzore të refugjatëve politikë. Mendoj se një gjë e tillë të përcjell gjithë jetën. Njëkohësisht, mendoj se është shumë i rëndësishëm kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit, përmes dialogut.

Në këtë kuptim Afrika e Jugut sërish është një shembull i shkëlqyer, sepse kapaciteti i durimit i treguar nga liderët, si rrinin dhe i dëgjonin njerëzit me orë të tëra – ndërsa unë vizitova shumë fshatra, kishim projekte për ujë dhe aksione të ngjashme – kështu

FRIKË Vlerësoj se Maqedonia duhet të marrë shembull nga Sllovenia, sidomos në pikëpamje të zbatimit të bisedimeve. Duhet të silltet në mënyrë absolutisht ndryshe nga kjo tani, sepse me të vërtetë nuk bëhen përpjekje që të shtrihet dora drejt shoqërisë civile ose kjo bëhet në mënyrë shumë selektive, duke e krijuar këtë ndarje të tmerrshme që e kemi në shoqëri. E ajo e krijon këtë frikë, e cila është tërësisht jonatyrale, që është shumë për të të ardhur keq, sepse ka efekt mbi kontributin që qytetarët mund ta japin në shoqërinë civile dhe organizatat civile, në zhvillimin e shtetit

që fshatarët ishin ata që i drejtonin punët. Ne i dëgjonim problemet e tyre dhe gjenim zgjidhje, sepse të gjithë respektoheshin mes vete. E dini, nuk kishte arrogancë. Nëse vijmë liderët ose kryenegociatori dhe nuk dëgjojnë, kjo nuk ndihmon. Problem i madh me klimën politike këtu është ajo që liderët politikë, Qeveria, aspak nuk dëgjojnë. Ata kanë një qëndrim arrogant se çfarëdo që të bëjnë është e drejtë. Mendojnë se mund të bëjnë çfarëdo qoftë. Qoftë kjo teleferik me gondolë në Vodno ose bëhet fjalë për vendosjen e gjithë këtyre përmendoreve, ata kanë autoritet që këtë ta bëjnë, i kanë paratë dhe prandaj - do ta bëjnë, në vend që të mendojnë për hapje të debatit me qytetarët, ta mësojnë qëndrimin e opinionit për këto punë, a pajtohen apo jo, sidomos në vend i cili ka resurse të kufizuara. Do të thotë, në fund mendoj se gjithçka çon në dialog dhe respektim të kundërshtarëve politikë.

ZGJIDHJE: Përmendet se vini nga një familje, e cila ka qenë e përndjekur politikisht. A mund të na tregoni për ato ditë dhe në çfarë mënyrë ajo ka ndikuar në ardhmërinë Tuaj?

Ervan Fuere: Kuptohet. Unë kam lindur menjëherë pas Luftës, por babai im ka qenë aktiv në lëvizjen e bretonëve që të përfitojë vlerësim të të drejtave linguiste të minoritetit kelt. Kanë ekzistuar shumë bretonë të akuzuar për bashkëpunim me Gjermaninë, akuzë e cila shumë lehtë ka mundur t'i diskreditojë lëvizjet bretonike, parimet dhe aspiratat e tyre. Janë arrestuar qindra e qindra njerëz. Mendoj se më shumë njerëz ka pasur nëpër burgje në Francë menjëherë pas Luftës sesa gjatë saj. Kjo është periudhë shumë e vështirë e hakmarrjes dhe "instant drejtësisë". Janë nevojitur vite të tëra që të rimëkëmbemi nga kjo. Kështu, babai im pasi që ka kaluar një vit në burg pa gjykim (është gjykuar në mungesë), ka ikur në egzil. Kemi shkuar në Uells, meqë partia e atjeshme nacionaliste e dinte për dënimin e bretonëve dhe i pranonte ata dhe të gjithë pakicat e tjera. Pastaj u transferuam në Irlandë. Rasti i babait tim ishte i pari që arriti para gjykatës pas Luftës, pothuajse pesë vjet pas përfundimit të saj. Akuzat kundër tij janë shpallur si të pabaza dhe ai është liruar tërësisht. Deri në atë kohë ne e kishim organizuar jetën tonë në Irlandë. Babai im përgjithmonë i mbajti parimet e tij, si dhe angazhimin e tij për të drejtat e minoriteteve. Tani ka njëqind vjet. Ka shkruar shumë libra, pjesa më e madhe e të cilëve janë libra universitarë për të drejtat e pakicave etnike në Bashkimin Evropian. Ai krijoi lidhje shumë të fuqishme me komunitetet pakicë në Zvicër, Itali, Austri... Kjo ishte pjesë shumë e madhe e jetëve tona. Nëna ime thotë se kur është martuar me të, njëkohësisht është martuar edhe me kauzën e tij politike. Ajo, gjithashtu është gjallë dhe ka 93 vjet. Supozoj se ajo që i ka mbajtur kaq gjatë në jetë është aktiviteti i tyre fizik dhe mental, por edhe përkushtimi i tyre ndaj parimeve dhe vlerave të tyre, të cilat i kanë rrënjësuar edhe te ne.

Unë jam interesuar gjithmonë për marrëdhëniet dhe integritet evropiane. E themeluan asociacionin e parë irlandez të studentëve në Dublin, ndërsa kam qenë edhe nënkryetar i Federalistëve të Rinj Evropianë për disa vite. Kam qenë shumë aktiv, ajo ishte periudhë e diktaturës në Portugali, Spanjë dhe Greqi dhe ne zhvilluam fushata aktive. Gjithashtu kam qenë edhe në Amnesti Interneshënël, kam shkruar letra për lirimin e të burgosurve politikë. E gjithë kjo lë shenjë në jetën e një njeriu, kurse unë gjithmonë i kisha për zemër çështjet nga sfera e të drejtave të njeriut, supozoj, edhe për shkak të asaj përvoj nga fëmijëria.

ZGJIDHJE: A mund të na tregoni shembuj dhe përvoja nga Sllovenia, si vendi më i afërt me Maqedoninë, në pikëpamje të së kaluarës së përbashkët prej gjysmë shekulli në federatë. A ekziston diçka që Maqedonia duhet ta mësojë nga Sllovenia ose nga ndonjë vend tjetër, përveç shembujve interesantë që i përmendët më parë nga pjesa tjetër e botës?

Ervan Fuere: Një nga faktorët që mundësoi që inkuadrimi i Sllovenisë në BE të jetë kaq i suksesshëm, ishte personaliteti dhe metodat e kryenegociatorit. Ai themeloi ekip bazë

negocues, në të cilin kishte përfaqësues nga qeveria, personel teknik, parti politike, organizata nga shoqëria civile, nga bashkësia e biznesit dhe mediat. Kështu që gjithmonë kur Sllovenia shkonte në negociata në Bruksel ose në ndonjë vend tjetër, njerëzit e dinin se ato që prezentohen janë me të vërtetë pikëpamjet e vërteta e të gjitha fuqive politike dhe faktorëve të kyçur shoqërorë. Kjo do të thoshte se zëri i vendit ishte shumë i fuqishëm dhe shumë efikas. Nëse keni situatë kur negociatori vepron në emër të vendit, i cili është tërësisht i ndarë, ku nuk ekziston interaksioni dhe nuk ka kyçje të të gjithëve në procesin negocues, atëherë ajo e dobëson zërin e atij vendi.

Gjithsesi, çmuj se Maqedonia duhet të marrë shembull nga Sllovenia, sidomos në pikëpamje të zhvillimit të bisedimeve. Duhet të silllet plotësisht në mënyrë të ndryshme nga kjo tani, sepse me të vërtetë nuk bëhen përpjekje që të shtrihet dora drejt shoqërisë civile ose kjo bëhet në mënyrë shumë selektive, duke e krijuar këtë ndarje të tmerrshme që e kemi në shoqëri. E ajo e krijon frikën, e cila është tërësisht jonatyrale, që është shumë për të të ardhur keq, sepse ka efekt mbi kontributin që qytetarët mund ta japin në shoqërinë civile dhe organizatat civile, në zhvillimin e shtetit. Sllovenët erdhën këtu, ofruan ndihmë dhe ekspertizë teknike, ofruan gjithçka...

Por, problemi këtu është që nuk ka kontinuitet. Trajnoni disa njerëz, por gjashtë muaj më vonë ata zhduken. Kjo është diçka që me të vërtetë e dobëson kapacitetin e Qeverisë dhe unë druaj se, siç po afrohet koha e zgjedhjeve, qofshin ato të parakohshme ose të rregullta, kjo frikë dhe mbushje e administratës publike me ushtarë partiakë vetëm do të rritet, që do të krijojë situatë të tmerrshme. Ky helm që mbillet dhe fruta helmues do të korren në vitet që vijjnë.

ZGJIDHJE: Me fjalë të tjera, niveli i kulturës politike në Maqedoni është akoma shumë i ndryshëm nga ai në Slloveni.

Ervan Fuere: Po, për fat të keq. Mendoj se, edhe pse ekzistojnë disa anëtarë solidë në parlament, organizata solide civile, ndarja dhe polarizimi, si dhe tendenca e qeverisë që t'i ndajë njerëzit në patriotë dhe tradhtarë, janë receta më e keqe për një shtet.

ZGJIDHJE: Receta më e mirë për mossukses.

Ervan Fuere: Gjithsesi.

ZGJIDHJE: Duke folur për Afrikën e Jugut, e përmendët vizionin. Ky është çelësi. A shihni këtu zhvillim të vizionit të përbashkët për shtetin?

Ervan Fuere: Për fat të keq mendoj se pikërisht kjo mungon këtu. Vizioni që e shohim këtu është vizion i çdo partie veç e veç për atë se si të qëndrohet në pushtet. Çdo parti politike ka agjendë të vetën, e ajo nuk është vizion për shtetin si tërësi që

VENDIME Ekzistonin vendime jopërkatese, që të riemërohet aeroporti dhe autostrada dhe si rezultat i kësaj Qeveria humbi gjashtëdhjetë milionë euro para nga Greqia. Të dhurara për ndërtimin e autostradës së njëjtë. Nuk kishte nevojë për këto akte të provokimit, por ato megjithatë janë bërë, e ajo e vështirësoi zgjidhjen finale të problemit



mund të bëjë dallime në procesin e arritjes së qëllimeve të projektuara të shtetit, qëllime që e kanë përkrahjen e popullit. Të gjithë qytetarët e Maqedonisë – e ata janë pasuria më e madhe që e ka Maqedonia – aq shumë e përkrahin idenë për Bashkimin Evropian. Që të vihet deri tek ai moment, duhet të ekzistojë vizion që do t'i reflektojë interesat e të gjithë sektorëve shoqërorë dhe të gjithë qytetarëve.



Këtu e keni këtë pushtet shtypës i cili e reflekton qëndrimin: ndarjen e presë mes ushtarëve partiakë dhe miqve, e nuk merret me atë se si ai pushtet t'u shërbejë të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga prirja e tyre politike. Është shumë shqetësuese kur do të vëreni që, në nivel komunash, që janë drejtuar nga kryetarë komunash të opozitës, ekziston një problem i madh në shprehjen e nevojave të tyre, vetëm për shkak se opozita është në pushtet. Kjo nuk është e drejtë.

PUSHTETI SHTYPËS: Këtu e keni këtë pushtet shtypës i cili e reflekton qëndrimin: ndarjen e presë mes ushtarëve partiakë dhe miqve, e nuk merret me atë se si ai pushtet t'u shërbejë të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga prirja e tyre politike.

Vendimet që merren në shpërndarjen e mjeteve financiare nëpër rajone duhet të jenë shumë më transparente dhe duhet të bazohen në kriterë objektive.

Kjo ishte një nga pikat të përfaqësuara në Raportin për përparim të shtetit – theksim i rëndësisë së procesit të decentralizimit. Përgjigjja e shkurtër e pyetjes juaj do të ishte – ju nevojiten njerëz me vizion afatgjatë për këtë shtet.

ZGJIDHJE: Është diskutuar mjaft për sjelljen e disa politikanëve ndaj punës dhe personalitetit Tuaj. Si i vlerësoni sulmet personale ndaj Juve? A është kjo pasojë e mungesës së kulturës politike apo edukimit elementar? Apo e të dyjave?

Ervan Fuere: Kam frikë se është rezultat i të dyjave nga pak. Përsëri do të them, këto janë veprime që e minojnë imazhin e shtetit dhe tregojnë moskuptim të plotë për atë se si funksionon BE-ja. Efekti që, hamendësoj se ata synonin ta arrin, ishte që të krijohet përshtypje se unë kam vepruar kokë në vete, duke dhënë qëndrime të miat personale, ndërsa në të vërtetë gjithçka që unë bëj këtu është në emër të BE-së. Unë vetëm e transmetoj mesazhin. Por, megjithatë, në njëfarë mënyre ata duan të përmbysin gjithçka që unë kam thënë dhe të bëjnë që kjo të ngjajë në qëndrime të miat personale. Mendoj se përvoja më shokuese ishte në Parlamentin Evropian, ku anëtar i Parlamentit, z. (Vlatko) Gjorçev, foli në një mënyrë, e cila ishte shokuese për të gjithë anëtarët e tjerë të Parlamentit. Ata nuk mund të besonin se kjo po ndodh. Njëkohësisht, kjo për ata ishte demonstrim i asaj se çka po ndodh këtu dhe demonstrim i mungesës së kulturës dhe vlerave elementare njerëzore, do të thosha. Është shumë për të të ardhur keq, duke pasur parasysh se ai vjen nga një parti që promovon vlera krishtere, e nuk pash asgjë krishtere në atë që ai e bëri, fare. Por, jam i sigurt se, siç thotë Mandela gjithmonë, në çdo individ duhet të ketë diçka të mirë, diku në të, por ajo duhet gjetur.

ZGJIDHJE: Megjithatë, a mendoni se në mandatin Tuaj këtu mund të bënit diçka më mirë dhe a mendoni se Bashkimi Evropian ka njëfarë përgjegjësie nivelin e ulët të kulturës politike dhe kapacitetin e dobët politik të vendit?

Ervan Fuere: Jo, nuk besoj në atë. Ne tentuam, ishim shumë konzistentë në këto tentativa që të zbatohet ajo që besonim se duhet bërë. Por, për fat të keq, pala tjetër e instancave të kyçura nuk donte t'i pranojë këto rekomandime dhe këshilla, edhe pse ato janë përsëritur shumë, shumë herë. Po, ndjej keqardhje për faktin se gjithë këto vlera për të cilat flasim, ndonjëherë janë tërësisht të harruara dhe se dialogu politik shumë shpesh ekziston vetëm si formë. Shpesh duket se përkushtimi për reformat e BE-së shprehet vetëm për shkak se Bashkimi Evropian kështu thotë, e jo pse ajo është e mirë për shtetin. Madje edhe kryeministri u citua në deklaratën e tij të paradokohshme, ku u kritikua se është më i afërt me bllokun lindor sesa me BE-në, e hodhi poshtë këtë, duke thënë se nëse me të vërtetë jemi më të afërt me bllokun lindor, atëherë nuk do të shpenzonim kaq shumë kohë në zbatimin e reformave të sëmura të BE-së. Kjo për mua ishte me të vërtetë shokuese, sepse mbi të gjitha këto janë reforma që janë të domosdoshme për shtetin, madje edhe të mos jetë e implikuar BE-ja. Këto janë reforma që janë provuar në vendet tjera, të cilat iu bashkangjitën BE-së në vitin 2004. Këto janë reforma në administratën publike, gjyqësinë, me rëndësi vitale në sigurimin se interesat e qytetarëve do të respektohen dhe do të njihen tërësisht.

Pikërisht në këtë kuptim, mund të them se marrim shumë ankesa nga qytetarët. Ne u përgjigjemi të gjithave, madje edhe rasteve individuale, kur, për fat të keq, nuk mund të intervenojmë. Unë besoj se qytetarët na drejtohen neve për shkak se ne jemi zgjedhja e fundit. Ky është tregues simptomatik për mosfunksionimin e sistemit juridik, për administratën jofunksionale, kur në kërkesat e tyre deri te Qeveria, deri te ndonjë ministër ose deputet, ata nuk marrin përgjigje. Ky është mospjesëmarrje në një qeverie në përmbushjen e aspiratave të qytetarëve dhe në zgjidhjen e problemeve që këtu janë evidente. Por, megjithatë, unë jam shumë krenar për faktin se arritëm të mbajmë kontinuitet në qasjen tonë. Unë këtu kam ekip të përkushtuar që punon pandërprerë. Jam krenar edhe për resurset financiare që i kemi investuar këtu. Grantet janë deri në njëqind milionë euro në vit, që është shumë mjaft e madhe.





Unë mendoj se qytetarët në mbarë vendin vërtet e vlerësojnë këtë, sepse kur udhëtojnë nëpër vend, gjithmonë më kënaqin reagimet e qytetarëve në të gjitha bashkësitë, madje edhe në vendet më të largëta. Kjo për mua është një ndjenjë që më ngroh zemrën dhe këtë e ndaj me personelin tim.

ZGJIDHJE: Si e vlerësoni efektin e kulturës së ulët politike dhe dialogut të dobët politik, mbi sundimin e së drejtës dhe zhvillimin demokratik, veçanërisht në pikëpamje të respektimit të të drejtave të njeriut dhe respektit ndaj pakicave, konkretisht në fushën e diskriminimit, gjegjësisht përpjekjeve për anti-diskriminim. Ku është ekuilibri mes dy fushave, kulturës politike dhe dialogut nga njëra anë dhe demokracisë dhe sundimit të së drejtës nga ana tjetër? Ku duhet të fillojmë? Çka duhet të bëjmë?

Ervan Fuere: Potencova në fillim se për përkufizimin e kulturës politike është shumë me rëndësi nëse ato të drejta respektohen dhe mënyra në të cilën reagon shoqëria ndaj të gjitha këtyre problemeve, të ndërlidhura me diskriminimin e të tjera. Gjithsesi, qytetarët marrin pikënisje fillestare nga të përzgjedhurit e tyre, por derisa përfaqësuesit e zgjedhur të Qeverisë për momentin promovojnë politika të cilat de fakto i ashpërsojnë paragjykimet, atëherë kjo fare nuk është mirë. Një shembull për këtë është debati rreth ligjit për antidiskriminim, në të cilin BE-ja ka qenë thellë e involvuar. Ne dërguam rekomandime, komisarit dërgoi letër deri te kryeministri, duke e theksuar rëndësinë e një ligji gjithëpërfshirës që do të krijonte atmosferë mjaft pozitive dhe do të ndihmonte në eliminimin e këtyre paragjykimëve. Për fat të keq, ai debat, për shkak të qëndrimit të disa anëtarëve të Parlamentit të cilët janë në pushtet, ishte debat i përçarjes dhe i përforcoi paragjykimet e njëjta në vend që t'i zbusë.

Kështu që tani kemi debat të krisur për martesën mes gjinisë së njëjtë, thuajse kemi radhë të njerëzve në pritje që. Kjo aspak nuk është tema, por për fat të keq, meqë është ngritur në fokusin e opinionit, u keqpërdor. Ngjashëm sikur me vëmendjen kushtuar çështjes së abortit, që është çështje shumë e ndjeshme. Në Irlandë, siç e dini, kjo është gjithmonë temë shumë e vështirë, por të paktën ekzistonte ndjesi më e madhe gjatë përballjes me këtë çështje, sesa që e kemi këtu. Ka manipulim nga grupe të caktuara, të cilët tentojnë të imponojnë agjendë, e cila nuk është reflektim i demokracisë, i sho-

qërisë së hapur, por është ngritje në sipërfaqe e paragjytimeve të mbuluara, duke u dhënë formë të plotë, që është plotësisht e panevojshme. Njeriu mund të ballafaqohet me paragjykim ose paragjykim të mbuluar me dialog, përmes diskutimit të hapur. Për fat të keq, kjo mungon këtu. Në atë plan, mendoj se atë që CIVIL e ka bërë, çka kanë bërë organizatat tjera nga sektori civil është me rëndësi të madhe, sepse e ngrit nivelin e vetëdijes për rreziqet nga këto paragjytime dhe krijon tolerancë më të madhe në shoqëri. Shpresoj se gradualisht kjo do të bëhet njëfarë standardi. Zëri i shoqërisë civile është me rëndësi vitale në këto fusha.

ZGJIDHJE: Për problemin kryesor të Maqedonisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, kontestin me Greqinë. Cili është niveli i kulturës politike dhe pjekurisë politike të subjekteve në vendin tonë (i pushtetit, partitve, sektorit civil, intelektualëve etj) kur bëhet fjalë për emrin, dialogun, mënyrën në të cilën e zhvillon dialogun me Greqinë dhe veçanërisht për mënyrën në të cilën Maqedonia i trajton sugjerimet e bashkësisë ndërkombëtare? Çka flet kjo për kulturën tonë?

Ervan Fuere: Sërisht do të thosha se mbisundon atmosfera e ndarjes në situatë kur do të duhej të ekzistojë përpjekje për promovimin e konsensusit për këtë çështje dhe kur e krahasoj atmosferën tani, rreth kësaj çështjeje, me atmosferën kur unë arrita, ekzistojnë dallime të mëdha. Tani ajo është shumë më emocionale, më shumë konfrontuese. Do të thosha që gabimisht fokusohet në identitetin. Identiteti, gjithsesi është brengë



legjitime për çdo qytetar, por ai, siç është thënë shumë herë, nuk është diçka për çka bisedohet, ndërsa problemi për emrin është problem për emërtimin e shtetit dhe sado qoftë kjo jologjike, për atë domosdo duhet të ketë zgjidhje. Kjo është krejtësisht e qartë për BE-në. Ne jemi inkurajuar nga takimet e dy kryeministrave, por tani duhet të gjendet ndonjë zgjidhje.

Ekzistonte, sipas meje, shpërdorim i çështjes së identitetit për motive të pastra politike vendore të kësaj qeverie. Kjo vetëm e vështirëson zgjidhjen. Nuk ekziston përgatitje përkatëse e qytetarëve, ndërsa ekziston edhe ky insistim në historinë antike, që ndoshta mund edhe ta reflektojë historinë, e saktë, por pse tani? Pse kjo bëhet tani dhe pse provokohet në rrethana të këtilla? Siç e dini, kanë ekzistuar vendime joadekuante, që të rrimërohet aeroporti dhe autostrada dhe si rezultat i kësaj Qeveria humbi gjashtëdhjetë milionë euro nga Greqia, para të dhuruara për ndërtimin pikërisht të kësaj autostrade. Nuk ishte nevoja për akte të këtilla të provokimit, por ato megjithatë u bënë, e kjo e vështirësoi zgjidhjen finale të problemit. Unë gjithashtu kam deklaruar



ar se BE-ja nuk merret me ndryshim të identitetit të njerëzve. Identiteti është diçka e shenjtë për çdo individ, për çdo komb dhe nuk është diçka për të cilën mund të debatoni mbi një fletë. Për mua, maqedonasit do të mbeten maqedonas, gjuha do të mbetet maqedonishte, shqipe etj. Kjo nuk guxon të vihet në pikëpyetje, por emri është guri pengues.

Për shkak të taktikës së kësaj qeverie, për fat të keq, duhet të jem plotësisht i sigurtë, Maqedonia humbi shumë miq në BE, të cilët kanë qenë shumë të interesuar që të ndihmojnë dhe të ushtrojnë presion më të madh mbi Greqinë, për këtë jam i sigurt. Por për shkak të këtyre veprimeve në sërë, për shkak të vendosjes së të gjitha këtyre statujave edhe krahas papunësisë së madhe dhe njerëzve që jetojnë në varfëri, ata miq thanë: ku është qëllimi? Më nuk ka fuqi për presion të rritur mbi Greqinë. Besoj se kjo akoma më shumë e ndërlikoi vendimin final. Duhet të ketë përgatitje të opinionit publik. Edhe një herë do ta marr si shembull shtetin tim, Republikën e Irlandës. Ju fola sa vendime të dhimbshme kemi pasur, por qeveria atje e përgatiti mendimin publik paraprakisht, e ajo ishte e rëndësishme për të ardhmen afatgjate të shtetit, për rajonin, për prosperitetin, investimet etj. dhe propozimi u pranua nga të gjithë qytetarët. Një vit më vonë, qeveria e njëjtë u zgjodh sërish.

ZGJIDHJE: Nuk i shtruum të gjitha pyetjet dhe temat, të paktën kur bëhet fjalë për një personalitet siç jeni Ju. Për fund, a keni ndonjë opinion ose mesazh tuajin?

Ervan Fuere: Ekzistojnë aq shumë mendime që do t'i mbaj me vete kur do ta braktis Maqedoninë, por ajo që me siguri do ta kultivoj është ngrrohtësia dhe miqësia e njerëzve. Madje edhe në viset më të largëta, ju presin krahehapur. Jam kënaqur edhe me përkushtimin ndaj traditave lokale. Në shoqëritë perëndimore humbin një numër të madh të këtyre traditave, por këtu keni një përkushtim të veçantë ndaj tyre, madje

edhe te gjeneratat e reja. Kjo është pjesë e indit krijues të shoqërisë këtu, si bartëse e vlerave, që do të thoshte edhe poeti irlandez, novelisti Shejmas Hini, “bartësit e vlerave i reflektojnë traditat morale dhe kulturore të shtetit”.

Gjithashtu, e çmoj shumë frymën që mbizotëron këtu, frymën shumë të fuqishme, njerëzit me të vërtetë duan të lëvizin përpara, duan t’i kryejnë punët, por gjithsesi janë të frustruar kur nuk shohin reagim nga liderët e zgjedhur politikë. Duhet të ekzistojë interaksion më i madh mes qytetarëve dhe udhëheqësve të zgjedhur. Personalisht shpresoj se këmbëngulja në atë përkushtim, ngrohtësia dhe miqësia do të ruhen tek njerëzit. Gjithmonë e kam çmuar shumë këtë mikpritje të shkëlqyer që më është dhënë në mbarë vendin, nëse kanë qenë gjatë ngjites në Vodno ose kur kam kërcyer në Liqenin e Ohrit ose kudo qoftë në një vend tjetër, gjithmonë ka qenë e shkëlqyer, ka qenë me të vërtetë privilegj që këto vite të jem këtu.

ZGJIDHJE: Na lejoni të bëjmë edhe një pyetje të fundit, pikërisht si ndërlidhje ndaj kësaj: Sa klone Tuaja ekzistojnë? Shumë njerëz thonë se nuk është e mundur të jeni në gjithë ato vende në kohë të njëjtë. A ka vend që nuk e keni vizituar në shtetin tonë?

Ervan Fuere: (qesh) Ju falemnderit, në të vërtetë vëreja një njeri të veshur si unë në karnavalin në Vevçan. Unë e fitoj energjinë nga njerëzit dhe nga njerëzit e ekipit tim, nga personeli im dhe ndjehem përfundimisht i motivuar kur takoj qytetarë nga bota. Për mua kjo është pjesë e punës, të cilën duhet ta bëjmë. Pulsin e popullit të Maqedonisë nuk do ta ndjeni në Shkup. Këtu nuk mund të hyni në zemrën dhe shpirtin. Mënyra e vetme që ta bëjmë këtë është që të dalim, të udhëtojmë, të takohemi me poetë, shkrimtarë dhe të gjithë ata që i prezantojnë gjithë këto vlera, muzicentët – këtu ka muzicentë të shkëlqyer, të cilët pata privilegjin t’i njoftoj. Gjithë këto janë punë të cilat kuptohet që do t’i kujtoj dhe do t’i kultivoj.

